RAPORTI PËRFUNDIMTAR

"MBI PËRPUTHSHMËRINË NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË THESARIT"

Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018

Tiranë, Tetor 2019

Nr. PËRMBAJTJA

I. HYRJA
Objektivat dhe qëllimi.
Identifikimi i çështjes
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese
Përgjegjësitë e audituesve
Kriteret e vlerësimit
Standardet e auditimit

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. Mbi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit

B. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

V. DOKUMENTE SHOQËRUESE

ANEKSE

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 240/1, datë 05.06.2019 miratuar nga Kryetari i KLSH, i ndryshuar me njoftimin nr. Prot.238/2 dt.14.08.2019 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për periudhën nga 01.01.2018 deri ne 31.12.2018.

Titulli: Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Marrësi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

Objektivat dhe qëllimi: Në zbatim të programit të auditimit objektivi kryesor është dhënia e një opinioni mbi përputhshmërinë e aktivitetit të sistemit të thesarit me ligjin e buxhetit të shtetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në funksion të realizimit të misionit dhe objektivit të kësaj drejtorie, si dhe bazueshmërinë me kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi nëse aktiviteti dhe informacionet e raportuara në zbatim të buxhetit të shtetit janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit.

Identifikimi i çështjes: Ligji përcakton Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit si përgjegjëse për:

-Menaxhimi i likuiditetit të qeverisjes së përgjithshme;

-Realizimi i kryerjes së pagesave në mënyrë të centralizuar nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë;

-Regjistrimi, kontrolli, kontabilizimi dhe përpunimi i informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme dhe mbi këtë bazë, gjenerimi i raporteve të ndryshme;

-Administrimi funksional i Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe raportimit financiar.

Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe menaxhimin e sistemit buxhetor. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Kriteret e vlerësimit: Për kryerjen e këtij auditmi, në lidhje me dhënien e opinionit për përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, kriteret e vlerësimit bazohen në procedurat e përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave për buxhetin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, etj.

Standardet e auditimit: Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren "Për Procedurat e Auditimit" miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, referenca të tjera ligjore dhe në referencë të Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Auditimi është kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të SAI mbi auditimin e përputhshmërisë. ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në ç'masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e

kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.” ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm: Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, u krye në kuadër të planifikimit fillestar të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar.
Objekti i këtij auditimi është dhënia e një opinioni mbi përputhshmërinë e aktivitetit të sistemit të thesarit me ligjin e buxhetit të shtetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në funksion të realizimit të misionit dhe objektivit të kësaj drejtorie, si dhe bazueshmërinë me kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me aktivitetin dhe raportimin për efekt të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe buxhetit. Gjithashtu, vlerësimi nëse aktiviteti dhe informacionet e raportuara në zbatim të buxhetit të shtetit janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit.
Çështjet kryesore të Auditimit: Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat në gjykimin tonë, kanë rezultuar më të rëndësishmet në bazë të vlerësimit të risqeve të identifikuara në fazën e parë të auditimit si dhe çështjeve të dala gjatë auditimit mbi aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Çështjet kryesore në auditimin e aktivitetit të kësaj Drejtorie për vitin 2017, paraqiten si më poshtë:

1. Planifikimi dhe identifikimi i riskut;

2. Strategjia dhe vlerësimi i riskut.

2.1. Kuptimi i proceseve të rrjedhjes së punës dhe kontrollet bazë të aplikuara.
2.2. Përcaktimi i kontrolleve kryesore për tu testuar dhe vlerësimi paraprak i kombinuar riskut (i rishikuar përgjatë gjithë punës audituese).
2.4. Përcaktimi i testeve të kontrolleve dhe testeve thelbësore të auditimit që do të kryhen në bazë risku.

3. Ekzekutimi i procedurave të testimit;

3.1.Testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
1.2. Saktësia e veprimeve mbyllëse për raportimin ne treguesit fiskale dhe paraqitja në pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit.
3.3. Ekzekutimi i testeve thelbësore.

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.

III . PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Nga auditimi i sistemit të thesarit, ashtu si një vit më parë, janë konstatuar thyrje të sistemeve të kontrollit përgjatë gjitha hallkave, të vendosura për mirëmenaxhimin e financave publike. Kështu KLSH ka konstatuar problematika në lidhje me çeljet buxhetore dhe rishikimet e planit buxhetor në SIFQ për vitin buxhetor 2018 ku **procesi i rregjistrimit të celjeve buxhetore pas informimit të Nëpunësve autorizues të njësive ekonomike nga NPA, është një proces i gjatë 3-mujor, në pritje të detajimeve nga institucionet buxhetore duke u bëhrë pengesë për fillimin në kohë të procedurave të prokurimit në APP nga institucionet**. Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) është një shëmbull tipik i vonesave në detajime dhe celje për projekte. Një tjetër fenomen i konstatuar është dhe numri i lartë i rishikimeve buxhetore përgjatë gjithë vitit 2018 me: 2065 rregjistrime (fletë kontabël) nga 1006 njësi ekonomike dhe 1179 projekte për investime kryesisht nga njësitë e qeverisjes vendore por edhe nga të gjitha Ministritë e linjës. Sipas Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt.06.12.2012, pika 79 e tij, numri i lartë i rishikimeve mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.

Për sa i përket rishikimeve buxhetore në SIFQ nuk identifikohen projektet e miratuara me Aktin Normativ nr.1, duke i bërë ato thjesht një përmbledhje dhe legjitimim i ndryshimeve tashmë të ndodhura gjatë **periudhës Prill- 26 Korrik 2018 gjithsej: 510[1] projekte për investime me një shumë fondi të rishpërndarë prej 14.3 miliardë lekë.** Nisur nga shpërndarja kohore evidentohen rishikime që shtrihen përgjatë gjithë periudhës Mars- Dhjetor, me një numër të lartë rishikimesh vecanërisht në 3-mujorin e II të vitit, pra para Aktit Normativ nr.1 i datës 26.07.2018. Përsa i përket Aktit Normativ nr.2 i datës 19.12.2018, në SIFQ rezultojnë 196 rregjistrime të kryera nga data 20.12.2018 deri 31.01.2019 me datë efektive vitin 2018. Nga këto rregjistrime vecojmë 74 rialokime për projekte të cilat financohen për herë të parë në shumën 1.9 miliardë lekë edhe pse tashmë në pamundësi realizimi brenda vitit 2018. Sipas nenit 43 "Detajimi i fondeve buxhetore" Nëpunësit autorizues detajojnë fondet sipas prioriteve të përcaktuara për tu mbajtur parasysh në planifikim.

Nga auditimi konstatohen celje **fillestare dhe rishpërndarje fondesh me Akte Normative për të mbuluar detyrime të pabuxhetuara të krijuara rishtaz dhe të mbartura nga vitet e kaluara, në total në shumën 19.8 miliard lekë nga të cilat 13.7 miliard lekë për shpenzime për investime ose rreth 26% e financimit të brendshëm.** Sipas institucioneve ato me detyrime më të larta janë njësitë e qeverisjes vendore me 9 miliard lekë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 4.45 miliard lekë dhe Fondi Zhvillimit Shqiptar me 3.45 miliard lekë. Detajuar sipas projekteve, rezulton se nga 1207 celje për projekte për investime për 84 prej tyre me vlerë 1.6 miliard lekë celja është bërë vetëm për të kryer pagesat e faturave të prapambetura pasi celja buxhetore është ekzaktësisht e barabartë me vlerën e faturës (ve) të prapambetura si psh 4 projekte të Bashkisë Tiranë me vlerë 349.3 milionë lekë; 12 projekte të ARRSH me vlerë 229.46 milion lekë. Gjithashtu, nga tabela e investimeve rezultojnë 129 projekte për investime të 67 njësive ekonomike, me realizim zero % pra projektet e planifikuara nuk kanë filluar zbatimin dhe ndërkohë fondet e tyre prej rreth 522 milionë lekë jo vetëm që nuk janë përdorur por as nuk janë rialokuar në projekte të tjera në nevojë për fonde, qëllim ky dhe i Akteve normative.

Nga auditimi u konstatua mosrregjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës dhe PBA në afërsisht 80% të rasteve në shkelje të Udhëzimit nr.2 datë 19.01.2018, pika 24 sipas të cilit kontratat për investime duhet të regjistrohet për vlerën e tyre të plotë dhe shoqëruar me planin e pagesave sipas PBA. Aktualisht ky kontroll nuk ushtrohet dhe informacioni për shpërndarjen në vite të kontratës plotësohet në mënyrë rastësore dhe jo i detyrueshëm.

---

1 Tabela "Rishikimet2018" nga SIFQ, vetëm rregjistrimet me shtesë fondi për projektet me financim të brendshëm (MXX)

KLSH konstaton se janë marrja angazhimeve pa fonde buxhetore disponibël dhe/ose për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA të konstatuar në 11 projekte me vlerë totale fondi buxhetor mbi 14.6 miliard lekë në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin Buxhetor të RSH, neni 51, dhe Udhëzimin plotësues nr.2 datë 19.01.2019 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018", pika f) e tij: "Projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së 2018-2020, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qëndrore". Më konkretisht këto raste janë konstatuar në këto institucione: -Autoriteti Rrugor Shqiptar në 5 projekte me një angazhim prej 13.6 miliard lekë; -Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime konstatuar në 1 projekt "Rrjeti i brendshem i ujësjellesit Ersekë", me vlerë 0.44 miliard lekë. -Agjensia Kombëtare Shërbimit Informatik (AKSHI) konstatuar në 5 projekte me një angazhim prej 0.76 miliard lekë përkatësisht.

Në SIFQ rezultojnë **vetëm 1120 urdhër-prokurime të rregjistruara nga mbi 30 mijë kontrata të rregjistruara** gjatë vitit 2018 në përfundim të procedurave të prokurimit jo në përputhje me Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 4, pika 1 dhe 2 e tij dhe me Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, and pika 15.1 "Faza para angazhimit" sipas të cilit institucionet buxhetore të cilat operojnë direkt në SIFQ, rregjistrojnë në sistem cdo vlerë prokurimi të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të rregjistrimit në SIFQ dhe vulën e Thesarit, procedojnë me dërgimin në APP. **Nga 7 subjektet për të cilat u kërkua rregjistri i prokurimit për vitin 2018, rezultoi se katër prej tyre nuk kanë një numër dhe datë rregjistri në Degën e Thesarit konkretisht: ARRSH, MFE, QSUT, MIE**. Gjithashtu, rregjistrime e Urdhër-prokurimeve janë kryer vetëm nga institucionet që kanë akses të plotë në SIFQ. Për urdhër-prokurimet e institucioneve pa akses të plotë në SIFQ nuk ekziston mundësia (fusha) për rregjistrimin e këtij dokumenti në SIFQ dhe rrjedhimisht nuk ka informacion nëse çdo prokurim ka filluar pasi janë konfirmuar fondet disponibël në Thesar. Pra jemi në të njëjtat kushte si gjatë vitit 2017 ku në SIFQ nuk ka informacion të plotë mbi të gjithë urdhër-prokurimet e paraqitura nga institucionet publike. Nga analiza e 1120 urdhër-prokurimeve që u gjenden në SIFQ, konstatojmë se janë rregjistruar dhe urdhër- prokurime për kontrata tashmë të lidhura në vitet 2009- 2017, duke humbur kështu komplet kuptimi i rregjistrimit të një urdhër-prokurimi si hapi i parë për të siguruar disponibilitetin dhe bllokimin e fondeve para se njësia të shkojë në APP, në total 469 UP me vlerë 16.1 miliard lekë.

Nga auditimi janë konstatuar diferenca **të theksuara në numrin e urdhër –prokurimeve të rregjistruara në SIFQ kundrejt numrit të shpalljeve për procedura prokurimi në APP si dhe midis numrit të kontratave** të nënshkruara të raportuara. Rastet më problematike janë në lidhje me të dhënat e ARRSH, Bashkisë Tiranë dhe AKSHI. Sipas SIFQ, 55 kontrata të lidhura në muajt Nëntor- Dhjetor 2018 nga MIE, FZHR, MFE, Ministri e Arsimit, Ministria E Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë etj nuk listohen në të dhënat e dërguara nga APP në total 1.07 miliard lekë. Gjithashtu, 3 kontratat e lidhura për projektin e rehabilitimit të Unazës së re nuk shfaqen në APP me një vlerë totale prej 5.98 miliardë lekë. Për Ministrinë e Shëndetësisë evidentohen 5 kontrata me vlerë totale 446 milionë lekë të lidhura nga njësitë e saj të varësisë. Nga të dhënat e APP rezultojnë 51 procedura prokurimi me kontraktor të qëndërzuar AKSHI-n sipas VKM nr.673 dt.22.11.2017, i ndryshuar me një fond të prokuruar prej 4.9 miliard lekë sipas të cilit AKSHI ka vepruar si autoritet kontraktor ndërkohë që fondet dhe rrjedhimisht rregjistrimet në SIFQ janë bërë në emër të përfituesit. Në këto kushte të dhënat midis APP dhe SIFQ bëhen të pakrahasueshme. Nga verifikimi i rasteve të vecanta u konstatuan edhe raste të mos rregjistrimit në SIFQ të kontratave të prokuruara nga AKSHI si në rastin e: projekti "Plotësimi i sistemeve të leje-drejtimit" me fond të prokuruar 156.2 milion lekë i pa rregjistruar në SIFQ. Një tjetër praktikë e ngjashme po krijohet me Agjensinë e Blerjeve të Përqëndruara e krijuar me vendimin nr. 81 dt.14.02.2018 e cila është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit për automjete dhe shërbime që e kalojnë vlerën limit për blerje të vogla, për llogari të Kryeministrisë,

ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë. Në të dy rastet autoriteti kontraktor në APP është i ndryshëm nga ai i rregjistruar në SIFQ si institucioni përfitues investimit.
Bashkia Tiranë shfaq problematika në saktësisë në rregjistrim, referuar datës së kontratës fizike. Për disa projekte kontratat e të cilave listohen në tabelën e PO-ve për vitin 2018 janë realisht kontrata të lidhura në vitin 2017 dhe disa prej tyre mund të jenë lidhur si kontrata në vitin 2018 por procedurat e prokurimit kanë filluar në vitin 2017.
Nga **auditimi i të dhënave të kontratave dhe krahasimi i tyre me të dhënat e dërguara nga APP konstatohen raste të kontratave të lidhura me shuma më të larta se fondet e miratuara, pra fondi limit pa TVSH sipas shpalljeve është në vlera më të larta se fondi disponibël i rregjistruar në SIFQ, konkretisht në me një një diferencë të fondit disponibël rreth 473 milion lekë:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)- 2 projekte me një vlerë prej 107.8 milion lekë mbi fondet buxhetore disponibël; Ministria e Shëndetësisë- 1 projekt me vlerë 173.84 milion lekë mbi fondet buxhetore disponibël; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)- 2 projekte në vlerën 58.62 milionë lekë mbi fondet buxhetore disponibël; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)- 2 projekte në total angazhimet e ndërmarra pa fonde buxhetore arrijnë vlerën 10.8 milion lekë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)- në 9 projekte me një vlerë totale prej 222.2 milionë lekë mbi fondet buxhetore disponibël; Ministria e Mbrojtjes- 2 projekte me vlerë 38 milion lekë mbi fondin disponibël.
Fenomeni i rregjistrimit me vonesë i kontratave të lidhura nga institucionet qëndrore dhe vendore vazhdon të jetë i përhapur edhe gjatë vitit 2018, ku në 20,264 raste me vlerë rreth 64 miliard lekë ose 64% e të gjithë kontratave të rregjistruara rezultojnë në thyerje të afatit ligjor 5 ditor në kundërshtim me pikën 144 të udhëzimit nr.2, datë 06/02/2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar. Sipas institucioneve me rregjistrimet në shkelje të afatit ligjor 5 ditor vecojmë Bashkitë me 7030 raste me vlerë kontratash 17.6 miliard lekë ose 34.7% e gjithë rasteve të konstatuara, MFE me 1604 raste me vlerë kontratash 4.2 miliard lekë ose 7.9% e totalit, Ministria e Brendshme me 1443 raste me vlerë kontratash 2.5 miliard lekë ose 7.1% e totalit, Ministria e Arsimit me 1033 raste me vlerë kontratash 2.6 miliardë lekë ose 5.1% e totalit, KLGJ me 956 raste me vlerë kontratash 236 milionë lekë ose 4.7% e totalit, etj. Nga njësitë e qeverisjes vendore vecojmë Bashkinë Tiranë me 425 raste vonese, Bashkinë Korcë me 169 raste. Gjithashtu, në këtë listë gjejmë dhe vetë Aparatin e MFE me 44 raste shkelje afati. Nisur dhe nga problematika e konstatuar në auditimin e vitit 2017, rregjistrimi jo në afat i kontratave mbetet një shkak dhe sinjal edhe për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu në 6-mujorin I-rë të vitit 2019 rezultojnë 1,985 kontrata të viteve 2006-2018 të rregjistruara rishtaz nga të cilat 618 kontrata për investime me vlerë 6.5 miliardë lekë. Nga këto 472 raste me vlerë 5.2 miliardë lekë janë kontrata të vitit 2018 rregjistruar në vitin 2019, gjë që tregon se vetë viti 2018 ka "kontribuar" në rritjen e detyrimeve të prapambetura, me shkeljet dhe mungesën e monitorimit të këtyre angazhimeve.
Konstatohen **29 prokurime në vlerë 2.2 miliard lekë të ndërmarra pas datës 15.10.2018 në shkelje të nenit 51 të Ligjit të Buxhetit në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 807**, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore" sipas të cilit mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar. Prokurimet ndërmarra pas datës 15 Tetor 2018 janë kryer nga disa institucione qëndrore dhe vendore si: AKSHI, ARRSH, Bashkia Tiranë.
Gjatë vitit 2018, nga auditimi u konstatua përsëri fenomeni i rregjistrimit të kontratës dhe faturës në të njëjtën ditë ku si rrjedhojë në 151 raste në vlerë rreth 7 miliard lekë rregjistrimi i kontratës është formal dhe vetëm si pjesë e rutinës së rregjistrimit të faturës. Nga shqyrtimi i rasteve të rregjistrimit të kontratave me vonesë vihen re se nga disa njësi kontrata rregjistrohet në të njëjtën datë me urdher shpenzimin për pagesën e faturës se parë si parakusht për rregjistrimin e faturës. Pra kontrata rregjistrohet jo si një procedurë ligjore në përputhje me Udhëzimin por vetëm si një dokumentacion shoqërues i faturës së miratuar për pagesë. Analizuar në korrelacion me problematikat e tjera të konstatuara që në procedurat e prokurimit

dhe celjeve buxhetore, fenomeni i rregjistrimit të kontratës dhe faturës në të njëjtën ditë është një sinjal për kontratat e lidhura në mungesë të fondeve buxhetore disponibël. Për sa i përket institucioneve vecojmë rregjistrimet e kryera nga DPT, FSHZH, KM, AKSHI, Aparati i MEPJ.

Gjatë vitit 2018, konstatohen rregjistrime të pjesshëm të kontratave në total 15 kontrata me vlerë 2 miliardë lekë, kjo me qëllim përputhjen me shumën e fondit të disponueshëm. Nga shqyrtimi i të dhënave të databazës së kontratave, konstatohen gjithashtu edhe raste të rregjistrimit të kontratës më shumë se një herë me vlera të fragmentarizuara për shkak të mungesës në SIFQ të obligimit sipas PBA. Pra jemi në situatën kur kontrata rregjistrohet cdo herë që rregjistrohet një faturë e lidhur me atë kontratë, duke marrë kështu cdo herë një numër të ri rendor PO-je. Nga rastet e konstatuara vecojmë rregjistrime të fragmentarizuara të kontratave të lidhura nga: MFE, Bashkia Tiranë, Bashkia Sarandë, Bashkia Roskovec, FZHR etj. Problematikë shfaqen dhe rregjistrimet e kontratave të inceneratorëve. Kështu është rasti i kontratës së inceneratorit të Elbasanit, e lidhur në vitin 2014 dhe që cdo vit vazhdon të rregjistrohet në mënyrë të copëzuar në vlera të barabarta me fondet në dispozicion të atij viti. Po kështu edhe rasti i inceneratorit të Fierit me kontratë të firmosur më 24.10.2016 është rregjistruar në SIFQ më 19.02.2018 me vlerë 2,2 miliard lekë ndërkohë që faturimet kanë filluar në Janar të vitit 2018. Rastet me lartë janë evidentuar në grupin e investimeve ndërsa në grupin e shpënzimeve operative inceneratori i Tiranës rezulton të jetë një kontratë koncesioni me vlerë materiale, e lidhur në 31.08.2017 që do të faturojë sipas volumit dhe shërbimit për të cilën në sipas SIFQ janë bërë 4 rregjistrime me vlerë totale 834 milion lekë.

Nga auditimi u konstatuan 33,031 raste në total me vlerë 44,3 miliard lekë, të faturave të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor dhe Ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare" neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar 30 ditë për proçedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për proçedurat e miratimit dhe proçesimit të pagesës në degën e thesarit. Konstatohet se ky fenomen është më i përhapur në Institucionet vendore me një numër prej 11,195 fatura në vlerën 18,7 miliard lekë nga të cilat Bashkia Tiranë rezulton me 2112 raste të vonesave në rregjistrim të faturave me vlerë 7.6 miliardë lekë, Bashkia Krujë me 557 raste në vlerë 341 milionë lekë. Ministritë e linjës të gjitha evidentohen me raste të shkeljes së afatit ligjor 30 ditor të dërgimit të faturave në Thesar, ku Ministria e Infrastrukturës rezulton me numrin më të lartë të rasteve për shkak të ARRSH. Midis të tjerave dhe vetë MFE rezulton me 178 raste me vlerë 788 milionë lekë. Nga institucionet e tjera vecojmë: AKSHI me 588 raste me vlerë 1.5 miliard lekë dhe FZHR me 139 raste me vlerë 3.6 miliardë lekë.

Gjithashtu, **u konstatuan 341 raste të faturave të paguara nga Degët e Thesarit jashtë afatit 30 ditor me vlerë 0.465 miliardë lekë** kryesisht nga Dega e Thesarit Tiranë dhe Vlorë, edhe pse duhet theksuar se Dega e Thesarit Tiranë kryen volumin më të madh të veprimeve krahasuar me cdo Degë tjetër Thesari dhe realisht numri i rasteve të pagesave mbi 30 ditë është në rënie. Nga analiza e faturave të ekzekutuara gjatë vitit 2018, konstatohet se janë likuiduar me një urdhër shpenzim disa fatura njëkohësisht në 196 raste në vlerën 1.86 miliard lekë, kur duhet që çdo faturë të regjistrohet në sistem në periudhën përkatëse, në mënyrë që shpenzimi të njihet në periudhën në të cilën ai është kryer dhe lind detyrimi. Ky fenomen konstatohet kryesisht në rregjistrimet e institucioneve: Bashkia Tiranë, Bashkia Maliq, MFE, Ministria e Arsimit, MIE. Kjo praktikë krijon mundësinë e mosidentifikimit të qartë dhe unik të një faturë/detyrimi, kohën kur ka ndodhur shpenzimi dhe nuk lejon monitorim të progresit të realizimit kontratave në mënyrë korrekte. Gjithashtu lidhur me respektimin e procedurave të radhës së prioriteteve të pagesës (FIFO) referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, u testuan 194,462 transaksione të rregjistruara në SIFQ për periudhën Janar 2018 – Janar 2019 me **një vlerë totale 112.2 miliard** lekë. Problematikë u konstatuan ekzekutimet e pagesave të kryera nga Dega e Thesarit Lezhë, si njësia me numrin më të lartë të rasteve të mosrespektimit të rradhës së pagesave. Një tjetër fenomen është ai i pagesave pjesore

si pasojë e mungesës së fondeve disponibël të mjaftueshme për të likujduar faturat me vlerën e tyre totale për punime tashmë të kryera nga kontraktorët i konstatuar në 12 raste me një vlerë rreth 262 milionë lekë ku me paraqitjen e faturës, rregjistrimi është bërë pjesorë dhe rrjedhimisht dhe pagesa me një vlerë të barabartë me fondin disponibël duke përmendur : Aparatin e MFE, AKSHI dhe Bashkia Tiranë të cilat kanë bërë rregjistrimi pjesore duke shkelur parimin kontabilitetit të njohjes së shpenzimeve në momentin kur ndodhin dhe me vlerën e tyre të plotë.
Pavarësisht shkeljeve të përhapura, kërkesave ligjore, dhe rekomandimit të KLSH, me qëllim disiplinimin e menaxhimit të financave publike, nga NPA nuk është marrë asnjë masë administrative e përcaktuar si gjobë në nenin 71 të Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 i ndryshuar, të përllogaritura nga KLSH në të paktën 9.9 miliardë lekë, për shkeljet e ligjit të menaxhimit të sistemit buxhetor dhe akteve nën ligjore të tij si dhe nuk është inciuar asnjë inspektim financiar në zbatim të nenit 69 "Inspektimi financiar" i Ligjit për marrje përsipër e angazhimeve jashtë fondeve të parashikuara në buxhet apo pagesa në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi përbëjnë elemente për fillimin e inspektimit financiar publik. Në bazë të raportimeve të rasteve të konstatura në shkelje të afateve ligjore të dorëzimit të faturave dhe kontratave në Degët e Thesarit, janë dërguar rreth 320 shkresa drejtuar institucioneve përgjegjës, për "tërheqje vëmëndje" të shkeljes së konstatuar duke cituar dhe bazën ligjore të saj, shkresë kjo e firmosur nga NPA. Në asnjë rast nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë për institucionet me raste përsëritje apo me kontrata me vlera të mëdha dhe impakt të konsiderueshëm në raportimin e buxhetit faktit. KLSH konstaton që ka një rritje të numrit të rasteve të raportuara nga degët e thesarit në krahasim me një vit më parë, por nëse marrim në konsideratë me numrin e lartë të shkeljeve të afateve ligjore, ato mbeten ende minimale dhe pa impakt në përmirësimin dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura. Në këtë rast përvec DPTH, struktura e Drejtorisë së Harmonizimit të KBFP ka përgjegjësi për monitorimin e këtyre shkresave në kuadër të raportimit të indikatorëve të performancës financiare. Nëse neni 71, gërma (f) dhe (gj) e Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH', i ndryshuar, do të ishte zbatuar rast pas rasti në masën nga 1 deri në 3 paga mujore (për regjistrimin me vonesë të kontratave) dhe 3 deri 7 paga për moszbatim të afateve të dorëzimit të urdhër-shpenzimit gjobat e përllogaritura vlerësohet të ishin minimalisht rreth 9.9 miliardë lekë.

IV.A GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Mbi Menaxhimin e Likuiditetit

Një nga përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit është dhe menaxhimi i likuiditetit dhe i llogarisë së unifikuar të thesarit nga e Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit. Në kuadrin e menaxhimit të likuiditetit të qeverisë shqiptare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Bankën e Shqipërisë, kanë nënshkruar marrëveshjen kuadër "*Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë*" me nr.prot.716/1 datë 20/01/2015, marrëveshje kjo e përditësuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë me nr.prot. 5633/1 datë 18.12.2017 "*Për një ndryshim në marrëveshjen ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së financave "Mbi instrumentet e ofruar nga Banka e Shqipërisë për menaxhiumin e likuiditeteve të Ministrisë së Financave* " të datës 20.01.2015, e ndryshuar" Në këtë marrëveshje, nga grupi i auditimit, me qëllim analizën e likuiditetit dhe veprimeve të llogarisë së unifikuar të thesarit është analizuar përdorimi i instrumenteve Sëap si një mjet për menaxhimin e likuiditetit të lirë në monedhën EUR . Sipas Marrëveshjes nr.716/1 datë 20.01.2015, në nenin 3 të saj *"Përkufizime",* jepet koncepti i një kontrate Sëap e cila përshkruhet si *"Kontratë Sëap- është një instrument i derivuar ku dy palë bien dakort të shkëmbejnë fondet bazuar në nevojat e ndryshme të secilit. Shkëmbimi i fondeve bëhet sipas kushteve të rëna dakort paraprakisht ku përfshihen kohëzgjatja e kontratës, instrumenti që po shkëmbejnë, mënyra e shlyerjes, etj."* Në vijim, në

nenin 5 të kësaj marrëveshje, në pikën 1, specifikohet qëllimi i përdorimit konkret të këtyre instrumenteve ku citohet *"me qëllim menaxhimin e likuiditetit në valutë dhe flukseve të shërbimit të borxhit të jashtëm, Ministria mund të kërkojë realizimin e kontratave Sëap me bankën."* Për të specifikuar mënyrën e zbatimit të kontratës Sëap, pika 2 ë nenit 5 të marrëveshjes në të cilën citohet se *"Në bazë të kontratës Sëap, Ministria ofron shitjen e valutës dhe blerjen e kundravleftës në lekë të përcaktuar nga çmimi spot me të drejtën për të riblerë të njejtën sasi valute me çmimin foreard të përcaktuar sipas pikës 6 të këtij neni".*

Sipas nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, si përkufizim të cmimeve spot (cmimi në shitje i valutës së huaj) dhe cmimi foreard (cmimi në blerje i valutës së huaj) citohet

- Cmimi "spot" - është kursi i këmbimit i përcaktuar në një marrëveshje që përfshin këmbim valuator dhe ku kalimi i fondeve në llogarinë e secilës prej palëve kryhet deri në 2 (dy) ditë pune pas datës së lidhjes së marrëveshjes"
- Cmimi "foreard" – përcaktohet sipas standarteve të tregëtimit në tregun e parasë dhe atë të këmbimeve valutore nga diferenca e normave afatshkurtra të interest të monedhave të këmbyera në lidhjen e kontratës SËAP. Normat afatshkurtra janë të shprehura në bazë vjetore me dy shifra mbas presjes dhjetore.

Pra sipas marrëveshjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë konverton, nga TSA në monedhë të huaj me çmim spot në TSA në monedhën lekë, vlerën e përcaktuar në kontratë. Pra në pjesën e parë të kontratës Sëap kemi një konvertim të thjeshtë nga valutë e huaj në monedhën vendase me qëllim menaxhimin e likuiditetit për kryerjen e pagesave në lekë. Më pas, në maturim të kontratës, MFE ka *<u>të drejtën por jo detyrimin</u>* (sipas marrëveshjes) të konvertojë apo blejë me cmim foreard, mjetet monetare në monedh të huaj duke shtuar TSA në monedh të huaj dhe duke pakësuar TSA në lek, për të njëjtën sasi valute të huaj që u shit me cmimin spot të marrëveshjes.

Megjithatë përdorimi i këtij instrumenti bazohet në analizën që sektorët përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Borxhit, i bëjnë;

- flukseve hyrëse dhe dalëse të mjeteve monetare
- parashikimet 3 mujore dhe vjetore të realizimit të të ardhurave buxhetore me 3 skenarë të mundshëm (skenari bazë, realist dhe negative), në varësi të faktorëve makroekonomik dhe politik
- pagesat e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe kërkesave për mbështetje buxhetore

Më pas këto analiza merren në shqyrtim në mbledhjet periodike të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit i cili përbëhet nga këta anëtarë:

Z. E.L, Zëvendësminister i Financave dhe Ekonomisë
Znj. G.P Sekretar i Përgjithshëm
Z. L. S Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit
Z. M.P Drejtor i Drejtorisë Operacionale të Thesarit
Znj.M.D Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit dhe Borxhit Publik
Z. E. L, Drejtori i Politikave Makroekonomike dhe Cështjeve Fiskale
Znj. A.K, Përgjegjëse e Sektorit të Drejtimit të Likuiditetit
Znj.B. M, Specialist i Sektorit të Huamarrjes

Vendimi për rinovimin e kontratës Sëap dhe termave të saj në vlera dhe maturim, kushtëzohet nga nevoja për të plotësuar llogarinë në monedhë të huaj në të njejtën shumë (blerje EUR, SDR apo USD) si dhe nevoja për likuiditet në monedhën LEK ,**nëse nga DPTH parashikohet që do të ketë nevojë për to** në kuadër të kryerjes së pagesave në valutë. Pra MFE, duke u bazuar te marrëveshja 716/1 datë 20.01.2015, **nuk është e detyruar të ushtrojë Sëap në maturim nëse nuk i nevojitet të plotësojë llogarinë në valutë** dhe nëse nuk parashikon kryerje të pagesave në monedhën e huaj.

Me kërkesë të grupit të auditimit na u vu në dispozicion lista e transaksioneve SËAP, urdhrat përkatës të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, evidencat e kontabilizimeve në librin e madh si dhe minutat e mbledhjeve periodike të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit. Nga shqyrtimi i këtyre evidencave, rezulton se përgjatë vitit 2018, është vazhduar në drejtim të përdorimit të instrumentave SËAP me Bankën e Shqipërisë në të tre monedhat e huaja në të cilat administrohet TSA: EUR, SDR dhe LEK. Kontratat spot- forëard kronologjikisht paraqiten në tabelën si vijon;

Nr	Datë Kontrate	Datë Valute	Datë Maturimi	Vlera	Monedha
1	18.12.2017	20.12.2017	18.06.2018	40,000,000	SDR
2	20.07.2018	24.07.2018	27.12.2018	35,000,000	SDR
3	27.12.2018	31.12.2018	22.04.2019	30,000,000	SDR
Nr	Dt. Kontrate	Datë Valute	Datë Maturimi	Vlera	Monedha
1	18.12.2018	20.12.2018	19.02.2018	88,000,000	USD
2	16.02.2018	19.02.2018	24.07.2018	50,000,000	USD
Nr	Dt. Kontrate	Datë Valute	Datë Maturimi	Vlera	Monedha
1	13.11.2017	15.11.2017	15.03.2018	170,000,000	EUR
2	13.03.2018	15.03.2018	24.07.2018	100,000,000	EUR
3	20.07.2018	24.07.2018	31.10.2018	40,000,000	EUR

Burimi: Të dhënat e Drejtorisë Operacionale të Thesarit dërguar me email dt

Nga shqyrtimi i minutave të mbledhjeve KMBL nuk gjejmë të analizuar dhe për më tepër të listuar në konkluzionet e mbledhjeve vendimet në lidhje me domosdoshmërinë e lidhjes së kontratës SËAP dhe termave të saj , me përjashtim të mbledhjes së datës 17/12/2018 ku citojmë pikën 2 të konkluzioneve: "*Për të siguruar kryerjen e pagesave në lekë të fillimit të vitit 2019, konvertimin e shumës 75 milionë euro në lekë, nëpërmjet SËAP, instrument i ofruar nga Banka e Shqipërisë për menaxhimin e likuiditetit në valutë. Domosdoshmëria e tij kushtëzohet nga fakti se për muajin janar të vitit 2019 është parashikuar dalje e mjeteve monetare nga TSA ne vleren mujore prej 4.7 miliarde leke, kurse ne javen e pare pritet nje dalje prej 7 miliarde leke sipas kalendarit te fundit te miratuar"*, domosdoshmëri kjo që buron në plotësimin e nevojës për kryerjen e pagesave nga TSA në monedhë të huaj, pas një analize faktike të flukseve hyrëse dhe dalëse monetare, parashikimeve 3 mujore dhe vjetore të realizimit të të ardhurave buxhetore me 3 skenarë të mundshëm dhe pagesave të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm.

Grupi i auditimit ka parë të nevojshme analizimin e flukseve hyrëse dhe dalëse të mjeteve monetare në llogarinë e TSA-së të të gjitha valutave (SDR, EURO, DOLLAR dhe Lekë), për të evidentuar balancat e tyre në ditët e nënshkrimit të kontratave spot-forëard në të treja monedhat e huaja.si dhe në monedhën vendase. Në tabelën e mëposhtme, e cila ka dalë pas përpunimit të cash-floë 2017 dhe 2018, paraqiten balancat hapëse,flukset hyrëse, dhe dalëse si dhe balanca mbyllëse e TSA në të katër monedhat (LEK, USD, SDR dhe EURO)

Sipas Cash Flow 2017- 2018

Në Lekë				*Në 000 lekë*	*Në SDR*			
Date Valute	*Gjendja Fillim*	*Hyrje*	*Dalje*	*Gjendja fund*	*Gjendja Fillim*	*Hyrje*	*Dalje*	*Gjendja fund*
20.12.2017	10,453,084	21,357,750	5,725,361	26,085,474	24,822,433	20,000,000	40,000,000	4,822,433
	nga te cilat SWAP SDR	*6,395,600*				SWAP	SWAP	
18.06.2018	10,225,987	3,947,200	8,370,819	5,802,367	1,854,743	40,000,000	-	41,854,743
		nga te cilat SWAP SDR	*6,439,823*					
24.07.2018	19,806,887	21,532,515	19,767,771	21,571,631	41,854,743	-	35,000,000	6,854,743
	nga te cilat SWAP SDR	*5,281,150*						
27.12.2018	14,611,734	1,588,740	*9,182,974*	7,017,500	1,619,239	35,000,000	-	36,619,239
		nga te cilat SWAP SDR	5,294,205					
31.12.2018	3,995,998	6,586,915	400	10,582,513	36,619,239	-	31,962,500	4,656,739
	nga te cilat SWAP SDR	*4,482,300*				*nga te cilat SWAP SDR*	*30,000,000*	

Në Lekë				Në 000 lekë	Në USD			
Date Valute	Gjendja Fillim	Hyrje	Dalje	Gjendja fund	Gjendja Fillim	Hyrje	Dalje	Gjendja fund
20.12.2017	10,453,084	21,357,750	5,725,361	26,085,474	93,139,142	42,562	88,001,556	5,180,148
	nga te cilat SWAP USD	9,950,160				SWAP	8,800,000	
19.02.2018	13,923,510	12,086,167	10,773,556	15,236,122	1,367,581	88,000,000	50,000,000	39,367,581
		nga te cilat SWAP USD	9,952,340			SWAP	SWAP	
19.02.2018	13,923,510	12,086,167	10,773,556	15,236,122	1,367,581	88,000,000	50,000,000	39,367,581
	nga te cilat SWAP USD	5,313,000				SWAP	SWAP	
24.07.2018	19,806,887	21,532,515	19,767,771	21,571,631	974,964	50,000,000	-	50,974,964
		nga te cilat SWAP USD	5,315,841					

Në Lekë				Në 000 lekë	Në EUR			
Date Valute	Gjendja Fillim	Hyrje	Dalje	Gjendja fund	Gjendja Fillim	Hyrje	Dalje	Gjendja fund
15.11.2017	**8,722,903**	26,382,575	24,165,800	10,939,677	80,711,708	170,000,000	173,961,933	76,749,775
	nga te cilat SWAP EUR	**22,676,300**	**22,795,349**			SWAP		
15.03.2018	**12,952,853**	16,607,700	24,223,923	5,336,631	45,902,122	170,000,000	101,482,212	114,419,910
	nga te cilat SWAP EUR	**13,183,000**	**22,880,730**			SWAP	100,000,000	
15.03.2018	**12,952,853**	16,607,700	24,223,923	5,336,631	45,902,122	170,000,000	101,482,212	114,419,910
	nga te cilat SWAP EUR	**13,183,000**	**22,880,730**			SWAP	100,000,000	
24.07.2018	19,806,887	21,532,515	19,767,771	21,571,631	29,649,361	100,000,000	40,157,796	89,491,565
	nga te cilat SWAP SDR	5,281,150				SWAP	40,000,000	
	nga te cilat SWAP EUR	5,033,600	13,301,579					
	nga te cilat SWAP USD		5,315,841					
24.07.2018	19,806,887	21,532,515	19,767,771	21,571,631	29,649,361	100,000,000	40,157,796	89,491,565
	nga te cilat SWAP SDR	5,281,150				SWAP	40,000,000	
	nga te cilat SWAP EUR	5,033,600	13,301,579					
	nga te cilat SWAP USD		5,315,841					
31.10.2018	31,797,739	959,428	6,406,124	26,351,043	334,199,536	40,389,057	441,495	374,147,097
		nga te cilat SWAP EUR	5,062,089		SWAP	40,000,000		

Sipas analizës së të dhënave dhe të Cash-Floë 2018, identifikohen rastet ku bëhen konvertim i panevojshëm i fondeve për arsye se **në datën e maturimit nuk ka qenë i mjaftueshëm likuditeti në Lek për plotësimin e llogarisë në Euro sipas urdhrit të vetë DPTH, dhe për këtë arsye, po në të njëjtën datë, urdhërohet nga DPTH një tjetër kontratë në monedhë të huaj, emetimi i së cilës do të përmbush nevojën për cash-in në lekë.**

Duke qenë se në disa raste, TSA në lekë ka qenë e pamjaftueshme për përballimin e konvertimit nga Lek në Euro (maturimi i kontratës) dhe kjo ka krijuar kushtet për lidhjen e kontratës së re (fillim kontrate) duke krijuar lëvizje në Euro që janë shoqëruar me kosto nga konvertimi i kursit të këmbimit, në kushtet që nevoja reale për Euro ka qenë në të gjitha rastet ndjeshëm më e ulët se konvertimi i realizuar.

Nëse analizojmë Sëap-et në Euro në tabelën e mësipërme, do të shohim se, me kërkesën e bërë nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe DPTH me shkresën nr.16189 prot., datë 10.11.2017, për shitjen e shumës 170 milion Euro me datë valute 15.11.2017, shumë e cila do të merret nga TSA në Euro dhe kundravlerfta në lekë do të depoziotohet në TSA në lekë, gjendja e llogarsië TSA në lekë për në këtë ditë ka balancë hapëse 8,722,903 mijë lekë. Kjo balancë hapëse nuk arrin dot të përballojë pagesën e maturimit të SËAP-it prej 170 milion euro, kundravlerfta në lekë e të cilit është 22,795,349 mijë lekë,, SËAP ky i emetuar me datë valute 14.09.2017 me vlerë totale 170 milion euro dhe me datë maturimi pikërisht 15.11.2017. Që të paguhet maturimi i këtij SËAP-i, me balancën hapëse (8,722,903 mijë lekë) është e pamundur, për këtë arsye MFE, më shkresën nr.16189 prot., datë 10.11.2017 i

kërkon Bankës së Shqipërise, bazuar në marrëveshjen 716/1 datë 20.01.2015, të emetohet SËAP-i ri, me të njëjtën vlerë në euro prej 170 milion eurosh dhe në të njëjtën datë valute datë 15.11.2017dhe datë maturimi 15.03.2018,, në mënyrë që të mbyllet pozicioni i cash-it për pagesat në lekë. Pra pagesa e Sëap-it të maturuar me kundravleftën në lekë prej 22,795,349 mijë lekë, tashmë përballohet nga cmimi spot i Sëap-it të ri me kundravleftë në lekë 22,676,300 mijë lekë si dhe balancën hapëse të llogarisë TSA në lekë prej 8,722,903 lekë.

Por reaksioni i emetimit të SËAP-eve për shkak të shlyerjes së pagesave të SËAP-eve të maturuara në atë datë me qëllim mbylljen e pozicionit të cash-it për pagesat në lek, nuk mbaron këtu. Në datën 15.03.2018, datë kjo kur është moment i maturimit të SËAP-it emetimi i të cilit u kërkua me shkresën nr.16189 prot., datë 10.11.2017, kërkohet blerja mbrapsht e 170 milion eurove me cmim forëard, kundravleftën në lekë e të cilit është 22,880,730 mijë lekë, në një moment kur balanca e TSA në lekë në datën 15.03.2018 është vetëm 12,952,853 mijë lekë, pra e pamjaftueshme për mbylljen e pozicionit të cash-it për pagesat në lekë.

Përsëri, gjendur përballë mungesës së likuiditetit në lekë, MFE si dhe DPTH kërkojnë me shkresën nr.4999 prot., datë 08.03.2018 emetimin e një SËAP-i të ri me datë valute 15.03.2018 dhe datë maturimi 24.07.2018 në vlerën 100 milion euro, pra me cmim spot të shitjes dhe kundravleftën në lekë prej 13,183,000 mijë lekësh. Tashmë, në datën 15.03.2018, llogaria e TSA në lekë ka mjaftueshëm likuiditet për pagesën e Sëap-it të maturuar në këtë datë me cmim forëard kundravleftën në lekë prej 22,880,730 mijë lekësh. Ky cmim përballohet vetëm nga emetimi i Sëap-it të ri prej 100 milion eurosh dhe cmim spot kundravleftën 13,183,000 mijë lekë si dhe balancës hapëse të TSA në lekë prej 12,952,835 mijë lekë në datën 15.03.2018. **Kjo situatë vjen për shkak të paracaktimit të ushtrimit të Sëap pa identifikuar nevojën reale për konvertim për pagesat përkatëse të muajit në Euro, duke krijuar një situatë ku fondet kanë lëvizur në konvertim të panevojshëm duke qenë se në datë të maturimit nuk ka qenë i mjaftueshëm likuditeti në Lek për plotësimin e llogarisë në Euro sipas urdhrit të vetë DPTH.**

Por politika e përdorimit nga ana e Ministrisë së Financave të instrumentit Sëap, ka filluar të aplikohet prej vitit 2010 me emetimin e Eurobond-it të parë në vlerën 300 milion euro. Më parë TSA mbahej vetëm në monedhën LEK, dhe Banka e Shqipërisë siguronte këmbimin nga lekë në valutë kur nevojitej kryerja e pagesës së shërbimit të borxhit të jashtëm. Me krijimin e një gjendje të lartë të depozitës në monedhë të huaj sipas këshillimit të agjentit fiskal, Bankës së Shqipërisë, ministria urdhëroi detajimin e TSA-së në tre llogari sipas monedhave LEK, EURO dhe USD në fillim dhe më pas në SDR me financimin e detyrimeve të prapambetura nga FMN-ja me qëllim eleminimin e humbjes nga këmbimet e monedhës LEK për pagesat në EUR dhe USD që janë monedhat më të përdorshme për financim të huaj. Aktualisht Banka e Shqipërisë nuk e ofron më shërbimin e konvertimit nga LEK në valutë të huaj(por vetëm këmbimet midis valutave nga gjendjet e TSA në EUR, USD dhe SDR) për kryerjen e pagesave të shërbimit të borxhit, duke lënë sit ë vetmin opsion konvertimi instrumentin SËAP. Përdorimi i këtij instrumenti ka sjellë një humbje nga diferenca e kurseve në konvertim prej 1,553 milion lekë në vitin 2016, 567 milion lekë në vitin 2017 dhe 414 milion lekë për vitin 2018. Analiza e humbjeve nga diferencat e kursit të këmbimit gjatë ushtrimit të kontratave Sëap gjatë 2018, paraqitet si më poshtë:

							Devianca +/-	
Veprimi	**Dt. Valuta**	**Shuma SDR**	**Shuma leke**	**Kursi i aplikuar**	dif nga kurset	Kursi i dites sipas BSH	në points	në %
Fillim SËAP	20.12.2017	40,000,000	6,395,600,000	159.89				
Maturimi	18.06.2018	40,000,000	6,439,822,960	161.00	44,222,960	152.92	8.08	5.28%
Fillim SËAP	24.07.2018	35,000,000	5,281,150,000	150.89				
Maturim Forëard	27.12.2018	35,000,000	5,294,204,790	151.26	13,054,790	149.75	1.51	1.01%
Fillim SËAP	31.12.2018	30,000,000	4,482,300,000	149.41				
		Shuma USD						
Emetim Forëard	20.12.2017	88,000,000	9,950,160,000	113.07				

Maturimi	19.02.2018	88,000,000	9,952,339,936	113.09	2,179,936	106.71	6.38	5.98%
Emetim Forëard	19.02.2018	50,000,000	5,313,000,000	106.26				
Maturimi	24.07.2018	50,000,000	5,315,840,550	106.32	2,840,550	107.55	(1.23)	-1.15%
		Shuma EURO						
Maturim SËAP i shtatorit	15.11.2017	170,000,000	22,795,349,470	134.09				
Fillim SËAP	15.11.2017	170,000,000	22,676,300,000	133.39				
Maturimi	15.03.2018	170,000,000	22,880,730,270	134.59	204,430,270	131.45	3.14	2.39%
Fillim SËAP	15.03.2018	100,000,000	13,183,000,000	131.83				
Maturimi	24.07.2018	100,000,000	13,301,578,900	133.02	118,578,900	125.80	7.22	5.74%
Fillim SËAP	24.07.2018	40,000,000	5,033,600,000	125.84				
Maturimi	31.10.2018	40,000,000	5,062,089,040	126.55	28,489,040	124.94	1.61	1.29%
Totali				***163,357,065,916***		***413,796,446***		

Humbja vjen për shkak të aplikimit në maturim të Sëap-it të cmimit forëard, cmim ky që sipas marrëveshjes 716/1 datë 20.01.2015 neni 5 i saj përkufizohet; *"Cmimi forëard i riblerjes së valutës nga Ministria, përcaktohet nga kurba e yield-eve të bonove të thesarit të Qeverisë Shqiptare për monedhën vendase dhe kurba e normës së depozitave të aplikuara nga Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare për kohëzgjatjen e kontratës të kuotuar në ditën e lidhjes së kontratës".* Nga evidencat e shqyrtuara, postimet në Librin e madh dhe intervista me specialistë të DPTH- sektori i menaxhimit të likuiditetit, kontabilizimet e dërguara nga BSH thjesht postohen në SIFQ duke referuar numrin e kontratës Sëap pa dhënë shpjegime për llogaritjen e çmimit të aplikuar nga Banka e Shqipërisë. Nga Marrëveshja, neni 7 i saj citohet se: "*Banka, në varësi të kushteve specifike dhe situatave të anomalive në tregun e brendshëm të parasë, të borxhit të qeverisë ose në tregun e parasë në monedhë të huaj, mund të aplikojë marzhe fitimi, por që në tërësinë e tyre nuk janë më tepër se 20 (njëzet) pikë bazë"*. Në kushtet e mungesës së informacionit nuk mund të testojmë mënyrën e llogaritjes dhe aplikimin ose jo të marzhit të fitimit nga BSH. Në kushtet kur marrëveshja nr.716/1 DT. 20/1/2015 parashikon një marzh fitimi për Bankën e Shqipërisë të përllogaritur në kursin e këmbimit të aplikuar në momentin e maturimit të kontratës, përdorimi i një instrumenti të tillë për të menaxhuar balancat larta të valutës së huaj kur paraprakisht dihet që ky transaksion sjell vetëm humbje mbetet i paqartë racionaliteti i drejtuesve të MFE në përzgjedhjen e kësaj teknike që në thelb ka si qëllimi minimizimin e riskut të humbjeve nga kurset e këmbimit.

Në gjykimin tonë jemi në të njëjtën situatë si edhe me një vit më parë, ku kontrata Sëap është një konvertim i thjeshtë nga valutë e huaj në monedhën vendase pa realizuar qëllimin e saj me qëllim menaxhimin e likuiditetit në valutë dhe flukseve të shërbimit të borxhit të jashtëm. Edhe për këtë vit, menaxhimi i likuiditetit ndërmjet monedhave specifike dhe përcaktimi i nevojave për konvertime paraqitet me menaxhim të dobët ku si pasojë e konvertimeve nëpërmjet përdorimit të instrumentit Sëap me Bankën e Shqipërisë janë akumuluar interesa nga diferenca e kurseve të ofruar Spot-Forëard në shumën 414 milion lekë (tabela e mësipërme). Total i humbjes që vjen nga kursi i këmbimit nga ushtrimi i instrumentit Sëap për vitin 2018 prej **414 milion lekësh**, **paraqitet një shpenzim i cili vazhdon si vitet e mëparshme të mos raportohet si një zë më vehte por të kontabilizohet në llogarinë 766 në formën e një të ardhure negative, duke denatyruar natyrën dhe koston e këtyre transaksioneve.**

Gjetje:	**Menaxhimi i likuiditetit nëpërmjet instrumentit SËAP pa një analizë të përdorimit të këtij instrumenti, i cili ka sjell për 2018 humbje financiare në vlerën 414 milion lekë, humbje kjo e rregjistruar në llogarinë 766 si e ardhur negative. Emetimi i SËAP-eve të reja për shkak të shlyerjes së pagesave të SËAP-eve të vjetra të maturuara në atë datë me qëllim mbylljen e pozicionit të cash-it për pagesat në LËK.**

Situata	Sipas Marrëveshjes nr.716/1 datë 20/01/2015, në nenin 5 pika 1, specifikohet qëllimi i përdorimit konkret të këtyre instrumentave ku citohet *"..me qëllim menaxhimin e likuiditetit në valutë dhe flukseve të shërbimit të borxhit të jashtëm, Ministria mund të kërkojë realizimin e kontratave Sëap me bankën."* dhe pika 2 e nenit 5 specifikon mënyrën e zbatimit të marrëveshjes Sëap *"Në bazë të kontratës Sëap, Ministria ofron shitjen e valutës dhe blerjen e kundravleftës në lekë të përcaktuar nga çmimi spot me të drejtën për të riblerë të njejtën sasi valute me çmimin forëard të përcaktuar sipas pikës 6 të këtij neni".* Pra sipas marrëveshjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë konverton, nga TSA në monedhë të huaj me çmim spot në TSA në monedhën lekë, vlerën e përcaktuar në kontratë që do të thotë se në pjesën e parë të kontratës Sëap kemi një konvertim të thjeshtë nga valutë e huaj në monedhën vendase me qëllim menaxhimin e likuiditetit për kryerjen e pagesave në lekë. Më pas, në maturim të kontratës, MFE ka *<u>të drejtën por jo detyrimin</u>* (sipas marrëveshjes) të konvertojë apo blejë me cmim forëard, mjetet monetare në monedhë të huaj duke shtuar TSA në monedhë të huaj dhe duke pakësuar TSA në LEK, për të njëjtën sasi valute të huaj që u shit me cmimin spot të marrëveshjes. Vendimi për rinovimin e kontratës Sëap dhe termave të saj në vlera dhe maturim, kushtëzohet nga nevoja për të plotësuar llogarinë në monedhë të huaj në të njejtën shumë (blerje EUR, SDR apo USD) si dhe nevoja për likuiditet në monedhën LEK, **nëse nga DPTH parashikohet që do të ketë nevojë për to** në kuadër të kryerjes së pagesave në valutë. Pra Ministri i Financave dhe Ekonomisë, duke u bazuar te marrëveshja 716/1 datë 20.01.2015, nuk është e detyruar të ushtrojë Sëap në maturim nëse nuk i nevojitet të plotësojë llogarinë në valutë dhe nëse nuk parashikon kryerje të pagesave në monedhën e huaj. Ndërkohë nga shqyrtimi i minutave të mbledhjeve KMBL nuk gjejmë të analizuar dhe për më tepër të listuar në konkluzionet e mbledhjeve vendimet në lidhje me domosdoshmërinë e lidhjes së kontratës SËAP dhe termave të saj , me përjashtim të mbledhjes së datës 17.12.2018. Grupi i auditimit ka parë të nevojshme analizimin e flukseve hyrëse dhe dalëse të mjeteve monetare në llogarinë e TSA-së të të gjitha valutave (SDR, EURO, USD dhe Lekë), për të evidentuar balancat e tyre në ditët e nënshkrimit të kontratave spot-forëard në të treja monedhat e huaja si dhe në monedhën vendase. Sipas **analizës së të dhënave dhe të Cash-Floë 2018, identifikohen rastet ku bëhen konvertim i panevojshëm i fondeve për arsye se në datën e maturimit nuk ka qenë i mjaftueshëm likuditeti në Lek për plotësimin e llogarisë në Euro sipas urdhrit të vetë DPTH, dhe për këtë arsye, po në të njëjtën datë, urdhërohet nga DPTH një tjetër kontratë në monedhë të huaj, emetimi i së cilës do të përmbush nevojën për cash-in në LEK.** Duke qenë se në disa raste, TSA në LEK ka qenë e pamjaftueshme për përballimin e konvertimit nga LEK në Euro (maturimi i kontratës) dhe kjo ka krijuar kushtet për lidhjen e kontratës së re (fillim kontrate) duke krijuar lëvizje në Euro që janë shoqëruar me kosto nga konvertimi i kursit të këmbimit, në kushtet që <u>nevoja reale për Euro ka qenë në të gjitha rastet ndjeshëm më e ulët se konvertimi i realizuar</u>. Nëse analizojmë Sëap-et, do të shohim se, me kërkesën e bërë nga ana e MFE dhe DPTH me shkresën nr.16189 prot., datë 10.11.2017, për shitjen e shumës 170 milion Euro me datë valute 15.11.2017, shumë e cila do të

	merret nga TSA në Euro dhe kundravlerfta në lekë do të depozitohet në TSA në lekë, gjendja e llogarisë TSA në lekë për në këtë ditë ka balancë hapëse 8,722,903 mijë lekë. Kjo balancë hapëse nuk arrin dot të përballojë pagesën e maturimit të SËAP-it prej 170 milion euro, kundravlerfta në lekë e të cilit është 22,795,349 mijë lekë,, SËAP ky i emetuar me datë valute 14.09.2017 me vlerë totale 170 milion euro dhe me datë maturimi pikërisht 15.11.2017. Që të paguhet maturimi i këtij SËAP-i, me balancën hapëse (8,722,903 mijë lekë) është e pamundur, për këtë arsye MFE, më shkresën nr.16189 prot., datë 10.11.2017 i kërkon BSH, bazuar në marrëveshjen 716/1 datë 20.01.2015, të emetohet SËAP-i ri, me të njëjtën vlerë në euro prej 170 milion eurosh dhe në të njëjtën datë valute datë 15.11.2017 dhe datë maturimi 15.03.2018, në mënyrë që të mbyllet pozicioni i cash-it për pagesat në lekë. Pra pagesa e Sëap-it të maturuar me kundravleftën në lekë prej 22,795,349 mijë lekë, tashmë përballohet nga cmimi spot i Sëap-it të ri me kundravleftë në lekë 22,676,300 mijë lekë si dhe balancën hapëse të llogarisë TSA në lekë prej 8,722,903 lekë. Por reaksioni i emetimit të SËAP-eve për shkak të shlyerjes së pagesave të SËAP-eve të maturuara në atë datë me qëllim mbylljen e pozicionit të cash-it për pagesat në lek, nuk mbaron këtu. Në datën 15.03.2018, datë kjo kur është moment i maturimit të SËAP-it emetimi i të cilit u kërkua me shkresën nr.16189 prot., datë 10.11.2017, kërkohet blerja mbrapsht e 170 milion Eurove me cmim forëard, kundravleftën në lekë e të cilit është 22,880,730 mijë lekë, në një moment kur balanca e TSA në lekë në datën 15.03.2018 është vetëm 12,952,853 mijë lekë, pra e pamjaftueshme për mbylljen e pozicionit të cash-it për pagesat në lekë. Përsëri, gjendur përballë mungesës së likuiditetit në lekë, MFE si dhe DPTH kërkojnë me shkresën nr.4999 prot., datë 08.03.2018 emetimin e një SËAP-i të ri me datë valute 15.03.2018 dhe datë maturimi 24.07.2018 në vlerën 100 milion euro, pra me cmim spot të shitjes dhe kundravleftën në lekë prej 13,183,000 mijë lekësh. Tashmë, në datën 15.03.2018, llogaria e TSA në lekë ka mjaftueshëm likuiditet për pagesën e Sëap-it të maturuar në këtë datë me cmim forëard kundravleftën në lekë prej 22,880,730 mijë lekësh. Ky cmim përballohet vetëm nga emetimi i Sëap-it të ri prej 100 milion Euro dhe cmim spot kundravleftën 13,183,000 mijë lekë si dhe balancës hapëse të TSA në lekë prej 12,952,835 mijë lekë në datën 15.03.*2018.* ***Kjo situatë vjen për shkak të paracaktimit të ushtrimit të Sëap pa identifikuar nevojën reale për konvertim për pagesat përkatëse të muajit në Euro, duke krijuar një situatë ku fondet kanë lëvizur në konvertim të panevojshëm duke qenë se në datë të maturimit nuk ka qenë i mjaftueshëm likuditeti në LEK për plotësimin e llogarisë në Euro sipas urdhrit të vetë DPTH.*** *Përdorimi* i këtij instrumenti ka sjellë një humbje nga diferenca e kurseve në konvertim prej 567 milion lekë në vitin 2017 dhe 414 milion lekë për vitin 2018. Humbja vjen për shkak të aplikimit në maturim të Sëap-it të cmimit forëard, cmim ky që sipas marrëveshjes 716/1 datë 20.01.2015 neni 5 i saj përkufizohet; *"Cmimi forëard i riblerjes së valutës nga Ministria, përcaktohet nga kurba e yield-eve të bonove të thesarit të Qeverisë Shqiptare për monedhën vendase dhe kurba e normës së depozitave të aplikuara nga Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare për kohëzgjatjen e kontratës të kuotuar në ditën e lidhjes së kontratës".* Nga evidencat e shqyrtuara, postimet në Librin e madh dhe intervista me specialistë të DPTH- sektori i menaxhimit të likuiditetit,

	kontabilizimet e dërguara nga BSH thjesht postohen në SIFQ duke referuar numrin e kontratës Sëap pa dhënë shpjegime për llogaritjen e çmimit të aplikuar nga Banka e Shqipërisë. Nga Marrëveshja, neni 7 i saj citohet se: "*Banka, në varësi të kushteve specifike dhe situatave të anomalive në tregun e brendshëm të parasë, të borxhit të qeverisë ose në tregun e parasë në monedhë të huaj, mund të aplikojë marzhe fitimi, por që në tërësinë e tyre nuk janë më tepër se 20 (njëzet) pikë bazë"*. Në kushtet e mungesës së informacionit nuk mund të testojmë mënyrën e llogaritjes dhe aplikimin ose jo të marzhit të fitimit nga BSH. Në kushtet kur marrëveshja nr.716/1 DT. 20.01.2015 parashikon një marzh fitimi për BH të përllogaritur në kursin e këmbimit të aplikuar në momentin e maturimit të kontratës, përdorimi i një instrumenti të tillë për të menaxhuar balancat larta të valutës së huaj kur paraprakisht dihet që ky transaksion sjell vetëm humbje mbetet i paqartë racionaliteti i drejtuesve të MFE në përzgjedhjen e kësaj teknike që në thelb ka si qëllimi minimizimin e riskut të humbjeve nga kurset e këmbimit.
Kriteri	Marrëveshja kuadër "*Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë*" me nr.prot.716/1 datë 20/01/2015, marrëveshje kjo e përditësuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë me nr.prot. 5633/1 datë 18.12.2017 "*Për një ndryshim në marrëveshjen ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së financave "Mbi instrumentat e ofruar nga Banka e Shqipërisë për menaxhiumin e likuiditeteve të Ministrisë së Financave* " të datës 20.01.2015, e ndryshuar"
Impakti	Humbje financiare të gjeneruara dhe kontabilizuara si e ardhur negative në llogarinë 766, që kanë ardhur si pasoj e konvertimeve të thjeshta të balancave në monedh të huaj duke mos përmbushur objektivin e menaxhimit të cash-it
Shkaku	Mungesa e një analize të kujdesshme nga ana e KMBL-së për sa i përket përfitimeve në përdorimin e sëap-it, krahasuar me kostot e tij, analizë që në kushtet e riemetimit të borxhit të jashtëm, bëhet imediate. Mungesa e një metodologjie për menaxhimin e flukseve të parase dhe pozicionit valuator me instrumenta efektive. Mungesë e detajimit të cmimit të aplikuar në maturim të kontratës sëap
Rëndësia	E Lartë

Observacioni i subjektit i audituar: *Në kundërshtimet me nr.prot 5927/9, datë 26.08.2019 për akt konstatimin nr.1 datë 20.08.2019, ku citohet se;*

1. Kurba e normës së depozitave të aplikuara nga ***Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare*** *për kohëzgjatjen e kontratës të kuotuar në ditën e lidhjes së kontratës nuk mund të parashikohet nga struktura operacionale e Thesarit për të shmangur humbjet në ditën e maturimit të instrumentit SËAP si dhe kushtëzohet nga objektivat operacionale të Bankës së Shqipërisë (e cila operon me ligj të veçantë, të pavarur nga qeveria). Për këtë arsye që në marrëveshje është miratuar marzhi i fitimit për Bankën e Shqipërisë.*

2. Sqarojmë se identifikimi i nevojave reale për monedhën e huaj nuk bëhet për pagesat përkatëse të muajit në euro (siç është shprehur më lart), por pagesat e një periudhe 3-mujore (ndryshe nga monedha në lekë që bëhet për çdo muaj). Për rrjedhojë gjendja e TSA në fund të muajit duhet të mjaftojë për të kryer pagesat e shërbimit të borxhit të tre muajve të ardhshëm. Kjo për shkak të vështirësisë së sigurimit

të mjeteve monetare në monedhë të huaj dhe mbajtjen në nivel të pranueshëm ("prudent") të riskut të likuiditetit. Parashikimi i nevojave për mjete monetare është kompleks/fleksibël dhe për rrjedhoje nuk ka "one fit ëay", pasi kuzhtëzohet nga shumë faktorë, duke filluar, së pari, nga vetë përditësimet ditore të njësive shpenzuese raportuar njësive të qeverisjes së përgjithshme nga varen dhe i nëpunesit autorizues/zbatues (NA/NZ) të këtyre të fundit (që kanë kryer detajimin fillestar të nevojave në janar në sistemin informatik financiar të qeverisë-SIFQ) për të raportuar në Thesar paraprakisht të gjitha ndryshimet e pritshme për periudhat në vijim. Sqarojmë njësoj si për konstatimin e mësipërm se duhet konsideruar gjendje e TSA në fund të muajit e mjaftueshme për të kryer pagesat e shërbimit të borxhit të tre muajve të ardhshëm.

3. Sqarojmë se kontabilizimi i të dhënave për vitin 2018 është përmirësuar në zbatim të udhëzimit nr. 18, datë 28.05.2019 "Për një shtesë në udhëzimin nr.39, datë 24.12.2018 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018" në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me aquis communitaire të BE në kuadrin e projektit të financuar nga SECO për përmirësimin e raportimit finaciar që do të sigurojë zbatimin e standarteve të kërkuara nga EUROSTAT në kushtet e anëtarësimit të Shqipërisë në BE

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket pikës së parë grupi i auditimit sqaron se në bazë të nenit 5 pika 2 të marrëveshjes kuadër me Bankën e Shqipërisë "Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë" me nr.prot.716/1 datë 20/01/2015, marrëveshje kjo e përditësuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë me nr.prot. 5633/1 datë 18.12.2017 theksohet se Ministria ofron shitjen e valutës dhe blerjen e kundravleftës në lekë të përcaktuar nga çmimi spot me të drejtën për të riblerë të njëjtën sasi valute me çmim forëard. Pra si fillim MFE nuk ka detyrimin, por të drejtën e riblerjes së valutës, që do të thotë, që prej 2010 pas emetimit të Eurobondit, ky instrument është aplikuar për efekt meanxhimi cash-i që ka gjeneruar vetëm humbje, dhe ju jeni plotësisht në dijeni të disa viteve humbje të njëpasnjëshme (1,553 milion lekë në vitin 2016, 567 milion lekë në vitin 2017 dhe 414 milion lekë për vitin 2018), dhe nuk mund të argumentohet me paparashikueshmëri të kurbës së normës së depozitave të aplikuara nga Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare, kur aplikimi i këtij çmimi forëard, sipas marrëveshjes kuadër, nuk është detyrim por e drejtë. Për sa i përket pikës së dytë, asnjë pjesë e argumentit tuaj në lidhje më identifikimin e nevojave reale për monedh të huaj nuk justifikon faktin e emetimit të kontratave të reja SËAP për shkak të shlyerjes së pagesave të SËAP-eve të vjetra të maturuara në atë datë, duke qenë se TSA në lek është e pamjaftueshme në atë datë për përballimin e konvertimit nga Lek në EURO (maturimi i kontratës), e cila përbën dhe thelbin e gjetjes nga ana e grupit të auditimit. Për sa i përket pikës tre, ju bëjmë me dije se udhëzimi nr.18 datë 28.05.2019 nuk ka efekt prapaveprues. Thënë kjo duke qenë se subjekt auditimi nga ana e KLSH-së është viti fiskal 2018, për të cilin grupi ka hyrë në SIFQ dhe gjithashtu ka bërë konfirmimin se kjo humbje nga kursi i këmbimit që vjen nga përdorimi i instrumentit SËAP për menaxhimin e cash-it, ishte kontabilizuar për vitin 2018 në llogarinë 766 si e ardhur negative, konfirmuar kjo edhe tek treguesit e konsoliduar fiskal për vitin 2018. Duke marrë në konsideratë argumentet tuaja dhe sqarimet tona, nga ana e grupit të auditimit kundërshtimi juaj nuk merret parasysh.

2. Mbi saktësinë e veprimeve në SIFQ raportimin ne treguesit fiskale dhe paraqitja në pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit

Nga të dhënat e vëna në dispozicion me burim sistemin SIFQ, moduli pagesave, rezultojnë gjithsej rreth 407 mijë transaksione të rregjistruara me një numër mesatar mujor prej rreth 33 mijë transaksione në shkallë sistemi të Degëve të Thesarit. Institucionet me numrin më të lartë të veprimeve, sipas SIFQ janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit me njësitë e tyre të varësisë. Për sa u përket degëve, Dega e Thesarit Tiranë e ndjekur nga Dega Thesarit Shkodër, Vlorë

dhe Korcë. Përvec modulit të pagesave SIFQ ofron dhe modulin për qëllime planifikimi dhe monitorim të zbatimit të buxhetit dhe anagazhimeve shumëvjecare të qeverisë shqiptare në tre vite sipas planit buxhetor afatmesëm të miratuar së bashku me Buxhetin e vitit të ardhshëm. Nga këto transaksione u shqyrtuan saktësia dhe përputhshmëria e rregjistrimit të celjeve buxhetore si dhe rregjistrimet për rishikimet e celjeve buxhetore si reflektim i kërkesave të institucioneve, VKM-ve dhe akteve normative 1 dhe 2, urdhër-prokurimeve, kontratave të angazhimeve për blerje dhe investime, urdhër-shpenzimet e dërguara nga njësitë ekonomike për pagesa të faturave dhe shpenzimeve të tjera operative.

2.1 Mbi celjet buxhetore dhe rishikimet e planit buxhetor në SIFQ përgjatë vitit buxhetor 2018

Në përputhje me Udhëzimin e përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, brenda 10 ditëve nga dekretimi i ligjit të buxhetit vjetor nga Presidenti, dhe pas miratimit nga Ministri i Financave sipas pika 52 të këtij udhëzimi, Nëpunësi i Parë Autorizues informon me shkrim Nëpunësit autorizues të çdo njësie të qeverisjes qëndrore për shpërndarjen e fondeve buxhetore, sipas klasifikimit buxhetor. Gjatë proçesit të shpërndarjes dhe rishpërndarjes së fondeve buxhetore, Nëpunësi i Parë Autorizues mbështetet nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave, e cila bën të vlefshme fondet buxhetore në sistemin informatik financiar të qeverisë SIFQ, për secilën nga nivelet e njësive të qeverisjes së përgjithshme. Sipas pikës 20 të Udhëzimit, Nëpunësi i Parë Autorizues miraton detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese dhe planin e arkës, si dhe është përgjegjës që kjo të reflektohet në kohë në sistemin informatik financiar të qeverisë. Pasi miratohet nga Nëpunësi i Parë Autorizues, detajimi i buxhetit dërgohet zyrtarisht tek çdo njësi qëndrore dhe **bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi rregjistrohet në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) nga struktura përgjegjëse për buxhetin.** Këto rregjistrime raportohen në SIFQ si "celje fillestare". Gjithashtu, gjatë vitit buxhetor institucionet mund të ushtrojnë të drejtën për të kërkuar shtesa apo rishpërndarje fondesh në varësi të ecurisë së shpenzimeve, prioriteteve. Sipas nivelit të autorizimit të përcaktuar me Ligjin nr. 9936 dhe udhëzimet përkatëse pas cdo miratimi ekzekutohen në SIFQ këto ndryshime fondesh. Në fund të periudhës buxhetore buxheti fillestar i ndryshuar pas cdo kërkese apo Akti normative quhet "buxheti operativ".

Gjetje:	**Proces i gjatë 3-mujor i detajimit të celjeve fillestare në SIFQ, në pritje të detajimeve nga institucionet buxhetore duke u bërë pengesë dhe shkak për vonesa të fillimit të procedurave të prokurimit në APP duke marrë në konsideratë faktin se procedurat e prokurimit nuk mund të fillojnë pa u bërë efektive fondet buxhetore në SIFQ, si parakusht i fillimit të procesit. Rasti i ARRSH-së.**
Situata:	Për sa sipër, u kërkua nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit raporti i nxjerrë nga SIFQ që pasqyron "celjet fillestare" pas detajimit të bërë sipas cdo programi/projekti të miratuar për cdo institucion me Ligjin nr.109/2017 "Për Buxhetin e vitit 2018". Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga kjo drejtori, konstatohet se të dhënat e plota pas detajimeve dhe saktësimeve përfundimtare për cdo institucion, njësi varsie, në nivel projekti për "celjet fillestare" janë ato të muajit Mars 2018. Sipas kësaj Drejtorie, në muajin Janar 2018 shumë celjet bëhen në nivel agregat (programi) deri në momentin që institucionet/ministritë e linjës paraqesin me shkresë detajimet në bazë projekti. Ndërkohë nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit u kërkua raporti për të gjithë rishikimet buxhetore të kryera gjatë vitit 2018 (Janar-Dhjetor). Në këtë raport konstatohen **285 rregjistrime** (fletë kontabël) për rishpërndarje fondesh datojnë në muajt Janar-Mars 2018 që do të thotë se rishikimet e kësaj periudhe nuk janë raste

	mirfilli "rishpërndarje buxhetore" të bëra mbi bazën e një kërkese apo Akti Normativ, por saktësime të detajimit të programeve në nivel projekti pra procesi i rregjistrimit të celjeve fillestare <u>në SIFQ **përfundon rreth muajit Mars 2018**</u>. <u>Duke qënë se Drejtoria e Buxhetit është përgjegjëse për rregjistrimin e buxheteve fillestare, u kërkuan celjet buxhetore si ekstrakte nga SIFQ, për cdo muaj nga Janar 2018 deri Dhjetor 2018, të cilat nuk na u vunë në dispozicion dhe deri në fund të periudhës auditues nuk kemi një përgjigje për arsyen.</u> Raporti përmbledhës në format excel-i[2], i vënë në dispozicion nga kjo drejtori nuk ka informacion për muajt Janar- Shkurt 2018 duke na shpjeguar se muaji Mars 2018 është celje fillestare përfundimtare në nivel projekti. Në kushtet kur në Udhëzimin plotësues nr.2 dt.19.1.2018 për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, nuk parashikohet ndonjë afat për përfundimin e procesit të detajimit të celjeve buxhetore, grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë nëse periudha 3 mujore për të bërë detajimet dhe saktësimin e celjeve fillestare sipas projekteve është e tejzgjatur, gjithësesi duke marrë në konsideratë faktin se procedurat e prokurimit nuk mund të fillojnë pa u bërë fondet buxhetore efektive në SIFQ, në gjykimin e audituesit ky proces 3 mujor pengon fillimin e procedurave të prokurimit në APP (celjet janë parakusht i fillimit të procesit).
Kriteri:	*Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar* *Udhëzimi i përhershëm Nr.2 Datë 06. 02. 2012"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, pika 20, 54 *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Ligji nr.68/2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar,* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"*

[2] *Tabela "SIFQ 2018_Investime"*

	Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018" *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*
Shkaku:	Mungesë e kontrolleve dhe procedurave me afate konkrete për monitorimin e procesit të celjeve në aplikacionit SIFQ dhe mosveprim i NPA për të aplikuar masat e parashikuara në ligj për shkelje të caktuara.
Rëndësia	E lartë

Gjetje:	**Procedura prokurimi të filluara para dorëzimit të planit të prokurimit në Degën e Thesarit, me një fond limit në tejkalim të celjes buxhetore në SIFQ duke mos ndjekur kështu nga institucioni kontraktor rradhën e parashikuar të miratimit ligjor të investimeve duke anashkaluar procedurat e kontrolleve të parashikuara në Ligjin mbi menaxhimin e buxhetit dhe akteve ligjore të lidhura me të. *Rasti i ARRSH-së.***
Situata:	Më konkretisht, u audituan celjet fillestare dhe rishikimet e buxhetore të ekzekutuara në SIFQ për njësinë Autoriteti Rrugor Shqiptar me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe proceduriale të procesit dhe saktësisë së rregjistrimeve. Theksojmë se përgjegjëse për rregjistrimin e celjeve dhe cdo rishikimi buxhetor është Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Për këtë qëllim u krahasuan të dhënat e raportit të realizimit të investimeve të vënë në dispozicion nga kjo Drejtori, kundrejt celjeve fillestare dhe rishikimeve e ekzekutuara në SIFQ. Ky raport liston për ARRSH zero celje fillestare për të 159 projektet për investime të miratuara, ilustruar në tabelën në vijim:

Entiteti i Qverisjes	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Emertimi Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i D.Thesarit	Kodi i projektit	Emri i projektit	Buxheti fillestar 2018	AN 2 dt. 19.12.2018 + VKM	Fakt 2018	Në % mbi AN 2
1001	06	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	01	04520	230	3535	M060526	Studim Projektim Oponence	-	53,582,974	53,582,974	100.00%
1001	06	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	01	04520	230	3535	M061283	Studim fisibiliteti dhe projekti ide rruga Koman - Fierze	-	5,150,951	5,150,951	100.00%
1001	06	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	01	04520	230	3535	M061906	Studim Projektim Sistemim Asfaltim rruga Boge -Theth	-	1,761,798	1,761,798	100.00%

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve (Sample)

Sipas specialistëve të Drejtorisë së Buxhetit ky raport është përpunuar mbi të dhënat e nxjerra nga SIFQ, raport ky i cili u kërkua të na vihej në dispozicion në formatin ".text" fillestar të tij por nuk na u vunë dispozicion. I njëjti raport më pas u kërkua në Drejtorinë e Thesarit sipas të cilit rezultoi se në fakt 125 projekte kanë të rregjistruar celje fillestare dhe të gjitha celjet janë bërë në datën 28 Mars 2018. Ndërkohë, Udhëzimi nr.2 dt.06.02.2012 dhe Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar si dhe VKM nr.914 dt.29.12.2014 i ndryshuar, neni 4, pika 1 e të cilit parashikojnë përgatitjen e planit të prokurimit brenda 10 ditëve nga data e miratimit të ligjit për buxhetin e vitit i cili duhet të dorëzohet pranë Degës së Thesarit për të bërë verifikim dhe konfirmimin e fondeve disponibël. Në kushtet kur celjet për ARRSH janë realizuar në 28 Mars 2018, u kërkua dhe u vu në dispozicion nga Dega e Thesarit Tiranë, kopja e rregjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit publik për ARRSH, një kopje e të cilit është dërguar edhe në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit, ku rezultoi se ky dokument me nr. prot. 3884 mban datën 08.05.2018, kjo në shkelje të

bazës ligjore të cituar më lartë duke shtyrë kështu në kohë dhe fillimin e procedurave të prokurimit për investime të miratuara për vitin 2018 deri në muajin Maj 2018. Megjithatë, nga verifikimi i të dhënave të APP për shpalljet për prokurim për periudhën Janar-Prill 2018 (periudhë para paraqitjes së rregjistrit të prokurimeve) rezulton i listuar shpallja për prokurimin e projektit M064213 "Supervizion punimesh. Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë" shpallur me një fond limit prej 34.49 milionë lekë:

Objekti i Prokurimit	Autoriteti Kontraktor	Tipi i Kontratës	Fondi Limit	Data Publikimit	Data Mbylljes	Numri i Thirrjes
"Supervizion punimesh Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 4,5,6	ARRSH	Services	34,490,193	18/04/2018		REF-63265

Ndërkohë që sipas raportit të Drejtorisë së Buxhetit këtij projekti i janë miratuar fondet me Aktet normative në total për vetëm 8.28 milionë lekë krahasuar me fondin limit prej 34.49 milionë lekë.

Kodi i instituc.	Emerti mi Instituc.	Programi	Llog. Ekon.	Dega Thesarit	Kodi i projektit	Emri i projektit	Buxheti fillestar 2018	AN 2 dt. 19.12.2018 + VKM
1006054	ARRSH	04520	231	3535	M064213	Supervizion Punimesh Ndertim rruga Kardhiq - Delvine Loti 4,5,6	-	8,280,000

Realisht, sipas rregjistrimeve në SIFQ rezulton se fillimisht është rregjistruar një celje fillestare prej 1.5 milionë lekë dhe më pas një shtesë fondi rregjistruar më 25.06.2018 për 6.78 milionë lekë duke e sjellë buxhetin operativ të këtij projekti në një vlerë totale prej 8.28 milionë lekë:

ID#	GL_ Date	Buxheti Fillestar	Shuma e rishikuar	Balanca e re	Kodi institucionit	TDO	Projekti	Dt.rishikimit
5810299	06-2018	1,500,000	+ 6,780,000	8,280,000	1006054	3535	M064213	25-JUN-18

Duke qënë se kemi të bëjmë me një kontratë shumëvjecare, 20% e fondit disponibël duhet të rialokohet në vitin e parë buxhetor sic del dhe nga kronologjia e veprimeve, ky kusht është plotësuar 2 muaj më vonë nga data e shpalljes për prokurim. Aktualisht me të njëjtin kod projekti janë lidhur dy kontrata: njëra për konsulencë për shumën 34,465,800 lekë dhe tjera për supervizim punimesh në shumën 41,268,000 lekë pra në total 75,733,800 lekë nga të cilat asnjëra nuk shfaqet në të dhënat e APP në listën e kontratave të nënshkruara.

PO#	Dt. Kont.	Kontraktori	Instituc	Kl.	Pershkrimi Llogarisë	Projekti	Pershkrimi Projektit	SHUMA Në lekë
1006054-1800032	16/07/2018	47XX & I. P.K.S	ARRSH	23	Shpenz. per rritjen e AQT – konstruksione te rrugeve	M064213	Supervizion Punimesh rruga Kardhiq – Delvine Loti 4,5,6	41,268,000
1006054-1800033	28/08 2018	47 XX & I P.K.S	ARRSH	60	Shpenz.per miremb.e rrugeve,veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, tel. ngrohjeetj	0000000	Unspecified	34,465,800

	Në konkluzion, shpalljet për prokurim në APP kanë filluar para dorëzimit të planit të prokurimit në Degën e Thesarit, me një fond limit në tejkalim të celjes buxhetore në SIFQ. Celjet dhe marrja e angazhimeve nga institucioni kontraktor nuk ndjekin rradhën e parashikuar në Udhëzimet përkatëse të zbatimit të buxhetit duke anashkaluar procedurat e kontrolleve të parashikuara me Ligjin mbi menaxhimin e buxhetit dhe akteve ligjore të lidhura me të. Specifikisht për institucionin e ARRSH, sic edhe është trajtuar më hollësisht në këtë raport celjet dhe rishikimet buxhetore nuk janë bërë në përputhje të plotë me procedurat e miratimit ligjor të projekteve për investimet përfshirë këtu dhe PBA-në. Dorëzimi me vonesë i planit të prokurimit ndikon dhe në një planifikim jo të saktë dhe koherent të "Planit të arkës" i cili është parashikimi i të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme i cili hartohet bazuar në: a) fluksin e të ardhurave, të parashikuara për t'u mbledhur dhe arkëtimet e tjera; b) planin e prokurimeve dhe angazhimet e tjera të planifikuara; c) pagesat e parashikuara, që rrjedhin nga angazhimet.
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Ligji nr.68/2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*
Impakti:	Thyerje e procedurave të marrjes së angazhimeve; masave për forcimin e disiplinës fiskale me pasojë krijimin detyrimeve të prapambetura
Shkaku:	Mungesë e kontrolleve të procedurave dhe të aplikacionit në marrjen e angazhimeve
Rëndësia	**E lartë**

Gjetje:	**Numër i lartë rishikimesh buxhetore përgjatë gjithë vitit 2018 me: 2065 rregjistrime për 1006 njësi ekonomike dhe 1179 projekte për investime, ku midis të tjerave konstatohet se SIFQ lejon rregjistrime korrigjuese edhe në periudhat tashmë të mbyllura dhe të raportuara buxhetore.**
Situata:	Në kuadër të objektit të këtij auditimi, u kërkua informacion mbi ndryshimet, rishikimet e fondeve buxhetore midis projekteve dhe programeve. Nga shqyrtimi i të dhënave të SIFQ- moduli i planifikimit, rezultojnë gjithsej **2065 rregjistrime** (Budget revision ID#) për ndryshime celjesh buxhetore të fondeve të **1006 njësive ekonomike. Këto rishikime kanë prekur si llogaritë e fondit të vecantë, fondeve rezervë, fondit të ngrirë si dhe kanë bërë rishpërndarje të fondeve midis projektesh sipas kërkesave të institucioneve. Kështu për llogarinë "për shpenzime për investime", këto rishpërndarje kanë prekur pothuaj të gjitha projektet: 1179 projekte me financim të brendshëm dhe 89 projekte me financim të huaj.** Tabela në vijim paraqet të gjitha rishikimet e rregjistruara gjatë vitit 2018 pavarësisht llojit të shpenzimit/programit apo institucionit:

Inst/Ministria linjes	**Jan**	**Feb**	**Mar**	**Apr**	**May**	**Jun**	**Jul**	**Aug**	**Sep**	**Oct**	**Nov**	**Dec**	**Total**
(T) Fondi Vecantë Pagave	22	28	23	7	38	27	46	19	10	24	19	46	**309**
(T) Fondi Rezerve	3		1	4	1	1	4	1	2	3	1	7	**28**
(T) Rezerve per rritjen e pagave										1			**1**
(T) Sherbimi Borxhit										15		4	**19**
Qeverisja Vendore	**286**	**250**	**118**	**479**	**321**	**407**	**246**	**284**	**397**	**692**	**481**	**338**	**4299**
Bashkia Tiranë	*27*	*8*	*6*	*118*	*19*	*52*	*9*	*5*	*6*	*179*	*42*	*70*	*541*
Bashkia Kamez	*24*	*8*	*19*	*2*	*19*	*24*	*7*	*5*	*42*	*57*	*19*	*25*	*251*
Bashkia Korcë	*2*	*63*	*6*	*13*	*14*	*19*	*17*	*19*	*5*	*23*	*19*	*2*	*202*
Bashkia Durrës	*4*	*10*	*7*	*9*	*33*	*10*	*11*	*4*	*42*	*4*	*23*	*4*	*161*
MASR	206	133	44	34	69	60	61	43	96	117	259	158	**1280**
MFE	44	62	41	61	136	66	34	170	39	58	245	298	**1254**
Ministria Shëndetësise	224	32	24	50	67	23	35	101	43	109	230	96	**1034**
Ministria Brendshme	50	14	58	15	30	119	96	59	91	66	232	117	**947**
MBZHR	4	58	20	31	30	25	14	99	43	43	103	187	**657**
Ministria e Drejtësise	11	6	80	4	21	25	42	24	91	20	114	47	**485**
MIE	7	3	7	13	38	54	13	69	30	64	18	330	**646**
Ministria e Kulturës	3	11	5	26	12	21	22	44	8	94	40	37	**323**
Ministria e Mbrojtjes	9		11	6	28	9	50	68	19	35	16	62	**313**
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	10	3	3	3	15	6	10	31	5	19	9	28	**142**
FZHSH		2		12	24	2	10	1	5	40	28	67	**191**

Institucione të tjera të pavarura	***39***	***55***	***35***	***33***	***91***	***48***	***106***	***147***	***50***	***128***	***160***	***321***	***1213***
Total	**913**	**651**	**466**	**772**	**910**	**892**	**783**	**1147**	**921**	**1512**	**1943**	**2099**	**13009**

Sipas llogarive ekonomike, ndryshimet e mësipërme kanë prekur:

	GL date v.2017		**GL date v.2018**		**GL date v.2019/20**		**Total**	
Pershkrimi	**Nr. Rishikimeve**	**Shuma e rishikimit në 000/lekë**	**Nr. Rishikimeve**	**Shuma e rishikimit në 000/lekë**	**Nr. Rishikimeve**	**Shuma e rishikimit në 000/lekë**	**Nr. Rishikimeve**	**Shuma e rishikimit në 000/lekë**
Shpenzime AQT dhe jo AQT	116	- 237,958	3,405	20,975,495	362	- 258,322	3,883	20,479,215
Paga dhe sig shoqërore	13	-6,697	3,406	12,453,230			3,419	12,446,533
Mallra dhe sherbime te tjera	14	7,960	1,696	9,623,384	10	248,814	1,720	9,880,158
Rezervat			389	- 5,375,371			389	-5,375,371
(T) Shërbimi i Borxhit		**- 4,100,000**		**-500,000**				**-4,600,000**
(T) Shërbimi i Borxhit llog#	1	-10,000	2	2,674,975			3	2,464,974
Interesa per BTH, kredi tjera, letra me vlerë	2	- 3,100,000	6	- 1,700,000			8	-4,800,000
Interesa për huamarrje te huaja	3	-990,000	8	- 1,474,974			11	-2,464,974

Pavarësisht se me Aktet normative nr.1 dhe 2, pritshmëria për një numër të lartë rishikimesh në muajt Gusht dhe Dhjetor është normale, ajo që rezulton nga të dhënat e vëna në dispozicion është se numri i lartë i rishikimeve buxhetore është i pranishëm përgjatë gjithë vitit, që prej muajit Mars 2018 ku presupozohet se saktësimi i detajimit të fondeve në nivel njësie ekonomike është finalizuar (trajtuar më hollësisht sa më lartë në këtë raport). Kërkesat për rishikime vijnë nga pothuaj të gjitha njësitë ekonomike, por njësitë e qeverisjes vendore janë ato që janë në proces rishikimi dhe rishpërndarje fondesh të vazhdueshme përfshirë këtu dhe kërkesat për celje projektesh të reja të financuara me të ardhurat e veta. Sipas Udhëzimit të përhershëm nr. 2 dt.06.12.2012, pika **79 e tij: "***Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qëndrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit", dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime ashtu edhe ato për shpenzime operacionale, nga ana e institucioneve qëndrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta para planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe vecanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve me rrjedhojë numrin e lartë të faturave të prapambetura nga vitit në vit***.**

Nga tabela e rishikimeve vecojmë gjithashtu situatat e mëposhtme:

- Rregjistrimet me datë vitin 2018 **dhe me efekt raportimin e vitit 2017** janë kryer kryesisht gjatë muajit Janar si reflektime të rialokimeve të miratuara me Aktin Normativ 3 të datës 06.11.2017. Megjithatë, nga rregjistrimet e bëra gjatë vitit 2018 me efekt në treguesit fiskal të vitit 2017 vecojmë rregjistrimin e bërë në muajin **Tetor 2018**

	me GL date 2017 në llogarinë teknike "Shërbimi i borxhit" në shumën -4.1 miliardë lekë. Ky regjistrim është bërë pas rekomandimit të KLSH në auditimin "Mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2017" ku u konstatua mosrakordim i treguesve fiskal të raportuar me ato të rregjistruar në SIFQ. Pavarësisht argumentit të dhënë për sistemimin e llogarisë "shërbimi i borxhit" të vitit 2017, është fakt që në SIFQ mund të kryhen rregjistrime në vitin korrent, në vitet e ardhshme për obligimet nga kontratat shumëvjecare por edhe veprime retrospektive për llogari të viteve të kaluara, periudha këto supozuar të rakorduara, raportuara dhe mbyllur në përputhje me Udhëzimin e përvitshëm '*Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit*". Nëse rregjistrimet deri në datën 31 Janar të vitit pasardhës për rishikim buxhetesh si reflektim i Aktit Normativ të datës 19.12.2018, janë deri diku të justifikuara sipas këtij Udhëzimi i cili lejon rregjistrime sistemuese për llogari të vitit të mbyllur, cdo veprim tjetër pas kësaj date është në shkelje të Udhëzimit, pika 33 e tij sipas të cilit "*Degët e Thesarit gjenerojnë nga sistemi i SIFQ brenda datës 31.1.2019 informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme…Të dhënat përfundimtare kontabël pasqyrohen në SIFQ (në periudhën e 13-të) nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit.."* - Një tjetër rast i konstatuar i rregjistrimeve në vitin pasardhës për vitin korrent është rasti i celjes buxhetore për **projektin nr. 1660372, në datë 23 Tetor 2018 në shumën 18,889,591,591 lekë me ID#5871327 për Bashkinë Kamëz. Kontrata e lidhur për këtë projekt sipas tabelës PO-ve është lidhur për 30,889,591 lekë. Nga verifikimi me shkresën e dërguar nga Bashkia Kamëz për Degën e Thesarit Tiranë të datës 19/10/2018 nr.prot.5699** kërkohet të celet fondi për këtë projekt në shumën 18,889,591 lekë dhe aktualisht fondi është celur për 18,889,591,591 lekë. Duket që kjo celje është një gabim njerëzor por me një diferencë në vlerë të konsiderueshme për këtë njësi, megjithatë rezulton i konstatuar dhe korrigjuar vecse në Prill të vitit 2019 me datë GL 2018, pra 7 muaj më vonë nga data erregjistrimit fillestar dhe përtej afateve të rakordimit dhe mbylljes së llogarive dhe raportimeve fiskale mi realizimin e investimeve. Megjithatë, përvec ndërhyrjeve retrospektive në vitet e mbyllura, ky rast sjell në vëmëndje dhe dy cështje: **mungesën e kontrollit të tavaneve buxhetore, realizimet e projekteve për investime në qeverisjen vendore si dhe lidhjen e kontratës mbi fondin disponibël të autorizuar për celje nga Bashkia Kamëz në shumën 12 milionë lekë.**
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017"* *Ligji nr.68/2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i*

	ndryshuar. *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*; *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018*
Impakti:	Krijim i detyrimeve të prapambetura, shkelje e radhës së prioriteteve në pagesa për shpenzime për investime
Shkaku:	Planifikim i dobët i shpenzimeve për investimeve si në nivelin e qeverisjen qëndrore dhe atë vendore. Mungesë kontrolli dhe monitorimi i ecurisë së projekteve për investime
Rëndësia	E lartë

Observacion i Drejtorisë së Buxhetit nr.prot.5927/12 dt.27.8.2019 *"Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë autonome në menaxhimin financiar të tyre dhe janë organet e njësisë të cilat vlerësojnë saktsinë e procesit dhe miratojnë planifikimin e të ardhurave për vitin buxhetor. Aktualisht procesi i rishpërndarjes së fondeve buxhetore në nivel vendor është rregulluar në përputhje me përcaktimet e nenit 44, i ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar dhe nenit 45, të ligjit nr.68, dt.27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku njësitë e vetëqeverisjes vendore në varësi të formës së rishpërndarjes duhet të bëjnë miratimin nga organet e saj. Në këto kushte, aktualisht nuk ekziston një akt ligjor/nënligjor që përcakton numrin e rishikimeve të pushtetit vendor prandaj edhe vlerësimi mbi nivelin e rishpërndarjeve duhet të trajtohet mbi bazën e argumentimit mbi këto ndryshime.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vlerësimin e procesit të rishpërndarjeve buxhetore dhe monitorimin e tij është patur pavarësia dhe autonomia që ligji i përmëndur nga DB i jep këtyre njësive megjithatë, ky ligj vepron mbi të njëjtat parime dhe rregulla të disiplinës fiskale me ato të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë monitorimi i përputhshmërisë së të cilave është edhe përgjegjësi e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (neni 8 i Ligjit nr.68 dt.27.04.2017) i cili e kryen këtë funksion nëpërmjet Drejtorisë përgjegjëse përkatese: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Grupi i auditimit i vlerëson një planifikim numrin e lartë të rishikimeve buxhetore në përputhje me Udhëzimin e përhershëm nr. 2 dt.06.12.2012, pika **79 e tij: "***Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qëndrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit", dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime ashtu edhe ato për shpenzime operacionale, nga ana e institucioneve qëndrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta para planifikimit nga*

ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe vecanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve me rrjedhojë numrin e lartë të faturave të prapambetura nga vitit në vit. Në këtë mënyrë i qëndrojmë mendimit që DPB në rolin e saj "si udhëheqëse metodologjike e procesit të hartimit dhe miratimit të PBA të pushtet vendor" duhet të analizojë dhe këtë situatë edhe në kuadrin e funksioneve të saj citojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit:

- *Të llogarisë dhe transferojë me drejtësi e transparencë transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor, të mbështesë dhe plotësojë me aktet e nevojshme ligjore, decentralizimin fiskal, duke synuar rritjen e të ardhurave, rritjen e eficencës të përdorimit të fondeve publike për pushtetin vendor.*
- *Shlyerja e detyrimeve të prapambetura. Menaxhimi me efektivitet i të dhënave mbi detyrimet e prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme-*

Drejtoria e Financave Vendore*:*

- *Udhëheq metodollogjikisht procesin e hartimit dhe miratimit të projektbuxhetit afatmesëm të pushtetit vendor.*
- *Harton dhe konoslidon standardet e nevojshme të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.*
- *Nëpërmjet konsolidimit të standarteve për mirëmenaxhimin e financave vendore, parandalon krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe të çdo lloj detyrimi tjetër që cënon integritetetin funksional të financave të njësive të qeverisjes vendore.*
- *Analizon dhe monitoron buxhetet e njësive të qeverisjes vendore.*

Observacioni nuk pranohet.

Gjetje:	**Mbi saktësinë e rregjistrimeve në SIFQ në bazë të shkresave miratuese përkatëse sipas nivelit të miratimit ligjor të rishpërndarjeve të fondeve buxhetore**
Situata:	Rasti i rishikimit nr ID#5807297 dhe ID#5852299 për rialokimin e fondeve nga Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë "fondi i ngrirë" te projekti M064236 "Inceneratori i Tiranës", u kërkuan shkresat miratuese nga Drejtoria e Buxhetit dhe Dega e Thesarit Tiranë. Kësaj kërkese iu përgjigj fillimisht vetëm Dega e Thesarit Tiranë e cila na vuri në dispozicion shkresën e NPA me dt.27.6.2018 dhe nr.prot.11150/4 "Miratim limiti", drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila citon shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr. **Prot.11150/1 dt.14.06.2018** që miraton shtesat dhe paksimet në zërin "shpenzime për investime" 2319999, ndryshime këto të cilat autorizohen të bëhen në muaji Qershor 2018. Duke qënë se jemi në rastin e transferimit të fondeve nga një njësi qëndrore te një njësi vendore, për të vlerësuar përputhshmërinë me nenin 44 të Ligjit 9936 "Për menaxhimin e buxhetit", i ndryshuar, u kërkua kopje e shkresës së Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.11150/1 e cituar në shkresën e NPA-së, e cila na u vu në dispozicion në dt.28.8.2019, pas Aktit konstatimit nr.6 dt.23.8.2019. Kjo shkresë miratuese, e dërguar në përgjigje të kërkesës së institucionit MIE nr.8410 dt.8.6.2018, për "*cngurtësim fondi*" prej 500 milionë lekë në favor të projektit M064236 "*Ndërtimi i landfieldit, inceneratori…*" kërkon gjithashtu, citojmë: "*saktësimin e autoritetit kontraktor,në programin "Menaxhimi i mbetjeve urbane sipas tabelës 1 bashkëlidhur*". Tabela citon institucionin Bashkisë Tiranë. **Pavarësisht se rialokimi i fondeve është brenda të njëjtit program #06220, jemi në rastin e rishpërndarjes së fondeve midis dy institucioneve të ndryshme, të cilat sipas nenit 44 të Ligjit 9936, pika a) janë kompetencë e Këshillit të Ministrave. Për**

këtë cështje të Akt konstatimit, subjekti nuk shprehet në observacionin e tij.
në mijë lekë

REVISION_ID	GL_PERIOD	Balanca fillestare	Lloji I rishik.	Shuma e rishik.	Kodi institucionit	Emri I Institucionit	Programi	Projekti	Pershkrimi i projektit	Dt.rishikimit
5807297	06-2018	500,000	D	(500,000)	1006001	Aparati MIE	06220	M060625	Fond i ngrire	18-Jun-18
5807297	06-2018	-	I	500,000	2101001	Bashkia Tirana	06220	M064236	Ndërtim i lanfieldit, inceneratori, zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë	18-Jun-18
5852299	08-2018	500,000	D	(500,000)	2101001	Bashkia Tirana	06220	M064236	Ndërtim i lanfieldit, inceneratori, zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë	12-Sep-18

Gjithashtu, nga shqyrtimi i rishikimeve të këtij projekti rezulton se fondet e alokuara në 18.06. 2018, janë ripërndarë (pakësuar) përsëri në shumën e plotë prej 500 milionë lekë në datën 12 Shtator 2018 me ID#5852299 me shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr.prot.14875/113 dt.11.9.2018 "Në zbatim të Aktit normativ nr.1 dt. 26.07.2018"

Në konkluzion, në gjykimin e audituesit , **pakësimi prej 500 milionë lekë ka shkuar si shtesë në programe të tjera, rishpërndarje kjo që do të kërkonte përsëri një VKM**. Më poshtë paraqitet dhe fleta kontabël e datës 12 Shtator 2018 e ekzekutuar nga Drejtoria e Buxhetit:

ID#	GL_Dt.	Buxheti Balanca	P/SH	Shuma e rishik	Kodi Instit.	Emri Institucionit	Programi	TDO	Projekti
5852299	08-2018	500,000	D	-400,000	1006095	DP Hekurudhave Durres	04550	0707	GM06089
5852299	08-2018	350,000	D	-350,000	1006047	DP Ujesjelles Kanalizimeve	06370	3535	KM06005
5852299	**08-2018**	**50,000**	**D**	**-50,000**	**1006928**	**Shoqata Rajonale Menaxh Mbetjeve Korce**	**06220**	**1515**	**KM06089**
5852299	08-2018	1,021,575	D	-300,000	1006933	Njesia Manaxh. projektit segmt rrugor Qukes Qafe Plloce, Lot 1,2	04520	3535	KM06111
5852299	08-2018	1,200,000	D	-450,000	1006933	Njesia Manaxh. projektit te ndertimit segmt rrugor Qukes Qafe Plloce	04520	3535	KM06112
5852299	08-2018	200,000	D	-180,000	1006095	DP Hekurudhave Durres	04550	0707	KM06125
5852299	08-2018	93,000	D	-85,000	1006095	DP Hekurudhave Durres	04550	0707	M063981
5852299	08-2018	130,000	D	-40,000	1006001	Aparati MIE	06180	3535	M064080
5852299	08-2018	35,200	D	-35,200	1006001	Aparati MIE	06180	3535	M064083
5852299	08-2018	35,716	D	-10,000	1006001	Aparati MIE	04320	3535	M064092
5852299	08-2018	1,374,300	D	-19,191	1006001	Aparati MIE	04320	3535	M064093
5852299	08-2018	55,000	D	-10,000	1006001	Aparati MIE	04320	3535	M064096
5852299	08-2018	127,989	D	-82,000	1006156	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	04430	3535	M064107
5852299	**08-**	**500,000**	**D**	**-**	**2101001**	**Bashkia Tirana**	**06220**	**3535**	**M064236**

	2018			**500,000**					
5852299	08-2018	-	I	10,000	1006047	DP UK	06370	3535	KM06076
5852299	08-2018	-	I	30,000	1006047	DP UK	06370	3535	KM06077
5852299	08-2018	-	I	30,000	1006047	DP UK	06370	3535	KM06090
5852299	08-2018	3,000,000	I	1,500,000	1006001	Aparati MIE	04320	3535	KM06129
5852299	08-2018	-	I	1,600	1006915	PIU Porti Durres	04540	3535	M062650
5852299	08-2018	-	I	19,200	1006001	Aparati MIE	04540	3535	M062800
5852299	08-2018	32,320	I	34,000	1006047	DP Ujesjelles Kanalizimeve	06370	3535	M063682
5852299	08-2018	60,183	I	43,000	1006047	DP Ujesjelles Kanalizimeve	06370	3535	M063875
5852299	08-2018	107,707	I	200,000	1006047	DP Ujesjelles Kanalizimeve	06370	3535	M063887
5852299	08-2018	-	I	250,000	1006001	Aparati MIE	04520	3535	M064247
5852299	08-2018	-	I	24,000	1006001	Aparati MIE	04560	3535	M064248
5852299	08-2018	-	I	7,000	1006160	Agj. Komb.Planif.Territorit	06180	3535	M064249

Për vlerësim të përputhshmërisë së rregjistrimeve në SIFQ për rishpërndarjet buxhetore, nga grupi i auditimit u kërkuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit shkresat miratuese edhe për rregjistrimet e listuara në tabelën në vijim, nga të cilat u përgjigj fillimisht vetëm Drejtoria e Financave vendore e cila vuri në dispozicion shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të datës 3.04. 2018 nr.prot. 5684/1 "*Alokim i investimeve nga FZHR për projektet në vazhdim*". Lista e shkresave miratuese të kërkuara për rishikimet e paraqitura në tabelën si më poshtë, u vunë në dispozicion me observacionin e datës 28.8.2019 nr.prot.5928/27:

ID#	GL_PERIOD	B.Fillestare	P/SH	Shuma e rishik 000/leke	Kodi inst	Emri i Institucionit	Programi	Projekti	dt.rishiki
5802293	06-2018	-	I	90,225	1087023	Agjencia Zhvillimit Rajonal nr.2 Tiranë	01150	M870207	06-Jun-18
5803298	06-2018	-	I	25,687	1011041	Universiteti Bujqesor	09450	M112798	11-Jun-18
5803298	06-2018	-	I	53,849	1011040	Universiteti Politeknik	09450	M112799	11-Jun-18
5803298	06-2018	-	I	62,844	1011047	Akademia e Arteve	09450	M112801	11-Jun-18
5798294	05-2018	-	I	122,617	1016079	Aparati i DP te policise	03140	M160977	28-May-18
5781312	**04-2018**	**-**	**I**	**55,595**	**1005118**	**AKU**	**04220**	**M050437**	**02-May-18**
5781323	05-2018	-	I	259,280	1010039	DPT	01140	M100500	02-May-18
5799309	05-2018	-	I	48,650	1010077	DPD	01150	M100024	31-May-18
5794293	05-2018	-	I	576,000	1006054	ARRSH	04520	M064228	21-May-18
5794293	05-2018	-	I	96,000	1006054	ARRSH	04520	M064230	21-May-18
5794292	04-2018	-	I	70,000	1026001	Ministria e Mjedisit	04760	M260403	21-May-18
5794292	04-2018	-	I	35,000	1026001	Ministria e Mjedisit	04760	M260404	21-May-18

Nga auditimi i këtyre shkresave rezulton një rast i rregjistrimit në SIFQ i rishikimit në një datë më të hershme nga ajo e shkresës miratuese, konkretisht rishikimi me ID# 5781312 për projektin M050437 me përfitues AKU në shumën 55,595 mijë lekë i rregjistruar në datën 02.05.2019 ndërkohë që shkresa miratuese e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë mban datën 03.07.2019.

Të dy rastet e shqyrtuara në këtë gjetje: projekti M064236 dhe M050437 janë

	rregjistruar me data efektive (GL date) më të hershme se data e miratimit. Nisur nga ky rast u përpunuan të dhënat për të gjitha rishikimet e kryera gjatë vitit 2018 ky u konstatua se në shumë raste rregjistrime me data efektive (GL period) retrospektive, cështje e trajtuar më hollësisht në vijim të këtij Raporti**.**
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Ligji nr.68/2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*; *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018*
Shkaku	Thyerje e procedurave të miratimit ligjor të shpërndarjes dhe rishpërndarjes së fondeve në përgjegjësinë e NPA
Rëndësia	E lartë

Observacioni i subjektit nr.5928/27 dt.28.8.2019, *Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve publike vuri në dispozicion shkresat miratuese të kërkuara të cilat pasi u shqyrtuan u reflektuan në gjetjen sa më lartë.*

Observacioni i subjektit nr.5927/13 dt.27.8.2019, *Drejtoria e Financave Vendore ripërsërit procesin e miratimit të projekteve të financuara nga FZHR, specifikat e këtij procesi duke theksuar dhe ritheksuar që Drejtoria e Financave vendore " ...nuk ka asnjë rol në buxhetimin e projekteve të bashkisë të financuara me të ardhurat e veta. Buxheti i Bashkisë miratohet nga Këshilli Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi për pushtetin vendor, dhe kontratat rregjistrohen në thesar sipas procedurave përkatëse".. më tej Observacioni citojmë "...bazuar në kërkesën zyrtare drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit me paraqitjen pranë ekipit të KLSH-së, të gjithë dokumentacionit pë rvitin 2018, për FZHR-Infrastruktura vendore dhe rajonale, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit/Drejtoria e Financave Vendore ka paraqitur të gjithë shkresat e akordimit të fondeve gjatë gjithë vitit buxhetor dhe ka qënë në dispozicion të ekipit të KLSH-së për cdo informacion që kanë kërkuar. Në këto kushte duhet*

ti rishikoni edhe një herë problematikat që keni paraqitur në Akt-konstatimin nr.6 lidhur me projektet e financuara nga FZHR-Infrasturktura vendore dhe rajonale".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Theksojmë se përvec një shkrese të Ministrit të financave për miratimin e shpërndarjes së fondit të FZHR, gjatë periudhës së auditimit konkluduar më 23.8.2019 nuk kemi marrë asnjë dokumnet tjetër fizik nga kjo Drejtori, për rastin në fjalë. Kemi sqaruar verbalisht dhe elektronikisht se, për rastin e projektit "Rikualifikimi i sheshit Skënderbëj Faza e I-rë dhe II-të, përvec sqarimeve me e-mail të Drejtorit të Drejtorisë së Financave vendore mbi procedurat dhe procesin e miratimit dhe vecoritë e buxhetit të vendorit, KLSH specifikisht ka kërkuar dokumentacion fizik nga të gjitha hallkat e përfshira: Drejtoria e Buxhetit, DPTH, Dega Thesarit, Bashkia Tiranë. Deri në datën e përpilimit të Ak-konstatimit nr.6 pjesërisht dokumentacioni përkatës është vënë në dispozicion vetëm nga Dega e Thesarit Tiranë. Gjithashtu për projektin M870207 në listë shkresa realisht është vënë në dispozicion me observacionin nr. 5928/27 të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve publike. Gjithësesi, theksojmë se Akt-konstatimi nr.6 nuk ka ngritur problematika në lidhje me projektet e FZHR-rë por vetëm liston **kërkesat për dokumentacion fizik** të disa rasteve pa përgjigje deri më 23.8.2019.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe përgjegjësitë eparashikuara për secilën strukturë në MFE mban përgjegjësi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj. M D, Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të buxhetit me drejtor znj.Xh A, Drejtoria e Menxhimit t Investimeve me drejtor znj.S S, Drejtoria e Financa vendore me drejtor Z.F B, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të parashikuara në ligj për parandalimin e shkeljeve dhe përmirësimin e situatës.

Gjetje:	**Në listën e rishikimeve buxhetore në SIFQ nuk identifikohen projektet e miratuara me Aktin Normativ nr.1, duke i bërë ato thjesht një përmbledhje dhe legjitimim i ndryshimeve tashmë të ndodhura gjatë periudhës Prill- 26 Korrik 2018 të gjithsej: 510[3] projekte për investime me një shumë fondi të rishpërndarë prej 14.3 miliardë lekë.**
Situata:	Sipas Metodologjisë për Monitorimin dhe Raportimin e Investimeve Publike, në përputhje me ciklin e buxhetimit të projekteve dhe të përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit, raporti për progresin 6-mujor të zbatimit të investimeve do të shërbejë si bazë për rialokime të mundshme të shpenzimeve për investime në kuadër të rishikimit të buxhetit të shtetit. Në këtë kuadër Akti Normativ nr.1 i datës 26/7/2018 synon një rishpëndarje të fondeve midis projekteve në varësi të ecurisë së tyre si dhe miratimin e projekteve të reja. Njësoj si në procesin e celjeve fillestare, pas miratimit në nivel agregat, cdo institucion duhet të bëjë detajimin e fondeve nga nivel programi në nivel projekti dhe më pas njofton Drejtorinë e Buxhetit për të bërë efektive rishpërndarjet në SIFQ. Në kuadër të këtij auditimi, iu kërkua Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të identifikonte në tabelën përmbledhëse të plan buxhetit për investimet që na u vu në dispozion, se cilat projekte ishin prekur (miratuar) nga Akti Normativ nr.1. Përgjigjja e specialistëve të kësaj Drejtorie ishte se rishikimet mund ti gjejmë në muaj specifik, rast pas rasti duke mos na vënë kështu në dispozicion listën e projekteve të miratuara me AN1 dhe AN2. Me qëllim testimin e rregjistrimeve për rishpërndarjeve të fondeve u shqyrtua dhe databaza e rregjistrimeve të nxjerra nga SIFQ ku gjithashtu është i pamundur

[3] *Tabela "Rishikimet2018" nga SIFQ, vetëm rregjistrimet me shtesë fondi për projektet me financim të brendshëm (MXX)*

identifikimi i projekteve të prekura nga rishpërndarjet buxhetore të miratuara me AN1 pasi nga pikëpamja kohore rishikimet shtrihen përgjatë gjithë periudhës me një numër mesatar pothuaj të njëjtë rishikimesh në bazë mujore përgjatë gjithë vitit.

Procedurialisht, Akti Normativ i cili daton 26 Korrik 2018, pas detajimeve përkatëse gjen reflektim në SIFQ në muajin Gusht-Shtator sic edhe konfirmohet nga datat që mbajnë shkresat njoftuese të Nëpunësit të Parë Autorizues dërguar Degëve të Thesarit për të bërë celjet përkatëse për projektet e prekura nga AN1. Në këta muaj pritet që dhe numri i rishpërndarjeve të ishte i lartë, m**egjithatë një numër i lartë rishikimesh janë rregjistruar edhe në periudhën para Aktit Normativ nr.1, pikërisht në muajt Prill-26 Korrik 2018, ku vetëm për projektet për investime janë rishikuar fondet e 510 projekteve për 110 institucione në shumën 14.3 miliard lekë**. Në mënyrë të detajuar rishikimet e kësaj periudhe paraqiten në Aneksin nr.7 të këtij raporti.

Përsa i përket **Aktit Normativ nr.2 i datës 19.12.2018**, në SIFQ rezultojnë 196 rregjistrime të kryera nga data 20.12.2018 deri 31.01.2019 me datë efektive vitin 2018. Nga këto rregjistrime vecojmë 74 rialokime për projekte të cilat financohen për herë të parë në shumën 1.9 miliardë lekë, nga të cilat 55 janë projekte me financim të brendshëm në shumë 0.963 milionë lekë, duke lënë të kuptohet se kemi të bëjmë me projekte të reja të miratura me AN2. Nga verifikimi i kodeve të projekteve me databazën e investimeve rezulton se vetëm 41 projekte jane projekte të filluara rishtazi.

Gjithashtu, në përpjekje për të identifikuar projektet e reja të miratuara gjatë vitit 2018 me qëllim testimin e përputhshmërisë së procedurave të miratimit u grupuan të gjitha rishikimiet për projekte për investime me buxhet fillestar zero për të cilët më pas, para apo pas Akteve Normative ju janë alokuar fonde buxhetore, konkretisht:

-795 projekte me financim të brendshëm në shumën 18.13 miliardë lekë

-586 projekte financuar me fondet e veta nga Bashkitë në shumën 23.56 miliardë lekë celje të reja

Tabela në vijim paraqet vetem rishpërndarjet per projektet "e reja" me financim të brendshëm ku 3-mujori i dytë i vitit ka dhe numrin më të lartë të rishikimeve, para datës 26.7.2018 të Aktit Normativ nr.1

Institucioni	Qtr1	Qtr2	Qtr3	Qtr4	Total
Bashkitë	257	8,424,590	258,822	123,625	8,807,293
Fondi i Zhvillimit Shqipetar	33,678	807,138	350,158	1,642,564	2,833,537
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	23,313	1,031,492	504,500	296,272	1,855,577
Ministria e Financave dhe Ekonomise	153,303	423,455	327,364	405,679	1,309,801
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	59,436	208,104	275,805	202,351	745,695
Ministria e Brendshme		163,586	134,262	151,700	449,548
Institucione te tjera Qeveritare	50,012	215,976	13,400	133,381	412,770
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	75,400	173,912	25,518	2,987	277,817
Ministria e Mbrojtjes		70,000	36,000	148,000	254,000
Ministria e Drejtesise	15,122	140,067	28,293	44,600	228,082
Drejtoria e Pergjithshme e RTSH			100,000	100,000	200,000
Ministria e Kultures		182,160	6,008	1,610	189,779
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit		140,000	43,829		183,829
Ministria e Shëndetesise dhe Mbrojtjes Sociale		22,520	13,080	101,639	137,239
Kuvendi	40,230		7,800		48,030
Drejtoria e Arkivit te Shtetit		35,000		950	35,950

Kontrolli Larte i Shtetit	7,025		21,975		29,000
Sherbimi Informativ Kombtar	2,250	10,800	14,000	1,920	28,970
Institucione të tjera	***15,950***	***45,281***	***21,083***	***23,099***	***105,412***
Total	**475,976**	**12,094,080**	**2,181,897**	**3,380,377**	**18,132,330**

Në konkluzion, **në tabelën përmbledhëse të plan buxhetit fillestar dhe atij operativ të fundvitit 2018 ishte e pamundur për grupin e auditimit të identifikonte projektet e reja të miratuara <u>vetëm nga AN1</u> apo shtesat për projektet ekzistuese**. Mos vënia në dispozicion i listës së projekteve të reja miratuara nga Drejtoria e Investimeve, si dhe numri i lartë i rishikimeve përgjatë gjithë vitit buxhetor na con në konkluzionin se Aktet Normative janë thjesht përmbledhje dhe legjitimim i rishikimeve buxhetore tashmë të ndodhura gjatë vitit. Në vijim, disa nga këto projekte janë testuar për të vlerësuar nëse ato janë realisht janë rishpërndarje për projekte "të reja".

Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*; *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018*; *Metodologjia për Monitorimin dhe Raportimin e Investimeve Publike*
Impakti:	Nxjerrja e akteve normative formale në emer të krijimit të projekteve të reja duke legjitimuar ndryshimet e ndodhura faktikisht para datës së këtyre akteve.
Shkaku:	Mungesë kontrolli dhe monitorimi i projekteve për shpenzime për investime në përgjegjësië e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit
Rëndësia	E lartë

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe përgjegjësitë eparashikuara për secilën strukturë në MFE mban përgjegjësi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj. M Dh, Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të buxhetit me drejtor znj.Xh A, Drejtoria e Menxhimit t Investimeve me drejtor znj.S S, Drejtoria e Financa vendore me drejtor Z.F B, Drejtoria e

Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të parashikuara në ligj për parandalimin e shkeljeve dhe përmirësimin e situatës.

Gjetje:	**Celje fillestare dhe rishpërndarje fondesh me Akte Normative për të mbuluar detyrime të krijuara rishtaz dhe të prapambetura, mbartur nga vitet e kaluara, në total në shumën 19.8 miliard lekë nga të cilat 13.7 miliardë lekë për shpenzime për investime ose 26% e financimit të brendshëm**
Situata:	Sipas nenit 43 "Detajimi i fondeve buxhetore**"** Nëpunësit autorizues detajojnë fondet për njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me shpërndarjen e fondeve buxhetore, të miratuara nga Ministri i Financave dhe përparësitë e njësive të qeverisjes së përgjithshme. Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qëndrore i paraqesin nëpunësit të parë autorizues propozimin për detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese në përputhje me udhëzimin për zbatimin e buxhetit. Sipas prioriteve të përcaktuara për tu mbajtur parasysh në planifikim, fonde të caktuara për programe apo projekte planifikohen për pagesa të detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara. Kështu, nga përpunimi i të dhënave të pagesave të kryera **gjatë vitit 2018, evidentohen 15,186 rregjistrime për fatura shpenzimesh të kryera në vitet e mëparshme, në vlerën prej 19.8 miliardë lekë nga të cilat 13.7 miliard për shpenzime për investime** (sipas balancave në llogarinë 230 dhe 231) nga gjithsej 52.6 miliardë lekë që është buxheti i vitit korrent për këtë zë ose 26% e tij. Sipas llojit të shpenzimit dhe sipas institucioneve këto pagesa paraqiten në tabelën në vijim ku evidentohet se njësitë e qeverisjes vendore, Ministria e Infrastrukturës dhe Fondi Zhvillimit Shqiptar janë ndër institucionet që mbartin detyrimet në vlera më të larta:

Ministria e linjës	**Blerje dhe mallra**	**Paga dhe shperblime**	**Sherbime dhe material e te tjera**	**Shpz gjyqesore per largim nga puna**	**Shpenzime gjyqesore te tjera**	**Shpenzime per rritje AQT**	**Subvenc., kompensime, transferta**	**Total në 000/lekë**
Bashkitë	789,960	216,076	**1,656,298**	97,777	349,514	**5,916,385**	30,761	9,056,771
MIE	10,532	4,867	**946,851**	4,037	10,000	**3,370,622**	111,271	4,458,181
FZHSH						**3,452,387**		3,452,387
MASR	25,234	318,014	**34,060**	1,675		**287,618**	23,247	689,849
MSHMS	172,523	172,994	**139,055**	16,588	717	**176,230**	1,029	679,135
MFE	27,409	71,135	**167,485**	345	99	**91,454**	5,213	363,141
MBZHR	21,437	1,686	**3,001**	5,256		**226,604**	7,012	264,996
Ministria e Mbrojtjes	94,035	35	**92,089**	226		**7,909**	13,816	208,112
Min. Brendshme	60,406	62,972	**36,107**	372	116	**19,142**	1,238	180,353
Inst. tjera Qeveritare	8,222	877	**67,550**			**105,266**	53	181,968
Min. e Drejtesise	53,388	14,430	**11,112**	622	3,836	**62,918**	30	146,336
Ministria e Kultures	2,784	2,546	**3,621**			**11,801**	3,372	24,123
KLGJ	4,610	9,160	**8,941**			**35**	717	23,463
MTM	914	1,895	**2,996**			**11,268**	6,398	23,471

Presidenca	2,540		**13,219**					15,759
Prokuroria Pergjith.	3,164	6,759	**3,005**				348	13,277
MEPJ	1,951		**6,297**			**788**		9,037
ShIK	2,583	2,753	**820**				8	6,164
KQZ	251		**2,638**			**3,186**		6,075
Instituti Statistikes	520	231	**4,745**					5,496
Kuvendi	1,012		**1,225**			**379**		2,616
Veprimtaria e Mbikq.Rivl. sist. e Drejtesise	1,472		**158**				539	2,169
Institucione të tjera	***1,591***	***23***	***2,685***	***0***	***0***	***481***	***140***	***4,921***
Total	**1,286,538**	**886,453**	**3,203,958**	**126,898**	**364,282**	**13,744,473**	**205,194**	**19,817,797**

Detajuar sipas projekteve, celjeve fillestare, rishikimeve dhe pagesave të kryera për këto projekte rezulton se nga 1207 celje për projekte për investime në total 52.6 miliardë lekë, për **84 prej tyre celja është bërë vetëm për të kryer pagesat e faturave të prapambetura me vlerë 1.6 miliardë lekë, pra celja buxhetore është ekzaktësisht e barabartë me vlerën e fatures (ve) të prapambetura**. Rastet e shqyrtuara ku vlera e faturave të prapambetura të paguara =celjen buxhetore me Ligj buxheti apo AN1, paraqiten në tabelën në vijim:

Emri Institucionit	**Nr. Projekteve**	**Celje+AN2 në 000/lekë**[4]	**Pagesa Për fatura para v.2018 000/lekë**
Bashkia Tirana	4	349,345	349,345
Autoriteti Rrugor Shqiptar	12	229,469	229,469
Bashkia Maliq	6	144,959	144,959
Bashkia Librazhd	4	125,181	125,181
Bashkia Koplik	1	83,955	83,955
Bashkia Durres	1	75,497	75,497
Bashkia Korce	4	63,403	63,403
Bashkia Berat	2	62,064	62,064
Bashkia Gjirokaster	1	52,235	52,235
DP e Ujesjellës Kanalizimeve	4	49,374	49,374
Aparati Ministrisë së Drejtësisë	1	43,080	43,080
Bashkia Ersekë	3	37,893	37,893
Bashkia Ballsh	2	33,852	33,852
Bashkia Fushë-Arrëz	1	32,592	32,592
Bashkia Ura Vajgurore	1	35,612	35,612
Bashkia Vlorë	2	25,181	25,181
Bashkia Bilisht	1	27,812	27,812
Bashkia Fier	2	26,708	26,708
Bashkia Bulqizë	1	24,211	24,211
Bashkia Lezhë	1	14,185	14,185

[4] *Sipas tabelës së investimeve të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve*

Aparati MFE	1	13,816	13,816
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë	2	11,046	11,046
Bashkia Kucovë	1	10,808	10,808
NJësi të tjera	***24***	***79,972***	***79,972***
Total	**84**	**1,652,251**	**1,652,251**

Ndërkohë që ka patur 129 projekte për investime të 67 njësive ekonomike, fondet e alokuara të të cilave nuk janë përdorur për projektet e planifikuara dhe as nuk janë rialokuar në projekte të tjera në nevojë për fonde, qëllim ky i Akteve normative pas gjashtë mujorit të pare, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim:

Emertimi Institucionit	**AN2 dt. 19.12.2018 + VKM Në 000/lekë**
Aparati i MASR	87,174
Aparati Drejt.Pergj.Doganave	68,604
Universiteti Politeknik	53,850
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	36,000
Agjencia Komb.Kërkimit Shkencor,Inovacionit	29,135
Aparati Ministrise se Drejtësisë	24,044
Akademia e Arteve	17,845
Autoriteti Komb. Çertif. ElektronikSigurinë Kibernetike	16,000
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	15,347
Bashkia Bilisht	15,246
Aparati i MTM	11,171
Agjencia e Eficencës së Energjisë	11,000
Aparati Ministrisë së Financave dhe Ekonomise	10,470
Njësi të tjera	***125,916***
Total	**521,801**

Një tjetër testim i kryer në lidhje me planifikimin e drejtë dhe rradhës së prioriteteve u krye duke shqyrtuar të dhënat e publikuara nga MFE mbi ecurinë e investimeve nga ku **konstatohen 53 projekte për investime me shuma të rregjistruara si "unpaid commitment" për vitin korrent 2018 në vlerën 286 milionë lekë për të cilat nuk u parashikuan fonde buxhetore.** Analiza e statusit të këtyre projekteve, nëse kemi ndërprerje të punimeve apo kjo nuk është objekt i këtij auditimit. Megjithatë, ky fakt sillet në vëmendje për të theksuar mundësinë që ofron SIFQ për monitorimin e projekteve nga drejtoritë përkatëse si dhe raportimit të anagazhimeve të qeverisë jashtë bilancit apo tabelës së treguesve fiskal. Në këtë kontekst, në përputhje me pikë 59 të Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 06.02.2012, Plani vjetor i buxhetit, akorduar nga Ministria e Financave për buxhetin qëndror në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, përfaqëson limitin maksimal të lejuar për t'u shpenzuar nga njësitë shpenzuese dhe struktura përgjegjëse për thesarin. *Gjatë detajimit të planit të buxhetit, njesitë e qeverisjes qëndrore më parë shpërndajnë fonde për të paguar detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve. Gjithashtu sipas pikës 65 të po këtij Udhëzimit, plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qëndrore në nivel projekti, mban parasysh këtë rradhë prioritare: a. Investimet në proçes nga viti i kaluar; b. Objektet e investimeve të paraqitura në Kuvend, gjatë shqyrtimit të projekt –buxhetit; c. Bashkëfinancimet e buxhetit të shtetit në projektet me financime të huaja; d. Investimet sipas prioriteteve sektoriale të miratuara në programin buxhetor afatmesëm.* **Nga shqyrtimi i pagesave të kryera gjatë 5-mujorit të parë të vitit 2019 si dhe nga numri i lartë i kontratave të viteve 2001-2018 të rregjistruara, shtjelluar më hollësisht në pikën 2.6 të këtij raporti, konstatojmë se shlyerja e detyrimeve të prapambetura vazhdon të jetë një ngarkesë për vitin korrent buxhetor. Kështu në**

	këtë 5-mujor rezultojnë pagesa të detyrimeve të prapambetura për investime në shumën 2.95 miliardë lekë.
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018*; *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018*;
Impakti:	Përdorimi I buxhetit të vitit korrent për detyrimet e prapambetura që vazhdojnë të krijohen nga viti në vit në vend të financimit të projekteve të reja
Shkaku:	Pavarësisht prioriteteve për planifikim të fondeve buxhetore për detyrimet e prapambetura, celja e këtyre fondeve është një praktikë e konstatuar përgjatë gjithë vitit buxhetor në diskrecionin e institucionit dhe e facilituar nga MFE.
Rëndësia	E lartë

Gjetje:	**Mbi rishikimet në lidhje me fondin rezervë: kontabilizime/rregjistrime pa informacion për destinacionin e fondeve të shkurtuara sipas AN2 të fondit rezervë nga 2.6 në 1.5 miliardë lekë.**

Situata:

Nga shqyrtimi i të dhënave mbi rishikimet buxhetore, 26 rregjistrime janë të lidhura me përdorimin e Fondit Rezervë i cili sipas Aktit Normativ nr.2 është shkurtuar në shumën 1,500 milion lekë. Nga rregjistrimet e bëra në SIFQ deri në datën 19.12.2018 të këtij akti, janë shpenzuar nga ky fond gjithsej 956,625 mijë lekë nga të cilat 120,000 mijë lekë për shpenzime për investime për Ministrinë e Drejtësisë. Deri në dt.31.12.2018 rezultojnë këto rregjistrime:

Nr.	Kodi institucionit	Emri i Institucionit	Llog. Ekonomike	Pershkrimi	Shuma e rishikuar ne 000/lekë
1	1006001	Aparati Min. Infrastukturës dhe Energjisë	602	Mallra dhe shërbime të tjera	77,400
			604	Transferime korrente të brendshme	80,000
2	1010001	Aparati Ministrise se Financave	602	Mallra dhe shërbime të tjera	257,058
			604	Transferime korrente të brendshme	35,552
3	1016059	Prefektura e qarkut Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirok., Korcë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë	231	Shpenzime AQT **(Blerje Autovetura)**	39,000
4	1087002	Drejtoria Sherb. Qeveritare	603	Subvencione	75,034
5	1087006	AKSHI	231	Shpenzime AQT	95,450
6	1010039	Aparati Drejt.Përgj.Tatimeve	231	Shpenzime AQT- **Implementimi në sistemin tatimore-taxation të ndryshimeve ligjore të paketës fiskale 2019**	50,000
7	1012001	Aparati Ministrise Turizmit	604	Transferime korrente te brendshme	40,000
			605	Transferime korrente te jashtme	6,302
8	1026001	Ministria e Mjedisit	602	Mallra dhe shërbime te tjera	80,934
			605	Transferime korrente te jashtme	2,784
9	1014001	Aparati Ministrisë së Drejtesisë	231	Shpenzime AQT	120,000
10	1015002	Përfaqësite Diplomatike	602	**transferim fondi ambasadave**	83,639
			605	Transferime korrente të jashtme	12,900
11	1020001	Drejtoria e Arkivave Shtetit	231	Shpenzime AQT- **Rikonstruksion, Shtrirje rrjeti, mobilim i Salles se Studimit dhe Laburatorit**	35,000
12	1026087	Agj. Kombëtare Zonave Mbrojtura	600	Paga dhe shpërblime, sig shoq	35,010
13	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar	602	Mallra dhe shërbime te tjera	22,131
14	1012024	Teatri Operas dhe Baletit	604	Transferime korrente të brendshme **(honorare për shfaqje)**	8,000
15	1012097	Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi	604	Transferime korrente të brendshme	4,200
16	1016020	Drejtoria e Policisë Tiranë	606	Transferta për buxhetet familjare	792
17	1010284	Enti Kombëtar i Banesave	606	Transferta për buxhetet familjare	6,064
18	1073001	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	600	Paga dhe shpërblime	5,000
	Total				**1,172,249**

Në një prej rregjistrimeve nuk përcaktohet llogaria dhe institucioni si destinacion i përdorimit të fondit rezervë në shumën prej 100 milionë lekë:

ID e rishikimi	GL_Period	Budget_Balance	Lloji rishikimit	Pakësimi 000/lekë	Shtesa 000/lekë	Ending Balance	Kodi institucionit	Institucioni/Ministria e linjes
5868331	10-2018	1,803,264	D	-100,000		1,703,264	1049001	(T) Fondi Rezerve

5868331	10-2018		I		?		?	?

Gjithashtu, në veprimin korrigjues të balancës së re të Fondit Rezervë sipas Aktit Normativ nr.2, nuk përcaktohet destinacioni i fondit të shkurtuar prej 1,100 milionë lekë përvec 275,000 mijë lekë që shkojnë në favor të fondit rezervë për rritjen e pensioneve:

REVISION_ID	GL_Period	Budget_Balance	Lloji rishikimit	Pakësimi 000/lekë	Shtesa 000/lekë	Ending Balance	Kodi institucionit	Institucioni/Ministria e linjes
5899304	12-2018	1,643,375	D	-1,100,000		543,375	1049001	(T) Fondi Rezerve
5899304	12-2018		I		275,000		1081002	(T) Rezerve per rritjen e pensioneve
5899304	12-2018		I		825,000		?	?

Rregjistrime e fundit për rialokim për përdorimi të fondit rezervë janë kryer më 21 Janar 2019 ku destinacion ka qënë Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës në shumën 324,966 mijë lekë duke mbyllur kështu balancën e kësaj llogarie me shumën e papërdorur prej 2,755,157 lekë.

Kriteri:

Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;
Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".
VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".
Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".
Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1
VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"
Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"
Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;
Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;

Shkaku: Përshkrime të paplota të veprimeve në SIFQ në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit

Rëndësia E lartë

Gjetje:	**Mbi 255 rregjistrime të rishikimeve buxhetore me data efektive retrospektive në shumën 5.4 miliardë lekë**
Situata:	Nga shqyrtimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, një tjetër fenomen që vihet re është rregjistrimi i rialokimeve me data kontabile, efektive të mëparshme (retrospektive). Përvec rasteve të cituara më lartë në lidhje me sistemimet e llogarisë së Borxhit dhe sistemimit të celjes së gabuar për investimin e Bashkisë Kamëz, duket se rregjistrimet me prekje të periudhave të mbyllura është një rutinë e zakonshme. Konkluzion ky i arritur bazuar në numrin e lartë të rasteve të konstatuara. Kështu vetëm në llogarinë e investimeve 230 dhe 231 rezultojnë gjithsej 255 rregjistrime datat efektive të të cilave janë të një ose disa muajve më të hershëm.

Nr.rishikimeve													
Data GL	**Jan**	**Feb**	**Mar**	**Apr**	**May**	**Jun**	**Jul**	**Aug**	**Sep**	**Oct**	**Nov**	**Dec**	**Total**
01-2018	1	3	1										5
01-2019									63	19	19	2	103
01-2020											1		1
02-2018		24	2										26
03-2018			8	15			1						24
04-2018				173	19								192
05-2018					75	6							81
06-2018						122	2		1		3		128
07-2018							99	10			1		110
08-2018								97	33				130
09-2018									21	6	2		29
10-2018										125	5	8	138
11-2017	2												2
11-2018											119	3	122
12-2017	51												51
12-2018												137	137
Total	**54**	**27**	**11**	**188**	**94**	**128**	**102**	**107**	**118**	**150**	**150**	**150**	**1,279**

Për të vlerësuar më tej këtë praktikë, arsyen e rregjistrimeve të tilla, autorizimet dhe udhëzimet përkatëse dhënë Degëve të Thesarit iu drejtuam Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit për të marrë një shpjegim mbi situatën por nuk morëm një përgjigje[5]. Në përputhje me Udhëzimin e përhershëm, detajimi i buxhetit dërgohet zyrtarisht tek çdo njësi qëndrore dhe bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi rregjistrohet në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) nga struktura përgjegjëse për buxhetin. Cdo rregjistrim kalon nëpër disa faza miratimi. Kështu sipas udhëzuesit Urdhërit nr 62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit" ku parashikohen këto hapa:

1) Pranimi i dokumentacionit nga institucionet buxhetore; 2) Hetimi i të dhënave në sistemin e thesarit; 3) Regjistrimi i transaksionit te rishikimit; 4) Paraqitja per aprovim; Veprimi i aprovimit; Postimi i rishikimit te buxhetit ne LM; Kryerja e mbylljeve ditore ne sistem, duke parashikuar kështu mjaftueshëm kontrolle për shmangien e gabimeve në rregjistrim. Gjithashtu, pas këtyre veprimeve procesi i rradhës është azhornimi i planit të

[5] *E-mail i dt.15.08.2019*

	thesarit.
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"*
Impakti:	Shkelje e rregullave të rregjistrimit të një transaksion në momentin kur ai është i miratuar
Shkaku:	Mungesë kontrollesh dhe thyerje e procedurave të rregjistrimit të dokumentave dhe transaksioneve nga personat autorizues
Rëndësia	E lartë

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe përgjegjësitë eparashikuara për secilën strukturë në MFEmban përgjegjësi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj. M Dh, Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të buxhetit me drejtor znj.Xh A, Drejtoria e Menxhimit t Investimeve me drejtor znj.S S, Drejtoria e Financa vendore me drejtor Z.Fran Brahimi, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të parashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Gjetje:	**Mbi të drejtën e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarje të fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, përtej afatit ligjor të 15 Nëntorit.**
<u>Situata:</u>	Në përputhje me Udhëzimin plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2 dt.

19/01/2018, pika 7 e tij, e drejta e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri më datën 15 Nëntor të vitit, e cila konsiderohet si data e fundit e paraqitjes së kërkesës për rialokim pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga shqyrtimi i të dhënave të vëna në dispozicion, të marra nga sistemi SIFQ rezultojnë gjithsej 58 rregjistrime për rishikim të buxheteve të 178 projekteve për investime me financim të brendshëm. Nga këto rishikime që datojnë midis datës 16 Nëntor deri në 19 Dhjetor 2018 (data e Aktit Normativ nr.2) u përzgjodhën 16 prej tyre dhe u kërkua informacion mbi datat e kërkesave të dërguara nga Institucionet, fondet e të cilave janë prekur përmbledhur në tabelën në vijim:

	Pakësim fondi		**Shtesë fondi**		**Total**
Institucioni	**Nr.**	**Shuma**	**Nr.**	**Shuma**	**Nr.**
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	19	- 662,339	13	539,568	32
Institucione te tjera Qeveritare	2	- 1,369	2	1,369	4
Ministria e Brendshme	2	- 143,341	9	237,169	11
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	2	- 16,787	3	16,787	5
Ministria e Drejtesise	2	- 29,000	3	29,000	5
Ministria e Financave dhe Ekonomise	20	- 174,357	31	165,888	51
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	8	- 375,340	6	375,340	14
Ministria e Kultures	1	- 446	1	446	2
Bashkitë	10	- 244,370	40	375,609	50
Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivleresimit ne sistemin e Drejtesise	2	- 700	2	700	4
Total	**68**	**- 1,648,048**	**110**	**1,741,877**	**178**

Nga informacioni i dërguar nga Drejtoria e Buxhetit rezulton se për të 16 rastet e përzgjedhura kërkesat e dërguara nga institucionet mbanin datat midis 11 Tetor deri 15 Nëntorit, pra brenda afatit ligjor.

Kriteri:

Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;
Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".
VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".
Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".
Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I

	ndryshuar, neni 4 pika 1 *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve"*
Rëndësia	E lartë

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe përgjegjësitë eparashikuara për secilën strukturë në MFE mban përgjegjësi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj. M Dh, Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të buxhetit me drejtor znj.XhA, Drejtoria e Menxhimit t Investimeve me drejtor znj.S S, Drejtoria e Financa vendore me drejtor Z.F B, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të parashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Mbi rregjistrimin e planit të pagesave të kontratës sipas PBA

Sipas pikës 24 të udhëzimit plotësuaes nr.2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", për të siguruar kontrollin që angazhimet shumëvjecare të jenë brenda tavaneve trevejecare të fondeve, të miratuara me ligj vjetor të buxhetit, duhet që njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të rregjistrojnë dhe mbartin direkt (BI online) ose nëpërmjet degës së thesarit (BI offline), kontratat e tyre, vjetore apo shumëvjecare, të reja apo në vazhdim, sipas vlerave përkatëse për cdo vit të buxhetit të miratuar trevjecar. Nga informacioni i marrë dhe vitin e kaluar nga Drejtoria e Procesimit të Biznesit, që prej muajit Prill 2016 në sistemin SIFQ, janë shtuar fusha për të rregjistruar kontratën në mënyrë të plotë dhe sipas skedulit të pagesave dhe PBA-së së miratuar. Kjo si domosdoshmëri kontrolli dhe monitorimi jo vetëm për buxhetin faktik por dhe për qëllim planifikimi të buxhetit të vitit të ardhshëm. Aktualisht ky kontroll nuk përdoret dhe informacioni për shpërndarjen në vite të kontratës plotësohet në mënyrë rastësore dhe i jo i detyrueshëm. Nëse kontrata rregjistrohet me shumën e saj të plotë, sistemi përputh vlerën e vitit të parë me fondin limit të celur për vitin aktual dhe më pas kërkon vitin e 2-të dhe të 3-të për planin buxhetor afatmesëm. Në rast se nuk gjendet asnjë shumë e rregjistruar për 2 vitet në vijim vlera e mbetur e kontratës rregjistrohet si rezervë në vitin 2021. Në këtë mënyrë ekziston rreziku që çdo institucion rregjistron kontratat vetëm kur ka fonde të disponueshme dhe vetëm për vlerën disponibël, dhe jo direkt kur ndërmerr një angazhim. Gjithashtu ekziston rreziku që fondet e planifikuara për vitin 2 dhe 3 nëse ka, mund të modifikohen më pas në varësi dhe në pritje të miratimit të buxhetit korrent të ri nëpërmjet Akteve Normative duke kaluar fonde nga një projekt në një tjetër.

Në konkluzion Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në më shumë se 90% e rasteve nuk bënë rregjistrimin e angazhimit (kontratës) sipas modulit të pagesave dhe PBA-së në SIFQ, duke mundësuar kështu ekgzistencën e riskut për rregjistrim kontrate vetëm kur ka fonde dhe jo kur është nënshkruar kontrata(afati 5 ditë për rregjistrim) qoftë ato angazhime aktive apo pasive. Tjetër risk përbën dhe rregjistrimi në vitin rezervë (në rastin tonë 2021) të të gjithë shumës së mbetur të kontratës, duke mos e rregjistruar atë në vitin e dytë dhe të tretë të planit buxhetor afatmesëm (në rastin tonë 2019 dhe 2020). Pra duke mos e rregjistruar angazhimin në planin e pagesave të angazhimit sipas PBA-së vitin e dytë dhe të tretë (2019 dhe 2020), atëherë fondet e planifikuara për këto dy vite mund të modifikohen më pas në varësi dhe në pritje të miratimit të

buxhetit korrent të ri nëpërmjet Akteve Normative duke kaluar fonde nga një projekt në një tjetër. Shumat e rregjistruara dhe raportuara në modulin e pagesave si angazhime (commitment) specifikisht dhe për vitet 2019, 2020 dhe 2021 paraqiten në tabelën në vijim. Theksojmë se burimi i këtoj informacioni është tabela e investimeve publike e publikuar në faqen zyrtare të MFE të konfirmuara me tabelat e marra nga specialistja përgjegjese për nxjerrjen e raportit cdo muaj.

Në 000 lekë

Institucionet	Nr. Projekteve	Angazhimi rregjistruar për vitet		
		2019	2020	2021
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise	77	-	3,202,829	36,621,498
Autoriteti Rrugor Shqiptar	722	1,071,979	3,862,121	25,296,349
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	282	17,627	56,240	3,755,290
Reparti Ushtarak Nr.1001 Tirane	23	-	-	1,788,444
Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve	170	120,745	99,881	1,772,836
Aparati Drejt.Pergj.Tatimeve	37	-	-	1,557,766
Aparati Ministrise se Financave dhe Ekonomise	82	-	-	337,827
Drejtoria e Pergjithshme e burgjeve	47	-	203,200	303,080
Universiteti Aleksander Moisiu (0707)	18	-	-	235,211
Spitali Kukes (1818)	43	-	1,862	189,282
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit	37	40,000	65,000	182,001
Sp. Durres (0707)	11	-	1,955	176,373
Drejtoria e Arkivave Shtetit	29	-	262	144,069
Laboratori i barnave	12	-	-	102,674
Reparti Special "Renea" Tirane	9	26,610	-	95,861
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	87	21,061	47,796	95,197
Inspektoriati Qendror	23	-	52,154	88,020
Aparati i Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit	111	-	-	68,465
Aparati i Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit	67	-	-	62,716
Spitali Vlore (3737)	48	-	-	58,848
Top 20 Institucione total	1,935	1,298,022	7,593,299	72,931,807
Institucionet e tjera total	5,788	12,954	344,666	313,333
Totali	***7,723***	***1,310,977***	***7,937,965***	***73,245,140***

Burimi : Tabela e Projekteve të investimeve publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Shohim se viti artific 2022 tashmë është axhustuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit, megjithatë procedura e copëzimit në rregjistrim të planit të pagesave për investimet, është prezente. Kjo identifikohet me rregjistrim të plan pagesave ,vecanërisht edhe për projektet aktive, në shumat zero për 2019 dhe 2020 dhe vlera e mbetur rregjistrohet e gjitha në 2021. Rast tjetër është dhe rregjistrimi i plan pagesave në shumat zero për vitin 2019 dhe vlera e mbetur rregjistrohet në 2020 dhe 2021. Ky rregjistrim i copëzuar, që praktikisht është e pamundur të kemi projekte investimi ku lidhet kontrata dhe punimet fillojnë vitin e dytë apo vitin e tretë të investimit (rast përjashtimor mund të përbëjnë kontratat koncesionare), lë hapsira për hapjen e projekteve të reja duke prishur radhën e prioritetit të investimeve për sa i përket PBA-së. Numri dhe vlera e lartë e rasteve të kontratave të rregjistruara nga njësitë shpenzuese në shkelje të afateve ligjore tregon që strukturat: Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtoria e Buxhetit, përgjegjëse për planifikimin, zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e likuiditetit nuk kanë informacion të plotë dhe koherent mbi angazhimet e marra. Nga analiza e të dhënave për projektet e investimit, ku identifikohen rastet e copëzimit të rregjistrimit të angazhimeve aktive në modulin e pagesave dhe që përbëjnë një numër total 1194 angazhimesh, 26 prej tyre kanë të hedhur në modulin e pagesave shpenzimet kapitale për vitet 2019 pjesërisht, dhe 2020, ndërsa viti 2021 është viti ku mbaron kontrata dhe me zero shpenzime investimi. Detajimi bëhet në tabelën 1.

Tabela 1 ***Në lekë***

Institucionet	Kodi Projektit	Pershkrimi	Viti Aktual 2018	Angazhimi rregjistruar për vitet 2019	2020	2021	Shpenzimi Aktual	Totali Angazhimit
Agjencia e Ofrimit te Sherbimeve Publike (ADISA)	M870339	Rikonstruksioni i Qend	-	-	39,505,886	-	5,865,606	45,371,492
Aparati i Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise	M112408	Pajisje te ndryshme -	-	-	476,069	-	30,527,505	31,003,574
Aparati i Ministrise se Kultures	M120730	Qendra Kombetare Kultu	363,022	-	342,706	-	479,629,494	480,335,222
Aparati Ministrise se Drejtesise	M140201	Zhvillimi dhe permires	630,000	-	1,800,000	-	68,412,000	70,842,000
Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike	M870087	Blerje pajisje per IT	1,706,000	-	1,072,000	-	294,000	3,072,000
Autoriteti Rrugor Shqiptar	M061304	Ndertim rruga Kardhiq	146,571	-	56,623,808	-	75,027,295	131,797,674
	M062783	Supervizion punimesh N	8,241,435	-	8,529,870	-	4,806,565	21,577,870
	M063004	Supervizion Ndertim I	1	-	6,503,253	-	19,907,999	26,411,253
	M063551	Studim projektzbatimi	-	-	53,965,200	-	67,465,200	121,430,400
	M063638	Supervizion punimesh S	-	-	74,619	-	1,813,200	1,887,819
	M063724	Supervizion punimesh S	-	-	972,400	-	1,472,400	2,444,800
	M064203	Supervizion punimesh P	237,962	500,000	541,400	-	262,038	1,541,400
	M064204	Supervizion punimesh P	500,000	500,000	560,600	-	-	1,560,600
Drejtoria e Pergjithshme Detare Durres	M063968	Rikonstruksion i godin	-	-	380,634	-	20,978,286	21,358,920
Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve	M063761	Supervizion punimesh P	-	2,000,000	1,230,000	-	6,430,000	9,660,000
	M063904	"Furnizimi me uje i qy	-	-	33,186,771	-	4,000,000	37,186,771
	M063946	Supervizion punimesh P	-	-	353,000	-	67,000	420,000
Drejtoria Vendore e Policise Shkoder	M160990	Ndertim /Rikosntruksio	-	-	82,882,108	-	140,102,643	222,984,751
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	M560332	Supervizim dhe kolaudi	-	-	1,254,845	-	19,202,727	20,457,572
	M560346	Studime dhe projektime	-	-	3,632,942	-	290,287,880	293,920,822
	M560348	Rikonsktruksioni i rru	-	-	23,002	-	40,727,315	40,750,317
	M560386	Rehabilitimi i kryqëzi	-	-	126,146	-	18,271,018	18,397,164
	M560412	Ndërtimi ujësjellësit	-	-	1,512,380	-	458,468,799	459,981,179
Gjykata e Apelit Durres	M290068	Rikonstruksion	-	-	712	-	11,180,031	11,180,743
QFM Teknike Tirane	M160883	Blerje pajisje për pol	-	-	18,777,648	-	151,499,356	170,277,004
Spitali Elbasan	M134063	Superv+kolaudim per ri	-	-	187,940	-	400,000	587,940
Totali			***11,824,991***	***3,000,000***	***314,515,939***	***-***	***1,917,098,357***	***2,246,439,287***

Burimi : Tabela e Projekteve të investimeve publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Se fundmi janë dhe 12 angazhime nga projektet aktive të cilët kanë të hedhura në plan pagesa vetëm vitin 2019 dhe zero investime në vitin 2020 dhe 2021. Detajimi paraqitet në tabelën 3.

Pra vetëm për projektet aktive të vitit 2018 kemi në total 233 angazhime (195+26+12) nga 1194 në total, për të cilët është rregjistruar angazhimi në modulin e pagesave sipas PBA dhe pjesa tjetër (961 angazhime ose 80% e totalit) nuk kanë rregjistrim të angazhimit në plan pagesa në SIFQ, dhe gjithashtu u janë alokuar fonde nëpërmjet ligjit të buxhetiti të vitit 2018 dhe Akteve normative nr.1 datë 26.07.2018 dhe Aktit Normativ nr.2 datë 19.12.2018.

Tabela 3 ***Në lekë***

Institucionet	Kodi Projektit	Pershkrimi	Viti Aktual 2018	Angazhimi rregjistruar për vitet 2019	2020	2021	Shpenzimi Aktual	Totali Angazhimit
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	M134013	Rikonstruksion Shtepia	152,283	19,959,441	-	-	66,847,717	86,959,441
Aparati i Ministrise se Kultures	M120781	Projekti i Restaurimit	-	4,960,000	-	-	35,000,000	39,960,000
Autoriteti Rrugor Shqiptar	M063848	Supervizion punimesh P	-	1,630,017	-	-	1,300,000	2,930,017
	M064229	Supervizion punimesh N	-	19,132,200	-	-	4,843,800	23,976,000
Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve	M063866	Furnizimi me ujë i fsh	-	31,318,918	-	-	45,154,239	76,473,157
	M063923	Supervizion punimesh P	-	1,174,691	-	-	625,500	1,800,191
	M064003	Furnizimi me uje i fsh	-	228,536	-	-	263,464	492,000
	M064146	Supervizion punimesh P	-	34,089,867	-	-	24,793,577	58,883,444
	M064153	Supervizion punimesh P	471,872	960,688	-	-	-	1,432,560
	M064155	Supervizion punimesh P	489,759	1,059,206	-	-	-	1,548,965
Drejtoria Vendore e Policise Shkoder	M160991	Pagese supervizori pe	-	716,780	-	-	2,198,500	2,915,280
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	M560431	Sistemim, asfaltim rru	-	17,626,755	-	-	1,051,578,548	1,069,205,303
Totali			***1,113,914***	***132,857,099***	***-***	***-***	***1,232,605,345***	***1,366,576,358***

Burimi : Tabela e Projekteve të investimeve publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Gjetjes:	**Mbi mosrregjistrimin e planit të pagesave të kontratës dhe PBA në SIFQ në afërsisht 80% të rasteve, duke rregjistruar vlerën më të madhe të angazhimit në**

	vitin rezervë pasardhës (2021) dhe pjesërisht në vitet 2019 dhe 2020.
Situata:	Në zbatim të Udhëzimit nr.2 datë 19.01.2018, pika 24, kontratat për investime duhet të regjistrohet për vlerën e saj të plotë dhe e shoqëruar me planin e pagesave në vite (angazhimet për 3 vite sipas PBA). Aktualisht ky kontroll nuk ushtrohet dhe informacioni për shpërndarjen në vite të kontratës plotësohet në mënyrë rastësore dhe i jo i detyrueshëm. DPTH ka udhëzuar Degët e Thesarit dhe institucionet me akses direkt në SIFQ për të anashkaluar detyrimin e regjistrimit të planit të pagesave, pra regjistrimin e vlerës së kontratës në tejkalim të fondeve të buxhetuara për vitin korrent si "rezervë" në vitin 2021. Në këtë mënyrë çdo institucion regjistron kontratat vetëm kur ka fonde të disponueshme dhe vetëm për vlerën disponibël, dhe jo për vlerën e plotë të angazhimit. Në konkluzion Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit rregjistron në më shumë se 90% e rasteve nuk bënë rregjistrimin angazhimit(kontratës) sipas modilit të pagesave dhe PBA-së në SIFQ, duke mundësauar kështu egzistencën e riskut për rregjistrim kontrate vetëm kur ka fonde dhe jo kur është nënshkruar kotrata(afati 5 ditë për rregjistrim) qoftë ato angazhime aktive apo passive. Tjetër risk përbën dhe rregjistrimi në vitin rezervë (në rastin tonë 2021) të të gjithë shumës së mbetur të kontratës, duke mos e rregjistruar atë në vitin e dytë dhe të tretë të planit buxhetor afatmesëm(në rastin tonë 2019 dhe 2020). Pra duke mos e rregjistruar angazhimin në planin e pagesave të angazhimit sipas PBA-së vitin e dytë dhe të tretë (2019 dhe 2020), atëherë fondet e planifikuara për këto dy vite mund të modifikohen më pas në varësi dhe në pritje të miratimit të buxhetit korrent të ri nëpërmjet Akteve Normative duke kaluar fonde nga një projekt në një tjetër
Kriteri:	*Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Udhëzimi i përhershëm Nr.2 Datë 06. 02. 2012"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit".* *Ligji nr 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018".* *Akti Normativ nr.1 datë 26.07.2018 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018"..* *Akti Normativ nr.2 datë 19.12.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018", të ndryshuar".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.23 datë 22.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2017".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe*

	shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Impakti:	Marrja e angazhimeve pa fonde buxhetore, mungesë raportimi për qëllime monitorimi të programeve buxhetore dhe menaxhimit të likuiditetit.
Shkaku:	Akomodimi në SIFQ nga ana teknike i rregjistrimit të angazhimeve pa fonde buxhetore
Rëndësia:	**E lartë**

Komentet nga subjekti i audituar: *Në kundërshtimet ardhur me email në datën 03.09.2019 në adresën zyrtarë të emailit të audituesve nga DRejtoresha e Operacioneve të Thesarit zj. M P citohet;*
Në vijim të konstatimit në paragrafin ***"Mbi rregjistrimin e planit të pagesave të kontratës sipas PBA"*** *(faqe 16-18 të akt konstatimit) sqarojmë si më poshtë:*
Dega e Thesarit Shkodër ka vënë në dijeni Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë Vendore të Policisë në lidhje me problematikën e hasur më datë 12.10.2018 kur në degën e Thesarit Shkodër janë paraqitur dy kontrata nga institucioni Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër të pa mbuluara me fonde buxhetore. Pas çeljes së fondeve në SIFQ nga strukturat përgjegjëse të Buxhetit është proceduar me rregjistrimin e këtyre kontratave.
Dega e Thesarit Kukës sqaron për kontratat e Spitalit Kukës se në mungesë të planit të buxhetit afatmesëm 2018-2020 janë rregjistruar në SIFQ në vitin e katërt 2021 (për të cilin SIFQ nuk ushtron kontroll automatik kundrejt planit të buxhetit) për të evidentuar vlerën e plotë të kontratës që kërkohet për analizën buxhetore të çeljes së fondeve të nevojshme.
Dega e Thesarit Durrës sqaron se Spitali Rajonal Durrës rezulton me mungesë fondesh buxhetore. Për këtë arsye kontratat janë regjistruar në vitet pasardhëse për të evidentuar vlerën e plotë të kontrates në SIFQ dhe ndjekjen e çeljes së fondeve shtesë në SIFQ nga strukturat përgjegjëse të Buxhetit. Po e njëjta arsye (mospasje fondesh të disponueshme) vlen edhe për Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës.
Dega e Thesarit Elbasan sqaron se PO nr. 29449 e Spitalit Elbasan nuk ka patur plan buxheti të mjaftueshëm. Në tabelen nr. 1 të Akt-Konstatimit nr. 3 vlera totale e kontratës me kod projekti M134063 është 1,606,940 leke, nga i cili për vitin 2018 plani i buxhetit ka qenë regjistruar në SIFQ vetëm për 400.000 lekë (nuk ka patur plan për vitet 2019 dhe 2020); diferenca e vlerës së kontratës është regjistruar në vitin 2021 (për të cilin SIFQ nuk ushtron kontroll automatik kundrejt planit të buxhetit) për të evidentuar vlerën e plotë të kontratës. Me hedhjen e planeve për vitin 2019 është bërë sistemimi i regjistrimit të vlerës së kontratës nga viti 2021 në vitet përkatëse sipas çeljes së planit të buxhetit, për rrjedhojë dhe pagesat përkatëse. Dega e Thesarit Vlorë sqaron për kontratën e Spitalit Vlorë se nuk ka pasur fonde disponibël në SIFQ për vitin 2019. Çelja e fondeve të nevojshme për këto projekte është bërë përkatësisht në muajt shkurt dhe mars të vitit 2019, ndërkohë që mbartja e kontratave nga viti i kaluar në rakordim me institucionin përfundon brenda muajit janar të vitit 2019.Në perfundim, në lidhje me masat e ndërmarra sqarojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka kërkuar nga përgjegjësit e degëve të Thesarit që të propozojnë masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi mbi punonjesit përgjegjës për gabimet. Për vitin 2018 nuk ka patur propozime të tilla pasi nuk kanë qenë gabime të përsëritura

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentimi i DPTH ku përmendet, mungesa e PBA-së së institucioneve shpenzuese, ardhja e kontratave pa pasur akoma PBA-në e miratuar që përbën shkelje të hapur të ligjit të buxhetit,nuk përbën argumentim ligjorë, ku të justifikohet ligjërisht pse janë bërë rregjistrimet e kontratave në modulin e pagesave në vitin e dytë apo vitine tretë të PBA-së apo në vitin 2021, nuk përbën argumentim ligjor mbi të cilin mund të konkludohet nga ana e grupit të auditimit. Për më tepër DPTH ka argumentuar vetëm për 5 institucione (Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, Spitali Kukës, Spitali Rajonal Durrës, Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës dhe Spitalin Elbasan) ndërkohë që në 90 % të rasteve nuk bëhet rregjistrimi i angazhimit sipas modulit të pagesave dhe PBA-së në SIFQ, si më sipër cituar dhe në tabelën 1 (13 institucione buxhetore) tabelën 2(15 institucione

buxhetore) dhe tabelën 3 (6 institucione buxhetore). Sa më sipër, grupi i auditimit del me konkluzionin se aurgumentimi juaj nuk mund të merret parasysh.
Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe përgjegjësitë eparashikuara për secilën strukturë në MFE mban përgjegjësi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj. M.Dh, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L,S dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G.P, për mosmarrje të masave administrative të parashikuara në ligj për paranalimine shkeljeve dhe përmirësimin e situatës.

Mbi rregjistrimet e Urdhër-prokurimeve dhe kontratave të lidhura në vitin 2018

Në përputhje e Vendimin 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 4, pika 1 dhe 2 e tij, parashikojnë përgjegjësinë e autoriteve kontraktore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i ligjit për buxhetin. Një kopje e regjistrit të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja duhet të dërgohet në degën e thesarit dhe në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore.
Gjithashtu, në përputhje me Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, and pika 15.1 "Faza para angazhimit... *Nëpunësi Zbatues kryen kontrollin dokumentar të përputhshmërisë si dhe të fondeve në SIFQ dhe në përfundim të procesit konfirmon direkt në SIFQ ngurtësimin e fondeve për prokurimin në fjalë, ose paraqet opinionin negativ zyrtarisht pranë Nëpunësit Autorizues.* ***Urdhër prokurimi autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit***".
Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, rregjistrojnë në sistem cdo vlerë prokurimi të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të rregjistrimit në SIFQ dhe vulën e Thesarit, procedojnë me dërgimin në APP.

<table>
<tr><td>Gjetje:</td><td>Në SIFQ rezultojnë vetëm 1120 urdhër-prokurime të rregjistruara nga rreth 30 mijë kontrata të lidhura gjatë vitit 2018 në përfundim të procedurave të prokurimit. Kjo pasi njësitë ekonomike me ose pa akses në SIFQ nuk paraqesin dhe rregjistrojnë pranë Degëve të Thesarit urdhër prokurimet para fillimit të procedurave në APP. Shkelje kjo për të cilën Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk kryhet asnjë kontroll dhe raportim për NPA me qëllim marrjen e masave dhe nxjerrjen e përgjegjësive.</td></tr>
<tr><td><u>Situata:</u></td><td>Me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë me këtë kriter u kërkuan rrëgjistrat e prokurimit të depozituar në Degën e Thesarit Tiranë dhe Sarandë për disa institucione dhe Ministri linje, nga të cilat u përgjigj vetëm Dega e Thesarit Tiranë. Data e dorëzimit dhe numrat e rregjistrimit të evidentuara në këto plane janë paraqitur në tabelën në vijim:
<table>
<tr><th>Institucioni/Ministria e linjës</th><th>Data e shkresës dhe nr.prot</th><th>Data e rregjistrimit në Th</th></tr>
<tr><td>Autoriteti Rrugor Shqiptar</td><td>Nr.3884 dt. 08.05.2018</td><td>S'ka</td></tr>
<tr><td>Bashkia Tiranë</td><td>Nr.6207 dt.12.02.2018
Nr.6872 dt.16.02.2018 (shtese)
Nr.10064 dt.09.03.2018 (shtese)
Nr.17773 dt.07.05.2018 (shtese)
Nr.28119 dt.19.07.2018 (shtese)
Nr.39423 dt.23.10.2018 (shtese)</td><td>Nr.1389 dt.13.02.2018
Nr.1621 dt.16.02.2018
Nr.2719 dt.13.03.2018
Nr.3859 dt.08.05.2018
Nr.5660 dt.23.07.2018
Nr.7382 dt.24.10.2018</td></tr>
<tr><td>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (shkollat e mesme profesionale,</td><td>Nr.1213/3 dhe 1213/1
dt.19.01.2018</td><td>S'ka</td></tr>
</table></td></tr>
</table>

Aparati, Degët e Thesarit)			
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Nr.121/2 dt.26.01.2018	Nr.1093 dt.6.02.2018	
Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë	Nr.306/3 dt.19.02.2018	S'ka	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	S'ka shkresë përcjellëse- Vetëm listë	S'ka	
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Nr.344 dt.22.01.2018 Nr.10618/1 dt.05.11.2018 (ndryshimet e planit fillestar)	Nr.643 dt.23.01.2018 Nr.7694 dt.5.11.2018	

Nga 7 subjektet për të cilat u kërkua rregjistri i prokurimit për vitin 2018, katër prej tyre nuk kanë një numër dhe datë rregjistri në Degën e Thesarit. Ndërsa shkresa për përcjellje të rregjistrit të Parashikimit të Prokurimeve Publike i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë jo vetëm nuk ka nuk ka një numër protokolli apo numër rregjistrimi të dorëzimit të tij por në fakt i drejtohet Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve njerëzore, aseteve dhe shërbimeve si dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe jo Degës së Thesarit.

Me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë të dy kritereve të mësipërme, u shqyrtuan gjithashtu të dhënat e vëna në dispozion mbi numrin e urdhër-prokurimeve të rregjistruara në SIFQ ku rezultojnë 1037 Urdhër –prokurime të rregjistruara të lidhura me 1120 kontrata me vlerë totale. Këto rregjistrime janë kryer vetëm nga institucionet që kanë akses të plotë në SIFQ ose ndryshe të quajtura BI- online. Për urdhër-prokurimet e përgatitura nga institucionet e tjera, pa akses të plotë në SIFQ, dhe që duhet të paraqiten në Degët e Thesarit <u>për të marrë vulën e konfirmimit të fondeve disponibël përpara se të fillojë proçesin e tenderimit, nuk ekziston mundësia (fusha) për rregjistrimin e këtij dokumenti në SIFQ. Ky dokument nuk rregjistrohet në sistem dhe rrjedhimisht nuk ka informacion nëse çdo prokurim ka filluar pasi janë konfirmuar fondet disponibël në Thesar, gjë do të shmangte marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore dhe rrjedhimisht krijimin e stokut të faturave dhe angazhimeve të prapambetura të cilat më pas rëndojnë buxhetin e vitit korrent.</u>

Pra jemi në të njëjtat kushte si gjatë vitit 2017 ku në SIFQ nuk ka informacion të plotë mbi të gjithë urdhër-prokurimet e paraqitura nga institucionet publike dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk kryhet asnjë kontroll dhe mundësia e verifikimit apo investigimit të një kontrate, që në momentin kur shpallet hapja e prokurimit, ekziston vetëm për këto kontrata (1120 rastet) nga mbi 20 mijë kontrata të lidhura dhe të rregjistruara në SIFQ gjatë vitit 2018.

Një element që do të lidhte kontratën me urdhrin e prokurimit do të ishte numri unik që urdhri merr në momentin e rregjistrimit, i cili më pas të lidhej me numrin e kontratës, kjo jo vetëm për institucionet online (15 institucione) por për të gjitha njësitë shpenzuese (mbi 1000 njësi). Aktualisht në sistem një PO (kontratë) nuk lidhet domosdoshmërisht me një Urdhër prokurimi.

Nga analiza e 1120 urdhër-prokurimeve që u gjenden në SIFQ, konstatojmë se janë rregjistruar dhe urdher prokurime për kontrata tashmë të lidhura në vitet 2009- 2017, duke humbur kështu komplet kuptimi i rregjistrimit të një urdhër-prokurimi si hapi i parë për të siguruar disponibilitetin dhe bllokimin e fondeve para se njësia të shkojë në APP, në total 469 UP me vlerë 16.1 miliard. Kjo sipas institucioneve:

		2009-2017		**2018**		**Total UP në SIFQ**	
Kodi institucio	**Emri I Institucionit**	**Nr. UP**	**Vlera 000/lekë**	**Nr. UP**	**Vlera 000/lekë**	**Nr. UP**	**Vlera 000/lekë**

nit							
1003001	Aparati i Keshillit te Ministrave	-	-	4	106,248	4	106,248
1005001	Aparati Ministrise se Bujqesise	-	-	47	112,371	47	112,371
1005117	AZHBR	1	528	118	973,364	119	973,892
1006001	Aparati Min Infrastrukturës Energjisë	15	4,712,875	25	40,927,785	40	45,640,660
1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar	10	249,178	69	23,735,893	79	23,985,071
1010001	Aparati Ministrise se Financave	23	761,169	36	845,249	59	1,606,418
1011001	Aparati Ministrise Arsimit	5	4,396	8	224,861	13	229,257
1012001	Aparati Ministrise Arsimit, Rinise dhe Sporteve	1	20,205	19	72,137	20	92,342
1013001	Aparati Ministrise se Shendetesise	18	783,985	23	396,347	41	1,180,332
1014001	Aparati Ministrise se Drejtesise	12	169,256	9	53,391	21	222,646
1016001	Aparati i Ministrise se Brendshme	1	179,935	8	70,936	9	250,872
1017001	Aparati Ministrise Mbrojtjes	1	2,402	9	46,026	10	48,428
1026001	Ministria e Mjedisit Pyjeve	-	-	56	280,575	56	280,575
1087006	AKSHI	17	648,835	74	3,602,331	91	4,251,167
2101001	Bashkia Tirana	365	8,636,078	146	4,160,067	511	12,796,145
Total		**469**	**16,168,843**	**651**	**75,607,581**	**1,120**	**91,776,424**

- 24 prej këtyre urdhër prokurimeve kanë vlerë zero pra janë të pavleshfme për testime të tjera,
- 140 urdhër-prokurime të rregjistruara në të njëjtën ditë me rregjstrimin e kontratës nga të cilat 36 UP për investime pra në shkelje të afatit dhe pa asnjë vlerë për kontrollin dhe bllokimin e fondeve disponibël. Disa nga rastet paraqiten në tabelën në vijim ku përsëri ajo që bie në sy është se vetë Aparati i MFE është në shkelje të udhëzimeve që lëshon dhe monitoron.

Institucioni	Data e Urdher-Prokurimit	Data e Kontratës fizike	Data e rregjistrimit të kontratës	Vlera e kontratës në mijë lekë
Aparati Ministrise se Financave	04/07/17	03/07/17	18/07/17	8,640
Autoriteti Rrugor Shqiptar	29/09/17	29/09/17	15/11/17	16,740
Agjencia per Zhvillimin Bujqesor dhe Rural	30/01/17	30/01/17	21/02/17	582
Agjencia per Zhvillimin Bujqesor dhe Rural	05/05/17	03/05/17	23/05/17	440
Bashkia Tirana	21/03/17	17/03/17	07/09/17	3,291
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit	13/10/17	11/10/17	16/10/17	900
Aparati Ministrise Mbrojtjes	25/05/17	22/05/17	06/06/17	3,425
Aparati Ministrise se Financave	04/07/17	03/07/17	19/07/17	3,240
AKSHI	08/08/17	04/08/17	08/08/17	1,084
Bashkia Tirana	24/11/17	24/11/17	24/11/17	802
Bashkia Tirana	17/08/17	15/08/17	18/08/17	17,527
Autoriteti Rrugor Shqiptar	30/11/17	30/11/17	04/12/17	29,211
Autoriteti Rrugor Shqiptar	16/03/17	16/03/17	30/03/17	12,149
Bashkia Tirana	13/12/17	09/12/17	24/04/17	325,118
Total				**423,150**

-Në 10 raste konstatohet se rregjistrimi është thjesht një migrim kontrate ekzistuese për balancën e mbetur gjë që konfirmon se në vitin kur kontrata është lidhur ajo nuk është rregjistruar me vlerën e plotë të angazhimit, detajuar si më poshtë:

UP_Nr	Dt.UP	Dt._Kontratës	SHUMA-UP 000/lekë	nr. Projekti	PERSHKRIMI	Emri I Institucionit
1006001-1800002	19/2/18	24/10/17	2,258,316	M064079	Migrim nga Ministria e Mjedisit Inceneratori Fier kontrata Kontrat vazhdim nr	Aparati MIE

						5553/5 dt 24.10.2016	
1006001 - 1800008	10/5/18	1/12/17	900	M064048	migrim nga Ministria e Energjise Raport vleresimi mjedisor	Aparati MIE
1006054 - 1800014	24/5/18	12/22/17	8,762	M063835	Migrim te dhenash Autorizim per lidhje kontrate nga MB Nr.22/45 "Blerje kompjutera, desktop	Autoriteti Rrugor Shqiptar
1010001 - 1800026	26/9/18	09/14/16	4,342	M100381	Migrimi i Kontrate nr. 4950/7, dt. 14.09.2016 "Ndertimi i ri shkolla "Hoteleri Turizem'	Aparati MFE
1010001 - 1800027	26/9/18	09/11/17	70,083	M100392	Migrim i kontrates nr. 1647/6, dt. 11.09.2017 "Rikonstruksioni i shkolles profesionale" Kamez	Aparati MFE
1010001 - 1800028	26/9/18	07/03/17	231,502	M100393	Migrim i nga MMSR i Kontrates nr. 1648/6, dt. 03.07.2018Ndertimi i shkolles AMP"Beqir Cela"Durres	Aparati MFE
1010001 - 1800029	27/9/18	04/09/17	31,499	M100390	Migrimi i kontrates 1645/6, dt. 04.09.2017 Ndertimi i bazes prodhuese per shkollen Karl Gega Tirane	Aparati MFE
1010001 - 1800035	21/11/18	05/09/17	1,860	M100390	Migrim i kontrates nr. 4073/7, dt. 05.09.2017 Mbikqyrje ndertim i bazes prodhuese per shkollen Karla Gega Tirane nga ish MMSR	Aparati MFE
1013001 - 1800026	04/12/18	11/12/15	9,600	M133678	Migrim te dhenash Kontrata nr 3030/17 dt 12.11.2015 Ngritja e sistemit per sherbimin Shendetesor (Receta Elektronike)	Aparati Ministrise se Shendetesise
2101001 - 1800427	06/9/18	16/09/16	1,347	M991454	Migrim Kont Vlere e mbetur FZHR Rikonstruksion i rruges Shote Galica	Bashkia Tirana

Përvec sa më sipër, ky kampion ka mungësi në cilësinë e të dhënave me raste pa përshkrim të objektit të prokurimit apo me data të pavlefshme.

Kriteri:

Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54; Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 për zbatimin e buxhetit të vitit 2018; Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".
VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për

	vitin 2018". *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Shkelje e Ligjit të mënaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të anagazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura**.**
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave të aplikacionit në SIFQ, nga Degët e Thesarit në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit me drejtor Z.LS, mosveprim dhe marrje e masave nga NPA znj.G P, dhe Agjensisë së Prokurimit Publik për pranimin e urdhër-prokurimeve pa marrë vulën në Thesar sipas parashikimeve të Udhëzimit përkatës.
Rëndësia	E lartë

Mbi rakordimin e të dhënave të angazhimeve në SIFQ me APP për parandalimin e marrjes së angazhimeve pa fonde buxhetore në kuadër të strategjisë për forcimin të disiplinës buxhetore

Me qëllim testimin e mëtejshëm të plotësisë dhe saktësisë së të dhënave mbi angazhimet e ndërmarra gjatë vitit 2018, jo vetëm në lidhje me zbatimin e afateve të rregjistrimit në SIFQ u kërkua në APP dhe na u vu në dispozicion lista e prokurimeve të realizuara dhe kontratat respektive të nënshkruara gjatë vitit 2018. Nga këto të dhëna rezulton se janë paraqitur dhe shpallur procedurat e prokurimit nga **1387 institucione të qeverisjes qëndrore, vendore dhe shoqëritë aksionere me një vlerë fondi limit prej 224.2 miliardë lekë** , nga të cilat kanë përfunduar **4,290 kontrata të lidhura** nga 528 institucione në vlerë fondi të prokuruar pa TVSH prej **61.4 miliardë lekë**. Sipas llojit të kontratës të dhënat sipas institucioneve me vlera prokurimi më të larta paraqiten në tabelën në vijim, ku ARRSH ka fondin më të lartë të prokuruar prej 10.8 miliardë lekë për punime dhe QSUT ka numrin më të lartë të kontratave të lidhura për blerje. Në SIFQ në total rezultojnë 28,604 kontrata nga të cilat 4468 kontrata për shpenzime për investime (llogaritë 230+231 për investime me fonde buxhetore dhe te ardhurat vendore) ndërsa në APP raportohen 3129 kontrata të lidhura për "punime" dhe "blerje".

	Shërbime		**Supplies**		**Punime**		**Total Numri i Thirrjes**	
Autoriteti Kontraktor	**Nr**	**Fondi Prokuruar pa TVSH ne 000/leke**	**Nr**	**Fondi Prokuruar pa TVSH ne 000/leke**	**Nr**	**Fondi Prokuruar pa TVSH ne 000/leke**	**Nr**	**Fondi Prokuruar pa TVSH ne 000/leke**
ARRSH	2	98,128		-	15	10,701,800	17	10,799,928
AKSHI	39	4,701,556	12	202,951		-	51	4,904,507
OSHE	16	965,118	16	1,499,824	15	1,750,694	47	4,215,636
OST	13	155,716	15	732,541	16	2,054,028	44	2,942,285

FSHZH		-	2	2,050	13	2,069,149	15	2,071,199
Ujesjelles Kanaliz. TR	38	141,302	19	221,210	25	1,398,011	82	1,760,523
Bashkia Tirane	32	82,534	14	111,281	30	1,141,061	76	1,334,876
KESH Tirane	13	434,565	7	380,969	8	335,830	28	1,151,364
DR e OSHEE Tirane	1	82,693	2	15,090	9	974,179	12	1,071,962
Autoriteti Portual DR	3	24,455	9	31,083	3	1,004,613	15	1,060,151
DP Policise se Shtetit	12	273,699	15	148,860	2	550,217	29	972,776
DP e Burgjeve	10	29,056	17	854,070	2	81,499	29	964,625
Sh.A Albpetrol	24	261,744	40	574,836	8	70,400	72	906,979
Bashkia Kamez	1	1,883	4	20,439	22	825,734	27	848,057
Agjen.BlerjevePerqendr	12	178,180	32	566,616		-	44	744,796
QSUT	81	226,672	131	468,190		-	212	694,862
Bashkia Durres	9	17,146	18	100,827	24	540,646	51	658,618
DR Verior Shkoder	12	643,360		-		-	12	643,360
Bashkia Shkoder	22	185,466	19	68,259	40	284,677	81	538,401
MFE	8	77,875	3	52,593	4	376,328	15	506,797
Bashkia Roskovec	1	4,017	19	62,959	40	417,399	60	484,374
DRajonale OSHEE Fier	2	59,245	3	400,582	1	19,197	6	479,024
Dr.Pergj. TensionitLarte		-	3	229,436	2	247,918	5	477,353
Ministria e Mbrojtjes	7	359,546	13	109,834	1	2,355	21	471,736
Institucione te tjera	***803***	***3,851,172***	***1,789***	***6,802,243***	***647***	***10,101,019***	***3,239***	***20,754,434***
Total	**1,161**	**12,855,129**	**2,202**	**13,656,744**	**927**	**34,946,753**	**4,290**	**61,458,625**

Rakordimi në numër dhe vlerë i kontratave sipas APP dhe SIFQ është i pamundur në kushtet e këtij auditimit pasi ky do të ishte një proces tepër manual për shkak të: referencave të ndryshme të përdorur për rregjistrim si dhe për shkak të mënyrës së rregjistrimit të kontratës në SIFQ sipas llogarive ekonomike nëse kontrata ka dy komponentë: dhe punimet dhe shërbimet por edhe për arsye të rregjistrimit të pjesshëm të kontratës, pro jo me vlerën e plotë të saj për shkak të mungesës së fondeve disponibël në SIFQ, cështje kjo e trajtuar më hollësisht në këtë raport. Vecanërisht për kontratat për blerje dhe shërbime, ajo që është lehtësisht e dallueshme nga krahasimi i numrit të kontratave në SIFQ, është rregjistrimi i copëzuar i kontratave cdo herë që rregjistrohet një faturë me vlerë të barabartë me faturën. Psh, më hollësisht rezulton se :

Gjetje:	**Diferenca të theksuara në numrin e shpalljeve për procedura prokurimit kundrejt urdher –prokurimeve të rregjistruara në SIFQ si dhe midis numrit kontratave të nënshkruara të raportuara nga SIFQ kundrejt atyre të rregjistruara në SIFQ: rastet e ARRSH dhe Bashkia Tiranë, AKSHI**
Situata:	-Sipas SIFQ 55 kontrata të lidhura në muajt Nëntor- Dhjetor 2018 (referuar datave të SIFQ) nuk listohen në të dhënat e dërguara nga APP në total 1.07 miliardë lekë. Të përmbledhura sipas ministrive të linjës numri dhe vlera e kontratave paraqitet në tabelën në vijim ndërsa të detajuara sipas njësive ekonomike paraqiten në aneksin e këtij raporti:

MINISTRIA_LINJES	Nr. Kontratave	Vlera e Kontratës në 000/lekë
Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë	7	168,189
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	8	112,672
Institucione të tjera Qeveritare	13	582,780
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	2	171,431
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	1	479
Ministria e Drejtësisë	14	27,029
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5	7,099
Avokati i Popullit	1	1,265

Ministria e Mbrojtjes	1	66
Ministria e Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale	2	171
Shërbimi Informativ Kombëtar	1	29
Total	**55**	**1,071,212**

- kontratat e lidhura për projektin e rehabilitimit të Unazës së re nuk shfaqen në APP sipas loteve në total me një vlerë kontratash **prej 5.98 miliardë lekë** e ndarë në tre operatorë, kontrata këto që më pas janë pezulluar për shkak të problematikave në prokurim.

-kontrata për rikonstruksionin e godinës së **ARRSH** nuk shfaqet në listën e kontratave të nënshkruara por vetëm në listën e shpalljeve nga APP: shpallur më 7/5/2018 me fond limit **33,3 milionë lekë** dhe reference# 77899-07-04-2018 me procedurë mbyllur më 8/10/2018. Në listën e fituesve referohet vetëm data e lidhjes së kontratës 18/12/2018 por jo fituesi. Ndërkohë në SIFQ rezulton e rregjistruar në 20/12/2018 kontrata e lidhur me operatorin INERTI (J66926804L) për shumën 32,385,895 lekë. Ky projekt është buxhetuar fillimisht me një fond prej 40 milionë lekë por pikërisht 15 ditë para firmosjes së kontratës më datë 3 Dhjetor 2018 ky fond shkurtohet me 30 milionë lekë dhe në datën 26 Dhjetor 2018 shkurtohet edhe me 9 milion lekë.

ID#	GL_ PERIOD	Celja fillestare	Lloji rishikimit	Shuma e rishikuar	Kodi institucit	Institucioni	Prog	Llog	Projekti	Dt.rishikimit
5886294	11-2018	40,000,000	D	(30,000,000)	1006054	ARRSH	04520	231	M064217	03-Dec-18
5899292	12-2018	10,000,000	D	(9,900,000)	1006054	ARRSH	04520	231	M064217	26-Dec-18

- 5 kontrata me vlerë totale 44**6 milionë** lekë, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësive të saj të varësisë nuk shfaqen në APP duke e bëre të pamundur verifikimin e fillimit të procedurave të prokurimit dhe afatet e rregjistrimeve:

Institucioni	Projekti	Përshkrimi Projektit	Dt. Kontratës	Kontraktori	Vlera kontratës sipas SIFQ 000/lekë	Celja 000/lekë	Fondi prokuruar pa TVSH
QSUT	M134057	Ndërtimi i depos qëndrore te barnave	03/09/2018	R T	168,000	**54,000**	S'ka të dhëna
Aparati Ministrisë Shëndetesisë	M134080	Rikonstruksione te QSH-ve	22/06/2018	A K	68,548	**220,000**	S'ka të dhëna
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	M133595	Blerje autoambulanca për sistemin shëndetësor (25 cope)	01/10/2018	AMC	196,371	**240,370**	S'ka të dhëna
Klinika Stomatologjike Universitare Tirane	M130555	Blerje aparature Panoramex KSU	15/11/2018	M/E	4,800		Shpallja më 18/10/2018. Nuk ka kontratë dhe fitues
Klinika Stomatologjike Universitare Tirane	M131475	Blerje unite dentare per ASHR,DSHP+ kl.qeveritare dhe KSU	15/11/2018	M/E	8,526	**9,325**	S'ka të dhëna

- **Bashkia Tiranë** shfaq problematika në saktësinë në rregjistrim, referuar datës së kontratës fizike. Për disa projekte kontratat e të cilave listohen në tabelën e PO-ve për vitin 2018 janë realisht kontrata të lidhura në vitin 2017 (nisur nga përshkrimi i

pagesave ose data e faturave) dhe disa prej tyre mund të jenë lidhur si kontrata në vitin 2018 por procedurat e prokurimit kanë filluar në vitin 2017. Në të dy rastet kontratat dhe operatorët fitues respektive nuk shfaqen në të dhënat e APP. Në vijim paraqiten disa raste të kontratave të rregjistruara në SIFQ nga kjo Bashki të cilat nuk shfaqen në listën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2018 të APP. Gjithashtu në këto raste të testuara u konstatuan edhe parregullsi në afatet e rregjistrimit të dokumentit Urdhër-prokurim, kontratë dhe faturë:

- **Rasti i projektit "Rikualifikimi urban i sheshit Skënderbej Faza I-rë dhe Faza II-të; Bashkia Tiranë (FZHR); #M991418, #M991479, #1011212 dhe #1011501**

Faza e I-rë dhe II-e projektit "Rikualifikim i sheshit Skënderbej rezulton të jetë një projekt i financuar nga fondet e FZHR me kodet M991418 dhe M991479 me kontrata të lidhura në vitin 2016 dhe 2017. Në vijim, nga shqyrtimi i planit të prokurimit për vitin 2018 i dorëzuar në Degën e Thesarit[6] si dhe ndryshimet e tij, për vitin 2018 Bashkia Tiranë ka parashikuar prokurimin për shtesa të të dy kontratave, këtë herë të financuara me fondet e veta, miratuar me VKB nr.41 dt.29.3.2018, të rregjistruara në SIFQ përkatësisht me kod projekti #1011501 dhe #1011212.

Sipas të dhënave të APP, janë listuar dy shpallje për hapje procedure prokurimi me llojin e procedurës "negocim pa shpallje" përkatësisht në datën **22 Gusht 2018** me objektin "*shtesë kontrate për objektin "Rikualifikimi urban i Sheshit Skënderbej **Faza e II-të***" për ndërtim dhe mbikqyrje punimesh me fond limit total prej 197,738,660 lekë pa TVSH nga i cili është prokuruar fondi pa TVSH prej **197,718,560** lekë (237,262,272 lekë me TVSH) dhe në datën **24 Dhjetor 2018** me objekt "*shtesë kontrate për objektin "Rikualifikimi urban i Sheshit Skënderbej **Faza e I-rë***" me fond limit total prej 106,092,943 lekë pa TVSH nga i cili është prokuruar fondi pa TVSH prej **106,081,521** lekë (127,297,825 lekë me TVSH). Informacioni i detajuar paraqitet në tabelën në vijim:

Nr.	Objekti i prokurimit	Tipi i kontratës	Lloji i Procedurës	Fondi limit pa TVSH	Fondi Prokuruar pa TVSH	Operatori fitues	Numri i Thirrjes	Data e lidhjes se kontrates
3926	Shtesë Kontrate per objektin **Mbikqyrja e punimeve** për "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, **Faza e II-të"**	Services	Negocim pa shpallje	2,050,000	2,049,900	51N4E	REF-83508-	9/13/2018
22464	Shtesë Kontrate per objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, **Faza e II-të**	Ëorks	Negocim pa shpallje	195,688,660	195,668,660	?	REF-83509-	9/13/2018
13612	Shtesë kontrate për **Mbikqyrje punimesh** për objektin: "Rikualifikimi	Services	Negocim pa shpallje	757,720	750,000	GG	REF-01493-	12/27/2018

[6] *Sipas planit fillestar të prokurimit të Bashkisë Tiranë dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë më dt.13.02.2018 dhe nr.prot.6207 rezulton se është parashikuar fillimisht vetëm projekti për "Shtesë kontrate: Rekualifikimin urban të Sheshit Skënderbej **Faza e I-rë**", në shumën totale financimi për punime dhe mbikqyrje punimesh prej 106,092,943 lekë duke cilësuar si burim financimi "vetëfinancim sipas VKB nr.132 dt.12.12.2017". Më pas në shkresën nr. 17773 dt.07.05.2018 "Shtesë dhe sistemim rregjistri I parashikimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2018", shtohet parashikimi për prokurim me objekt "Shtesë kontrate: Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, **Faza II-të**" për 195,688,660.83 lekë dhe 2,088,855.83 lekë për Mbikqyrje punime-shtesë kontrate" pra në total 197,777,516.66 lekë duke cilësuar si burim financimi "vetëfinancim sipas VKB nr.41 dt.29.03.2018".*

	Urban i Sheshit Skënderbej, **Faza e I-rë**							
22469	Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, **Faza e I-rë**	Ëorks	Negocim pa shpallje	105,335,223	105,331,521	?	REF-01483-	12/27/2018

Në listën e kontratave të lidhura sipas APP rezultojnë të listuara 2 kontrata për mbikqyrje punimesh me kontraktorët: **51NXX** për fazën e I-rë dhe me kontraktorin **G G** për fazën e II-të, por nuk listohet emri i operatorit fitues për punimet që në këtë rast është F shpk.

Shpenzimet për investime të njësive vendore pavarësisht burimit të financimit duhet të ndjekin procedurën ligjore "për marrjen e angazhimeve" e cila parashikon rregjistrimin më parë në Degën e Thesarit të urdhër-prokurimit, para fillimit të procedurave. Nga të dhënat e SIFQ, rezultoi:

- **Për projektin #1011212,** urdhër-prokurimi me nr. 2101001-1800304 i rregjistruar në datën 20 Qershor 2018, për shumën 45,941,175 lekë, shumë e cila është shumë më e vogël se fondi limit i shpallur në APP. Për një verifikim më të hollësishëm u kërkua kontrata e lidhur me këtë UP ku rezultoi se ky UP ishte lidhur me një kontratë më të hershme të këtij projekti e datës 8 Mars 2017 dhe nuk kishte lidhje me prokurimet e reja për shtesë kontrate të vitit 2018. **Pra, jemi në rastin e rregjistrimit të një kontrate pas 474 ditësh nga nënshkrimi i saj**.

PO_ID	PO_NR	DT_kontrates	Kontraktori	Dt. Rregjistr.	Institucioni	Vonesa	Projekti	PERSHK_projektit	Shuma
1859023	2101001-1800238	03/08/2017	Fshpk	25.06.2018	Bashki Tiranë	474 ditë	**1011212**	Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, Faza e II-re, Ndertim ¿ Montim	**45,941,175**

Në bazë të kontratës të vënë në dispozicion nga Dega e Thesarit Tiranë, kjo kontratë e lidhur më 8.3.2017 me F shpk, ka një vlerë prej **1,174,654,654.54** lekë dhe një afat prej 12 muaj, ndërkohë që fondin disponibël ka qënë për vetëm **94,930,921** lekë dhe është rregjistruar në SIFQ pjesërisht me një shumë të barabartë me vlerën e faturës për 45,941,175 lekë.

- **Për projektin #1011501** urdhër-prokurimi me nr. 2101001-1800358 i rregjistruar më datë 8 Gusht 2018 në shumën 234,802,392 lekë i lidhur me kontratën me nr. 2101001-1800377 datë **13 Shtator 2018** rregjistruar në datën 25 Shtator 2018 pra në tejkalim të afatit ligjor 5 ditor. Megjithatë, kjo kontratë në momentin e auditimit, **22 Gusht 2019** rezulton në SIFQ me status "unreserved", status që do të thotë se është ndërhyrë për të bërë ndryshime në kontratë dhe kërkon miratimin përfundimtar të NA-së së Bashkisë dhe më pas të Degës së Thesarit Tiranë në mënyrë që të bëhet i vlefshmë për tu lidhur me faturat.

PO_ID	PO_NR	DT_kontrates	Kontraktori	Dt. Rregjistr.	Institucioni	Llog.	Projekti	PERSHK_projektit	Shuma
1897004	2101001-1800377	2018/09/13	Fshpk	25.09.2018	Bashkia Tirana	231	1011501	Shtese kontrate - Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, Faza e II-te	**234,802,392**

Nga verifikimi i celjeve dhe PBA së rregjistruar për këtë kontratë rezulton vetëm një

celje për vitin korrent 2018 në shumën 48,871,726 lekë pa plan për vitet 2019 dhe 2020. Me këto të dhëna konkludojmë se arsyeja e statusit të pafinalizuar i **kësaj kontrate është fakti që nuk ka buxhet të celur dhe planifikuar. Pra jemi në rastin e marrjes së angazhimit pa fonde buxhetore disponibël në shumën 234,802,392 lekë.**
Gjithashtu edhe **dy kontratat e lidhura për mbikqyrje punimesh respektivisht me operatorët 51NXX dhe G G nuk figurojnë të rregjistruara në SIFQ**.
Në përmbledhje këto kontrata do të paraqiteshin si vijon:

Kod Projekt	Përshkrim projekti	Fondi Disponibël Buxhet Operativ	Data e celjes	Data e kontratës	Vlera kontratës fizike në lekë	Vlera kontratës në SIFQ në lekë	Total pagesa
1011212	Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, **Faza e II**-re, Ndertim ¿ Montim	94,930,921	2018	08/03/2017		45,941,175	45,941,175
1011501	**Shtesë** kontrate – rikualifikim urban i sheshit Skenderbej	48,692,959	2018	13/09/2018	234,802,392	234,802,392	0
M991418	Rikualifikim urban i Sheshit Skëndërbej, Faza I	247,764,085	03/04/2018	06/09/2016	**633,043,125**	Për pagesa ë faturave të vitit 2017	247,764,085
M991479	Rikualifikim urban i Sheshit Skëndërbej, Faza II[7]	144,514,121	03/04/2018	08/03/2017	**1,174,654,654.54**	Për pagesa të faturave të vitit 2017	144,514,121
						Total	**438,219,381**

Në mënyrë të detajuar pagesat e kryera gjatë vitit 2018 për këto dy projekte paraqiten në tabelën në vijim:

	Nr. Fatures	PERSHKRIMI_FATURES	KODI_PROJECT	FURNITORI	SHUMA në lekë	DATA_Fatures	Dt. Dergimit në thesar
+1 pagesë në vitin 2017	1626210100 12018	2101001 Bashkia tirane Likuidim pjesor objekti Rikualifikimi i sheshit Skenderbej Faza I Shk.47429/1 19.12.17 kont vazh 20575/6 06.09.16 **sit 3 fill 10.11.17** fat.05713631 **12.12.17**	M991418	Fshpk	196,088,777	12-Dec-17	17-MAY-2018
2 pagesa pjesor	2848210100 12018	2101001 Bashkia Tirane Rikualifikim Sheshi Skenderbej Faza 1 Shkresa 23634 dt 14.06.18 Kont ne vazhd 20575/6 dt 06.09.16 **sit 06.12.17** fat 48931152 dt **08.05.18** (dif) Pv 26.01.2018	M991418	Fshpk	24,776,211	08-May-18	06-SEP-2018
	2290210100 12018	2101001 Bashkia Tirane Rikualifikim Sheshi Skenderbej faza I Kont ne vazhd 20576/6 dt 06.09.2016 Shkresa 23634 dt 14.06.2018 sit **06.12.2017** Fat 48931152 dt **08.05.2018** Pv kolad 26.01.2018	M991418	Fshpk	26,899,097	08-May-18	12-JUL-2018
2 pagesa pjesor Lidhur me 2 projekte të	1624210100 12018	2101001 Bashkia Tirane Likuidim objekt Rikualifikim i sheshit skenderbej Faza II garanci shk.43529/1 19.12.17 kont 626/4 08.03.17 **sit punimesh 4 fill - 30.11.17** fat.05713630 **11.12.17**	M991479	Fshpk	144,514,121	11-Dec-17	17-MAY-2018

[7] *Nga të dhënat që disponojmë nga viti 2017, kjo kontratë ka një vlerë prej 1,174,654,654 lekë rregjistruar me PO# 2101001-1700095 përshkrimin "FZHR -Rikualifikim urban Sheshi Skenderbej Faza II në datën 11 Maj 2017" e cila është ende e palikujduar plotësisht.*

ndryshme	2015210100 12018	2101001 Bashkia Tirane Rikualifikimi i sheshit skenderbej Faza II shkrese 43529/1 19.12.17 kont 626/4 08.03.2017 **sit 4** fat.05713630 **11.12.17**	**1011212**	Fshpk	45,941,175	19-Dec-17	25-JUN-2018

Përvec pagesave të faturave të lëshuara në vitin 2017 kemi edhe një rast ta faturimit të situacionit të Dhjetorit 2017 faturuar në Maj të vitit 2018, pra 5 muaj më vonë. Gjithashtu konstatohen edhe rregjistrime dhe pagesa pjesore të të njëjtave fatura (sipas shenimeve në kolonën e parë të tabelës më lartë).

Nga shqyrtimi i kontratave të rregjistruara deri në Maj 2019 rezulton edhe një rregjistrim tjetër për projektin# 1011212 dhe kontratën e lidhur me të në vitin 2017:

PO_ID	PO_NR	DT_kontrates	Kontraktori	Dt. Rregjistr.	Institucioni	Projekti	PERSHK_projektit	Shuma
1946509	2101001-1900036	08/03/2017	Fshpk	**21.02.2019**	Bashkia Tirana	1011212	Shtese kontrate - Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, Faza e II-te	**85,742,696**

Ky konstatim con në konkluzionin se kontrata e rregjistruar në 8 Mars 2017 është rregjistruar e copëzuar, pra jo me vlerën e saj të plotë. Pra, praktika e rregjistrimit të faturave vetem për vlerën e celjeve të vitit korrent vazhdon edhe gjatë vitit 2019.

Në konkluzion, nga shqyrtimi rregjistrimeve të të gjithë dokumentacionit në lidhje me këto dy projekte konstatohen:

Te dy shtesat e kontratave të listuara në APP nuk rezultojnë të rregjistruara në SIFQ. Kërkesa e KLSH për kopje të këtyre kontratave shtesë nuk mori përgjigje nga Dega e Thesarit Tiranë. Pavarësisht nga dokumentat fizike, nga të dhënat e shqyrtuara në SIFQ për këtë projekt rezultojnë shkeljet dhe parregullsitë e mëposhtme:

- marrje e angazhimeve pa fonde buxhetore, mos rregjistrim i UP në Thesar para dërgimit në APP; rregjistrim kontratash përtej afatit ligjor 5ditor, rregjistrim i copëzuar i kontratave, celje buxhetore vetëm për pagesa të faturave të prapambetura, pagesa pjesore të fatura; faturime të situacioneve të punimeve të kryera në vitin 2017; lëshuar dhe rregjistruar në vitin 2018; shkelje e afatit 30 ditor i dërgimit të faturave në Thesar.
- Në kushtet kur dy kontratat fillestare për fazën e I-rë dhe të II-të me vlerënë totale prej 1,807,697,779.54 lekë, të konsideruara të përfunduara kanë ende detyrime të papaguara (1,807,697,779.54- 1,078,261,082) janë ndërmarrë dhe dy angazhime të reja "shtesë kontrate" nëshumën 364,560,097 lekë me TVSH.

- **PO# 2101001-1800164 Projekti 1011017: Ndërtim Shkolle 9-vjecare tek ish Kombinati Tekstil me kontraktor Fshpk , përfitues Bashkia Tiranë**

Ky projekt realisht është prokuruar në vitin 2017 dhe jo në Maj 2018 sipas urdhër-prokurimit dhe datës kontratës referuar në SIFQ. Për më tepër fatura e parë daton Janar 2017 ndërkohë që sipas përshkrimit të pagesës në SIFQ kontrata daton Dhjetor 2017. Ndërkohë dhe dokumenti PBA2018 i vënë në dispozicion nuk ka të plotësuar listën e projekteve për investimeve sipas formatit të kërkuar nga MFE, me qëllim monitorimin e angazhimit kundrejt fondeve disponibël të miratuara:

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime

dt. Dokumentit UP			Nuk ka info mbi datën e dokumentit fizik UP
Dt.rregjisrimit te UP në SIFQ	15/05/2018		**Realisht prokuruar në 2017**
dt.kontratës sipas pershkrimit te faturave	**12/12/2017**		kontrata 115/5 sipas përshkrimit të faturës
dt. Rregjistrimit kontratës SIFQ	16/05/2018	208,703,987	
dt. Faturës I-rë	12/01/2017	5,000,000	**Data e faturës 11 muaj para datës së kontratës**
celja		132,013,614	

- **PO#2101001-1800206 Projekti 1011163: Rikonstruksioni i Infrastrukturës së bllokut që kufizohet nga rruga Endri Keko, Sadik Petrela dhe Lana me kontraktor G K shpk**, përfitues **Bashkia Tiranë**

Procedura e prokurimit për këtë kontratë daton Tetor 2017 ndërkohë që urdhër prokurimi rregjistrohet në SIFQ në Qershor 2018, megjithatë objekti i këtij prokurimi dhe ky operator nuk shfaqet në të dhënat e APP. Rregjistrimet e dokumentacioneve përkatëse në SIFQ bëhen në momentin e mbërritjes së urdhër-shpenzimit nga Bashkia për faturën e parë e cila daton Shkurt 2018. Ndërkohë dhe dokumenti PBA2018 i vënë në dispozicion nuk ka të plotësuar listën e projekteve për investimeve sipas formatit të kërkuar, me qëllim monitorimin e angazhimit kundrejt fondeve disponibël të miratuara.

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime
dt. UP sipas përshkrimit të faturës	**30/10/2017**	107,971,090	**Nuk shfaqet në të dhënat e APP-2017**
dt.kontrates në SIFQ	**31/01/2018**	107,971,090	
dt. Faturës I-rë	28/02/2018	6,733,041	**Fatura e rregjistruar 3 muaj me vonesë në shkelje të afatit 30 ditor**
dt. Rregjistrimi UP dhe Kontratës në SIFQ	07/06/2018	107,971,090	**Kontrata e rregjistruar 5 muaj me vonesë, kur dërgohet fatura për pagesë**
celja		29,046,075	
Rishikimi	02-Oct-18	43,575,130	

- **PO#2101001-1800357 Projekti 101169: Rikonstruksioni i rrugës "Dhimitër Shuteriqi" me kontraktor L VII , përfitues Bashkia Tiranë**

Për këtë projekt ka një urdhër-prokurim të rregjistruar në Mars 2018 por kontrata e këtij operator fitues, për këtë objekt prokurimi nuk shfaqet në APP për të patur mundësi verifikimi të shumës së angazhimit. Ndërkohë dhe dokumenti PBA2018 i vënë në dispozicion nuk ka të plotësuar listën e projekteve për investimeve sipas formatit të kërkuar, me qëllim monitorimin e angazhimit kundrejt fondeve disponibël të miratuara.

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime
dt. UP	?		**Nuk shfaqet në të dhënat e APP, as si shpallje apo kontratë**
Dt.rregjisrimit të UP në SIFQ	28/03/2018	45,010,957	
dt. Kontratës në SIFQ	30/08/2018	45,010,957	
dt. Faturës I-rë	0		
dt. Rregjistrimi Kontratës	04/09/2018		

celja		11,594,472	

- **PO#2101001-1800369 Projekti 1011179: Rikonstruksioni i rrugës Zall - Bastarit (Ura Zall Dajt deri ne Zall Bastar) - Loti I, me kontraktor Kshpk përfitues <u>Bashkia Tiranë</u>**

Për këtë projekt procedura e prokurimit ka nisur në vitin 2017, ka një urdhër-prokurim të rregjistruar në Qershor 2017 por kontrata e këtij operator fitues, për këtë objekt prokurimi nuk shfaqet në APP për të patur mundësi verifikimi të shumës së angazhimit. Gjithësesi, sipas SIFQ kjo kontratë është lidhur në Janar 2018 dhe rregjistruar rreth 8 muaj me vonesë. Ndërkohë dhe dokumenti PBA2018 i vënë në dispozicion nuk ka të plotësuar listën e projekteve për investimeve sipas formatit të kërkuar, me qëllim monitorimin e angazhimit kundrejt fondeve disponibël të miratuara.

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime
dt. UP sipas përshkrimit të faturës	06/10/2017		**nuk shfaqet në të dhënat e APP-2017**
Dt.rregjisrimit të UP në SIFQ	06/10/2017	**72,764,396**	
dt. Kontrates në SIFQ	**25/01/2018**	**72,764,396**	
dt. Faturës I-rë	23/08/2018	20,000,000	
dt. Rregjistrimi Kontratës	**19/09/2018**		**Kontrata e rregjistruar SIFQ 8 muaj me vonesë, kur dërgohet fatura për pagesë**
celja		**20,926,740**	

- **PO#2101001-1800421 Projekti# 1011182: Parkimi Nëntokësor të Sheshi Italia me kontraktor A- S, përfitues <u>Bashkia Tiranë</u>.**

Për këtë projekt procedura e prokurimit ka nisur në vitin 2017, ka një urdhër-prokurimi të rregjistruar në Nëntor 2017 por kontrata e këtij operator fitues, për këtë objekt prokurimi nuk shfaqet në APP për të patur mundësi verifikimi të shumës së angazhimit. Ndërkohë dhe dokumenti PBA2018 i vënë në dispozicion nuk ka të plotësuar listën e projekteve për investimeve sipas formatit të kërkuar, me qëllim monitorimin e angazhimit kundrejt fondeve disponibël të miratuara.

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime
dt. UP sipas përshkrimit të faturës	**22/11/2017**	**346,567,091**	
Dt.rregjisrimit të UP në SIFQ	23/11/2017		REF-35591-11-23-2017 në APP
dt. Kontratës në SIFQ	23/03/2018	**96,846,381**	**Kontrata nuk shfaqet ne APP për cilin fitues ?**
dt. Faturës I-rë	21/09/2018	**57,606,459**	
dt. Rregjistrimi Kontratës	12/10/2018		**Kontrata rregjistrohet në SIFQ 5 muaj me vonesë, kur dërgohet fatura për pagesë**
celja		**130,170,272**	
celja e rishikuar	02/10/2018	**78,571,941**	

- **PO# 2101001-1800422 Projekti#1010972: Furnizim Vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambjenteve/godinave të Tirana Olimpik Park me kontraktor ITE. G, përfitues <u>Bashkia Tiranë</u>**

Edhe kjo kontratë e rregjistruar me datë të vitit 2018, aktualisht është prokuruar në Tetor të vitit 2017. Për këtë projekt gjejmë të listuar në APP shpalljen për

prokurim por jo kontratën me fituesin përkatës. Dokumentacioni përkatës: urdhër-prokurim dhe kontratë rregjistrohen në SIFQ 1 vit më vonë në Tetor 2018.

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime
dt. UP	16/10/2017		**shënimi "migrim kontrate". Shpallja listohet në APP-2017 por jo kontrata për cilin fitues?**
Dt.rregjisrimit të UP në SIFQ	15/10/2018		**Rregjistrimi i UP 1 vit më vonë**
dt. Kontrates në SIFQ	10/04/2018	**184,105,625**	
dt. Faturës I-rë	10/04/2018	78,571,941	
dt. Rregjistrimit KontratësSIFQ	16/10/2018		**Kontrata rregjistrohet 6 muaj me vonesë nëse marrim të mirëqënë dt. e kontratës në SIFQ**
celja		78,571,941	

- **PO# 2101001-1800171 Projekti# M112690 Ndërtimi i sallës së koncerteve, pranë auditorit të Liceut Artistik "Jordan Misja", Tiranë me kontraktor EK , përfitues Bashkia Tiranë**

Kontrata për këtë projekt është lidhur në 2017 por e rregjistruar në SIFQ në vit 2018. Gjithashtu, sipas APP-2017 kontrata është lidhur me operatorin: Fl shpk p shumën 96,243,533 lekë pa TVSH në dt.14/12/2017 me REF-27344-09-21-2017 dl jo me EK.

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime
dt. UP në SIFQ	22/11/2017		
Dt.Kontratës fizike	23/11/2017		**Sipas përshkrimit të faturës dhe Sipas APP-2017 kontrata është lidhur me operatorin :FLONDI shpk për shumën 96,243,533 lekë pa TVSH në dt.14/12/2017 me** REF-27344-09-21-2017 **dhe jo me ED KONSTRUKSION**
dt. Kontratës në SIFQ	23/05/2018	**115,492,240**	
dt. Faturës I-rë	31/08/2018	**23,000,000**	**Fatura dërguar për pagesë 4 muaj më vonë 27 Dhjetor 2018**
dt. Rregjistrimi Kontratës	26/05/2018		
celja		**115,492,240**	

- **PO# 2101001-1800452 Projekti 1011433 "Rehabilitimi dhe Instalimi i Sistemit të Ngrohjes i Shkollës 9-vjeçare Mihal Grameno" me kontraktor GSM K, përfitues <u>Bashkia Tiranë.</u>**

Shpallja për këtë prokurim listohet me 25/05/2018 me nr. ref --71244-05-24-2018 por kontrata nuk shfaqet në listën e APP për të verifikuar fituesin, datën e kontratës dhe vlerën totale të angazhimit. Kontrata dhe fatura rregjistrohen me vonesë në shkelje të afateve ligjore:

Dokumenti	Data	Vlera në lekë	Konstatime
dt. UP	16/05/2018	**63,025,697**	**Shpallja për këtë prokurim listohet me 25/05/2018 me nr. ref --71244-05-24-2018 por Kontrata nuk shfaqet në listën e APP**
Dt.rregjisrimit te UP	18/05/2018	**58,250,425**	
dt. Kontrates në SIFQ	01/08/2018	**58,250,425**	

dt. Faturës I-rë	16/10/2018	**5,272,617**	
dt. Rregjistrimi Kontratës	26/12/2018		**Kontrata rregjistrohet 3 muaj më vonë kur dërgohet fatura për pagesë**
celja		**16,138,127**	

Në rastin e blerjeve të pajisjeve kompjuterike dhe sistemeve IT, ku sipas VKM nr.673 dt.22.11.2017 "*Për organizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*, i ndryshuar, është krijuar **Agjencia Kombëtare e shoqërisë së informacionit (AKSHI)** e cila është përgjegjëse për kryerjen e prokurimeve të qendërzuara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet *softëare* dhe *hardëare*, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, për institucionet në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, që janë nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Në këtë mënyrë në listat e APP si autoritet kontraktor nuk shfaqet institucioni përfitues i investimit por AKSHI duke i bërë testimet e auditimit për vlerësimin e përputhshmërisë me Udhëzimin e përhershëm nr. 2 dt. 06. 02. 2012 *"Për proçedurat standarde të zbatimit* të buxhetit si dhe VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" të vështirë dhe tepër manual. Kështu nga të dhënat e APP rezultojnë 51 procedura prokurimi të përfunduara me nënshkrimin e kontratës me një fond të prokuruar prej 4.9 miliardë lekë (nga të cilat 1.9 miliardë lekë pa TVSH është projekti me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve). Nga krahasimi i të dhënave të SIFQ me ato të listuara në APP konstatojmë se kontratat e mëposhtme nuk janë të rregjistruara në SIFQ.

Objekti i prokurimit	**Autoriteti Kontraktor**	**Lloji i Proçedurës**	**Operatori fitues**	**Nipt**	**Numri i Thirrjes**	**Data e lidhjes se kontrates**	**Fondi Prokuruar pa TVSH 000/lekë**
Ngritja e Sistemit të Dixhitalizimit të Bibliotekës Kombëtare.	AKSHI	Open Local	U.R.		REF-94226-11-14-2018	**12/27/2018**	**102,270**
Plotësimi i sistemeve të lejedrejtimit.	AKSHI	Open Local	- ABS		REF-74133-06-08-2018	**12/10/2018**	**156,200**

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 është ngritur dhe **Agjensia e Blerjeve të Përqëndruara** me vendimin nr. 81 dt.14.2.2018 e cila është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit për automjete dhe shërbime që e kalojnë vlerën limit për blerje të vogla, për Kryeministrinë, ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë. Kështu nga të dhënat e APP rezultojnë 44 procedura prokurimi të përfunduara me lidhje kontrate, me nje vlerë fondi të prokuruar prej **747.7 milionë lekë nga të cilat 18 për automjete**. Në këto raste në listat e APP si autoritet kontraktor shfaqet Agjensia por jo institucioni përfitues i fondeve buxhetore duke e bërë testimin e auditimit të vështirë dhe tepër manual.

Nga ky grup prokurimesh u konstatua se disa projekte lidhur me kontrata sipas APP nuk i gjejmë të miratuara në dokumentin PBA, shtjelluar më hollësisht në vijim.

Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;*

	Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ; *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Ligji nr.68/2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Shkelje e Ligjit të mënaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të anagazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura**.**
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave dhe të aplikacionit SIFQ, mosveprim dhe marrja e masave nga MFE, mungesë kontrolli dhe monitorimi nga Drejtoria e Përgjithshme e
Rëndësia	E lartë

Observacion i Drejtorisë Përgjithshme të Buxhetit nr.5927/12 dt.27.8.2019 *" Përsa konstatimit në lidhje me projektin "Rikualifikimi i sheshit Skënderbej faza e I-re dhe e II-të, ju bëjmë me dije se, ky projekt është financuar nga FZHR për kodet M991418 dhe M991479, financim i miratuar nga Komiteti i FZHR (referuar aneksit 3 të ligjit vjetor të buxhetit). Ndërkohëpër sa i përket projekteve me kodet 1011212 dhe 1011501 me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë Tiranë ju bajmë me dije se DPB nuk ka asnjë rol për shkak të se buxheti i bashkisë miratohet nga Këshilli Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi për pushtetin vendor, dhe kontratat rregjistrohen në thesar sipas procedurave përkatëse.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në observacion citohen të njëjtat fakte të cituara në akt-konstatim duke theksuar se DPB nuk ka asnjë përgjegjësi për rastin në fjalë. Si në observacionin më lartë citojmë detyrat e:

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit:

- *Të llogarisë dhe transferojë me drejtësi e transparencë transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor, të mbështesë dhe plotësojë me aktet e nevojshme ligjore, decentralizimin fiskal, duke synuar rritjen e të ardhurave, rritjen e eficencës të përdorimit të fondeve publike për pushtetin vendor.*
- *Shlyerja e detyrimeve të prapambetura. Menaxhimi me efektivitet i të dhënave mbi detyrimet e prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme-*

Drejtoria e Financave Vendore*:*

- *Udhëheq metodologjikisht procesin e hartimit dhe miratimit të projektbuxhetit afatmesëm të pushtetit vendor.*
- *Harton dhe konoslidon standardet e nevojshme të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.*
- *Nëpërmjet konsolidimit të standarteve për mirëmenaxhimin e financave vendore, parandalon krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe të çdo lloj detyrimi tjetër që cënon integritetetin funksional të financave të njësive të qeverisjes vendore.*
- *Analizon dhe monitoron buxhetet e njësive të qeverisjes vendore.*

Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj.M D, Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të buxhetit me drejtor znj.Xh A, Drejtoria e Menxhimit t Investimeve me drejtor znj.S S, Drejtoria e Financa vendore me drejtor Z.F B, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.LS dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G Pi, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Mbi kontratat e lidhura para alokimit të fondeve buxhetore ose për projekte <u>të paparashikuara</u> në PBA 2018-2020

Sipas Udhëzimit plotësues nr.2 datë 19.01.2019 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018", pika f) e tij: *Projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së 2018-2020, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qëndrore*. Sipas pikës 8, gërma f) e VKM nr.185 dt.19.3.2018, <u>projekte të reja për investime të politikave ekzistuese përfshihen shpenzimet e investimeve kapitale që ende nuk kanë filluar por për të cilat janë ndërmarrë angazhimet ligjore dhe që janë miratuar në procesin e mëparshëm të PBA-së gjithashtu</u> pika 10 e kësaj VKM përcaktohet një minimum alokimi fondesh prej 20% në vitin e parë të zbatimit të projektit shumëvjecar.

Gjetje:	**Marrja e angazhimeve pa fonde buxhetore disponibël dhe /ose për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA të konstatuar në 11 projekte me vlerë totale fondi buxhetor mbi 14.6 miliard lekë**
<u>Situata:</u>	Nga shqyrtimi kronologjik i transaksioneve të rregjistruara në SIFQ për disa projekte të reja (nisur nga data e kontratës) përzgjedhur nga lista e projekteve të kontraktuara gjatë vitit 2018 u konstatuan raste të prokurimit dhe kontraktimit për projekte të pamiratuara në PBA 2018-2020. Më hollësisht: • **Rasti i 3 projekteve M064176, M064177 dhe M064178 "Ndërtim rruga Kardhiq – Delvine Loti 4, 5, 6" me kontraktorë: A- S; CXXL; A C dhe përfitues**

Autoriteti Rrugor Shqiptar:

M064176, M064177 dhe M064178	Fondi ne 000/lekë	Data e transaksionit	Shënime të audituesit
PBA2018-2020	0		
Buxheti fillestar DBuxhetit	0		Excel file nga Dr.Investimeve
Buxheti fillestar sipas SIFQ	1,560,536	28/03/2018	
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	1,560,536	31/12/2018	
Realizimi 2018	1,560,536	Tetor-Dhjetor	
Shpallja ne APP	7,428,967	02/08/2018	Urdhër-prokurimi rregjistruar 20 ditë më vonë
Kontrata në SIFQ	**7,828,453**	24/09/2018	
Diferenca	**(7,828,453)**		Pa miratim në PBA
PBA2019-2020	7,960,000		

Projektet për 3 lotet e reja nuk kanë qënë të parashikuara në PBA 2018-2020. Në përgjigje të kërkesës për dokumentacion na u vunë dispozicion korrespondencat mbi detajimet fillestare të miratura të buxhetit për shpenzimet kapitale sipas programeve ku rezulton se ka një kërkesë nga Ministria e Infrasturkturës me nr.3238/5 datë 15.03.2018 për ridetajim të buxhetit 2018-2019 ku si produkte të reja cilësohen: By- pass i Tepelenës dhe ndërtimi i rrugës Porto Romano Lot 3 ndërsa 3 lotet e reja të rrugës Kardhiq –Delvinë listohen si projekte tashmë të miratura për vitin 2018-2020 gjë nuk përputhet me dokumentin e PBA2018-2020. Më pas në PBA2019-2021, 3 projektet listohen si projekte "në vazhdim" dhe jo si projekt "i ri" me kohë zgjatje 4 vjet referuar "vitit të përfundimit". Megjithatë shumat për 4 vitet 2018-2021 vlerën e plotë të kontraktuar kanë një diferencë prej 1,592 milion lekë. Duket se viti i përfundimit të projektit është 2022 dhe 2021:

Programi	Statusi projektit (vazhdim/I ri)	Vitit Fillimit	Viti përfundimit	Emërtimi Projektit	Vlera Totale e projektit	Detajimi Buxhetit v.2018 *Plan*	Parashikimi për v.2019	Parashikimi për v.2020	Parashikimi për v.2021
04520	vazhdim	2018	2021	Ndertim rruga Kardhiq - Delvine Loti 4	**2,880,000**	576,000	576,000	576,000	576,000
04520	vazhdim	2018	2021	Ndertim rruga Kardhiq - Delvine Loti 5	**2,200,000**	440,000	440,000	440,000	440,000
04520	vazhdim	2018	2021	Ndertim rruga Kardhiq - Delvine Loti 6	**2,880,000**	576,000	576,000	576,000	576,000
			?	Total	**7,960,000**	1,592,000	1,592,000	1,592,000	1,592,000

- **Rasti i projektit M064228 "Ndërtim By Pass Tepelenë" me kontraktorë: G. P. G. C dhe përfitues Autoriteti Rrugor Shqiptar:**

M064228	Fondi ne 000/lekë	Data e transaksionit	Shënime të audituesit
PBA2018-2020	0		
Buxheti fillestar	0		Sipas Excel file nga Dr.Investimeve

Dr.Buxhetit			
Buxheti fillestar sipas SIFQ	576,000[8]	21/05/2018	20% e totalit të kontratës ok
rishikim 1	- 2,400	23/08/2018	
rishikim 2	47,201	23/12/2018	shtesë buxheti për pagesë fature të dt.12/12/2018
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	**620,801**	Gusht- Dhjetor	
Realizimi 2018	620,801		
Shpallja ne APP	**1,825,714**	18/05/2018	**Në APP shkon 3 dite para alokimit te fondeve ne SIFQ%. Urdhër -prokurimi në SIFQ rregjistruar 3 muaj me vonë 24/8/2018**
Kontrata	**2,867,624**	**12/07/2018**	**Rregjistruar pas 48 ditesh në SIFQ**
Diferenca	**(2,867,624)**		Pa miratim në PBA
PBA2019-2020	**2,867,624**		

Projekti për bypassin Tepelenë nuk kanë qënë të parashikuara në PBA 2018-2020. Në korrespondencat mbi detajimet fillestare të miratura të buxhetit për shpenzimet kapitale sipas programeve ku rezulton se ka një kërkesë nga Ministria e Infrasturkturës me nr.3238/5 datë 15.03.2018 për ridetajim të buxhetit 2018-2019 ku si produkte të reja cilësohet By- passi i Tepelenës. MFE përgjigjet se fondi për këtë projekt fillimisht hapet si fond i ngrirë me qëllim ruajtjen e tavaneve të miratuara për këtë program. Më pas me shkresën nr. 84901 dt.7.5.2018 konfirmohet nga MFE c'ngurtësimi i fondeve për projektin e bypassit Tepelenë. Alokimi fondeve në këtë projekt **M064228 bëhet efektiv në SIFQ më datë 21/5/2018 por sipas të dhënave të APP shpallja për thirrje daton 18/5/2018 , pra 3 ditë para azhornimit të SIFQ. Edhe ky projekt në** PBA 2019-2021 listohet si projekt "në vazhdim" dhe jo si projekt "i ri" me kohë zgjatje 4 vjet referuar "vitit të përfundimit". Megjithatë shumat për 4 vitet 2018-2021 rezulton **2,294.17 milion lekë me një diferencë me** vlerën e plotë të kontraktuar prej 573,525 mijë lekë. Duket se viti i përfundimit të projektit është 2022 dhe 2021:

Programi	**Statusi projektit (vazhdim/ ri)**	**Vitit Fillimit**	**Viti përfundimit**	**Emërtimi i Projektit**	**Vlera Totale e projektit**	**Detajimi Buxhetit v.2018 *Plan***	**Parashikimi për v.2019**	**Parashikimi për v.2020**	**Parashikimi për v.2021**
04520	vazhdim	2018	2021	Ndertim By Pass Tepelene Loti 1	2,867,624	573,600	573,525	573,525	573,525

- **Rasti i projektit M064194 "Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 3", kontraktues "GJ" dhe përfitues <u>Autoriteti Rrugor Shqiptar</u>:**

M064194	**Fondi ne 000/lekë**	**Data e transaksionit**	**Shënime të audituesit**
PBA2018-2020	0		
Buxheti fillestar Dr.Buxhetit	0		Excel file nga Dr.Investimeve
Buxheti fillestar sipas SIFQ	**200,000**	28/03/2018	**9%**
rishikim 1	376,000	23/08/2018	**25%**
rishikim 2	(200,000)	10/12/2018	

[8] *Miratuar me shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8490/1 dt.7.05.2018 "Transferim fondi"*

rishikim 3	(732)	26/12/2018	
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	**375,268**	Tetor-Dhjetor	
Realizimi 2018	**375,268**		
Shpallja ne APP	2,337,758	13/08/2018	**Shkon në APP pa konfirmuar 20% e fondeve disponibel të cilat alokohen në SIFQ 10 ditë më vonë. Urdhër -prokurimi rregjistruar në SIFQ 2 muaj me vonë**
Kontrata	**2,777,157**	10/10/2018	
Diferenca	**(2,777,157)**		**Pa miratim në PBA**
PBA2019-2020	2,777,157		

Jemi në rastin kur projekti nuk është i miratuar në PBA2018-2020 por edhe në kushtet kur ARRSH fillon procedurat në APP 10 ditë para se të bëhen efektive fondet shtesë prej 376 milionë, të domosdoshme për të plotësuar kushten e 20% të fondeve disponibël në vitin e parë sipas nenit 51 të ligjit nr.9963.

Programi	**Statusi projektit (vazhdim/I ri)**	**Vitit Fillimit**	**Viti përfundimit**	**Emërtimi i Projektit**	**Vlera Totale e projektit**	**Detajim i Buxhetit v.2018** *Plan*	**Parashikimi për v.2019**	**Parashikimi për v.2020**	**Parashikimi për v.2021**
04520	vazhdim	2018	2021	Ndertim By Pass Tepelene Loti 1	2,867,624	573,600	573,525	573,525	573,525

- **Rasti i projektit M063896 "Rrjeti i brendshem i ujesjellesit Erseke", kontraktues "A.N.K" dhe përfitues <u>Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve</u>:**

M063896	**Fondi ne 000/lekë**	**Data e transaksionit**	**Shënime të audituesit**
PBA2018-2020	99,893		sipas dokumentit PBA ky projekt mbaron në 2019. Sipas dokumentit të miratimit nga Ministri i Financave buxheti per vitin 2019 është 111.82 milione lekë pra në total fondi i miratuar ishte 172 milion lekë
Buxheti 2019 në SIFQ (Obligimi)	-		Angazhimi për vitin 2019 nuk hidhet në SIFQ
Buxheti fillestar 2018 sipas SIFQ	60,211		**14%**
rishikim 1	35,000	22/06/2019	**I alokohen fondet shtesë ndërkohë nuk kryhet asnjë pagesë gjatë vitit.**
Buxheti Operativ me AN2	0	31/12/2018	**Fondet i zerohen në Dhjetor 2018. Nuk ka rekorde ne tabelën e rishikimeve të celjeve për rialokimin e ketij fondi ndërkohë kontrata është lidhur në Dhjetor 2018.**
Realizimi 2018	-		
Shpallja ne APP	436,498	03/08/2018	**Nuk ka Urdhër-prokurim në SIFQ. Njësia Shkon ne APP pa konfirmuar fondet disponibël në SIFQ.**
Kontrata	428,374	11/12/2018	**Regjistruar pas 8 ditësh**
Diferenca	**(328,481)**		
PBA2019-2020	434,458		

Rialokimi para shpalljes në APP e cojnë në 95.211 milionë lekë fondin disponibël, megjithatë kjo nuk e plotëson kriterin e 20% të vitit të parë. **Në PBA2019-2020 është**

listuar si projekt në vazhdim me përshkrimin" "Ujësjellësi i jashtëm Ersekë nga burimet Mavro dhe Glladishtë &Rrjeti i brendshem i ujesjellesit Ersekë" **nën të njëjtin kod projekti**. Megjithatë kjo kontratë mbetet pa fonde për vitin 2018 pasi ato të gjitha rialokohen në projekte të tjerë. Ne nuk gjejmë rekord për këtë rishikim, pra për ndryshimin e fondit nga 95,211 milion lekë në 0 lekë.

Programi	Statusi projektit (vazhdim/ri)	Vitit Fillimit	Viti përfundimit	Emërtimi i Projektit	Vlera Totale e projektit	Detajimi Buxhetit v.2018 *Plan*	Parashikimi për v.2019	Parashikimi për v.2020	Parashikimi për v.2021
04520	vazhdim	2018	2020	"Ujësjellësi i jashtëm Ersekë nga burimet Mavro dhe Glladishtë & Rrjeti i brendshëm ujësjellesit Ersekë"	434,458	95,211	183,894	155,352	

- **Rasti i projektit "Regjistri elektronik për formularët e vizitave të Mjekut të Familjes", kontraktues "I & C D", prokuruar nga <u>AKSHI</u>:**

Për këtë objekt prokurimi, nuk gjejmë asnjë të dhënë në SIFQ apo dokumentin PBA2018 apo 2019

N/A	Fondi ne 000/lekë	Data e transaksionit	Shënime të audituesit
PBA2018, PBA2019	0		
Buxheti fillestar sipas SIFQ	0		
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	0		
Shpallja ne APP	190,001	27/12/2018	Sipas APP fondi limit
Kontrata	215,664	19/03/2019	Sipas APP fondi i prokuruar + TVSH
Diferenca	**(215,664)**		Pa miratim në PBA, pa buxhet 20%viti i I-rë në SIFQ

Nga tabela e PO-ve të rregjistruara në SIFQ deri në Maj 2019, kjo kontratë nuk është rregjistruar ende në SIFQ.

- **Rasti i projektit "Ngritja e Sistemit të Dixhitalizimit të Bibliotekës Kombëtare.", kontraktues "U.R.T", prokuruar nga <u>AKSHI</u>:**

Për këtë objekt prokurimi, nuk gjejmë asnjë të dhënë në SIFQ apo dokumentin PBA2018 apo 2019.

N/A	Fondi ne 000/lekë	Data e transaksionit	Shënime të audituesit
PBA2018, PBA2019	0		
Buxheti fillestar sipas SIFQ	0		
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	0		
Shpallja ne APP	113,639	05/05/2018	Sipas APP fondi limit
Kontrata	122,724	27/12/2018	Sipas APP fondi i prokuruar + TVSH
Diferenca	**(122.724)**		Pa miratim në PBA, pa buxhet 20%viti i I-rë në SIFQ

Nga tabela e PO-ve të rregjistruara në SIFQ deri në Maj 2019, kjo kontratë nuk është rregjistruar ende në SIFQ.

- **Rasti i projektit "Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)", kontraktor; A-T-D- ATD, prokuruar nga <u>AKSHI</u>:**

Për këtë objekt prokurimi , nuk gjejmë asnjë të dhënë në SIFQ apo dokumentin PBA2018 apo 2019. Pavarësisht se kontrata është finalizuar në Shkurt 2019, procedurat e prokurimit kanë filluar pa fonde disponibël të miratuara.

N/A	Fondi ne 000/lekë	Data e transaksionit	Shënime të audituesit
PBA2018, PBA2019	0		
Buxheti fillestar sipas SIFQ	0		
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	0		
Shpallja ne APP	199,998	15/11/2018	Sipas APP fondi limit
Kontrata	220,800	04/02/2019	Sipas APP fondi i prokuruar + TVSH
Diferenca	**(220,800)**		Pa miratim në PBA, pa buxhet 20%viti i I-rë në SIFQ

Nga tabela e PO-ve të rregjistruara në SIFQ deri në Maj 2019, kjo kontratë nuk është rregjistruar ende në SIFQ.

- **Rasti i projektit "Marrëveshje shërbimi për sistemet informatike të PCAMS për llogaritjen dhe caktimin e pensioneve, FMS për Menaxhimin Financiar, CMIS për menaxhimin e deklarimit online te kontribuesve", kontraktor; I S, prokuruar nga <u>AKSHI</u>:**

Për këtë objekt prokurimi, nuk gjejmë asnjë të dhënë në SIFQ apo dokumentin PBA2018 apo 2019. Pavarësisht se kontrata është finalizuar në Shkurt 2019, procedurat e prokurimit kanë filluar pa fonde disponibël të miratuara.

N/A	Fondi ne 000/lekë	Data e transaksionit	Shënime të audituesit
PBA2018, PBA2019	0		
Buxheti fillestar sipas SIFQ	0		
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	0		
Shpallja ne APP	194,736	15/11/2018	Sipas APP fondi limit
Kontrata	194,736	04/02/2019	Sipas APP fondi i prokuruar + TVSH
Diferenca	**(194,736)**		**Pa miratim në PBA, pa buxhet 20%viti i I-rë në SIFQ**

Nga tabela e PO-ve të rregjistruara në SIFQ deri në Maj 2019, kjo kontratë nuk është rregjistruar ende në SIFQ.

- **Rasti i projektit M870318 "Ngritja e sistemit te gjobave elektronike për Policinë e Shtetit", kontraktues "I & C D", prokuruar nga <u>AKSHI</u>:**

Pavarësisht se nuk është i miratuar në PBA2018-2020 , këtij projekti i është celur fondi prej 40 milionë lekë dhe kanë filluar procedurat e prokurimit më 11 Qershor 2018 me një fond limit prej 239 milionë lekë pa plotësuar minimalisht kushtin për 20% fonde disponibël në vitin e parë të zbatimit. Ky projekt aktualisht është i miratuar në PBA2019-2021 një vlerë totale 171.2 milion lekë me një tejkalim të fondit të miratuar prej

N/A	Fondi ne 000/lekë	Data e transaksionit	Shënime të audituesit
PBA2018	0		

PBA2019-2021	171,209		
Buxheti fillestar sipas SIFQ	**40,000**		**15%**
Rishikimi 1	**26,974**	**19/01/2019**	
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	**66,974**		
Urdhër prokurimi rregjistruar në SIFQ	171,209	20/10/2018	Rregjistruar në SIFQ 2 muaj pas lidhjes së kontratës ose 4 muaj pas shpalljes në APP
Shpallja ne APP	**239,029**	**11/06/2018**	**Sipas APP fondi limit**
Kontrata në APP	**273,060**	**08/07/2018**	**Sipas APP fondi i prokuruar shtuar TVSH**
Kontrata rregjistruar në SIFQ	171,209		**Pa miratim në PBA2018, pa buxhet 20%viti i I-rë në SIFQ**
Diferenca	**(101,851)**		**Ne tejkalim te miratimit vlerë totale projekti dhe vlerës reale të kontratës së lidhur**

Nga tabela e PO-ve të rregjistruara në SIFQ deri në Maj 2019, kjo kontratë është ende e parregjistruar në SIFQ.

Në kampionin e zgjedhur për testim ishin dhe projektet e menaxhuara nga njësitë e qeverisjes vendore si **Bashkia Tiranë**. Në përputhje me Ligjin nr.9936 i ndryshuar, për menaxhimin e sistemit buxhetor, dhe Ligjit 68/2017 neni 33 "Për Financat e qeverisjes vendore", dhe Udhëzimit nr.23 dt. 30/7/2018 " Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 4 e tij "*Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore përgatit kërkesat buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, me qëllim që të sigurohet që shpërndarja e fondeve buxhetore të reflektojë arritjen e objektivave të përcaktuara në dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor apo dokumente të tjerë strategjikë të njësisë së vetëqeverisjes vendore*", ku MFE luan një rol këshillues në përgatitjen e tij duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse. Në bazë të dokumentit PBA të venë në dispozicion për 2018-2020 dhe 2019-2021 nuk mund të kryenim testime mbi celjet në nivel projekti nëse ato ishin ekzekutuar pas miratimeve ligjore përkatëse. Dokumenti PBA i Bashkisë Tiranë nuk ishte i plotë dhe nuk jep informacion mbi projektet e investimeve pjesë e formatit të unifikuar të nxjerë nga MFE për këtë qëllim, të cilin e gjejmë të zbatuar nga Bashki të tjera si: Bashkia Durrës apo Roskovec.

Kriteri:

Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;
Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".
VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".
Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të

	njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit". *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Shkelje e Ligjit të mënaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të anagazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura**.**
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave dhe të aplikacionit SIFQ, mosveprim dhe marrja e masave nga MFE, mungesë kontrolli dhe monitorimi nga Drejtoria e Buxhetit
Rëndësia	E lartë

Observacioni i Drejtorisë Përgjithshme të Buxhetit nr.5927/12 dt.27.8.2019 "*Në mbështetje të nenit 36, të ligjit nr.68, datë 27.4.2017 " Përfinancat e vetëqeverisjes vendore", njësitë e vetëqeverisjes vendore (përfshirë këtu dhe Bashkinë Tiranë) kanë të përcaktuara qartë se cfarë duhet të përmbajë dokumenti i programit buxhetor afatmesëm. Referuar rastit konkret, Bashkia Tiranë duhet të ndjekë procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore". Formatet mbi të cilat hartohet PBA-ja janë të përcaktuara në udhëzimet vjetore të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit vendor. Në zbatim të pikës 5, të nenit 36, të ligjit të sipërcituar Ministria e Financave dhe Ekonomisë analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm për cdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe ia dërgon zyrtarisht, këtyre të fundit brenda datës 20 qershor. Për sa më sipër , ju bëjmë me dije se MFE ka përgatitur një raport me rekomandime mbi cilësinë e këtij dokumenti të cilën ja ka dërguar zyrtarisht Bashkisë Tiranë. Një nga këto rekomandime ka qënë edhe paraqitja e listës së plotë të projekteve të investimeve, gjë të cilën Bashkia Tiranë e ka reflektuar me miratimin e buxhetit vjetor dhe dërgimin e tij në Degën e Thesarit.*

Qëndrimi i grupit të auditimit . Drejtoria e Financave Vendore pranë DPB mund të vinte në dispozicion të grupit të auditimit shkresën e sipërcituar, me rekomandime të dërguara të Bashkia Tiranë dhe listën e plotë të investimeve të përpiluar nga kjo Bashki pas këtyre rekomandimeve, në vijim të citimeve të përsëritura të përgjegjësive që i ngarkon ligji Bashkisë apo MFE. Observacioni nuk pranohet.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj. M. D, Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të buxhetit me drejtor znj.Xh A, Drejtoria e Menxhimit t Investimeve me drejtor znj.SS, Drejtoria e Financa vendore me drejtor Z.F B, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

2.4.1 Mbi kontratat e lidhura me vlera më të larta se fondet disponibël

Gjetje: **Konstatohen raste të kontratave të lidhura me shuma më të larta se fondet e miratuara: Rastet e MIE, Ministrisë së Shëndetsisë**

Situata:

Nga shqyrtimi i të dhënave të kontratave dhe krahasimi i tyre me të dhënat e dërguara nga APP rezultuan raste ku fondi limit pa TVSH në shpallje të prokurimit dhe më pas fondi i prokuruar ishin në vlera më të larta se fondi disponibël në SIFQ. Më konkretisht:

- **Rasti i projektit M064091 "Aplikimi i përdorimit të sistemeve alternative me efiçencë të**

lartë për sistemet teknike në një qënder rezidenciale" me kontraktor "R&T" dhe përfitues Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës:

Nga tabela rekordeve të gjithë rishikimeve të projektekteve gjatë vitit 2018, evidentohet se një shtesë prej 79 milionë lekë për këtë projekt është bërë efektive më 4/8/2018:

ID#	Periudha GL	Celja Fillestare	Shuma e rialokuar	Neë balance	Kodi institucionit	Programi	Llogaria ekonomike	Data e rishikimit
5833307	07-2018	-	79,000	79,000	1006001	04320	2310000	03-AUG-18
5861298	09-2018	79,000	19,000	**98,000**	1006001	04320	2310000	04-OCT-18
5861298	09-2018	**19,000**	- 19,000	-	1006001	04320	2300000	04-OCT-18

Me një fond disponibël prej 98 milion lekë, MIE nis në APP procedurat e prokurimit me shpalljen REF-86723-09-20-2018 me datë 21/9/2018 me një fond limit prej 113,866 mijë lekë pa TVSH, shumë kjo mbi fondet disponibël prej 68.355 milionë lekë.

M064091	**Fondi ne 000/lekë**	**Data e transaksionit**	**Shënime të audituesit**
Buxheti fillestar sipas SIFQ	19,000		
Rishikimi 1	79,000	03/08/2018	Në SIFQ GL date Korrik 2018.
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	98,000	31/12/2018	
Realizimi 2018	68,001	24/12/2018	
Shpallja ne APP	113,316	21/09/2018	
Kontrata në SIFQ	131,886	04/12/2018	**Kontrata nuk shfaqet në APP. Regjistruar në SIFQ më 26/12/2019**
Diferenca	**(68,335)**		**Mbi fondin disponibël**

- **Rasti i projektit M064120 "Rehabilitimi i Uzinës së Rafinimit të Bakrit" me kontraktor "K" dhe përfitues <u>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës</u>:**

Me një fond disponibël prej 57,340 mijë lekë, MIE nis në APP procedurat e prokurimit me shpalljen REF-82234-08-07-2018 me datë 21/9/2018 me një fond limit prej 96,787 mijë lekë me TVSH, shumë kjo mbi fondet disponibël prej 39,447 mijë lekë. Nga verifikimi me rregjistrin e prokurimeve të dorëzuar nga MIE pranë degës së thesarit Tiranë ky projekt listohet me një fond të përllogaritur prej 47,783 mijë lekë pa TVSH ndërkohë që në APP publikohet

M064091	**Fondi ne 000/lekë**	**Data e transaksionit**	**Shënime të audituesit**
Buxheti fillestar sipas SIFQ	57,340		
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	57,340	06/12/2018	

Realizimi 2018	57,340	24/12/2018	
Shpallja ne APP	96,787	08/08/2018	**Shuma me TVSH**
Kontrata në SIFQ	95,503	08/10/2018	Kontrata nuk shfaqet në APP. Regjistruar në SIFQ më 13/12/2018. **2 muaj me vonesë**
Diferenca	**(38,163)**		**Mbi fondin disponibël**

- **Rasti i projektit M134065 "Rekonstruksione në Spitalin rajonal Kukës" me kontraktor "C- shpk" dhe përfitues <u>Ministria e Shëndetësisë-Spitali Kukës</u>:**

Fondi i parashikuar në PBA për këtë projekt është 15.334 milionë lekë. Më Maj 2018 rregjistrohet një shtesë fondi prej 24.320 milionë lekë duke plotësuar kushtin për të patur 20% të fondeve disponibël për të filluar kështu procedurat e prokurimit në APP. Megjithatë në APP nuk gjejmë rekorde të shpalljes dhe fituesit që sipas SIFQ është lidhur për shumën 189.1 milionë lekë, vlerë e cila më pas përfshihet dhe miratohet në PBA e vitit pasardhës 2019-2021.

M134065	**Fondi ne 000/lekë**	**Data e transaksionit**	**Shënime të audituesit**
PBA2018-2020	15,334		
Buxheti fillestar sipas SIFQ	15,000		
Rishikim 1	24,320	31/05/2018	Rialokohen fondet për të plotësuar kushtin e 20% të buxhetit të alokuar në vitin e I-rë të investimit.
Rishikim 2	(38,000)	26/12/2018	
Buxheti Operativ(AN2) SIFQ	1,320	26/12/2018	
Realizimi 2018	0		
Shpallja ne APP	0		**Nuk ka të dhëna në APP, nuk ka Urdhër prokurim ne SIFQ**
Kontrata në SIFQ	189,177	11/12/2018	**Nuk ka të dhëna në APP**. Regjistruar në SIFQ më 28/12/2018.
Diferenca	**(174,177)**		**Mbi fondin disponibël**

Me këto të dhëna nuk verifikojmë dot datën e fillimit të procedurave të prokurimit. Fondet e vitit 2018 rialokohen përsëri në projekte të tjera. Sipas të dhënave që disponojmë deri në Maj 2019 nuk ka asnjë situacion dhe pagesë të kryer për këtë projekt.

<u>Raste të konstatuara në kontratat e rregjistruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në total mbi fondin disponibël 58,622 mijë lekë</u>

- Në popullatën e shpenzimeve kapitale prej 5 kontratash, 2 prej tyre (**M100551 dhe M100013**) janë projekte prokurimi i shpenzimit kapital i të cilëve është ndërmarrë pa fonde buxhetore të alokuara, anagzhime të cilat kapin vlerën 58,622 mijë lekë nga totali prej 137,220 mijë lekë. Pra afërsisht 43% e investimeve angazhohen pa patur fondet buxhetore përkatëse të alokuara nga buxheti.

Ky konstatim evidenton shkeljen e procedurës së përcaktuar në Udhëzimin 2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018" për konfirmimin në Thesar të fondeve disponibël përpara shpalljes së procedurës së prokurimit

Në popullatën e shpenzimeve kapitale prej 5 kontratash, tek të 5-të nuk është respektuar afati 5 ditor i rregjistrimit të kontratave në SIFQ pas nënshkrimit të saj nga operatori fitues dhe autoriteti kontraktor, të cilat kapin vlerën totale prej 137,220 mij lekë ose 100% të vlerës totale të tyre. Kjo procedurë është në kundërshtim me Udhëzimin specifik nr.26 dt. 20/11/2012, pika 17 Gjithashtu në 1 nga 5 kontratat kemi

	mosrespektim nga njësia shpenzuese për rregjistrimin e urdhër shpenzimit në thesar brenda afatit 30 ditor nga data origjinale e faturës së furnitorit me vlerë totale 8,520 mij lekë. Kjo procedure është bërë në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit nr.9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 52* - Nga përshkrimi i transaksionit që bën thesari, në projektin me kod **M100466** kemi konstatuar se janë pranuar dhe likujduar fatura me datë fature më të hershme se data e situacionit pjesor ose përfundimtar të punimeve(operatori "SHPRESA" SHPK me faturë me nr.serie 58921838 dt 26.12.2018 dhe vlerë 14,549,091 lekë por situacion përfundimtar i datës 31.12.2018, si dhe operatorin "ALTEC" SHPK, i cili ka paraqitur faturat me nr.serie 50841896 datë 26.12.2018 dhe vlerë 23,790,788 lekë dhe nr.serie 50841898 dt 26.12.2018 dhe vlerë 14,258,722 lekë ndërkohë që situacionet perfundimtare ka datën 31.12.2018). Në total kemi 52,598 mij lekë pagesa me dokumentacione justifikues të shpenzimeve jokonsistentë në kronologjinë e lëshimit dhe paraqitjes së tyre në thesar. Dega e Thesarit nuk duhet të pranoj dokumentacion dhe të kryejë pagesa mbi këtë dokumentacion. Për **projektin M100500 "Përmirësimi i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit**", duke marrë parasysh vlerën materiale të tij, është vlersuar e arsyeshme dhe analiza e tij nëpërmjet sigurimit nga degët e thesarit të kontratës përkatëse dhe vezhgimin e procedurës së rregjistrimit në sistemin SIFQ. Në PBA 2019 - 2021 vlera totale e projektit është rregjistruar për 1,727,792 mijë lekë, specifikuar kjo dhe në databazën e projekteve të investimeve publikuar në faqen zyrtare të MFE. Në databazën e investimeve, si pjesa më e madhe e angazhimeve,,dy vitet e para janë në vlerën zero dhe totali i angazhimit është rregjistruar në vitin 2021 me vlerën 1,727,792 mijë lekë. Pra buxheti i celur për këtë kontratë në PBA 2019 – 2021 është vetëm 1,727,792 mijë lekë, ndërsa prokurimi është zhvilluar me fond limit pa TVSH për 1,869,825 mijë lekë, në pamjaftueshmëri fondesh. Gjithashtu për këtë projekt, alokimi i fondeve nga buxheti është bërë në datën 2 maj 2018 me nje vlerë 259,280 mijë lekë dhe është rishikuar vlera me Aktin Normativ duke rezultuar përfundimisht në 170,047 mijë lekë, aq sa është dhe pagesa përkatëse për vitin 2018. Ndërkohë zhvillimi i procedurës së prokurimit e nisur më 5 gusht 2018 dhe përfunduar 21 shtator 2018, ka shpallur fitues "Jehona Softëare" me vlerë prokurimi me TVSH prej 2,238,184 mijë lekë. Bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit nr.9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar*", neni 40 ku citohet; "*Për angazhimet buxhetore shumëvjecare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës", vlera minimale e alokuar për këtë projekt me vlerë totale* 2,238,184 mijë lekë, duhet të ishte minimalisht 446,636 mijë lekë (2,238,184 mijë x 20%), por fakti është se është prokuruar duke pasur fond vetem në vlerën 170,047 mijë lekë, në kundërshtim të plotë me nenin 40 të ligjit organik të buxhetit të shtetit dhe VKM nr.185 dt.19.3.2018 "*Për procedurat e miratimit të investimeve publike*" pika 10 e saj ku përcaktohet një minimum alokimi fondesh prej 20% në vitin e parë të zbatimit të projektit shumëvjecare. Më tej vihet re rregjistrimi i kontratës 21 ditë me vonesë nga data e nënshkrimit të sajnë kundërshtim me Udhëzimin specifik nr.26 dt. 20/11/2012, pika 17.

<u>Raste te konstatuara në kontratat e rregjistruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave</u>

Për këtë BI Offline nga një total popullsie prej 24 kontratash për investime në vitin 2018, janë testuar 8 prej të cilëve kanë qenë të financuar nga buxheti i shtetit dhe jo nga të ardhurat e veta, si dhe kanë pasur procedurë prokurimi të evidentuar në databazën e Agjensisë së Prokurimeve Publike. Nga testimi i kampionit prej 8 kontratash, është konstatuar projekti M100454 Blerje dhe montim gjeneratorësh, prokurimi i shpenzimit kapital i të cilit, me vlerë kontrate 7,272 mijë lekë, është ndërmarrë pa fonde buxhetore të alokuara, E njëjta situatë paraqitet dhe për projektin M100493 Blerje dhe montim stabilizator tensioni për vlerën 894 mijë lekë. Për projekti M100487 Blerje Bateri per shtimin e kapaciteteve te UPS Rack Mounted, procedura e prokurimit është zhvilluar dhe mbyllur në dhjetor të vitit 2017, ndërkohë fondet buxhetore i janë alokuar në vitin 2018, pra angazhimi me vlerë kontrate 3,559 mijë lekë është ndërmarrë pa fonde buxhetore. Në total nga DPD kemi angazhime të ndërmarra pa fonde buxhetore arrijnë vlerën ***10,831 mijë lekë.*** *Ky konstatim evidenton shkeljen e procedurës së përcaktuar në Udhëzimin 2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018" për konfirmimin në Thesar të fondeve disponibël përpara shpalljes së procedurës së prokurimit*

Nuk është respektuar afati 5 ditor i rregjistrimit të kontratës për projektin M100487 Blerje Bateri per shtimin e kapaciteteve te UPS Rack Mounted në SIFQ pas nënshkrimit të saj nga operatori fitues dhe autoriteti kontraktor, të cilat kapin vlerën totale prej 3,559 mijë lekë. Kjo procedurë është në kundërshtim me Udhëzimin specifik nr.26 dt. 20/11/2012, pika 17 e tij. Për të njëjtin projekt janë bërë pagesat mbas datës 31 janar të vitit 2018 për një shpenzim që ka ndodhur në 26 tetor 2017 (data furnitorit), në shkelje të nenit 52 të ligjit organik të buxhetit si dhe ky angazhim është ndërmarrë pas datës 15 tetor të vitit buxhetor 2017 në shkelje të ligjit organik të buxhetit 9936 neni 51 dhe VKM nr. 807 datë 16.11.2016 "*Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore*".

<u>Raste te konstatuara në kontratat e rregjistruara nga Financave dhe Ekonomisë.</u>

- ***PO# 1010001-1800032 Projekti M100390: Ndertim i bazes prodhuese për shkollën AMP "Karl Gega", Tirane, Kontraktor "G J" , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.***

Nga realizimi i testeve janë evidentuar këto problematika si më poshtë:

-Kontrata nr.1265/6 datë 04/09/2017 është lidhur për vlerën totale (bashke me tvsh) për 128,362,004 lek për një afat prej 10 muajsh dhe në 2017 ka ardhur situacioni nr.1 me vlerë 40,908,904 lek, i cili është paguar pjesërisht 20,600,000 lek, kurse pjesa tjetër prej 20,308,904 lek është paguar në 2018. Në 2018 është bërë një shtesë kontrate në datë 26/07/2018 me një vlere totale prej 25,550,233 lek (fondi i prokuruar pa tvsh 21,291,861 lek) duke e çuar vlerën totale të kontratës bashkë me shtesën në vlerën 153,912,237 lek (128,362,004 lek + 25,550,233 lek) (shtesa e kontratës është ndërmarrë pa pasur fondet e nevojshme në dispozicion sepse me fondet e çeljes buxhetore (40,308,904 lek) janë bërë pagesat e 2 faturave të para (verifikohet nga datat e kryerjes së pagesave) si dhe shtesa e fondeve është bërë në 03/08/2018). Kontrata në sistem nuk është paraqitur/regjistruar me vlerën e saj totale por është e copëzuar në varësi të fondeve që ka disponibel për të kryer pagesat e faturave që faturohen nga operatoret. Pra fondet në dispozicion janë përdorur për të shlyer ekzaktesisht faturat (disa prej te cilave janë fatura të prapambetura dhe disa në momentin e kryerjes së pagesës nuk janë te

	lidhura ne nje PO-number së për cilën kontratë janë bërë këto pagesa) dhe çdo shtesë e fondeve me AN është përdorur në të njëjtën mënyrë. Projekti nga çelja buxhetore evidentohet se nuk i ka të gjitha fondet e nevojshme në dispozicion prandaj kontrata është copëzuar për mos tu hedhur/regjistruar me vlerën e saj të plotë, për të pritur shtesat e fondeve me Akte Normative (janë bërë gjithsej 3 rishikime gjatë vitit) për të bërë njohje/regjistrim kontratës dhe pagesën e faturave për fondet që ka disponibël. -Nga databaza e PBA siguruar nga Drejtoria e Buxhetit, jepet informacioni se projekti është parashikuar që të ketë vit fillimi vitin 2017 dhe viti i mbarimit 2018. Por shpërndarja e fondeve buxhetore në PBA kalon deri në vitin 2019 (shtesa e kontratës ka afat 28 ditë). -Fatura me ***"Nr-Fat" 13510100012018*** është faturë e prapambetur e cila është faturuar në 26/12/2017 dhe po paguhet në vitin 2018, si diferencë pagese, pra kemi edhe pagesa pjesore. -Nuk ka respektuar radhën e kryerjes së pagesave (FIFO) sepse fatura me vlere 3,386,230 lek dhe numer ***"78210100012018"*** ka datë furnitori 28/02/2018 dhe është paguar në 24/08/2018 dhe në vend te saj eshte paguar fatura me nr ***"32610100012018"*** me vlerë 20,000,000 lek e cila përkon barabartë me fondet në dispozicion në atë moment (çelja buxhetore është 40,308,904 lek dhe mbasi ka bërë pagesën e faturës me nr "**13510100012018"** prej 20,308,904 lek i kane mbetur fonde në dispozicion para shtesës së fondeve, vetëm 20,000,000 lek sa ç'është vlera e faturës me nr ***"32610100012018")***, e cila ka date furnitori 28/03/2018 dhe është paguar në 20/04/2018. Kjo sepse nga njësia ekonomike urdhër shpenzimi për faturën nr ***"78210100012018"*** është miratuar me vonesë dhe në shkelje të afateve 30 ditore. - Fatura me ***"Nr- Fat" 32610100012018*** ka datë të ndryshme furnitori nga ajo e përshkruara tek seksioni "Përshkrim i faturës". Data e furnitorit tek file i pagesave është 28/03/2018 kurse data e faturës tek përshkrimi është 28/02/2018, në këtë rast kemi edhe pagesa pjesore të faturave si dhe "fatura në shkelje të afatit 30 ditorë" të cilat po shlyhen/likuidohen tani. - ***PO#* 1010001-1800030 *Projekti M100392: Rikonstruksion shkolla AM Profesional Kamez, Kontraktor "A C" , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** Nga realizimi i testeve janë evidentuar këto problematika si më poshtë: -Fatura me *"Nr-Fat" 21910100012018, 13610100012018, 33510100012018, 36410100012018, 36410100012018, 52910100012018*, kanë data të ndryshme furnitori tek file i pagesave nga ato të përshkruara në faturë tek seksioni "Përshkrim i faturës". Në këtë rast verifikohet se kemi të bëjmë me "fatura në shkelje të afatit 30 ditorë" të cilat po shlyhen tani. Rasti i faturës me nr ***33510100012018 është që nga pjesa e "përshkrimit të faturës" data e faturës rezulton 29.12.2017 kurse tek file i pagesave "data e furnitorit" është 28.03.2018 e cila është faturë e prapambeturë (në shkelje të afatit 30 ditorë) e cila po regjistrohet dhe paguhet tani.*** -Kemi pagesa pjesore të faturave, ku evidentohen në dy fatura me ***"Nr-Fat" (21910100012018 dhe 13610100012018)***, të cilat janë faturuar në 2017 pasi janë marr në dorëzim dhe pranuar situacionet e punimeve, por nuk është bërë likuidimi total i tyre, dhe pjesa e mbetur është paguar në vitin 2018 (29,999,543 lek). -Kontrata nr. 1647/6 datë 11.09.2017 "Rikonstruksioni i shkollës Profesionale Kamëz"

	është lidhur për vlerën totale (bashkë me tvsh) për 153,629,722 lek për një afat prej 10 muajsh dhe në 2017 kanë ardhur situacioni nr.1 me vlerë 33,912,503 lek dhe situacioni nr.2 me vlerë 16,087,040 lek, nga të cilët janë paguar pjesërisht 20,000,000 lek, kurse pjesa tjetër prej 29,999,543 lek është paguar në 2018. Në 2018 është bërë një shtesë kontratë në datë 27/08/2018 me një vlerë totale prej 29,810,360 lek (fondi i prokuruar pa tvsh 24,841,866 lek) duke e çuar vlerën totale të kontratës bashkë me shtesën në vlerën 183,440,082 lek (153,629,722 lek + 29,810,360 lek) (shtesa e kontratës është ndërmarë pa pasur fondet e nevojshme në dispozicion sepse me fondet e çeljes buxhetore (86,559,546 lek) janë bërë pagesat e 6 faturave (verifikohet nga datat e kryerjes së pagesave), si dhe shtesa e fondeve është bërë në 31/08/2018). Kontrata në sistem nuk është paraqitur me vlerën e saj totale por është e copëzuar në varësi të fondeve që ka disponibel për të kryer pagesat e faturave që faturohen nga operatorët. Pra fondet në dispozicion janë përdorur për të shlyer ekzaktesisht faturat (disa prej të cilave janë fatura të prapambetura dhe disa në momentin e kryerjes së pagesës nuk janë të lidhura me një PO-number së për cilën kontratë janë bërë këto pagesa) dhe çdo shtesë e fondeve me AN është përdorur në të njëjtën mënyrë. Projekti nga çelja buxhetore evidentohet se nuk i ka të gjitha fondet e nevojshme në dispozicion prandaj kontrata është copëzuar për mos tu hedhur/regjistruar me vlerën e saj të plotë, për të pritur shtesat e fondeve me Akte Normative për të bërë njohje/regjistrim kontratës dhe pagesën e faturave për fondet që ka disponibël. -Nga databaza e PBA siguruar nga Drejtoria e Buxhetit, jepet informacioni se projekti është parashikuar që të ketë vitë i fillimit 2017 dhe viti i mbarimit 2018. Por shpërndarja e fondeve buxhetore në PBA kalon deri në vitin 2019. (shtesa e kontratës ka afat 21 ditë - ***PO#* 1010001-1800025 *Projekti M100379: Blerje pajisje laboratorike, arsimi profesional, Kontraktor "E" , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** Nga realizimi i testeve janë evidentuar këto problematika si më poshtë: -Afati i regjistrimit të U.P në SIFQ (5 ditë) është tejkaluar sepse publikimi i U.P sipas APP është bërë në dt 12/06/2018 kurse në SIFQ në dt 19/09/2018. -Dt U.P është 12/06/2018 sipas APP, kurse buxheti për këtë projekt është çelur me vlerën 40,000,000 lek dhe shtesa e fondeve me AN është bërë më dt 31/08/2018, por kontrata është lidhur më 22/08/2018, nga ku rezulton se janë ndërmarrë angazhime dhe kane filluar proçedurat e prokurimit pa pasur të gjithë fondet buxhetore në dispozicion. (Vlera totale e kontratës sipas APP është 53,089,560 lek, që është 13,089,560 lek më shumë sesa vlera e çeljes buxhetore që është 40,000,000 lek). -Kemi tejkalim të afateve të lejuara në ligj (5 ditë), për regjistrimin në SIFQ pas dt së nënshkrimit të kontratës, pra në SIFQ është regjistruar në dt 24/09/2018 kurse nënshkrimi i kontratës është bërë në 22/08/2018. -Data e krijimit të REQ 19/09/2018 dhe data e krijimit të PO (Kontrata) 24/09/2018, diferencë 5 ditë midis tyre, nga ku konkludohet se kemi të bëjmë me regjistrime në sistem vetëm kur duhet të bëhen pagesa për faturat dhe jo duke kryer regjistrimet në mënyrë kronologjike në sistem sipas udhëzimeve përkatëse. -Ka një diferencë midis shumave të (Vlera e kontratës, Shumave të faturuara, Pagesave) dhe Faktit 2018, kjo diferencë është 40.100 lek. Mbas sqarimeve dhe kontrollin me sistemin del që kjo diferencë vjen si pasojë e axhustimi/rregullimit të ditarëve në

	kontabilitet ku është pakësuar projekti M100384 me 1,000,100 lek dhe janë shtuar projektet e tjera përkatësisht: M100480 me 960,000 lek dhe M100379 me 40,100 lek. (Nr dokumentit të ditarit 19759, ndryshimi i bërë në Dhjetor). - ***PO#* 1010001-1800019 *Projekti M100519: "Upgrade i sistemit ALPHA për llogari të institucioneve'' Loti 2: Azhurnim I sistemit të qëndërzuar financiar për MFE dhe deget e thesarit ALPHA ËEB buxhetor, Kontraktor "I M B" , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** Nga realizimi i testeve janë evidentuar këto problematika si më poshtë: -Afati i regjistrimit të U.P në SIFQ (5 ditë) është tejkaluar sepse publikimi i U.P sipas APP është bërë në dt 09/05/2018 kurse në SIFQ në dt 13/08/2018. -Kemi tejkalim të afateve të lejuara në ligj (5 ditë), për regjistrimin në SIFQ pas dt së nënshkrimit të kontratës, pra në SIFQ është regjistruar në dt 06/09/2018 kurse nënshkrimi i kontratës është bërë në 22/06/2018. -Data e krijimit të REQ 13/08/2018 dhe data e krijimit të PO (Kontrata) 06/09/2018, të dyja jashtë afateve ligjore të përshkruara mësipër, për tu theksuar është se janë regjistruar në sistem mbas kalimit/shtesës së fondeve në dt 03/08/2018, pavaresisht nga data reale/fizike e tyre. Si dhe fatura e parë e furnitorit ka ardhur më 10/09/2018 vetëm 4 ditë mbas regjistrimit të kontratës në sistem, nga ku konkludohet se kemi të bëjmë me regjistrime në sistem vetëm kur duhet të bëhen pagesa për faturat dhe jo duke kryer regjistrimet në mënyrë kronologjike në sistem sipas udhëzimeve përkatëse. (Afati i kontratës është 27 muaj). -Shuma e paguar = shuma e faturuar = çeljes/shtesën buxhetore = 11,668,000 lek (çelja buxhetore fillestare për këtë projekt ka qënë 0 lek dhe fondet janë alokuar nëpërmjet AN), ndërkohë që nga APP fondi i prokuruar pa tvsh është 13,240,868 lek dhe vlera e plotë e kontratës bashkë me tvsh është 15,888,000 lek. Nuk kemi njohje të kontratës me vlerën e saj të plotë por copëzim dhe njohje vetëm të vlerës së kontratës aq sa ka fonde buxhetore disponibël për të bërë pagesat e faturave. Vlera e faturës = kontratës = fondet disponibël që janë alokuar nga shtesa me AN, por që nuk është e barabarte me vlerën totale te kontratës sipas APP, kemi të bëjmë me copëzim kontrate. Në këtë mënyrë institucioni regjistron kontratat vetëm kur ka fonde të disponueshme dhe vetëm për vlerën disponibël, dhe jo për vlerën e plotë të angazhimit. -Dt U.P është 09/05/2018 sipas APP, për këtë projekt nuk ka pasur çelj e buxhetore (0 lek) edhe pse është një projekt/angazhim shumëvjeçarë (27 muaj) dhe duhet të kishte një PBA të miratuar ku të ishin detajuar shpërndarja e fondeve buxhetore sipas viteve përkatëse dhe shtesa e fondeve është bërë më dt 03/08/2018. Por kontrata është lidhur më 22/06/2018, janë ndërmarrë proçedurat e prokurimit pa pasur fonde në dispozicion dhe është lidhur kontrata me operatorët fitues. - ***PO#* 1010001-1800035 *Projekti M100544: "Hartim projekt preventiv për Ndërtimin e shkollës profesionale të IT-së", Kontraktor "T" SHPK , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** Nga realizimi i testeve janë evidentuar këto problematika si më poshtë: -Afati i regjistrimit të U.P në SIFQ (5 ditë) është tejkaluar sepse publikimi i U.P sipas APP është bërë në dt 13/09/2018 kurse në SIFQ në dt 12/11/2018. -Dt U.P është 13/09/2018 sipas APP, për këtë projekt nuk ka pasur çelje buxhetore dhe

	shtesa e fondeve është bërë më dt 09/11/2018, por kontrata është lidhur më 16/10/2018, janë ndërmarrë angazhime dhe kanë filluar proçedurat e prokurimit pa pasur fonde në dispozicion dhe është lidhur kontrata me operatoret fitues. -Kemi tejkalim të afateve të lejuara në ligj (5 ditë), për regjistrimin në SIFQ pas dt së nënshkrimit të kontratës, pra në SIFQ është regjistruar në dt 12/11/2018 kurse nënshkrimi i kontratës është bërë në 16/10/2018. -Data e krijimit të REQ 12/11/2018 dhe data e krijimit të PO (Kontrata) 12/11/2018, të dyja jashtë afateve ligjore të përshkruara mësipër, për tu theksuar është se janë regjistruar në sistem në të njëjtën ditë bashkë, 3 ditë mbas kalimit/shtesës së fondeve në dt 09/11/2018. Si dhe fatura e parë e furnitorit ka ardhur me 01/11/2018, 11 ditë para kalimit të fondeve për këtë projekt dhe regjistrimit të kontratës në sistem, po në 12/11/2018 është bërë urdhër-shpenzimi dhe regjistrimi i faturës dhe 1 ditë më vonë është bërë ekzekutimi i saj, nga ku konkludohet se kemi të bëjmë me regjistrime në sistem vetëm kur duhet të bëhet pagesa për faturat dhe jo duke kryer regjistrimet në mënyrë kronologjike në sistem sipas udhëzimeve përkatëse. - ***PO#* 1010001-1800039 *Projekti M100545: "Krijimi i sistemit Konference Room", Kontraktor "A-CO" , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** Nga realizimi i testeve janë evidentuar këto problematika si më poshtë: -Afati i regjistrimit të U.P në SIFQ (5 ditë) është tejkaluar sepse publikimi i U.P sipas APP është bërë në dt 20/07/2018 kurse në SIFQ në dt 20/11/2018. -Kemi tejkalim të afateve të lejuara në ligj (5 ditë), për regjistrimin në SIFQ pas dt së nënshkrimit të kontratës, pra në SIFQ është regjistruar në dt 27/11/2018 kurse nënshkrimi i kontratës është bërë në 07/09/2018. -Dt U.P është 20/07/2018 sipas APP, për këtë projekt nuk ka pasur çelje buxhetore dhe shtesa e fondeve është bërë më dt 26/11/2018, por kontrata është lidhur më 07/09/2018, janë ndërmarrë angazhime dhe kanë filluar proçedurat e prokurimit pa pasur fonde në dispozicion dhe është lidhur kontrata me operatorët fituesë. -Data e krijimit të REQ 26/11/2018 dhe data e krijimit të PO (Kontrata) 27/11/2018, të dyja jashtë afateve ligjore të përshkruara mësipër, për tu theksuar është se janë regjistruar në sistem me 1 ditë diferencë nga njëra-tjetra, në të njëjtën ditë me kalimin/shtesës së fondeve në dt 26/11/2018. Si dhe fatura e parë e furnitorit ka ardhur me 26/10/2018, 30 ditë para kalimit të fondeve për këtë projekt dhe regjistrimit të kontratës në sistem, në 04/12/2018 është bërë urdhër-shpenzimi dhe regjistrimi i faturës dhe me 11/12/2018 është bërë ekzekutimi i saj, të cilat janë bërë të gjitha pas datës 26/11/2018, në të cilën janë kaluar fondet, nga ku konkludohet se kemi të bëjmë me regjistrime në sistem vetëm kur duhet të bëhen pagesa për faturat dhe jo duke kryer regjistrimet në mënyrë kronologjike në sistem sipas udhëzimeve përkatëse. - ***PO#* 1010001-1800016 *Projekti M100312: "Asistencë Këshillimore për financat publike dhe borxhin", Kontraktor "R B SH.A" , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** -Fatura me **"Invoice-ID" 3724993** dhe **"Nr-Fat" 71210100012018**, ka tek seksioni "Përshkrimi i faturës", një faturë me **nr 2201804300206** dhe datë 30/04/2018 gjë që nuk përkon me datën e faturës së furnitorit për këtë faturë e cila është 17/07/2018. Në këtë

	rast verifikohet se kemi të bëjmë me fatura të prapambetura të cilat po shlyhen tani. -Kemi tejkalim të afateve të lejuara në ligj (5 ditë), për regjistrimin në SIFQ pas dt së nënshkrimit të kontratës, pra në SIFQ është regjistruar ne dt 25/07/2018 kurse nënshkrimi i kontratës është bërë në 12/01/2018. - ***PO#* 1010001-1800023 dhe 1010001-1800022 *Projekti M100520 (18BP401): "Blerje licensa ORACLE", Kontraktor "I +" dhe "I S" , Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** -Afati i regjistrimit të U.P në SIFQ (5 ditë) është tejkaluar sepse publikimi i U.P sipas APP është bërë në dt 30/04/2018 kurse në SIFQ në dt 06/09/2018. -Kemi tejkalim të afateve të lejuara në ligj (5 ditë), për regjistrimin në SIFQ pas dt së nënshkrimit të kontratës, pra në SIFQ është regjistruar në dt 12/09/2018 kurse nënshkrimi i kontratës është bërë në 21/06/2018. -Dt U.P është 30/04/2018 sipas APP, nënshkrimi fizikë i kontratës është bërë 21/06/2019, për këtë projekt nuk ka pasur çelje buxhetore (0 lek) edhe pse është një projekt/angazhim shumëvjeçarë (24 muaj) dhe duhet të kishte një PBA të miratuar ku të ishin detajuar shpërndarja e fondeve buxhetore sipas viteve përkatëse dhe shtesa e fondeve është bërë në datë 03/08/2018 janë bërë kalimi i fondeve prej 67,140,000 lek për këtë projekt. Po në këtë mënyrë evidentohet se janë ndërmarrë angazhime dhe kanë filluar proçedurat e prokurimit pa pasur fonde në dispozicion dhe është lidhur kontrata me operatorët fituesë. - ***PO#* 1010001-1800037,*Projekti M100480 (18AY614): "Rikostruksion i pjesshëm i shkollës Hoteleri, Turizëm" Tiranë, Kontraktor "A-G", Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*** Nga realizimi i testeve janë evidentuar këto problematika si më poshtë: -Afati i regjistrimit të U.P në SIFQ (5 ditë) është tejkaluar sepse publikimi i U.P sipas APP është bërë në dt 23/07/2018 kurse në SIFQ në dt 19/11/2018. -Kemi tejkalim të afateve të lejuara në ligj (5 ditë), për regjistrimin në SIFQ pas dt së nënshkrimit të kontratës, pra në SIFQ është regjistruar në dt 19/11/2018 kurse nënshkrimi i kontratës është bërë në 05/10/2018. -Dt U.P është 23/07/2018 sipas APP më shumen 96,542,521 lek, kur për këtë projekt ka pasur çelje buxhetore në vlerën 15,000,000 lek dhe shtesa fondeve është bërë përkatësisht në dt 03/08/2018 me 5,000,000 lek dhe në datë 31/08/2018 me 30,000,000 lek, kurse kontrata është lidhur më dt 05/09/2018. Janë ndërmarrë angazhime dhe kanë filluar proçedurat e prokurimit pa pasur të gjithë fondet buxhetore në dispozicion -Data e krijimit të REQ 19/11/2018 dhe data e krijimit të PO (Kontrata) 19/11/2018, të dyja jashtë afateve ligjore të përshkruara mësipër, për tu theksuar është se janë regjistruar në sistem në të njëjtën ditë të dyja, pavarësisht nga data reale/fizike e tyre. Si dhe fatura e parë e furnitorit ka ardhur më dt 12/11/2018, nga ku konkludohet se kemi të bëjmë me regjistrime në sistem të fushave përkatëse vetëm kur duhet të bëhen pagesat për faturat dhe jo duke kryer regjistrimet në mënyrë kronologjike në sistem sipas udhëzimeve përkatëse. -Ka një diferencë midis shumave të (Vlera e kontratës, Shumave të faturuara, Pagesave) dhe Faktit 2018, kjo diferencëështë 960,000 lek. Mbas sqarimeve dhe kontrollin me sistemin del që kjo diferencë vjen si pasojë e axhustimi/rregullimi të ditarëve në

kontabilitet ku është pakësuar projekti M100384 me 1,000,100 lek dhe janë shtuar projektet e tjera përkatësishtë: M100480 me 960,000 lek dhe M100379 me 40,100 lek. (Nr dokumentit të ditarit 19759, ndryshimi i bërë në Dhjetor).

Këshilli i Lartë Gjyqësorë (KLGJ).

- ***PO# 58556, Projekti M290068: "RIKONSTRUKSION GODINE CIVIL" Tiranë, Kontraktor "B - I SH.P.K", Përfitues: Gjykata e rrethit TIrane (3535).***

-Proçedura e prokurimit të kësaj kontrate nuk gjenden në file e APP por sipas kontratës fizike të skanuar është marr informacioni se kjo kontratë ka vlerën pa tvsh 29,144,269 lek dhe vlerën totale me tvsh 34,973,123 lek dhe është lidhur në datë 28/03/2018 me afat punimesh 8 muaj. Ka nje diferencë midis vlerës totale të kontratës dhe vlerës me të cilën është bërë njohja/regjistrimi i saj në sistem. Vlera totale e kontratës eshte 34,973,123 lek kurse vlerë totale me të cilën është njohur është 34,967,707 lek (shuma e rreshtave të shpërndarjes), duke na sjell një diference prej 5,416 lek nga vlera reale e kontratës.
-Nga të dhënat e file të pagesave evidentohet se për këtë kontratë janë kryer në total 34,967,707 lek, kurse sipas të dhënave te file i buxhetit rezulton se në total janë paguar aq sa ka pasur fonde disponibel nga çelja buxhetore pra 29,450,000 lek (sepse nuk janë bërë shtesa të fondeve me akte normative). Del diference midis pagesave të raportuara sipas file të buxhetit dhe file të pagesave në vlerën 5,517,707 lek.
-Kontrata është nënshkruar fizikisht në datë 23/03/2018 dhe në sistem është regjistruar në datë 10/04/2018, regjistrimi i secilës është jashtë afateve të përcaktuara nga ligji për regjistrimin në sistem brenda 5 ditë të kontratës mbas nënshkrimit fizikë të saj.

<u>Rastet e konstatuara nga kontratat e rregjistruara nga Ministria e Mbrojtjes.</u>

- ***PO# 61751, Projekti M170424: "ARMATIM I LEHT MUNICION DHE PAISJE E MAKINERI PER FORCAT E ARMATOSURA" Tiranë, Kontraktor "DX", Përfitues: Reparti Ushtarak Nr.XX Tirane (3535) (Kontratë e klasifikuar sekrete).***

-Kontrata është nënshkruar fizikisht në datë 10/09/2018 dhe në sistem është regjistruar në datë 11/10/2018, regjistrimi i së cilës është jashtë afateve të përcaktuara nga ligji për regjistrimin në sistemë brenda 5 ditëve të kontratës mbas nënshkrimit fizikë të saj.
-Nga databaza e PBA siguruar nga Drejtoria e Buxhetit, jepet informacioni se projekti M170424 ka vlerë totale prej 6,194,684,000 lek dhe është parashikuar që të ketë vitë i fillimit 2016 dhe viti i mbarimit 2018. Por shpërndarja e fondeve buxhetore në PBA kalon deri në vitin 2021, në tejkalim të afateve fillestare të parashikuara.
-Faturat me ***<u>"Nr-Fat", 28510170092018, 82110170092018</u>,*** nga verifikimet në sistem dalin që janë të palidhura me një numër kontrate. (PO Number).

Nr.Fatures	Kodi Projektit	Përshkrimi i projektit	FURNITORI	Shuma faturës në 000/lekë	Dt.Faturë

28510170092018	M170424	PAISJE E MAKINERI PER FORCAT E ARMATOSURA	DX	27,710	05-Prill-18	05-Prill-1
82110170092018	M170424	PAISJE E MAKINERI PER FORCAT E ARMATOSURA	DX	3,375	18-Tetor-18	25-Tetor-

- ***PO#* 9371 dhe 9380*, Projekti M170531: "Masa inxhinierike per stabilizimin e rreshqitjes "Kodra e Shtufit" Rruga Vangjel Zhaba, Gjirokaster" Kontraktor "SH" dhe "NG S" dhe L79326502O, Përfitues: Bashkia Gjirokaster (1111).***

-Kontrata me operatorit "NG S" është nënshkruar fizikisht në datë 26/10/2018 dhe në sistem është regjistruar në datë 15/11/2018, regjistrimi i sëcilës është jashtë afateve të përcaktuara nga ligji për regjistrimin në sistem brenda 5 ditë, të kontratës mbas nënshkrimit fizik të saj.

-Çelja buxhetore për këtë projekt ka qënë 0 lek dhe është bërë shtesa e fondeve me AN në datë 17/10/2018 në vlerën 85,000,000 lek. Kontrata është lidhur fizikisht në datë 26/10/2018, që duke arsyetuar rrjedhë që proçedurat e prokurimit janë zhvilluar më herët se kjo datë. (Mesatarisht proçedurat e prokurimit kërkojnë 30-45 ditë kohë deri në shpalljen e operatorit fitues dhe nënshkrimit të kontratës *Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Ligjin Nr.103/2018. "PËR PROKURIMIN PUBLIK", Neni 43 "Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave"*). Për rrjedhojë konkludojmë së janë ndërmarrë angazhime dhe kanë filluar proçedurat e prokurimit pa pasur fonde buxhetore disponibël në dispozicion.

- ***PO#* 57383 dhe 57384*, Projekti M170491: "Blerje pajisje hardëare për Rrjetin e Paklasifikuar (SHPFA ,AISM,IGJIU,QPR,KM,KDS)J-6", Tirane, Kontraktor " BNT " dhe "BT S", Përfitues: Reparti Ushtarak Nr.XX Tirane .***

Kontrata për "BNT " është nënshkruar fizikisht në datë 26/12/2017 dhe në sistem është regjistruar në datë 19/01/2018, kurse për "BT S" kontrata fizikisht është nënshkruar në datë 02/11/2017 dhe në sistem është regjistruar në datë 19/01/2018, regjistrimet e secilës janë jashtë afateve të përcaktuara nga ligji për regjistrimin në sistem brenda 5 ditëve të kontratës mbas nënshkrimit fizike të saj.

- ***PO#* 63458*, Projekti M170534: "Blerje e instrumentave muzikore per banden FA" Tiranë, Kontraktor "L B", Përfitues: : Reparti Ushtarak Nr.XX Tirane (3535).***

Nga "Përshkrimi i faturës" konstatohet se data e U.Prokurimit është 25/10/2018 por çelja buxhetore për këtë projekt ka qënë 0 lek dhe fondet janë shtuar më vonë me anë të AN, më datë 24/12/2018 në vlerën 13,500,000 lek. Nga rrjedh se janë ndërmarrë angazhime dhe kane filluar proçedurat e prokurimit pa pasur fondet buxhetore disponibël në dispozicion. Urdhër-prokurimi është ndërmarrë mbas datës 15 tetor në kundërshtim me ligjin e buxhetit nr 9936 dt 26.6.2008, neni 51.

- ***PO#* 61187 dhe 62549*, Projekti M170496: "Rikonstruksion i depove te kazermimit -veshmbathjes qender,1004", Tirane, Kontraktor "S" dhe "E-G", Përfitues: Reparti Ushtarak Nr.XX Tirane (3535) (Kontrate e klasifikuar***

	sekrete). Nga "Përshkrimi i faturës" konstatohet se data e U.Prokurimit është 28/05/2018 por çelja buxhetore për këtë projekt ka qënë 12,000,000 lek dhe fondet janë shtuar më vonë me anë të AN, më datë 24/12/2018 në vlerën 12,000,000 lek duke e çuar vlerën totale të fondeve në dispozicion në 24,000,000 lek. Vlera totale e kontratës (e paraqitur tek file i kontratës, pasi nuk kam informacion më të detajuar mbi proçedurën e APP dhe kontratën fizike të skanuar, pasi kjo kontratë është e klasifikuar sekrete dhe nuk më është vënë në dispozicion) është 46,6678,616 lek, nga ku rrjedh se janë ndërmarrë angazhime dhe kanë filluar proçedurat e prokurimit pa pasur të gjitha fondet disponibël në dispozicion. (Proçedurat e prokurimit janë ndërmarrë kur gjendja e fondeve në dispozicion para së të bëhej shtesa me AN, ka qënë vetëm 12,000,000 lek).
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Shkelje e Ligjit të mënaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të anagazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura**.**
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave dhe të aplikacionit SIFQ, mosveprim dhe marrja e masave nga MFE, mungesë kontrolli dhe monitorimi nga Drejtoria e Buxhetit

Rëndësia	E lartë

(DPD-DPT) Observacioni nga subjekti i auditurar: *Në observacionet ardhur me email në datën 03.09.2019 në adrësën zyrtarë të emailit të audituesve nga Drejtoresha e Operacioneve të Thesarit zj. M, P citohet;*

1.Në vijim të konstatimit të mëposhtëm;

"Nga përshkrimi i transaksionit që bën thesari, në projektin me kod M100466 kemi konstatuar se janë pranuar dhe likujduar fatura me datë fature më të hershme se data e situacionit pjesor ose përfundimtar të punimeve (operatori "SH" SHPK me faturë me nr.serie 58921838 dt 26.12.2018 dhe vlerë 14,549,091 lekë por situacion përfundimtar i datës 31.12.2018, si dhe operatorin "A" SHPK, i cili ka paraqitur faturat me nr.serie 50841896 datë 26.12.2018 dhe vlerë 23,790,788 lekë dhe nr.serie 50841898 dt 26.12.2018 dhe vlerë 14,258,722 lekë ndërkohë që situacionet perfundimtare ka datën 31.12.2018). Në total kemi 52,598 mij lekë pagesa me dokumentacione justifikues të shpenzimeve jokonsistentë në kronologjinë e lëshimit dhe paraqitjes së tyre në thesar. Dega e Thesarit nuk duhet të pranoj dokumentacion dhe të kryejë pagesa mbi këtë dokumentacion"

Në rastet e cituara ku data e faturës është më e hershme se data e situacionit sqarojmë se situacionet nuk kanë datë, por periudhë, data e shkruar në përshkrim është gabim. Në rastet konkrete të operatoreve S.SHPK dhe A SHPK janë situacione të periudhës dhjetor 2018.

2.Në vijim të konstatimit për projektin M100500 "Përmirësimi i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit" sqarojme se Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk ka në përgjegjësi administrimin e fondeve buxhetore pasi urdhërues të fondeve përkatëse janë ***nëpunësit autorizues*** *dhe* ***zbatues*** *të njësive të qeverisjes së përgjithshme që janë përgjegjës për miratimin e çdo transaksioni të zbatimit të buxhetit (paragrafi 40-49 i udhëzimit të përheshëm nr. 9 (prot. 5678), datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit").*

3. Në vijim të konstatimit se në SIFQ janë identifikuar projekte, pagesa e fatures të të cilëve në modulin e pagesave, nuk lidhet me kontratën përkatëse të shpenzimit kapital në total 95,983 mijë lekë sqarojmë se rastet e KM për projektin M030029 kanë kontratë të lidhur në vitin 2017 dhe likuidimi nuk është kryer në vitin 2018, por në vitin 2017, i cili është audituar nga grupi i mëparshëm i KLSH për veprimtarinë e vitit 2017.

4. Në vijim të konstatimit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sqarojmë se marrja e angazhimeve pa plan buxheti është përgjegjësi e D.P.Doganave dhe Agjencisë së Prokurimit Publik që pranon dhe vazhdon prokurimin pa marrë më parë konfirmim nga struktura përgjegjëse e degës përkatëse të Thesarit.

Gjithashtu subjekti ka dorëzuar dorazi në takimin përmbyllës më datën 03.10.2019 pranë zyrave të KLSH dokumentacion justifikues në lidhje me shpenzimet jokonsistentë në kronologjinë e lëshimit dhe paraqitjes së tyre në thesar. Ne kemi marrë parasysh këtë dokumentacion duke qenë se është dokumentacion faktik i vlefshëm dhe jemi në pritje të që DPTH ti dërgoj zyrtarisht me protokoll.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket pikës së parë, sqarojmë së jemi duke folur për situcaion me datë përfundimi 31.12.2018 ndërsa faturat fizike janë emetuar në datën 26.12.2018 në të dyja rastet. Bëjmë me dije se në momentin e emetimit të faturës (data 26) mund të ketë punime mbas ksaj date të cilat teorikisht nuk mund të përfhsihen kur fatura emetohet përpara kohe. Parimi i konsistencës në dokumentacion është bazë si për funksionimin e anës proceduriale, ashtu dhe për saktësinë në kompetencësn e përiudhës kontabël që prek rregjistrimi rregjistrimi i një fature (duke qenë se jemi në fund të vitit fiskal). Nëse situacioni mbulon gjith periudhën e dhjetorit 2018 (për këtë do na duhet të shohim dokumentacionin justifikues) atëherë patjetër që fatura do të emetohej pas dhjetorit dhe kjo do ndikonte dhe në vitin fiskal kur raportohej kjo periudh (që i bie të ishte 2019). Për këtë arsye argumenti juaj nuk merret parasysh nga ana e grupit të auditimit.

Për sa i përket pikës së dytë nuk kemi ngarkuar specifikisht me përgjegjësi DPTH, por e kemi shprehur edhe në akt konstatim se përgjegjësi kanë dhe NA dhe NZ të njësive shpenzuese përkatëse.Por theksojmë se ky argument nuk përbën bazë për rrëzimin e gjetjes nga grupi i auditimit.
Për sa i përket pikës së tretë, për saktësim faturat të palidhura me kontratë nga furnitori A-S janë dy, ajo e datës 11.12.2017 dhe vlerë 37,181,801 lekë dhe ajo e datës 18.01.2018 me vlerë 58,801,767 lekë, pra argumentimi juaj se janë fatura të likujduara në 2017 nuk qëndron. Për këtë rast kemi siguruar dhe të dhënat e SIFQ për mënyrën se si është egzekutuar pagesa e këtyre faturave dhe është faktuar që në momentin e pagesës nuk u është lidhur kontratë.Për këtë arsye argumentimi i DPTH nuk merret në konsideratë nga ana e grupit të auditimit. Për sa i përket pikës së katërt, sqarojmë se përgjegjësitë do të citohen më tej në Projekt-Raportin dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit, duke dhënë dhe masat përkatëse. Në lidhje me dokumentacionin faktik të dorëzuar dorazi pranë zyrave të KLSH, përsëri shohim se nga akt-kolaudimet bashkangjitur dhe të përmendur dhe në përshkrimet e urdhër shpenzimeve, datat e akt-kolaudimeve janë më të vonshme së datat e fatura, duke dalë në konkluzionin se përsëri jemi përball faktit që shpenzimet jaë miratuar përpara se të bëhej akt kolaudimi, pra jokonsistencë në kronologjinë e dokumentacioneve në kryerjen e shpenzimit. Ndaj nga grupi i auditimit argumentimi juaj nuk merret parasysh.
(MFE) Obsevacionit të dërguar nga, Dega e Thesarit Tiranë *me* ***Nr 15486 Prot., datë 26/08/2019****, ku pretendohen se: Në vijim të konstatimit për Ministrine e Financave dhe Ekonomisë (MFE: faqe 7-13) po ju paraqesim shpjegimin e dhënë nga nëpunësi zbatues i MFE me e-mail-in bashkëlidhur, të përmbledhur si më poshtë: "Të gjitha këto kontrata kanë qenë kontrata në vazhdim, të mbartura nga ish-Ministria e Mirëqënies, Rinisë dhe Sportit. Pra nuk kanë qenë procedura të kryera nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë; rregjistrimi i kërkesë blerjeve, urdhër blerjeve dhe lëshimeve ishin kryer nga ky institucion "online" me SIFQ, me kod 1010025. Mbartja e kontratave nga MFE nuk mund të bëhej, pasi ishin regjistruar nga institucioni 1010025 që u mbyll, ndërsa pagesat u kryhen në kodin e institucionit 1010001 (MFE) që mbarti funksionet e tij; mungesa e stafit dhe eksperiencës ishtë një tjetër arsye. Gjithashtu, nëse do të bëhej rregjistrimi nga fillimi i kërkesë blerjeve, urdhër blerjeve dhe lëshimeve, kjo kërkonte kohë dhe do të shkaktonte vonesa në likuidimin e detyrimeve kontraktuale, pasi sikurse e përmenda edhe më lart, mungonte stafi i nevojshëm për realizimin e të gjitha detyrave të drejtorisë. Për këtë arsye këto fatura janë likuiduar pa përputhje me një kontrate PO, por pagesa është kryer mbasi është rakorduar vlera kontratave dhe realizimi i tyre, të rregjistruar në sistem nga ish-institucioni 1010025 (MMRS-ja).Së pari, vlera e kontratave nuk ishte e shpërndarë ndër vite nga ish-MMRS-ja dhe nga ana jonë mungonte informacioni i saktë mbi vlerat e detyrimeve kontraktuale, sipas kontratave, sepse nga institucioni i mbyllur u mbartën kontrata të viteve 2016 dhe 2017."Gjithashtu, sic kemi sqaruar edhe për gjetjet e auditimit të vitit të kaluar, theksojmë përsëri se SIFQ nuk lejon modifikimin (edit-imin) e fushës "Përshkrimi" pas miratimit të faturës dhe specialisti i degës së Thesarit nuk mund të ndërhyjë që të vendosi datën e saktë të faturës në fushën "përshkrimi" kur e ka konstatuar se është regjistruar gabim.*
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Observacioni nuk pranohet, sepse përgjigja juaj nuk është e argumentuar me fakte, dokumenta justifikues dhe bazë ligjore për të replikuar konstatimin e grupit të auditimit.

Sipas ***Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit Tiranë me Nr 15486 Prot., datë 26/08/2019****, ku pretendohen se: Sqarojmë se mospërputhja midis vlerës së kontratës së regjistruar në SIFQ me vlerën e kontratës fizike prej 5,416 lekë është rezultat i vlerës së realizuar sipas faturave tatimore për PO 58556.*

Mosperputhja e vlerës së realizimit të kontratës (pagesa) me vlerën e fondeve buxhetore (sipas çeljes nga buxheti) është financuar me fondet e të ardhurave të realizuara jashtë limitit (kapitullit 6).
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Observacioni juaj është në të njëjtën linjë me konstatimin e grupit të auditimit, që kontrata nuk është regjistruar me vlerën e saj të plotë por është regjistruar sa vlera e fondeve disponibel për këtë kontratë, pra janë ndërmarrë angazhime pa pasur gjithë fondin buxhetor në dispozicion dhe janë përdorur "të ardhurat jashtë limitit për të bërë likuidimin e pjesës së diferencës së kontratës. Si dhe vlera e realizuar sipas faturave tatimore për kontratën me PO# 58556 duhet të jetë e barabartë me vlerën totale të kontratës të regjstruar në SIFQ, e barabartë me vlerën reale të kontratës së nënshkruar fizikisht dhe të mos ketë diferenca ndërmjet tyre. Observacioni nuk pranohet.

(MB) Sipas Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit *Tiranë me* ***Nr 15486 Prot., datë 26/08/2019****, ku pretendohen se: Sqarojmë se faturat nr. 28510170092018 dhe 82110170092018 janë të pa lidhura me urdhër blerje (PO) pasi janë pagesa të kryera me furnitor B, transferta për furnitor të huaj.*
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Observacioni nuk pranohet, sepse përgjigja juaj nuk është e argumentuar me fakte, dokumenta justifikues dhe bazë ligjore për të replikuar konstatimin e grupit të auditimit.

(*Bashkia Gjirokastër) Sipas Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit Tiranë me Nr 15486 Prot., datë 26/08/2019**, ku pretendohen se: Sqarojmë se për PO nr. 9371 Bashkia Gjirokastër e ka filluar procedurën e prokurimit në bazë të Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018 (dokumentat bashkëlidhur), rast në përgjegjësi të NA dhe NZ. Gjithashtu sqarojmë se urdhri i blerjes nr. 9371 është regjistruar në SIFQ me datë 30.10.2018 dhe kontrata është lidhur me datë 26.10.2018. Për PO nr. 9380 është hedhur me vonesë nga dega e Thesarit, sepse është një kontratë me dy furnitorë të ndryshëm për të cilët nuk ishin depozituar pranë degës së Thesarit akt marrëveshjet përkatëse ku ishin specifikuar vlerat e veçanta për secilin furnitor për kontrollin me fondet buxhetore disponibël; konfirmohet nga dega se nuk është përgjegjëse Bashkia për vonesën.*
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Në bazë të fakteve dhe dokumentave të paraqitura nga ana juaj dhe të shqyrtuara nga grupi i auditimit, vendosë që observacioni të pranohet pjesërisht. Nuk pranohet pjesa e observacionit: *"Për PO nr. 9380 është hedhur me vonesë nga dega e Thesarit, sepse është një kontratë me dy furnitorë të ndryshëm për të cilët nuk ishin depozituar pranë degës së Thesarit akt marrëveshjet përkatëse ku ishin specifikuar vlerat e veçanta për secilin furnitor për kontrollin me fondet buxhetore disponibël; konfirmohet nga dega se nuk është përgjegjëse Bashkia për vonesën*", konstatimi i regjistrimit të kontratës në SIFQ në tejkalim të afateve ligjore vazhdon të qëndrojë sepse s'janë sjellë argumenta, dokumenta justifikues dhe bazë ligjore e mjaftueshme për të replikuar konstatimin e ngritur nga grupi i auditimit.
Sipas dokumentacionit bashklidhur të dërguar prej jush, shkresa me nr prot.6723, datë 10.10.2018 ku është urdhër-blerja nr.333 datë 10.10.2018, dhe regjistrimi i tij në SIFQ është bërë në datë 30.10.2018 në tejkalim të afateve ligjore të regjistrimit brenda 5 ditë.

Sipas Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit Tiranë me ***Nr 15486 Prot., datë 26/08/2019****, ku pretendohen se: Sqarojmë se kontratat PO nr. 57383 dhe PO nr. 57384 janë rregjistruar jashtë afatit 5*

ditor pasi nuk kanë qënë të regjistruar planet në SIFQ. Plani është hedhur në janar 2018 për llogari të dhjetorit 2017.
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Observacioni nuk pranohet, sepse përgjigja juaj nuk është e argumentuar me fakte, dokumenta justifikues dhe bazë ligjore për të replikuar konstatimin e grupit të auditimit.

Sipas Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit Tiranë me Nr 15486 Prot., datë 26/08/2019, *ku pretendohen se: Sqarojmë se nga verifikimi në SIFQ institucioni ka prokuruar pa marrë më parë vulën për miratim në thesar për PO 63458. Përgjegjësia është e NA/NZ së institucionit dhe e APP që fillon procesin e prokurimit pa marrë më parë miratimin e Thesarit mbi disponueshmërinë e fondeve buxhetore.*
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Observacioni nuk merret parasysh për t'ju hequr ju nga përgjegjësia, krahas përgjegjësisë së NA/NZ së institucionit dhe e APP që fillon proçesin e prokurimit pa marrë më parë miratimin e thesarit mbi disponueshmërinë e fondeve buxhetore, sepse sipas: Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 *"Për Proçedurat Standarde Të Zbatimit Të Buxhetit" i ndryshuar*, pika 135, 144, 149, 157, 158 dhe 159 si dhe sipas Vendim Nr.50, datë 05.02.2014 "*Për Miratimin E Strategjisë Për Parandalimin Dhe Shlyerjen E Detyrimeve Të Prapambetura E Të Planit Të Veprimit", pika 9.4*

Sipas Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit Tiranë me ***Nr 15486 Prot., datë 26/08/2019,*** *ku pretendohen se: Sqarojmë se PO nr. 61187 dhe PO nr. 62549 janë kontrata "Të klasifikuara", të cilat nuk vihen në dispozicion të degës së Thesarit për miratim në zbatim të legjislacionit në fuqi. Është përgjegjësi e NA/NZ së institucionit dhe APP që lejojnë fillimin e proçedurave të prokurimit pa pasur plan buxheti disponibël.*
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Observacioni nuk merret parasysh për t'ju hequr ju nga përgjegjësia, krahas përgjegjësisë së NA/NZ së institucionit dhe e APP që fillon procesin e prokurimit pa marrë më parë miratimin e thesarit mbi disponueshmërinë e fondeve buxhetore, sepse sipas: Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 *"Për Proçedurat Standarde Të Zbatimit Të Buxhetit" i ndryshuar*, pika 135, 144, 149, 157, 158 dhe 159 si dhe sipas Vendim Nr.50, datë 05.02.2014 "*Për Miratimin E Strategjisë Për Parandalimin Dhe Shlyerjen E Detyrimeve Të Prapambetura E Të Planit Të Veprimit", pika 9.4*

Për sa më sipër mban përgjegjësi NA dhe NZ e institucioneve të përmëndua në këtë raport, Dre, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S Drejtoria e Operacioneve të Thesarit me drejtor znj.M P dhe dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të parashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Mbi urdhër prokurimet e lëshuara mbas datës 15 Tetor 2018 për projektet e reja.

Një tjetër masë për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe monitorimin e angazhimeve dhe zbatimit të buxhetit është edhe kërkesa e parashikuara në nenin 51, pika g e Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, *Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të*

reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor. Kështu, nga një përpunim i thjeshtë i datave të rregjistrimit në korrelacion me datën e kontratës evidentojmë **147 urdhër-prokurime** për shpenzime për investime në vlerë 5.101 miliardë lekë *(prokurime me vlerë të madhe)*, të ndërmarra pas datës 15.10.2018 në shkelje të nenit 51. Megjithatë, sipas nenit 2 të VKM nr. 807 datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike", pika. 2 "*Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në rregjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës*. Sic edhe është konstatuar në gjetjen më lart në këtë raport, Urdhër-prokurimet regjistrohen vetëm nga BI-online ndërsa për institucionet pa akses në SIFQ Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk ka informacion edhe pse ka detyrimin ligjor për raportimin mujor te Drejtoria e Buxhetit, të gjithë urdhër-prokurimeve brenda 10 ditëve të muajit pasardhës. Mungesa e kontrollit të aplikacionit në këtë faze të proçedurës së prokurimit rrit rrezikun e fillimit të proçedurave të prokurimit pa fonde buxhetore disponibël, krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Nga këto argumenta të paraqitura më sipër nuk ofrohet siguri e arsyeshme nga databaza në dispozicion ku të mund të identifikojmë në mënyrë të besueshme një numër të saktë të urdhër prokurimeve të rregjistruara në SIFQ pas datës 15 Tetor 2018, dhe aq më tepër nuk mund të idenfikojmë projektet nëse janë të reja apo ekzistuese.

Sa më lartë, për një vlerësim më të saktë dhe të plotë u analizuan edhe të dhënat e dërguara nga APP për tipin e kontratës "punime" ku rezultojnë në total 254 shpallje për tipin e kontratës punime me vlerë fondi limit pa TVSH 5.5 miliardë lekë të publikuara pas datës 15.10.2018 nga të cilat kontraktuar e nënshkruar **167 prej tyre me vlerë 2.86 miliardë**. Megjithatë, rastet e mësipërme mbeten gjithësesi objekt i mëtejshëm investigimi për të verifikuar nëse ato janë prokurime, pjesë e projekteve me plan buxhetor 3 vjeçar të miratuar.

Gjetje:	**Kontrata të lidhura pas datës 15 Tetor: 29 prokurime me vlerë 2.2 miliardë lekë.**
Situata:	Një tjetër masë për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe monitorimin e angazhimeve dhe zbatimit të buxhetit është edhe kërkesa e parashikuara në nenin 51, pika g e Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, *Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor*. Në kushtet kur tabela e Urdhër-prokurimeve nuk ofron saktësi, besueshmëri dhe plotësi të të dhënave të rregjistruara, ku pjesa e 'Përshkrimit" ka mangësi dhe gabime të theksuara në informacion, qoftë kjo në mënyrën dhe saktësinë e tij, rr**egjistrimet e urdhër–prokurimeve në SIFQ janë formale pasi në shumicën e rasteve ato janë regjistruar pas firmosjes së kontratës dhe në shkelje të afateve ligjore 5 ditë mbasi janë nënshkruar fizikisht, pra urdhër-prokurimi është regjistruar formalisht vetëm për efekt të plotësimit të fushave që lejojnë më pas krijimin e dokumentit kontratë dhe faturave respektive.** Urdhër-prokurimet regjistrohen vetëm nga BI-online ndërsa për institucionet pa akses në SIFQ Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk ka informacion edhe pse ka detyrimin ligjor për raportimin mujor te Drejtoria e Buxhetit, të gjithë urdhër-prokurimeve brenda 10 ditëve të muajit pasardhës. **Nga një ripërpunim i datave të rregjistrimit në**

korrelacion me datën e kontratës si dhe duke shqyrtuar dhe marr parasysh observacionet e dërguara prej jush së bashku me faktet, argumentat dhe dokumentat justifikuese përkatëse, evidentojmë se nga konstatimet tona qëndrojnë 29 urdhër-prokurime për shpenzime për investime në vlerë 2.2 miliard lekë (prokurime me vlerë të madhe**), të ndërmarra pas datës 15.10.2018 në shkelje të nenit 51**. Sipas institucioneve këto raste paraqiten në tabelën në vijimË

Institucioni	Nr i rasteve	Vlera në lekë
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit (3535)	3	265,056,000
Agjencia per Zhvillimin Bujqesor dhe Rural (AZHBR) (3535)	2	3,829,080
Aparati i Keshillit te Ministrave (3535)	1	97,970,580
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (3535)	4	54,823,752
Aparati i Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit (3535)	3	73,557,265
Aparati Ministrise Mbrojtjes (3535)	1	24,936,300
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	10	1,613,105,905
Bashkia Tirana (3535)	5	67,372,957
Total	**29**	**2,200,651,839**

Megjithatë, sipas nenit 2 të VKM nr. 807 datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike", pika. 2 "*Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në rregjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës*.
Sa më lartë, për një vlerësim më të saktë dhe të plotë u analizuan edhe të dhënat e dërguara nga APP për tipin e kontratës "punime" ku rezultojnë në total 254 shpallje për tipin e kontratës punime me vlerë fondi limit pa TVSH 5.5 miliardë lekë të publikuara pas datës 15.10.2018 nga të cilat kontraktuar e nënshkruar 167 prej tyre me vlerë 2.86 miliardë. Megjithatë, rastet e mësipërme mbeten gjithësesi objekt i mëtejshëm investigimi për të verifikuar nëse ato janë prokurime pjesë e projekteve me plan buxhetor 3 vjeçar të miratuar. **Nga këto argumenta të paraqitura më sipër nuk na ofrohet siguri e arsyeshme nga databaza në dispozicion ku të mund të identifikojmë në mënyrë të besueshme një numër të saktë të urdhër prokurimeve të rregjistruara në SIFQ pas datës 15 Tetor 2018, dhe aq më tepër nuk mund të idenfikojmë projektet nëse janë të reja apo ekzistuese.**

Kriteri:

Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Udhëzimi nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", të ndryshuar me udhëzimin nr.1 datë 22.02.2005 "Për disa shtesa në udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit".
Udhëzimi i përhershëm Nr.2 Datë 06. 02. 2012"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018".
Akti Normativ nr.1 datë 26.07.2018 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 "Për

	buxhetin e shtetit të vitit 2018". *Akti Normativ nr.2 datë 19.12.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018", të ndryshuar".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.23 datë 22.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2017".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166: Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve të llogarisë së unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë dhe pika 167: "Me pas, struktura përgjegjëse për thesarin vijon me procedurën e grupimit të kërkesave për pagesë sipas rregullit të rregjistrimit kronologjik të urdhër-shpenzimeve në sistemin informatik financiar (hyrje e parë - dalje e parë)".*
Impakti:	Mosdisiplinim i angazhimeve buxhetore. Mungesa e kontrollit të aplikacionit në këtë faze të proçedurës së prokurimit rrit rrezikun e fillimit të proçedurave të prokurimit pa fonde buxhetore disponibël, krijimin e detyrimeve të prapambetura
Shkaku:	Mungesë monitorimi dhe raportimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit mbi rregjistrimin dhe raportimin e angazhimeve nga të gjithë njësitë ekonomike.
Rëndësia:	E mesme.

Sipas **Obsevacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit,** Dega e Thesarit Tiranë me Nr 5237/1 Prot., datë 26/08/2019, ku pretendohen se: Për kostatimin e urdhër-prokurimeve të ndërmara pas datës 15 Tetor, Dega e Thesarit Tiranë ka pasur parasysh VKM-në nr 807 datë 16.11.2016, e cila i lejon të kryhen disa prokurime . Më poshte po ju sqaroj disa nga rastet e gjetura nga Ju për njësitë shpenzuese që kryejnë vetë transaksionet në SIFQ .

-Ministria e Drejtësisë, nga verifikimet e bera në SIFQ, rezultoi se prokurimi është rregjistruar më datë 24.10.2018 ndërsa dokumenti fizik i UP ka datën 18.07.2018.

-Institucioni i AZHBR nga verifikimet e bera ne SIFQ dhe nga shkresa e institucionit nr 5000 datë 24.10.2018 nuk rezultojnë të jene bërë prokurime për investime dhe blerje, por është bere zbatimi i VKM-së nr 72 datë 7.02.2018 i ndryshuar nga VKM nr 14 datë 29.09.2018 për suvencione për fermeret. (Bashke lidhur shkresat)

-Ministria e Kulturës në të dy rastet e kostatuara nga Ju, janë UP datë 08.02.2018 dhe datë 01.12.2017 të cilat rezultojnë te jenë para datës 15 Tetor, dhe janë prokurime të vogla që lejohen nga VKM-ja e sipërpërmëndur.

-Këshilli i Ministrave, UP është në datën 24.09.2018 dhe rregjistrimi në SIFQ është bërë më datën 18.12.2018.
-Ministria e Brëndshme , UP fizik është në datën 29.06.2018 dhe rregjistruar në SIFQ në datën 15.11.2018 .
-Për institucionet e tjera të kostatuara nga Ju që kanë më shumë se nje rast, do të keni bashkëlidhur këtij materiali të dhënat nga SIFQ që tregojnë se prokurimet janë marrë para datës 15 tetor, vetëm rregjistrimi është bërë më vonë .
-Rastet e tjera, janë prokurime me vlera të vogla .

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: *Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Në kushtet kur tabela e Urdhër-prokurimeve nuk ofron saktësi, besueshmëri dhe plotësi të të dhënave të rregjistruara, ku pjesa e 'Përshkrimit" ka mangësi dhe gabime të theksuara në informacion, qoftë kjo në mënyrën dhe saktësinë e tij. Regjistrimet e urdhër–prokurimeve në SIFQ janë formale pasi në shumicën e rasteve ato janë regjistruar pas firmosjes së kontratës dhe në shkelje të afateve ligjore 5 ditë mbasi janë nënshkruar fizikisht, pra urdhër-prokurimi është regjistruar formalisht vetëm për efekt të plotësimit të fushave që lejojnë më pas krijimin e dokumentit kontratë dhe faturave respektive. Urdhër-prokurimet regjistrohen vetëm nga BI-online ndërsa për institucionet pa akses në SIFQ Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk ka informacion edhe pse ka detyrimin ligjor për raportimin mujor te Drejtoria e Buxhetit, të gjithë urdhër-prokurimeve brenda 10 ditëve të muajit pasardhës. Mungesa e kontrollit të aplikacionit në këtë faze të proçedurës së prokurimit rrit rrezikun e fillimit të proçedurave të prokurimit pa fonde buxhetore disponibël, krijimin e detyrimeve të prapambetura.*
*Nga këto argumenta të paraqitura mësipër nuk na ofrohet siguri e arsyeshme nga databaza në dispozicion ku të mund të identifikojmë në mënyrë të besueshme një numër të saktë të urdhër prokurimeve të rregjistruara në SIFQ pas datës 15 Tetor 2018, dhe aq më tepër nuk mund të idenfikojmë projektet nëse janë të reja apo ekzistuese***. Nga një ripërpunim i datave të rregjistrimit në korrelacion me datën e kontratës si dhe duke shqyrtuar dhe marr parasysh observacionet e dërguara prej jush sëbashku me faktet, argumentat dhe dokumentat justifikuese përkatëse, evidentojmë se nga konstatimet tona qëndrojnë 29 urdhër-prokurime për shpenzime për investime në vlerë 2.2 miliardë lekë (prokurime me vlerë të madhe), të ndërmarra pas datës 15.10.2018 në shkelje të nenit 51.** *Megjithatë, sipas nenit 2 të VKM nr. 807 datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike", pika. 2 "Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës. Rastet e mësipërme mbeten gjithësesi objekt i mëtejshëm investigimi për të verifikuar nëse ato janë prokurime pjesë e projekteve me plan buxhetor 3 vjeçar të miratuar.*

Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj. M D, Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të buxhetit me drejtor znj.XhA, Drejtoria e Menxhimit të Investimeve me drejtor znj.S S, Drejtoria e Financa vendore me drejtor Z.F B, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Mbi rregjistrimin e kontratave shumëvjecare, plotësia dhe përputhshmëria me afatet ligjore të rregjistrimit

Me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë me Udhëzimin nr.2 dt. 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 144 e tij, u përpunuan të dhënat, me burim sistemin SIFQ nga ku rezultuan gjithsej **31,623 kontrata unike**[9] **me vlerë 111.1 miliardë lekë,** të rregjistruara gjatë periudhës 1.1.2018-31.12.2018 (255 rekorde nuk u morën parasysh për shkak të pavlefshmërisë së vlerës së kontratës rregjistruar me 0 ose 1 lek). Sipas llojit të shpenzimit 4,467 **kontrata me vlerë 73.4 miliardë lekë janë kontrata për investime** ndërsa 27,156 me vlerë 37.6 miliardë lekë janë kontrata për shpenzime operative. Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën në vijim, numrin më të lartë të kontratave të investimeve të rregjistruara e kanë njësitë njësitë e qeverisjes vendore me 2,668 kontrata ose 60% e totalit të kontratave të rregjistruara gjatë gjithë vitit 2018 me një vlerë prej 15.3 miliardë lekë duke u ndjekur nga Ministria e Arsimit me 252 kontrata për investime, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 177 kontrata dhe Ministria e Shëndetësisë me 281 kontrata për investime dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor me 264 kontrata. Pavarësisht numrit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë menaxhon kontratat për investime me vlerat më të mëdha, në total 31.8 miliardë lekë ose 43% të totalit të kontratave për investime të rregjistruara gjatë vitit 2018.

	Investime-23		**Shpenzime-60**		**Total**	
MINISTRIA_LINJES	**Nr. Kontratave**	**Vlera e kontratave ne 000/ leke**	**Nr. Kontratave**	**Vlera e kontratave ne 000/ leke**	**Nr. Kontratave**	**Vlera e kontratave ne 000/ leke**
MIE	177	31,790,853	325	3,084,553	502	34,875,406
Bashkite	2,668	15,435,200	6,718	12,835,059	9,386	28,270,259
Ministria Shendetesise Mbrojtjes Sociale	281	2,381,889	7,988	7,543,930	8,269	9,925,819
Ministria e Mbrojtjes	26	2,562,926	750	3,499,111	776	6,062,037
MASR	252	4,708,215	1,230	1,230,674	1,482	5,938,890
MFE	166	4,128,689	2,363	1,337,143	2,529	5,465,832
Fondi i Zhvillimit Shqipetar	76	5,405,138		-	76	5,405,138
Ministria e Brendshme	80	1,700,147	1,925	1,657,043	2,005	3,357,190
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	107	1,190,888	1,082	1,892,854	1,189	3,083,742
Ministria e Drejtesise	64	1,114,592	1,145	1,954,279	1,209	3,068,870
Institucione te tjera Qeveritare	82	1,146,156	241	1,570,005	323	2,716,161
Ministria e Zhvillimit Urban Turizmit	7	473,303		-	7	473,303
Keshilli i Larte Gjyqesor	264	142,115	1,302	244,627	1,566	386,742
Ministria e Kultures	32	210,346	532	145,892	564	356,238
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	11	246,905	197	91,781	208	338,686
Drejtoria e Arkivit te Shtetit	10	236,542	26	39,286	36	275,828
Prokuroria e Pergjithshme	45	42,504	810	161,437	855	203,941
Sherbimi Informativ Kombtar	11	60,930	167	131,798	178	192,728
Kuvendi	25	75,122	47	54,196	72	129,319
Ministria per Evropen dhe Punet Jashtme	7	94,706	20	30,075	27	124,782
Kryeministria	1	97,971	3	8,278	4	106,248
Drejtoria e Pergjithshme e RTSH	3	101,052		-	3	101,052
Presidenca	8	17,561	41	31,002	49	48,563
Kontrolli Larte i Shtetit	7	24,099	23	11,956	30	36,054
Autoriteti per te Drejten e Informimit	3	33,285	5	2,341	8	35,626
Instituti Statistikes	5	6,124	39	28,096	44	34,220
Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtesisë	14	17,576	21	10,097	35	27,672
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	101	23	17,441	24	17,541

[9] Referuar PO_Header

Gjykata Kushtetuese	9	3,941	19	13,031	28	16,973
Komisioneri MbrojtjenDhenavePersonale	2	3,897	27	8,173	29	12,070
Autoriteti Konkurences	8	7,203	8	4,760	16	11,963
ILKDPKI	2	2,567	11	8,691	13	11,258
Komisioni i Sherbimit Civil	2	3,666	5	3,544	7	7,211
Avokati i Popullit	3	2,604	9	4,523	12	7,126
Shkolla e Magjistratures	1	586	14	5,718	15	6,303
Akademia e Shkencave		-	6	5,792	6	5,792
Komisioneri Mbrojtjen nga Diskriminimi	1	4,000	5	1,742	6	5,742
Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit	3	663	15	4,778	18	5,441
Agjensia Telegrafike Shqiptare	1	941	7	2,598	8	3,539
Mbeshtetje per Shoqerine Civile	2	366	3	829	5	1,195
Komisioni i Prokurimit Publik		-	3	1,073	3	1,073
Keshilli Kombetar i Kontabilitetit		-	1	98	1	98
Total	**4,467**	**73,475,367**	**27,156**	**37,678,304**	**31,623**	**111,153,671**

Gjetje: **Fenomeni i rregjistrimit me vonesë i kontratave të lidhura nga institucionet qëndrore dhe vendore vazhdon të jetë i përhapur edhe gjatë vitit 2018, ku në 20,264 raste ose 64% e të gjithë kontratave të rregjistruara rezultojnë në thyerje të afateve ligjore për rregjistrim në Degët e Thesarit**

Situata:

Në zbatim të pikës 144 të udhëzimit nr.2, datë 06/02/2012, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" kontratat duhet të rregjistrohen pranë degëve të thesarit brënda 3 ditëve nga data e firmosjes. Kjo e ndryshuar në Udhëzimin specifik nr.26 dt. 20/11/2012, pika 17 ndryshon pikën 144 të Udhëzimit nr.2 në "*Pas miratimit nga nepunesi zbatues dhe nepunesi autorizues i njesise brenda* ***pese diteve*** *pune nga nënshkrimi i tyre, dokumentacioni fizik si me siper paraqitet ne gjuhen shqipe (ne rastin e kontratave të lidhura ne gjuhe te huaj) bashke me njoftimin perfundimtar zyrtar per shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjese per thesarin ne dege*".

Në vlersim të përputhshmërisë me këtë afat, nga analiza e datës së kontratës fizike konstatohet se **fenomeni i rregjistrimit me vonesë e kontratave vazhdon të shfaqet edhe këtë vit i përhapur, si në njësitë e qeverisje vendore ashtu dhe në ato qëndrore,** përfshirë dhe institucionet e pavarura. Sipas, ministrive të linjës, situata paraqitet si më poshtë ku nga 31,623 kontrata të rregjistruara vetëm 11,359 kontrata (investimesh dhe shpenzimesh operative) janë rregjistruar në afat, ndërsa 20,264 kontrata ose 64% **e totalit të kontratave të rregjistruara me vlerë 64 miliardë lekë janë rregjistruar në shkelje të afatit 5 ditor tipikisht nga Bashkitë (34.7%) njësitë e varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë (20.9%)**. Sipas institucioneve, rregjistrimet në shkelje të afatit 5 ditor sipas pikës 144 të Udhëzimit të ndryshuar janë:

Ministritë e linjes	**Nr. Kontratave**	**Vlera e kontratave ne 000/ leke**	**% ndaj totalit**
Total	***20,264***	***64,023,240***	
Bashkitë	7,030	17,677,690	34.7%
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	4,227	4,745,075	20.9%
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1,604	4,193,579	7.9%
Ministria e Brendshme	1,443	2,549,074	7.1%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	1,033	2,671,913	5.1%
Këshilli i Lartë Gjyqësor	956	236,439	4.7%
Ministria e Drejtësisë	869	1,536,172	4.3%
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	629	1,017,352	3.1%

Prokuroria e Përgjithshme	536	96,704	2.6%
Ministria e Mbrojtjes	511	5,101,812	2.5%
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	336	15,393,615	1.7%
Ministria e Kulturës	300	134,090	1.5%
Institucione të tjera Qeveritare	203	2,480,945	1.0%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	132	283,416	0.7%
Sherbimi Informativ Kombëtar	89	51,321	0.4%
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	60	4,784,853	0.3%
Kuvendi	51	63,160	0.3%
Presidenca	35	21,654	0.2%
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	27	124,782	0.1%
Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit sistemin e Drejtesisë	22	15,526	0.1%
Kontrolli Larte i Shtetit	22	13,692	0.1%
Drejtoria e Arkivit te Shtetit	21	57,084	0.1%
Instituti i Studimeve të Krimeve te Komunizmit	15	3,609	0.1%
Instituti Statistikës	15	3,516	0.1%
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	12	12,686	0.1%
Autoriteti Konkurencës	10	10,595	0.0%
Komisioneri per Mbrojtjen e të Dhënave Personale	10	3,461	0.0%
Shkolla e Magjistratures	9	2,772	0.0%
Autoriteti për të Drejtën e Informimit	8	35,626	0.0%
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	7	473,303	0.0%
Gjykata Kushtetuese	7	1,833	0.0%
Komisioni i Shërbimit Civil	5	5,405	0.0%
Akademia e Shkencave	5	4,862	0.0%
Inspektoriati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive	5	4,014	0.0%
Mbështetje për Shoqërinë Civile	5	1,195	0.0%
Kryeministria	4	106,248	0.0%
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	3	1,201	0.0%
Drejtoria e Përgjithshme e RTSH	2	100,572	0.0%
Agjensia Telegrafike Shqiptare	2	1,361	0.0%
Avokati i Popullit	2	775	0.0%
Komisioni i Prokurimit Publik	1	157	0.0%
Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	1	98	0.0%

Sic del qartë dhe nga tabela, fenomeni është i shtrirë si në njësitë e qeverisjes qëndrore dhe asaj vendore të cilat vazhdojnë të mos rregjistrojnë kontratat sipas afateve gjë që do të garantonte disponibilitetin e fondeve dhe parashikimin e tyre sipas planit të pagesave që i shoqëron. **Në nivel institucioni, evidentohen Bashkia Tiranë me 425 raste vonese, Bashkia Korcë me 169 raste**. Gjithashtu, në këtë listë gjejmë dhe institucione si Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me 44 raste (*detajimi sipas institucioneve paraqitet në Aneksin e këtij raporti*).

Përvec vonesave, fenomeni tjetër që konstatohet në vazhdimësi është edhe rregjistrimi gjatë vitit korent i kontratave të "vjetra" të cilat datojnë nga viti 2006 deri 2017, paraqitur në tabelën në vijim ku rezultojnë 3,019 rregjistrime të kontratave të lidhura në vitet 2008- 2017 me vlerë 17.8 miliardë lekë, nga të **cilat 1,031 janë kontrata investimesh me vlerë 11.9 miliardë lekë**. Detajimi sipas viteve paraqitet në tabelën në vijim:

			Për Investime	
Viti I kontratës	**Nr. Kontratave**	**Vlera e kontratës 000/lekë**	**Nr. Kontratave**	**Vlera e kontratës 000/lekë**
2006	1	1,442		-
2008	3	10,719	1	3,000
2009	8	12,554	8	12,554
2010	17	21,322	5	11,964

2011	33	33,477	16	31,097
2012	17	87,517	12	86,339
2013	47	111,948	36	107,089
2014	98	777,095	35	741,957
2015	76	1,067,462	45	348,394
2016	174	3,548,119	106	3,019,140
2017	2,545	13,572,195	767	7,527,747
2018	28,604	91,909,819	3,436	61,586,086
Total	**31,623**	**111,153,671**	**4,467**	**73,475,367**
Total para v.2018	***3,019***	***19,243,851***	***1031***	***11,889,281***

Sipas Institucioneve, në mënyrë të detajuar dhe sipas viteve të angazhimit (datë firmosje kontrate), numri dhe vlera e kontratave të prapambetura për shpenzime për investime me status "aktiv" më 31.8.2018, paraqitet si më poshtë**:**

Ministria linjes	**Viti i kontratës**	**Nr. Kontratave**	**Vlera e kontratës 000/lekë**
Bashkitë	2008	1	3,000
	2009	6	11,784
	2010	5	11,964
	2011	16	31,097
	2012	8	64,465
	2013	28	76,044
	2014	29	47,125
	2015	28	51,938
	2016	53	163,234
	2017	417	3,841,324
MIE	2012	1	170
	2013	1	27,780
	2014	1	661,500
	2016	4	2,287,809
	2017	26	563,868
Ministria e Shendet. dhe Mbrojtjes Sociale	2015	1	9,600
	2016	7	82,844
	2017	11	100,827
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	2012	1	21,456
	2013	1	423
	2015	4	107,326
	2017	11	310,922
MFE	2015	1	2,436
	2016	1	4,343
	2017	15	740,176
Fondi i Zhvillimit Shqipetar	2014	1	1,348
	2015	7	176,338
	2016	8	116,079
	2017	16	560,215
Institucione te tjera Qeveritare	2017	13	295,033
KLGJ	2017	3	371
Komisioneri Mbrojtjen nga Diskriminimi	2017	1	4,000
KQZ	2017	1	101
Kuvendi	2017	1	379
Ministria e Brendshme	2017	2	218,792
Ministria e Drejtesise	2017	4	128,431
Ministria e Mbrojtjes	2017	4	89,401
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	2016	1	6,203

	2017	1	109,740
Ministria per Evropen Punet e Jashtme	2017	1	489
Prokuroria e Pergjithshme	2017	1	332
Total		**742**	**10,930,706**

Në nivel institucioni informacioni paraqitet në Aneksin e këtij raporti, ku veçojmë: Bashkitë me 591 raste rregjistrimi të kontratave të lidhura para vitit 2018 me vlerë 4,3 miliardë lekë (*nga të cilat 281 kontrata të Bashkisë Tiranë)***,** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 33 kontrata me vlerë 3.5 miliardë lekë të ndjekur; Ministria e Shëndetësisë, Financave dhe Arsimit dhe njësitë e tyre të varësisë. **Nisur dhe nga problematika e konstatuar në auditimin e vitit 2017, rregjistrimi jo në afat i kontratave jo vetëm është në shkelje të një parashikimi ligjor në:** *Udhëzimin nr.2,datë 6.2.2012, i ndryshuar, Ligji nr.48/2014 Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare* **por është shkak edhe për krijimin e detyrimeve të prapambetura** *në kundërshtim dhe me VKM nr.50 datë 5.2.2014 Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit pika 9 e tij.*

Kriteri:

Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;
Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".
VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".
Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".
Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1
VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"
Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"
Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7
Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;
Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"
Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve",

	pika 15.1
Impakti:	Shkelje e Ligjit të menaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të anagazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura**.**
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave dhe të aplikacionit SIFQ, mosveprim dhe marrja e masave nga MFE, mungesë kontrolli dhe monitorimi nga Drejtoria e Buxhetit
Rëndësia	E lartë

Observacioni i Degës Thesarit Tiranë dt. 2/9/2019 nr. Prot.5363 *Në lidhje me moszbatimin e afateve të rregjistrimit të kontratave subjekti shprehet "Lidhur me konstatimin tuaj për rregjistrimin me vonesë në SIFQ të kontratave, ju sqaroj se Dega e Thesarit Tiranë ka njoftuar MFE në zbatim të Udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar me Udhëzimin Plotësues nr.2 dt.19.01.2018 dhe një shtesë në Udhëzimin nr.2/1 datë 12.04.2018 pika 24/1, ku më konkretisht citohet: "Në rast vonese, Dega e Thesarit procedon me rregjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë nëpunësin e parë Autorizues, I cil merr masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor* ***"***

Bashkia Tiranë në 425 raste që ju konstatoni, ju sqaroj se rezulton të jenë migrim kontrate nga përthithja e veprimtarisë së Komunave dhe Njësive Bashkiake, të cilat rregjistrohen në SIFQ, por data e kontratës është më hershme"

QSUT në 203 raste, ju duhet të keni parasysh Udhëzimin plotësues nr.2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018" pika 24 shkronja d ku citohet:" Përjashtim nga procedurat e mësipërme përbën rregjistrimi në SIFQ i angazhimeve korrente për spitalet, pasi referuar nenit 5 të ligjit nr.109/2017 "për buxhetin e vitit 2018" fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për vitin 2018 hedhja në SIFQ të kontratave për shërbimin spitalor do të bëhet pas miratimit të detajimit të fondit përkatës për shërbimin spitalor për vitin 2018. Në rastin e kontratave shumëvjecare, në SIFQ do të hidhet vetëm shuma përkatëse e kontratës për vitin aktual 2018.

Rregjistrimi në SIFQ i kontratave me data më të hershme vjen edhe nga zbatimi i Aktit Normativ nr.3 dt.6.11.2017 "Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me përgjegjësinë e Degës së Thesarit është mbajtur parasysh roli raportues i saj në dallim nga përgjegjësia dhe autoriteti për dhënie masash administrative i NPA-së.
Në lidhje me kontratat e Bashkisë Tiranë, në dijenin tonë reforma territorial ka përfunduar 2 vite më parë dhe migrimi i kontratave nga Komunat duhet të kishte përfunduar tashmë. Gjithashtu sjellim në vëmëndje se 121 raste nga 425 të cituara në tabelë janë kontrata që janë lidhur gjatë vitit 2018. Në lidhje me kontratat e QSUT, observacioni pranohet dhe reflektuar në paragrafin respektiv.

Për sa më sipër mban përgjegjësi NA/NZ e institucioneve të konstatuara në shkelje në këtë gjetje, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S, Drejtoria e Operacioneve me drejtor znj.M P dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Mbi saktësinë dhe plotësinë e databazës së kontratave (moduli angazhime në SIFQ)

Gjetje:	**Mosrregjistrim i kontratave në momentin e lidhjes së kontratës në vijim të mos rregjistrimit të urdhër-prokurimeve, me qëllim verifikimin e fondeve disponobël**

përpara marrjes së angazhimit. Vetëm në 6-mujorin e I-rë të 2019 janë rregjistruar 618 kontrata që datojnë midis 2006-2018 nga të cilat 472 i përkasin kontratave të parregjistruara të vitit 2018

Situata:

Nisur nga rezultatet e të dhënave të analizuara më lartë, për vjetërsinë e kontratave të rregjistruara gjatë vitit 2018 dhe në 6-mujorin e viti 2019, mund të themi se në SIFQ nuk ka ende një informacion të plotë mbi të gjitha kontratat e lidhura nga të gjitha njësitë ekonomike ndër vite. Në vitin 2018 vazhdojnë ende të rregjistrohen kontrata të vitit 2017 e më herët dhe po ashtu edhe në vitin 2019. Nga tabela krahasuese më sipër për të jëjtën periudhë 6-mujori të parë të vitit 2019 dhe 2018 situata nuk duket të ketë asnjë përmirësim edhe pas problematikës dhe rekomandimeve të lënë nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Ky fakt konfirmon konkluzionin e grupit të auditimit se ka ende kontrata të lidhura por të parregjistruara në Thesar, në pritje të fondeve buxhetore, me ose pa punime të kryera. Kështu, nga shyrtimi i të dhënave të periudhës Janar- Qershor 2019, konstatohet se MFE si monitoruese nuk ka ndërrmarrë asnjë masë për shmangien e fenomenit. Kështu, sic edhe paraqitet në tabelën në vijim përgjatë 6 muajve rezultojnë 1,985 kontrata të viteve 2006-2018 të rregjistruara rishtaz, nga të cilat 618 kontrata investimesh me vlerë 6.5 miliardë lekë**. Vetëm viti 2018, me shkeljet dhe mungesën e monitorimit ka krijuar një "stok" të ri të kontratave të parregjistruara rrjedhimisht dhe fatura të prapambetura prej 5.2 miliardë lekë, të mbartura si një "borxh" i parregjistruar që do të ngarkojë buxhetin e vitit të ardhshëm.**

Viti	6-M I parë 2018		6-M I parë 2019	
Viti	Nr. Kontratave	Vlera e kontratave për Investime ne 000/ leke	Nr. Kontratave	Vlera e kontratave për Investime ne 000/ leke
2006			3	7,905
2007			1	1,095
2008			1	2,949
2009	6	11,784	2	3,418
2010	4	3,129		
2011	9	13,000	5	18,152
2012	3	78,006	3	1,828
2013	16	14,920	1	2,446
2014	22	695,529	6	675,928
2015	20	118,443	6	62,769
2016	53	2,482,038	20	85,951
2017	388	4,447,648	98	500,252
2018			**472**	**5,208,611**
Total	**521**	**7,864,497**	**618**	**6,571,305**

Pra, në konkluzion të sa më lartë grupi I auditimit nuk mund të konfirmojë plotësinë e databazës së angazhimeve në SIFQ.

Kriteri:

Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;
Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

	Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar. *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Mungesë informacioni mbi totalin e angazhimeve të ndërrmarra nga institucionit me qëllim monitorimin e tyre dhe vlerësimin e detyrimeve totale të qeverisë ndaj të tretëve.
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave nga DPTH në bashkëpunim me DBuxhetit dhe NPA si dhe mungesë e kontrollove të aplikacionit SIFQ me qëllim parandalimin të këtyre shkeljeve
Rëndësia	E lartë

Observacioni i Degës së Thesarit Tiranë nr.5363 dt.02.09.2019 "Ashtu sic kemi shpjeguar te gjetjet tuaja, janë disa arsye të rregjistrimit të kontratave me datë të hershme në vitin 2018. Nuk është përgjgegjësi e Degës së Thesarit sjellja me vonesë e kontratave për rregjistrim në SIFQ, Dega e Thesarit bën rregjistrimin e kontratave në SIFQ në momentin e paraqitjes së kontratës dhe kundrejt planit buxhetor.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pjesa e përgjegjësisë së Degëve, DPTH dhe NPA sa shpjeguar më lartë nuk rrëzon gjetjen nga auditimin për një fenomëne të vazhdueshëm dhe të përhapur të thyerjes së procedurave dhe sistemit.

Gjetje:	**Mbi rregjistrimin e pjesshëm të kontratave në total 15 kontrata me vlerë 2 miliardë lekë, me qëllim përputhjen me shumën fondit të disponueshëm në përputhje me udhëzimet për zbatimin e buxhetit.**
<u>Situata:</u>	Gjithashtu, një tjetër fenomen i konstatuar në vazhdimësi <u>është rregjistrimi pjesor apo i fragmentarizuar i kontratës (me vlerë të barabarta me faturën e rradhës</u>). Një kontratë duhet të rregjistrohet vetëm një herë në modulin e angazhimeve e shoqëruar edhe me planin e pagesave i cili për kontratat shumëvjecare duhet të përputhet me shumat e planifikuara e miratuara në PBA2018-2020. Nga shqyrtimi i të dhënave të databazës së kontratave, konstatohen gjithashtu edhe raste të rregjistrimit të kontratës më shumë se

një herë. Në pothuajse të gjitha rastet e evidentuara shuma e kontratës korrespondon me vlerën e faturës. **Pra jemi në situatën kur kontrata rregjistrohet cdo herë që rregjistrohet një faturë e lidhur me atë kontratë**. Duke marrë kështu cdo herë një numër të ri rendor PO-je. Në tabelën në vijim paraqiten dhe rastet e konstatuara në total 15 kontrata me vlerë 2 miliardë lekë të rregjistruara më shume se një herë:

Dega Thesarit	EMRI_Institucionit	Projekti	Emri furnitorit	Dt. Kontrates	Shuma në 000/lekë	Nr. Rregjistrimeve
Berat - Berat	**Prefektura qarkut Berat**	M160101	E I	27/12/2018	208	3
Durres	**DP Hekurudhave Durres**	M064005	Z	06/08/2018	7,717	2
Fier	**Bashkia Roskovec**	M991535	F	19/12/2018	130,269	2
Fier - Lushnje	**Gjykata e rrethit Lushnje**	M290072	M	18/06/2018	104	2
Korce - Devoll	**Dogana Kapshtice**	M100002	I S	29/10/2018	128	2
Tirane -	**Admin Qendrore e ISHP**	M100088	H A A	28/05/2018	5,520	2
	AAPSK	M100462	S CO	11/12/2018	1,072	3
	Aparati MFE	M100386	T&T B	13/06/2017	73,696	2
		M100499	V P M T V D.O.O	22/11/2017	64,680	2
	Aparati MEPJ	M150024	T	23/04/2018	1,193	2
		M150036	S CO	21/11/2018	2,145	2
	Bashkia Tirana	M991398	B - I SH.P.K	04/10/2016	61,806	2
		M991467	FBS	11/12/2017	8,165	2
	FZHSH	M560346	I C P 04	19/01/2015	2,902	3
		M560442	B	23/07/2018	547,492	2
	D.P. Burgjeve	0000000	DP 2007	07/06/2018	159,167	2
			J G	2018/04/16	810	3
	Aparati i MIE	M064078	A E	16/12/2014	661,500	1
Vlore - Sarande	**Bashkia Sarande**	M112606	B		107,326	4
		M990343	G J	11/06/2015	129,204	2
		M991389	E K	30/06/2016	7,521	2
	Sp. Sarande	M133765	G J	15/02/2016	13,712	3
				17/11/2016	38,926	2
		M134017	G J	27/12/2017	9,000	2
Total					**2,034,263**	

Për t'u vecuar nga lista më sipër është rasti i kontratës së inceneratorit të Elbasanit, kontratë kjo e lidhur në vitin 2014 dhe që cdo vit vazhdon të rregjistrohet në mënyrë të copëzuar në vlera të barabarta me fondet në dispozicion të atij viti. **Nga të dhënat e kontratave të rregjistruara në vitin 2019 e gjejmë përsëri këtë kontratë të rregjistruar në datën 4 Shkurt për një vlerë prej 1,480,364,472 lekë**. Sipas tabelës së ecurisë së investimeve cdo me rregjistrimin e një fature rritet dhe vlera e kontratës:

Project	Pershkrimi	Muaji	Current Year 2018	F-Y 2019	F-Y 2020	F-Y 2021	F-Y 2022	Payments	Total Commitment
M064078	Incenerator i Elbasan	Janar	-	-	-	-	-	131,309	131,309
M064078	Incenerator i I Elbasan	Shkurt	557,085	-	-	-	-	235,723	792,809
M064078	Incenerator	Mars	505,453	-	-	-	-	287,356	792,809

		i I Elbasan								
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Prill	454,714	-	-	-	-	338,095	792,809
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Maj	404,908	-	-	-	-	387,900	792,809
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Qershor	404,908	-	-	-	-	387,900	792,809
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Korrik	305,778	-	-	-	-	487,031	792,809
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Gusht	305,778	-	-	-	-	487,031	792,809
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Shtator	256,059	-	-	-	-	536,750	792,809
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Tetor	206,627	-	-	-	-	586,181	792,809
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Nentor	157,530	-	661,500	157,364	-	635,278	1,611,673
	M064078	Incenerator i I Elbasan	Dhjetor	60,069	-	661,500	157,364	-	732,7393	1,611,673

Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Shkelje e Ligjit të mënaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të anagazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të

	prapambetura**.** Raportim i jo i saktë i angazhimeve buxhetore.
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave dhe të aplikacionit SIFQ, mosveprim dhe marrja e masave nga MFE, mungesë kontrolli dhe monitorimi nga Drejtoria e Buxhetit
Rëndësia	E lartë

Observacioni i Degës së Thesarit nr.5363 dt.02.09.2019"Nga verifikimi i gjetjeve për rregjistrim pjesor të vlerave të kontratave dhe rregjistrim të kontratave, sa herë që bëhet likujdim ju sqarojmë disa raste:
Institucioni AAPSK me kod M100088 janë kontrata të ndryshme sipas objektit të shpenzimit me të njëjtin furnitor, nuk ka coptim kontrate, përkatësisht PO63324, PO63476, PO63480.
KLSH : Sipas të dhënave që na janë vënë në dispozicion, të tre rregjistrimet citojnë kontrata të lidhura në të njëjtën datë dhe me të njëjtën natyrë shpenzimi "blerje pajisje llo#2318600?

Dega	PO #	Projekti	Furnitori	Dt.kontrates	Dt.rregjistrimit	INSTITUCIONI	Emri Insitucionit	Llog	Përshkrimi llog	Përshkrimi projektit	Shuma
3535	63324	M100462	S CO	11/12/2018	21/12/2018	1010099	Agjensia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara	2318600	Shpenz. per rritjen e AQT - paisje kompjuteri	Blerje pajisje	231,000
3535	63476	M100462	S CO	11/12/2018	26/12/2018	1010099	Agjensia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara	2318600	Shpenz. per rritjen e AQT - paisje kompjuteri	Blerje pajisje	793,200
3535	63480	M100462	S CO	11/12/2018	26/12/2018	1010099	Agjensia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara	2318600	Shpenz. per rritjen e AQT - paisje kompjuteri	Blerje pajisje	47,418

Aparati i MPJ janë 2 kontrata të ndryshme, me furnitor S CO me PO63394 dhe PO63393 dhe për furnitorin T me PO 60618 dhe PO59852. Furnitori T janë kontrata të klasifikuara.
KLSH: Pavarësisht statusit mbetet në përgjegjësinë e institucionit që i ka hedhur saktësia dhe përputhshmëria me afatet.
Aparati INSTAT me furnitor IS, janë kontrata, përkatësisht me datë 30.8.2018 me nr.9/12;13;14,8,15 nuk ka coptim kontrate PO58459, PO58458, PO58487, PO58456.
KLSH: Observacioni pranohet
Autoriteti i Konkurrences me kod M770032 janë dy pagesa me blerje të vogla për të cilat nuk ka kontratë, por rregjistrimi në SIFQ bëhet UB standarte.
KLSH: Observacioni pranohet
ARRSH për kontratën me kod projekti M064183, me furnitor 4AX, është rregjistruar me kërkes-blerjen 1006054-1800023, më pas, PO 1006054-1800025 me vlerë 169,176,925 lekë, më vonë është konstatuar që PO është rergjistruar pa vlerën e TVSH, më pas për këtë objekt është bërë PO10006054-1800078 (vlera e TVSH).
KLSH: Observacioni pranohet
Avokatura e Shtetit me kod projekti M140194, janë 2 kontrata të ndryshme me nr.2581/1 dhe 2581/2 datë 22.10.2018 me objekte të ndryshme, përkatësisht PO62693 dhe PO62691
KLSH: Observacioni pranohet
QFM Teknike Tiranë me kod projekti M160883, janë 2 kontrata të ndryshme me nr.1207/26, 1027/28, rregjistruar në SIFQ me PO 61968, PO61965
KLSH: Observacioni pranohet
DP Burgjeve me furnitor D P 2007, janë kontrata të ndryshme, me nr.160/147, 159/25 datë 7.6.2018, përkatësisht PO59853 dhe PO 59851, për furnitorin J, janë bërë 3 blerje të vogla në SIFQ, ku rregjistrohet UB standarte.
KLSH: Vlerat e rregjistruara nuk duket të jenë në limitet e blerjeve të vogla:

Dega Thesarit	PO_ Nr	Projekti	Furnitori	Dt.kontrates	Dt.rregjistrimit	Kodi inst.	Emri Institucionit	Llog	Pershkrimi llog	Pershkrimi projektit	Shuma
3535	59851	00000000	D P 2007	07/06/2018	12/06/2018	1014048	DP e burgjeve	6021004	Furnizime dhe sherbime me ushqim per mencat	Unspecified	123,399,600
3535	59853	00000000	D P 2007	07/06/2018	12/06/2018	1014048	DP e burgjeve	6021004	Furnizime dhe sherbime me ushqim per mencat	Unspecified	35,767,080

<u>Aparati i MIE</u> me furnitor A E, është bërë megrim kontrate nga Minsitria e Mjedisit. Migrimi I kontratës ëstë bërë në vlerën 1,480,364,472 e ndarë në vite buxhetore përkatësisht 2019,2020,2021.
Nuk është e vërtetë që për kodin M064078 është shtuar vlera e kontratës për cdo kalim, sistemi nuk ta lejon këtë veprim, tek të dhënat tuaja, në akt-konstatimin tek kolona current year 2018, është pasqyruar obligimi i vitit 2018 me vlerë 661,500,000.
KLSH: Observacioni nuk pranohet. Sipas tabelës së ecurisë së investimeve ky angazhim është raportuar me vlera të ndryshme "total commitment" në muajin janar, Nëntor apo Dhjetor. Migrimi ndodh një herë dhe me vlerën e plotë të angazhimit pavarësisht obligimit në vite,

Për sa më sipër mban përgjegjësi NA/NZ e institucioneve të konstatuara në shkelje në këtë gjetje, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S, Drejtoria e Operacioneve me drejtor znj.M P dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Gjetje:	**Mbi rregjistrimin e kontratës dhe faturës në të njëjtën ditë ku në 151 raste rregjistrimi i kontratës është formal dhe vetëm si pjesë e rutinës së rregjistrimit të faturës.**
<u>Situata:</u>	Fenomeni i rregjistrimit me vonesë i kontratave është i përhapur jo vetëm në njesitë të cilat nuk kanë akses në SIFQ dhe që fizikisht duhet të cojnë kontratën për rregjistrim pranë degëve të thesarit por edhe nga njësitë të cilat kanë akses në SIFQ sic janë gjithë aparatet e Ministrive të linjes dhe Bashkia Tiranë**.** Nga shqyrtimi i rasteve të rregjistrimit të kontratave me vonesë vihen re se nga disa njësi k**ontrata rregjistrohet në të njëjtën datë me urdher shpenzimin për pagesen e fatures se parë si parakusht për rregjistrimin e faturës.** Pra kontrata rregjistrohet jo si një domosdoshmëri në përputhje me Udhëzimin por vetëm si një dokumentacion shoqërues i faturës miratuar për pagesë. Nga shqyrtimi i datës së urdhër shpenzimit krahasuar me datën e rregjistrimit të kontratës për faturat korrente të vitit 2018 u konstatuan 151 raste të tilla të paraqitura në detaj në Aneksin përkatës të këtij raporti. Nga këto raste vecojmë rregjistrimet e mëposhtme të kontratave nga DPT, FSHZH, KM etj:

Kodi Institucionit	Enri institucionit	NrKontrates	Projekti	SHUMA 000/leke	Dt.Kontrates	Dt.Rregjistrimit Kontrates	Dt.Fatures	Dt,Urdher Shpnz
1010039	**DPT**	**63186**	**M100500**	**2,238,185**	**2018/11/27**	**18/12/2018**	**06/12/2018**	**18/12/2018**
1006054	**ARRSH**	**100605 4-18000**	**M064188**	**1,548,620**	**2018/07/09**	**13/08/2018**	**31/07/2018**	**13/08/2018**

		24						
1056001	**FZHR**	**63358**	**M560436**	**1,200,000**	**2018/03/21**	**24/12/2018**	**30/11/2018**	**24/12/2018**
1056001	**FZHR**	**63605**	**M560454**	**811,564**	**2018/09/26**	**27/12/2018**	**24/12/2018**	**27/12/2018**
1013068	Spitali. Durres	25920	M134049	199,993	2018/11/14	27/12/2018	21/12/2018	27/12/2018
1003001	Aparati KM	1003001-180004	M030029	97,971	2018/10/25	18/12/2018	03/12/2018	18/12/2018
1015001	Aparati Ministrise Puneve te Jashtme	59849	M150024	89,172	2018/04/23	12/06/2018	24/04/2018	12/06/2018
1006098	DP Detare Durres	25950	M063966	76,536	2018/12/03	28/12/2018	21/12/2018	28/12/2018
1087006	AKSHI	1087006-180051	M870338	70,800	2018/11/14	28/12/2018	27/12/2018	28/12/2018
1016056	QFM Teknike Tirane	63202	M161032	67,808	2018/10/15	18/12/2018	15/11/2018	18/12/2018
1013001	Aparati Ministrise Shendet.	1013001-180039	M134028	64,575	2018/11/27	26/12/2018	13/12/2018	26/12/2018
1014045	Qendra Publikime ve zyrtare	63309	M140347	64,080	2018/06/14	21/12/2018	16/07/2018	21/12/2018

Nga testimet e mëtejshme të të dhenave të kontratave të rregjistruara me vonesë, konstatohet se në disa raste arsyeja e rregjistrimit me vonesë të kontratës është mungesa e fondeve disponibël në SIFQ. Kjo cështje është trajtuar më hollësisht në pikën më lartë të këtij Raporti.

Kriteri:

Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".
VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".
Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".
Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura

	VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore" *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Raportim i pasaktë i kontratave shumëvjecare
Shkaku:	Mungesë kontrolli dhe marrja masash pas raportimeve te DPTH nga ana e NPA
Rëndësia	E lartë

Observacion i Degës Thesarit Tiranë nr.5363 dt.2.9.2019 "Mbi rregjistrimin e kontratës dhe faturës në të njëjtën ditë në 151 raste. Në rastet që ju keni konstatuar, kur kontrata është rregjistruar në SIFQ, në të njëtën kohë me pagesën e faturës tatimore, ju sqaroj se janë kontrata shumëvjecare, dhe nuk kanë të rregjistruar në SIFQ planin PBA".

Qëndrimi i grupit të auditimit. Pavarësisht shkakut dhe përgjegjësisë direkte të Drejtorisë përgjegjëse për rregjistrimin e PBA-së, mosrregjistrimi i saj si një shkelje në vetvetë nuk mund të jetë justifikim i një shkelje tjetër.

Për sa më sipër mban përgjegjësi NA/NZ e institucioneve të konstatuara në shkelje në këtë gjetje, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me drejtor znj.M Dh, Drejtoria e Menaxhimit të investimeve me drejtor znj. S S, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S, Drejtoria e Operacioneve me drejtor znj.MP dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Gjetje:	**Faturat nuk lidhen me një kontratë në momentin e rregjistrimit në SIFQ, konstatuar në 27 raste nga Degë të ndryshme të Thesarit si Dega Tiranë, Durrës etj.**
<u>Situata:</u>	Nga **auditimi janë konstatuar raste të rregjistrimit të faturave për shpenzime për investime të palidhura me një kontratë.** Sipas specialisteve të Drejtorisë së Procesimit te biznesit, lidhja e faturës me një kontratë, në momentin e rregjistrimit të saj është opsionale kjo edhe për arsye të rregjistrimit të shpenzimeve operacionale të cilat jo gjithmonë janë rrjedhë e një kontrate. <u>Pra, mbetet në përgjegjshmërinë e specialistes së thesarit dhe autorizuesve të transaksionit në SIFQ për të siguruar zbatimin e procedurës së rregjistrimit të transaksioneve në SIFQ.</u> Më poshtë paraqiten dy raste të evidentuara gjatë testimeve: -Njësia: **Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (BI Online)** Llogaria ekonomike: 2312103 Shpenzime për rritje AQT-ndërtesa e shkollës

Nr.Faturës	Kodi Projektit	Përshkrimi i projektit	Furnitori	Shuma faturës në 000/lekë	Dt.Faturës	Dt. Rregjistrimit
13510100	M100390	Ndertim i bazes prodhuese per	GJ	20,308	26-Dhj-17	22/02/2018

012018		shkollen AMP "Karl Gega", Tirane				
32610100 012018	M100390	Ndertim i bazes prodhuese per shkollen AMP "Karl Gega", Tirane	GJ	20,000	28-Mar-18	17/04/2018
88110100 012018	M100390	Ndertim i bazes prodhuese per shkollen AMP "Karl Gega", Tirane	GJ	10,735	20-Qer-18	04/09/2018
78310100 012018	M100390	Ndertim i bazes prodhuese per shkollen AMP "Karl Gega", Tirane	GJ	22,189	20-Qer-18	14/08/2018
88310100 012018	M100390	Ndertim i bazes prodhuese per shkollen AMP "Karl Gega", Tirane	GJ	25,751	02-Kor-18	04/09/2018

Nr.Faturës	**Kodi Projektit**	**Përshkrimi i projektit**	**Furnitori**	**Shuma faturës 000/lekë**	**Dt.Faturës**	**Dt. Rregjistrimit**
21910100 012018	M100392	Rikonstruksion shkolla AM Profesional Kamez	A C	16,087	12-Dhj-17	12/03/2018
13610100 012018	M100392	Rikonstruksion shkolla AM Profesional Kamez	A C	13,912	12-Dhj-17	22/02/2018
33510100 012018	M100392	Rikonstruksion shkolla AM Profesional Kamez	A C	8,280	28-Mar-18	18/04/2018
9.021E+1 3	M100392	Rikonstruksion shkolla AM Profesional Kamez	A C	5,751	30-Mar-18	10/09/2018
36410100 012018	M100392	Rikonstruksion shkolla AM Profesional Kamez	A C	19,043	03-Pri-18	27/04/2018
36410100 012018	M100392	Rikonstruksion shkolla AM Profesional Kamez	A C	20,961	03-Pri-18	27/04/2018

-Njësia: **Aparati i Këshillit të Ministrave**

Për projektin "M030029 Rikonstruksion- restaurim i katit nëntokësor" me institucion përfitues Aparatin e Këshillit të Ministrave, në modulin e pagesave kishte likujdime të faturave për investim (231 shpenzime AQT) për vitin 2017 të cilat nuk lidheshin me PO number (kontrate) në momentin që likujdoheshin. Pra sistemi SIFQ në modulin e pagesave, jep opsionin personit të autorizuar për pagesë , të lidhte ose jo faturën që likujdohej me PO number (kontratën përkatëse). Por ky system e linte opsionale këtë funksion sepse sipas arsyetimit thesari bënë likujdime jo vetëm për fatura investimesh (231 të cilët domosdoshmerisht kanë një kontratë me PO number ku bazohet shpenzimi kapital), por gjithashtu likujdon dhe shpenzime operative, ndihma ekonomike etj etj të cilat nuk mund ti referosh me një kontratë. Për këtë projekt, faturat e palidhura me kontratë gjatë vitit 2017 kanë qenë dy, përkatësisht fatura me datë 18.01.2018 të furnitorit A-S dhe nr.serie sistemi 1062954510030012017 me vlerë 58,801 mijë lekë dhe fatura me datë 11.12.2017 të furnitorit A-S dhe nr. serie sistemi 44410030012017 si dhe vlerë 37,181 mijë lekë. Pra totali i faturave për shpenzime kapitale të palidhura me një kontratë (PO number) në modulin e pagesave të sistemit SIFQ për këtë projekt në vitin 2017 ***është 95,983 mijë lekë.***

Për të testuar nëse këto dy raste rregjistrimi të fatura pa i lidhur me një kontratë ishin raste të izoluara apo një praktikë normale nga Degët e Thesarit u krahasuan të dhënat nga databaza e PO-ve të cilat figuronin me pagesa zero. Nga verifikimi i cdo rasti me databazën e faturave/pagesa rezultoi se faktikisht këto kontrata kishin patur pagesa gjatë vitit 2018 por lidhja faturë/kontratë nuk ishte kryer në momentin e rregjistrimit edhe për

23 kontrata të tjera me vlerë rreth 727 milionë lekë. Këto rregjistrime janë kryer nga këto degë:

Kodi Degës	Dega	Numri i kontratave të palidhura
0202	Berat - Berat	1
0707	Durres - Durres	2
0716	Durres - Kruje	1
0909	Fier - Fier	1
0922	Fier - Lushnje	1
0924	Fier - Mallakaster	1
1134	Gjirokaster - Tepelene	1
1812	Kukes - Has	1
3513	Tirane - Kavaje	1
3535	Tirane - Tirane	10
3704	Vlore - Delvine	2
3731	Vlore - Sarande	1
Total		**23**

Më hollësisht të gjitha rastet e identifikuara paraqiten në tabelën në vijim:

PO#	Dt. kontratës	VENDOR_NAME	Dt. Rregjist. kontratës	EMRI_Instit.	TDO	Projekti	PERSHKrimi	Shuma faturuar sipas dtbazës PO	SHUMA e kontratës	Pagesa sipas SIFQ
1005001-1800031	2018/10/26	I ()	26-OCT-18	Aparati MBZHR	3535	**M05 1513**	Ndertimi I Tregut te peshkut Shengjin	0	59,966,670	5,154,918
1026001-1800050	2018/12/12	D& C	28-DEC-18	Aparati i Ministrisë Mjedisit	3535	M26 0403	Permiresimi dhe rritja e kapaciteteve pritese, vendosja e sinjalistikes turistike ne projektin 100 fshatrat.	0	719,133	67,596,232
12059	2018/07/19	E M	23-JUL-18	Drejtoria e shendetit publik Kavaje	3513	M13 4032	Rikonstruksion i godines se ish poliklinikes per t'u pershtatur per QKSHM - Kavaje	0	293,760	3,606,014
18127	2018/12/17	SH 07	18-DEC-18	Spitali Lushnje	0922	M13 0339	Te Ardhurat Dytesore (Spitalori)	0	1,992,840	2,137,221
23997	2018/01/25	E	01-FEB-18	Bashkia Durres (0707)	0707	**M99 1510**	Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga Rruga "Skënderbej" sistemimi i ujërave Ura Dajlanit, Faza 1	0	182,094,840	76,691,160
2435	2017/07/11	G. P. G.	18-APR-18	Bashkia Finiq	3704	M99 1507	Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja	0	15,352,500	42,019,247
24443	2017/12/29	BA	06-FEB-18	Bashkia Ura Vajgurore	0202	M06 3870	Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës	0	19,454,899	35,611,800

							Vajgurore			
2452	2016/11/25	G. P. G.	24-AUG-18	Bashkia Delvine	3704	M99 1374	Rijetësimi i qendrës së Delvinës	0	21,676,614	21,733,613
25464	2018/10/17	E-A	24-OCT-18	Bashkia Durres (0707)	0707	M10 0399	Permiresim i kushteve te banimit per komunitetin Rom/Egjiptian	0	6,235,476	5,809,387
26031	2018/05/25	"SH"	25-MAY-18	Bordi i Kullimit Fier	0909	M05 1519	Rehabilitim ne rezervuarin e Doftise	0	2,248,081	2,273,414
4477	2018/08/20	"LA"	11-SEP-18	Bashkia Krume (1812)	1812	**M06 3869**	Rikonstruksion i ujësjellësit fshatit Krumë dhe Zarisht	0	10,393,388	89,695,308
4777	2018/09/18	PV	19-SEP-18	Bashkia Ballsh	0924	M11 2769	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Beslidhja	0	10,131,752	27,195,541
5619	2018/11/14	B-93	13-DEC-18	Sh.A. UK Tepelene	1134	**M06 3880**	Rikonstriksion i rrjetit te ujesjellesit Memaliaj,	0	74,292,302	17,000,135
60012	2018/06/14	A F - AL	19-JUN-18	Aparati Qendror i SHIKUT	3535	M18 0037	Blerje e mjeteve te transportit	0	14,164,800	18,388,800
62791	2018/07/23	B A	04-DEC-18	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	3535	**M56 0442**	Rikonstruksioni rrugevë të brendshme tek zona e plazhit te Shkëmbi i Kavajës	0	273,746,114	54,749,222
62897	2018/10/18	V	07-DEC-18	Autoriteti per informim dosjet ish Sig. Shtetit	3535	M95 0005	Mbikëqyrje punimesh	0	133,767	133,766
63036	2018/10/26	D G A	13-DEC-18	DP e Ujesjelles Kanalizimeve	3535	M06 2839	Kosto Lokale projekti I kanalizimeve te Tiranes se madhe	0	2,588,844	42,556,520
63313	2018/01/12	IK	21-DEC-18	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	3535	**M56 0435**	Hartimi i projekteve per rruget rurale	0	22,236,120	9,508,017
6736	2017/12/27	G J	31-JAN-18	Sp. Sarande	3731	M13 4017	Ndertimi i maternitetit te ri, sp.Sarande-shtese kontrate	0	6,000,000	39,173,773
9632	2016/12/28	E-G	26-APR-18	Bashkia Kruje	0716	M06 3462	Studim projektim për shtimin e sasisë së furnizimit me ujë për qytetin e Krujës	0	1,595,760	4,787,280
Total										

Pra sistemi SIFQ i thesarit ka mangësi në procedurat e kontrollit të shpenzimeve kapitale, duke lënë hapsira dhe duke u ekspozuar me riskun e likujdimit të faturave pa pasur kontratë respektive për shpenzimin në fjalë., gjë që përkthehet në mosfunksionim të sistemit të kontrollit në momentin e pagesave.

Nisur nga rastet e mësipërme, nuk mund të konfirmohet saktësia në numër dhe vlerë e të dhënave mbi angazhimet në SIFQ. Me rishfaqjen e praktikës për rregjistrimet pjesore

	edhe këtë vit ushtrimor, mund të konkludojmë që vetëm nga kjo situate numri i kontratave është i mbivlerësuar ndërsa në vlerë i nënvlerësuar pasi mund të priten fatura të reja për të njëjtat kontrata (sidomos për kontratat me terma mbi 12 muaj). Në këtë kontekst, vazhdon të mbetet si problem i evidentuar edhe në auditimin e kaluar, cështja e identifikimit të kontratave shumëvjecare me qëllim ndjekjen dhe transferimin e balancave të mbetura në fillim të vitit korrent. Po sipas specialistëve të Drejtorisë së Procesimit të Biznesit kjo është parashikuar të rregullohet në vitin 2019 me ndryshimin e algoritmit që gjeneron kodin e projektit, dy shifrat e para të të cilit do të jenë numra të cilat i referohen vitit kur është lidhur kontrata psh. "18AD801".
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Shkelje e Ligjit të mënaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të anagazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura**.** Raportim i jo i saktë i angazhimeve buxhetore.
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave dhe të aplikacionit SIFQ, mosveprim dhe marrja e masave nga MFE, mungesë kontrolli dhe monitorimi nga Drejtoria e Buxhetit
Rëndësia	E lartë

Observacioni i Degës Thesarit Tiranë nr.5363 dt.2.9.2019: *Për kontratat që lidhen me disa fatura në SIFQ rregjitrohet UP e planifikuar, dhe sa herë që ka pagesë, bëhet lëshimi dhe përputhja me Urdhër-shpenzimin.*
Ministria e Mjedisit për pagesën e furnitorit DC me kod projekti M260403, është përputhur me PO 1026001-1800049, vlera e të cilës në sistem është 67,596,232, po aq sa është dhe pagesa. Shuma e kontratës 719133 është anulluar nga institucioni i cili operon vetë në SIFQ.
Instituti i Monumenteve të Kulturës me kod projekti M120785, PO59643, është anulluar me kërkesë të institucionit dhe është rihedhur në SIFQ me PO59929 e përputhur me pagesën.
KLSH: Observacioni pranohet
Aparati qëndror I SHIK-ut me kod projekti M180037 PO60012, është anulluar dhe rihedhur me nr.PO60014. Pagesat janë të lidhura me PO60014 për vlerën 14,164,800 lekë, pjesa tjetër e pagesave është me PO58929 dhe me UB standarte për furnitorin A-F-al.
Për po62622, është bërë anullimi për kodin e projektit që është bërë gabim, i cili është hedhur nga Buxheti dhe pagesa që është bërë standarte, pasi është bërë likujdimi i plotë.
KLSH: Observacioni pranohet
Kuvendi, PO62111, është anulluar, pagesa është lidhur me shumë PO për objekte të ndryshme. PO59964, 60892, 59618, 63189, 62466,61349, 61590 me furnitorë të ndryshëm.
KLSH: Observacioni pranohet
Aparati i Bujqësisë, me kod projekti M51513, PO1005001-1800031, është mbyllur. Pagesa me vlerë 5154918, është përputhur me PO1005001-1800051.
Fondi i Zhvillimit Shqiptar me kod projekti M560434, pagesa prej 9508017 lekë, është përputhur me PO63313 dhe dt.21.12.2018. Pagesa me kod projekti M560442, është përputhur me PO62791.
Autoriteti per Informim me kod projekti M950005 PO62897, është mbyllur me kërkesë të institucionit. Pagesa me vlerë 133766 lekë është lidhur me PO62941.
DP Ujësjellëz Kanalizime, me kod projekti M062839 PO63036, është anulluar dhe janë mbylur pagesat të cilat nuk janë lidhur me një PO, pasi janë shpenzime për kosto lokale.
KLSH: Për rastet e tjera në observacion cila është arsyeja e anullimit të një kontrate pasi ajo lidhet me një faturë? A duhet ta lejojë sistemi një gjë të tillë?

Për sa më sipër mban përgjegjësi NA/NZ e institucioneve të konstatuara në shkelje në këtë gjetje, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S, Drejtoria e Operacioneve me drejtor znj.M P dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Gjetje:	**Pasaktësi në datat e kontratave gjatë rregjistrimit në SIFQ, me impakt në identifikimin e rasteve në shkelje të afateve dhe ecurise së projekteve për investimeve të reja apo në vazhdim.**
Situata:	Në kampionin e zgjedhur për testim, 3 raste rezultojnë me datë rregjistrimi në sistemin e thesarit më të hershme se data e firmosjes së kontratës, fakt që tregon se sistemi nuk ka sinjalizues për detektimin të rasteve që përbëjnë shkelje të ligjit.

Institucioni	dt. Kontratës	Dt.rregjistrimit	Llog.Ekonomike	Dega e thesar
Sherbimi i Kontrollit te Brendshem	0208/09/11	02.10.2018	602	Tirane - Tirane
Bashkia Konispol	0208/09/24	31.10.2018	231	Vlore - Sarande

Qendra Kombetare e Trajtimit te Viktimave te Dhunes ne Familje	1018/10/31	12.12.2018	602	Tirane - Tirane
Spitali Shkoder	1018/12/13	17.12.2018	602	Shkoder - Shkoder

Pra përveç mundësisë së rregjistrimit të kontratave me çdo lloj date historike sa cituar më lartë, sistemi nuk ka një kontroll aplikacioni dhe /ose Drejtoria e Thesarit nuk kontrollon pas faktit cilësinë e të dhënave për të vërtetuar nëse këto janë raste të gabimeve njerëzore dhe për më tepër të bëjë sistemin e tyre për efekt të raportimeve mujore financiare dhe fiskale dhe monitorimit të realizimit të investimeve.

Kriteri: *Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54; Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 për zbatimin e buxhetit të vitit 2018; Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;*
Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar
Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.
Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017".
Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".
VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.
Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".
Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".
Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"
Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"
Udhëzimi plotësues nr.1 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7
Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"
Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1

Impakti: Raportim i pasaktë i kontratave shumëvjecare

Shkaku: Mungesë kontrolli i aplikacionit në rregjistrimin e ekstremiteteve me formate të caktuara

Rëndësia E lartë

Observacioni i Degës Thesarit Tiranë nr.5363 dt.2.9.2019 "*Nga kontrolli i të 2 rasteve të rregjistrimit gabim në datën e kontratës, janë bërë gabime njerzore të cilat u rregulluan në SIFQ. Bashkëlidhur do të keni të printuar nga SIFQ rregullimin e rregjistrimit.*

Qëndrimi i grupit të auditimit. Duke marrë parasysh gabimet njerëzore dhe numrin e vogël të rasteve grupi i auditimit nuk nxjerr me përgjegjësi specialistin e Degës së Thesarit. Qëllimi i evidentimit është në kuadrin e cilësimit të mungesave të kontrollit të aplikacionit në SIFQ ku ne midis të tjerash vlersojmë

si shumë të rendësishëm datën e dokumentit dhe SIFQ duhet të ketë mundësinë e një kontrolli mbi formatin e datë apo vendosjen e një date "viti" i shkuar apo i ardhshëm jo korrekt.

Mbi rregjistrimin, deklarimin dhe raportimin e stokut të detyrimeve të prapambetura

Në fillim të vitit 2017, i është urdhëruar institucioneve shpenzuese dërgimi i informacionit të faturave të prapambetura pranë Degëve të Thesarit si pjesë e strategjisë për menaxhimin e faturave të prapambetura. Për këtë qëllim, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka përpiluar një Manual udhëzues përdorimi përfundimtar "*Mbi regjistrimin, ngarkimi dhe postimin në sistemtë detyrimeve të prapambetura*" mbi bazën e të cilit udhëzohen Degët e Thesarit për mënyrën e rregjistrimit të tyre në sistemin SIFQ. Sipas këtij manuali, institucionet rregjistrojnë faturat në Thesar ku ky i fundit i kontabilizon ato jo mbi bazë trasaksioni por si balanca kontabël në një llogari të hapur enkas për këto fatura; grupi 486, llogaria 4864 "*shpenzime të periudhave të ardhshme-fatura të prapambetura"***.** Ky informacion na u vu në dispozicion i detajuar sipas natyrës dhe institucionit por jo sipas faturave dhe datave historike të tyre, kjo për vetë skemën e ndërtuar me qëllim deklarimin dhe rregjistrimin e faturave të prapambetura deri në momentin e celjes buxhetore

<table>
<tr><td>Gjetje:</td><td>1. Stoku i detyrimeve të prapambetura i raportuar në shumën 15.5 miliard lekë raportohet se është ulur me 8% krahasuar me një vit më parë, raportim ky që rezulton i jo i plotë dhe i saktë pasi konstatohen vlera më të mëdha të pagesave të kryera faktikisht gjatë vitit 2018 me të paktën 7 miliard lekë më shumë për zërin "detyrime për shpenzime për investime" . Gjithashtu, rezulton se vetëm viti 2018 ka rritur këtë stok me të paktën 9 miliardë lekë për të njëjtin zë, paguar gjatë vitit 2019.
2. Skema e udhëzuar përvec kontabilizimit të gabuar të këtij detyrimi duke e klasifikuar nuk mund të jetë një zgjidhje e përhershme për shkeljet e procedurave të parashikuara për disiplinimin e angazhimeve buxhetore.</td></tr>
<tr><td><u>Situata1:</u></td><td>Sipas raporteve të vëna në dispozicion balanca progresive, ajo e mbartur dhe e krijuar rishtaz gjatë vitit 2018 është 27,817,290,069 lekë më 31.12.2018. <u>Kjo balancë në fund të periudhës raportues paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara më 31.12.2018, klasa 4 në shumën</u> <u>15,505,241,700</u> lekë. Sipas llojit të detyrimit përbërja e këtij stoku është paraqitur në vijim ku shihet qartë se detyrimet e prapambetura për shpenzime për investim zënë 50% të totalit të detyrimeve:
<table>
<tr><th>4864100-Vendime Gjyqesore</th><th>4864200-DetPrap Sherbime</th><th>4864300-DetPrapMirembajtje</th><th>4864400-DetPrap Investime</th><th>4864500-DetPrapRimbursiTVSH</th><th>4864900-DetPrapTeTjera</th><th>TOTALI</th></tr>
<tr><td>4,409,845</td><td>3,053,194</td><td>1,952,628</td><td>14,879,647</td><td>930</td><td>3,521,044</td><td>27,817,290</td></tr>
<tr><td>-1,377,414</td><td>-1,685,709</td><td>-1,131,912</td><td>-7,363,798</td><td>-</td><td>- 753,214</td><td>-12,312,048</td></tr>
<tr><td>3,032,432</td><td>1,367,485</td><td>820,715</td><td>7,515,849</td><td>930</td><td>2,767,829</td><td>15,505,241</td></tr>
</table>
Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Operacioneve në grupin "Detyrime të prapambetura të tjera "listohen kryesisht shpenzime për blerje mallra dhe shërbime të tjera.[10]
Në tabelën në vijim janë paraqitur balancat progressive të faturave të prapambetura të</td></tr>
</table>

[10] *Email I dt.23.8.2019 Drejtoria e OPeracioneve*

mbartura dhe atyre të krijuara rishtaz gjatë vitit 2018, ku 30 prej institucioneve kanë në total 22.22 miliardë lekë detyrime ose 80% të stokut total, ku vecojmë Bashkinë Tiranë me 21% dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar me 20% të stokut të faturave të prapambetura.

Kodi Inst.	Emri Institucionit	Progresiv	Në % ndaj totalit	Paguar	Mbetur 31.12.2018
2101001	Bashkia Tirana (3535)	**5,970,327,759**	21%	3,479,316,363	2,491,011,396
1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar	**5,483,466,643**	20%	2,722,099,520	2,761,367,123
1006047	Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kan	**1,077,908,118**	4%	51,040,900	1,026,867,218
1017001	Aparati Ministrise Mbrojtjes	**900,678,406**	3%	0	900,678,406
1006077	Drejtoria e Rajonit Verior (Shkoder) (333	**861,108,300**	3%	444,091,913	417,016,387
2122001	Bashkia Korce (1515)	**523,270,417**	2%	364,204,826	159,065,591
2167001	Bashkia Ura Vajgurore	**480,432,710**	2%	245,670,137	234,762,573
2127001	Bashkia Lezhe (2020)	**459,013,574**	2%	81,984,245	377,029,329
2106001	Bashkia Peshkopi (0606)	**456,643,487**	2%	145,024,249	311,619,238
2107001	Bashkia Durres (0707)	**424,395,445**	2%	25,625,699	398,769,746
2136001	Bashkia Pogradec (1529)	**419,522,549**	2%	104,080,074	315,442,475
2128001	Bashkia Librazhd (0821)	**379,701,355**	1%	291,842,309	87,859,046
1006079	Drejtoria e Rajonit Qendror	**377,451,587**	1%	212,589,998	164,861,589
2103001	Bashkia Bulqize (0603)	**340,903,867**	1%	87,984,304	252,919,563
2101155	Ndermarja e punetoreve nr. 2	**338,529,336**	1%	338,488,774	40,562
1016130	INUK (3535)	**318,982,048**	1%	0	318,982,048
2109014	Nd-ja Mirembajtja Rruga	**313,403,626**	1%	220,673,975	92,729,651
2146001	Bashkia Vlore (3737)	**300,634,247**	1%	0	300,634,247
2109001	Bashkia Elbasan (0808)	**280,894,836**	1%	112,570,196	168,324,640
1017051	Reparti Ushtarak Nr.4300 Tirane (3535)	**273,104,744**	1.0%	28,132,740	244,972,004
2129001	Bashkia Lushnje (0922)	**271,542,058**	1.0%	112,690,804	158,851,254
2168001	Bashkia Maliq (1515)	**268,983,531**	1.0%	160,003,677	108,979,854
2118001	Bashkia Kavaja (3513)	**268,289,993**	1.0%	57,531,679	210,758,314
2166001	Bashkia Kamez (3535)	**248,680,137**	0.9%	0	248,680,137
2101146	Nd-ja Punetore Nr.1 (3535)	**221,189,727**	0.8%	212,066,895	9,122,832
1006001	Aparati i MIE	**219,786,573**	0.8%	154,371,883	65,414,690
2133001	Bashkia Rreshen (2026)	**218,767,848**	0.8%	119,920,601	98,847,247
2130001	Bashkia Koplik (3323)	**183,923,132**	0.7%	0	183,923,132
2157001	Bashkia Vau Dejes (3333)	**176,561,133**	0.6%	96,579,674	79,981,459
2113001	Bashkia Roskovec (0909)	**169,512,503**	0.6%	93,244,945	76,267,558
	Total Top 30	**22,227,609,690**	**80%**	**9,961,830,380**	**12,265,779,310**
	Institucione të tjera	***5,589,680,378***	***20%***	***2,350,217,989***	***3,239,462,389***
	TOTAL	**27,817,290,068**		**12,312,048,370**	**15,505,241,699**

Referuar manualit të cituar më lart, në momentin që një faturë e prapambetur autorizohet për t'u paguar nga NA (pas alokimit të fondeve buxhetore), me dërgimin e dokumentacionit në Thesar, veprimi i parë i rregjistruar në llogarinë 4864 stornohet, fatura rregjistrohet për herë të parë si si transaksion shpenzimi dhe më pas paguhet.

Vetëm nga këto të dhën është e qartë se krijimi i faturave të prapambetura është një fenomen në rritje si pasojë e thyerjeve në vazhdimësi e procedurave miratuese

të angazhimeve buxhetore dhe mungesës së kontrolleve dhe masave në rregjistrimin e dokumentave dhe transaksione përkatëse, shtejlluar më hollësisht në këtë raport auditimi.

Gjithashtu, nisur nga problematika e konstatuar në auditimin e kaluar, mbi faturat që realisht ishin të viteve të mëparshme por të rregjistruara me data furnitori për vitin 2018, u shqyrtuan përshkrimet e faturave për investime ku <u>përsëri rezultuan fatura të vitit 2017 të rregjistruar si fatura të vitit 2018. Për më tepër, gjatë këtij verifikimi një tjetër fenomen u konstatua në lidhje me deklarimin dhe faturimin e shpenzimeve të kryera: ai i faturimit të situacioneve të vitit 2017 në vitin 2018</u>. Shpesh në përshkrime gjejmë të cituar dhe datën e akt-kolaudimit apo marrjes në dorëzim e vitit 2017, duke konfirmuar kështu përfundimin e punimeve në 2017 por të pafaturuar në momentin e konstatimit në përputhje me Udhëzimet e MFE, si në shëmbujt e paraqitur në vijim:

Nr.FATURES	PERSHKRIMI FATURES	INSTITUCIONIT	Projekti	SHUMA	Dt.Furnitorit
239232600120 18	lik fat nr 458 dt31.01.2018,493 dt 18.04.2018,488 dt 31.03.2018 kontrat nr 2126 dt 21.07.2017 up nr 14 dt 22.05.2017 **situacioni nr 2 dt 21.07.2017**	Bashkia Finiq (3704)	M991543	72,347,000	18-APR-18
329211600120 18	2116001 BASHKIA LIBOHOVE .Rikualifikim i qendres urbane te qytetit Libohove,fatura nr.94,dt.27.11.2018,seria 47240604 **Situacion perfundimtar kontrate punimesh dt.08.08.2017** aktkolaud dt 27.06.2018 Çertifik marrje perkoh ne dorez 09.07.2018	Bashkia Libohove	M991495	67,484,491	27-NOV-18
131215700120 18	Bashkia Vaudejes rik i qendres se qytetit F 1 kon nr 39/10 dt 20.07.17 vazhdim sit nr 3 **+ft nr 7235 seri 59592753 dt 16.11.17, akt kol +pcv dt 15.12.2017**, shkrese nr 15973 dt 09.11.2017, shkrese MFE nr 5684/2 dt 05.04.2018	Bashkia Vau Dejes (3333)	M991521	57,597,647	11-APR-18

Lista e plotë e 86 rasteve të konstatuara paraqitet në Aneksin 7 të këtij raporti nga të cilat disa prej tyre paraqiten në vijim. Duke marrë në konsideratë këto raste si raste të munguara në raportimin e detyrimeve të prapambetura për shkak të faturimit të mëvonshëm balanca e raportuar do të shtohej me shumën 884,644,201 lekë.

<u>Në kushtet kur</u> balanca në fund të vitit 2018 në krahasim me fund-vitin 2017 është ulur me vetëm 1.32 miliard lekë ose 8% ndërkohë që:

- më datën 31.12.2017 presupozohet se të gjitha njësitë kanë raportuar pranë Degëve të Thesarit, faturat e mbërritura për punime dhe shërbime të kryera por për të cilat nuk ka fonde disponibël,
- raportohen pagesa të kryera përgjatë gjithë vitit 2018 në shumën **12.26 miliardë** nga të cilat **7.5 miliard për investime**,

Atëherë balanca më 31.12.2018 do të ishte 4.55 miliard lekë.

<u>Në fakt</u>, nga auditimi rezultojnë:

- **19.8 miliardë** lekë pagesa gjatë vitit 2018 për detyrime të viteve 2001-2017, nga të cilat **13,7 miliard për investime** (llog 230+231) ose **6.2 miliardë lekë pagesa më shumë** se shifra e raportuar nga MFE.
- Punime të pafaturuara në vitin përkatës duke u paraqitur si detyrime të vitit korrent me rreth **0.88 miliard lekë** (për sa konstatuar nga audituesi).

Kjo con në konkluzionin se në Degët e thesarit kanë vazhduar të vijnë fatura të prapambetura të padeklaruara më parë nëpërmjet skemës parashikuar në Udhëzimin n**r**.5 datë 27/02/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", procedurë që do të rriste balancën fillestare për vitin 2018 me rreth **7 miliardë lekë**.

Situata 2	Gjithashtu stoku i stoku i detyrimeve të prapambetura është rritur edhe për shkak të angazhimeve të ndërmarra gjatë vitit 2018 në shkelje të procedurave ligjore. Kështu vetëm në 5 mujorin e I-rë të vitit 2019 rezultojnë 12860 fatura që datojnë viti 2018 në shumën 11.7 miliard lekë nga të cilat **9.2 miliard** lekë janë fatura për shpenzime për investime (llog.230+231) si dhe **2.46 miliard** lekë pagesa për shpenzime gjyqësore për largime nga puna. ***Mbi mënyrën e kontabilizimit dhe mos raportimit në treguesit fiskal të detyrimeve të prapambetura*** Mënyra e kontabilizimit të stokut të faturave të prapambetura si "*shpenzime të periudhave të ardhshme"* vazhdon të jetë e njëjtë sin ë vitin 2017 e cila në gjykimin e grupit të auditimit është e gabuar dhe në kundërshtim me ligjin e zbatimit të buxhetit dhe standardeve të kontabilitetit dhe me parimin e njohjes së shpenzimit në momentin e ndodhjes sipas Udhëzimit nr. 8 dt 9.3.2018 pika 36[11] sipas të cilit shpenzimi njihet në momentin e ndodhjes/kryerjes. Kjo me impakt, deformim të pasqyrave financiare dhe treguesve fiskal: zëri shpenzime dhe rrjedhimisht deficitit buxhetor. Llogaria e zgjedhur për kontabilizimin e faturave është një llogari aktive dhe duhet të preket për shpenzime të parapaguara dhe që i përkasin periudhave të ardhshme. Pavarësisht se këto shpenzime janë kryer me ose pa fonde buxhetore përveç mungesës së masave për parandalimin e kryerjes së këtyre shpenzime pa fonde disponibël, fenomen që mbetet tepër problematic dhe i përhapur edhe gjatë vitit 2018, MFE me arsyetimin që "*të paktën të kemi informacion mbi stokun e faturave të prapambetura*" ka zgjedhur një kontabilizim që denatyron zërin e zgjedhur të bilancit. Për më tej, kjo mënyrë kontabilizimi duke mos prekur klasën e duhur të shpenzimeve apo investimeve, bën që stoku i detyrimeve të prapambetura apo borxhi ndaj palëve të treta i krijuar nga anazhime të pabuxhetura apo parashikuara në PBA, nuk raportohet në treguesit e konsoliduar fiskal me arsyetimin që "*ligji lejon njohjen, rregjistrimin dhe pagesën vetëm të faturave për të cilat ka fonde disponibël*". Në këto kushte, nisur edhe nga fakti që nuk është bërë asnjë ndryshim në procedurën e deklarimit të faturave të prapambetura, pa asnjë masë nga NPA dorëzimin me vonesë të kontratave dhe fatura shkak për rritjen e këtij stoku, nuk mund të japim siguri se stoku i fatura të prapambetura të mbetura pa paguar më 31.12.2018 është i saktë dhe i plotë. **Në konkluzion detyrimet ndaj furnitorëve mbeten një "burim financimi" i paraportuar.**
Kriteri:	*Udhëzimi nr.2 dt.6.2.2012, pika 20 dhe 54; Udhëzimi plotësues nr.2 dt.19.1.2018 për zbatimin e buxhetit të vitit 2018; Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ;* *Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.*

[11]Udhëzimi nr. 8 dt. 9.3.2018 ", Për Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme", pika 36 paragrafi 2*:"Detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare. Në këtë rast, duhet të mbahet nën kontroll evidentimi joreal i detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".*

	Ligji nr 109/2017 date 19.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017". *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimi nr.39 datë 24.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018".* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzim nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura* *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, I ndryshuar, neni 4 pika 1* *VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore"* *Udhëzim i Posacëm nr.24 dt.29.12.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"* *Udhëzimi plotësues nr.1 dt.19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018;pika 7* *Akti Normative 1 dt.26.07.2018; Akt Normativ nr.2 dt.19.12.2018;* *Urdhërit nr.62 date 31.08.2010 "Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit"* *Udhëzimin nr.9/1 dt.19.01.2018, pjesa III "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", pika 15.1*
Impakti:	Mos raportim i detyrimeve ndaj të tretëve sipas parimeve të kontabilitetit dhe si një burim financimi I shpenzimeve për investime
Shkaku:	Mosveprim i strukturave të MFE për rishikim të udhëzimit të nxjerrë për rregjistrimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura
Rëndësia	E lartë

Për sa më sipër mban përgjegjësi NA/NZ e institucioneve të konstatuara në shkelje në këtë gjetje, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L Sj, Drejtoria e Operacioneve me drejtor znj.M P dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Mbi zbatimin e afateve dhe proçedurave të aprovimit të faturave nga njësia shpenzuese dhe dërgimit në thesar brenda 30 ditëve nga data e marrjes së faturës nga furnitori.

Referuar, Ligjit Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) *parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për proçedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për proçedurat e miratimit dhe proçesimit të pagesës në degën e thesarit.* Nga auditimi i të

dhënave të transaksioneve të proçesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të këtyre afateve si nga ana e njësive shpenzuese ashtu edhe nga degët e thesarit. Këto tejkalime afatesh janë paraqitur në tabelën në vijim:

Nga auditimi u konstatuan 33,031 raste në total me vlerë 44,279,986,783 lekë, të faturave të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor. Në këtë numër rastesh u përjashtuan rastet e Ministrisë së Shëndetësisë, për të cilën i referohemi *Neni 8 i Ligjit 48/2014 '**Zgjatja e afateve për autoritet publike'** Afatet e parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, nuk zbatohen për sa i përket pagesave të vonuara për veprimet juridike tregtare, të kryera me autoritete publike që ofrojnë shërbime në fushën e kujdesit shëndetësor. Në këto raste afatet nuk mund të jenë më të gjata se një vit kalendarik, duke filluar nga data kur ka lindur e drejta për të kërkuar kryerjen e pagesës për shitjen e mallrave apo dhënien e shërbimeve.* Nga analiza me vizualizim i shkeljes për mosrespektim të afateve vërehet se ky fenomen është më i perhapur në Institucionet vendore me një numër prej **11,195** fatura në vlerën **18,714,991,142** lekë. Më poshtë paraqitet shpërndarja e transaksioneve të regjistruara nga institucionet mbi 30 ditë vonesë nga data e faturës fizike.

Emri i Institucionit	Nr. Faturave	Vlera e faturave në lek
Njësitë e vetqeverisjes vendore	11,195	**18,714,991,142**
Autoriteti Rrugor Shqiptar	540	**5,652,658,593**
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit	588	**1,549,021,404**
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	139	**3,638,671,154**
Aparati Ministrise se Financave dhe Ekonomise	178	**788,625,666**
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise	191	**387,681,871**
Aparati Drejt.Pergj.Tatimeve	305	**293,328,339**
Aparati Drejt.Pergj.Doganave	171	**204,319,672**
Aparati i Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise	190	**189,408,610**
Aparati i Ministrise se Kultures	108	**111,306,335**
Aparati Ministrise se Drejtesise	263	**243,567,746**
Aparati i Ministrise se Brendshme	200	**116,694,301**
Aparati i Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit	132	**171,925,399**
Aparati i Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit	144	**114,345,153**
Presidenca	279	**37,178,133**
Kuvendi Popullor	161	**41,723,019**
Aparati Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	52	**29,746,878**
Aparati i Ministrise për Evropën dhe Punët e Jashtme	439	**78,227,642**
Aparati i Ministrise se Mbrojtjes	278	**77,745,610**
Aparati Qendror i SHIKUT	100	**10,057,414**
Aparati Drejt.Pergj.RTSH	4	**27,828,825**
Aparati i Akademise	23	**683,553**
Aparati prokurorise se pergjitheshme	32	**9,657,784**
Aparati Qendror INSTAT	59	**8,652,120**
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	23	**8,395,033**
Institucione të tjera	17,237	**11,773,545,387**
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale *	678	**455,479,097**
Total me Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	*33,709*	***44,735,465,880***
Total pa Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	*33,031*	***44,279,986,783***

Në rang njësie ekonomike top 20 njësitë me rastet më të larta të dërgimit të faturave në Thesar rezultojnë njësitë si më poshtë:

Nr	*Emri i Institucionit*	*Nr. i rasteve në shkelje të afatit 30 ditor*	*Shuma*

1	Bashkia Tirana (3535)	2,112	7,651,798,236
2	[12]Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	678	455,479,097
3	Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit (3535)	588	1,549,021,404
4	Bashkia Kruje (0716)	557	341,447,230
5	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	540	5,652,658,593
6	Drejtoria e Ndihmes Juridike Falas	531	15,687,674
7	Sanatoriumi Tirane (3535)	516	211,058,469
8	Bashkia Lac (2019)	478	92,029,463
9	Aparati i Ministrise për Evropën dhe Punët e Jashtme	439	78,227,642
10	Bashkia Peqin (0827)	384	80,218,279
11	Spitali Elbasan (0808)	363	116,658,141
12	Bashkia Ballsh (0924)	359	193,010,052
13	Bashkia Kavaja (3513)	344	313,448,306
14	Spitali Fier (0909)	331	118,215,284
15	Bashkia Kamez (3535)	315	744,565,658
16	Aparati Drejt.Pergj.Tatimeve (3535)	305	293,328,339
17	Spitali Universitar i Traumes (3535)	304	163,238,629
18	Presidenca (3535)	279	37,178,133
19	Aparati i Ministrise se Mbrojtjes (3535)	278	77,745,610
20	Spitali Gjirokaster (1111)	274	70,242,319

Gjetje:	**Nga auditimi u konstatuan 33,031 raste në total me vlerë 44,2 miliard lekë, të faturave të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor**
Situata:	Referuar, Ligjit Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) *parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për proçedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për proçedurat e miratimit dhe proçesimit të pagesës në degën e thesarit.* Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të proçesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të këtyre afateve si nga ana e njësive shpenzuese ashtu edhe nga Degët e Thesarit. Këto tejkalime afatesh janë paraqitur në tabelën në vijim: **Nga auditimi u konstatuan 33,031 raste në total me vlerë 44,279,986,783 lekë, të faturave të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor. Në këtë numër rastesh** u përjashtuan rastet e Ministrisë së Shëndetësisë, për të cilën i referohemi *Neni 8 i Ligjit 48/2014 '**Zgjatja e afateve për autoritet publike'** Afatet e parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, nuk zbatohen për sa i përket pagesave të vonuara për veprimet juridike tregtare, të kryera me autoritete publike që ofrojnë shërbime në fushën e kujdesit shëndetësor. Në këto raste afatet nuk mund të jenë më të gjata se një vit kalendarik, duke filluar nga data kur ka lindur e drejta për të kërkuar kryerjen e pagesës për shitjen e mallrave apo dhënien e shërbimeve.* Nga analiza me vizualizim i shkeljes për mosrespektim të afateve vërehet se ky

[12] *Neni 8 i Ligjit 48/2014 '**Zgjatja e afateve për autoritet publike'** Afatet e parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, nuk zbatohen për sa i përket pagesave të vonuara për veprimet juridike tregtare, të kryera me autoritete publike që ofrojnë shërbime në fushën e kujdesit shëndetësor. Në këto raste afatet nuk mund të jenë më të gjata se një vit kalendarik, duke filluar nga data kur ka lindur e drejta për të kërkuar kryerjen e pagesës për shitjen e mallrave apo dhënien e shërbimeve.*

	fenomen është më i perhapur në Institucionet vendore me një numër prej **11,195** fatura në vlerën **18,714,991,142** lekë.
Kriteri:	*Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Udhëzimi i përhershëm Nr.2 Datë 06. 02. 2012"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit".* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166: Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve të llogarisë së unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë dhe pika 167: "Me pas, struktura përgjegjëse për thesarin vijon me procedurën e grupimit të kërkesave për pagesë sipas rregullit të rregjistrimit kronologjik të urdhër-shpenzimeve në sistemin informatik financiar (hyrje e parë - dalje e parë)".*
Impakti:	Rritja e stokut të detyrimeve të prapambetura .
Rëndësia:	E lartë.

Sipas **Obsevacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega e Thesarit Tiranë** me Nr 5237/1 Prot., datë 26/08/2019, ku pretendohen se: *Për urdhër-shpenzimet ku fatura tatimore është paraqitur në Degen e Thesarit Tiranë mbi 30 ditë, është dërguar shkresë MFE (Bashke lidhur do të keni shkresat e dërguara nga Dega e Thesarit Tirane). Në konstatimin tuaj, theksohet që fenomeni i dërgimit në Thesar i faturave tatimore mbi 30 ditë, është më i përhapur të pushteti vendor,(pushteti vendor ka pasur kufizim në fund të vitit 2017) po ju dërgoj shkresën e MFE nr 15973 datë 9.11.2017' Mbi limitin e përdorimit të cash-it për njesitë e veteqeverisjes vendore' ,shkresa e MFE nr 13433 datë 02.10.2017 ' mbi projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve'.*

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve, bazës ligjore dhe dokumentave justifikues të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Pranohet pjesërisht pjesa e parë e observacionit ku ju i keni dërguar shkresa NPA-ve, në lidhje me rastet e vonesave dhe shkeljeve të afateve ligjore 30 ditë nga ana e njësive shpenzuese për dorëzimin në degët e thesarit të faturave që nga momenti i marrjes së tyre nga furnitorët, ***por numri i shkresave të dërguara prej jush është relativisht i vogël krahasuar me numrin total të rasteve me vonesë të konstatura nga grupi i audituesve.*** Për shak të veprimeve dhe mosveprimeve të NA dhe NZ të njësive shpenzuese të

cilat kanë sjellë vonesa mbi 30 ditë në dorëzimin e faturave pranë degëve të thesarit duke shkelur ligjin Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) *parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për proçedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për proçedurat e miratimit dhe proçesimit të pagesës në degën e thesarit,* do të mbajnë përgjegjësi, kurse NPA-të e Ministrive përkatëse do të mbajnë përgjegjësi për mos zbatimin e Udhëzimit Plotësues nr. 3, datë 17.01.2014, pika 32 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014" si më poshtë cituar: *"Kontratat e lidhura nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të paraqiten dhe të proçedohen në degët e thesarit të rrethit sipas kërkesave të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Në rast vonese, dega e thesarit proçedon me regjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë Nëpunësin e Parë Autorizues, i cili ndërmerr masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për paraqitjen me vonesë në degën e Thesarit të dokumenteve që vërtetojnë shpenzimet e kryera"*.
Kurse pjesa e dytë e observacionit në të cilën na janë paraqitur 2 shkresa. *shkresa e MFE nr 15973 datë 9.11.2017' Mbi limitin e përdorimit të cash-it për njesitë e veteqeverisjes vendore' ,shkresa e MFE nr 13433 datë 02.10.2017 ' mbi projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve',* për të justifikuar situatën dhe numrin e madh të faturave me mbi 30 ditë vonesë që grupi i auditimit ka konstatuar në lidhje me njësitë e qeverrisjes vendore. Kjo pjesë observacionit nuk pranohet sepse në faturat me vonesë të evidentuara nuk kemi vetëm fatura me datë emetimi/furnitori muajit nëntor-dhjetor, për të cilët u janë referuar shkresat e mësipërme dhe të mund të justifikoheshin vonesat mbi 30 ditë, por ato kanë shtrirje dhe përhapje në të gjithë muajt e vitit, duke e bërë fenomemin material dhe të përhapur, pavarësisht shkresave të dërguara prej jush për të justifikuar.

Për sa më sipër mban përgjegjësi NA/NZ e institucioneve të konstatuara në shkelje në këtë gjetje, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S, Drejtoria e Operacioneve me drejtor znj.MP dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të paashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Mbi zbatimin e afateve të likujdimit të faturave nga Degët e Thesarit brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të urdhër-blerjes nga njësia ekonomike.

Referuar, Ligjit Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për proçedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për proçedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit. Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të proçesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të këtyre afateve edhe nga Degët e Thesarit. Nga një total prej ***402,736*** pagesa të regjistruara gjatë vitit 2018 rezultojnë ***341 raste*** me vlerë ***465,274,968 lekë*** me tejkalim të afatit 30 ditor të kryerjes së pagesës nga momenti i regjistrimit në sistemin e thesarit. Këto tejkalime afatesh janë paraqitur në tabelën në vijim:

Dega e Thesarit	**Nr. Faturave paguar mbi 30 dite**	**Shuma**
Tirane	175	394,297,377
Gjirokaster	22	31,404,904
Lezhe	33	10,821,113

Vlore	52	7,565,751
Elbasan	4	6,383,941
Shkoder	6	3,982,313
Kukes	2	3,612,000
Sarande	12	2,787,597
Berat	8	1,998,427
Pogradec	18	1,471,277
Lushnje	3	320,382
Kruje	1	260,114
Peqin	1	249,900
Has	2	78,492
Fier	1	37,380
Durres	1	4,000
Total	**341**	**465,274,968**

Dega e Thesarit Tiranë dhe Vlorë përbëjnë 67% të totalit të shkeljeve me përkatësisht 175 dhe 52 raste nga 341 gjithsej të identifikuara. Në krahasim me vitin 2017 ku nga auditimi rezultoi që nga një total prej **375,665** pagesa të regjistruara dhe paguara gjatë vitit 2017 ku rezultuan **393 raste** me vlerë **514,616 mijë lekë** me tejkalim të afatit 30 ditor të kryerjes së pagesës nga momenti i regjistrimit në sistemin e thesarit dhe ku Dega e Thesarit Tiranë përsëri ishte një nga degët me numrin më të lartë të rasteve me vonesë.

Gjetje:	**Nga auditimi u konstatuan 341 raste të faturave të paguara jashtë afatit 30 ditor me vlerë 0.465 miliardë lekë.**
Situata:	Referuar, Ligjit Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit. Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të proçesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të këtyre afateve edhe nga Degët e Thesarit. Nga një total prej ***402,736*** pagesa të regjistruara gjatë vitit 2018 rezultojnë ***341 raste*** me vlerë ***465,274,968 lekë*** me tejkalim të afatit 30 ditor të kryerjes së pagesës nga momenti i regjistrimit në sistemin e thesarit. Dega e Thesarit Tiranë dhe Vlorë përbëjnë 67% të totalit të shkeljeve me përkatësisht 175 dhe 52 raste nga 341 gjithsej të identifikuara. Në krahasim me vitin 2017 ku nga auditimi rezultoi që nga një total prej **375,665** pagesa të regjistruara dhe paguara gjatë vitit 2017 ku rezultuan **393 raste** me vlerë **514,616 mijë lekë** me tejkalim të afatit 30 ditor të kryerjes së pagesës nga momenti i regjistrimit në sistemin e thesarit dhe ku Dega e Thesarit Tiranë përsëri ishte një nga Degët me numrin më të lartë të rasteve me vonesë.
Kriteri:	*Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit*

	të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166, 167.*
Rëndësia:	E lartë.

Sipas Obsevacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega e Thesarit Tiranë me Nr 5237/1 Prot., datë 26/08/2019, ku pretendohen se: -*Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Dega e Thesarit Tirane ka rregjistruar në SIFQ Urdhër-shpenzime të miratuara nga NA dhe NZ, kundrejt planit vjetor të buxhetit, pavarësisht se nuk ka patur plan thesari (limit mujor) të mjaftueshëm, me qëllim evidentimin/monitorimin e detyrimeve të prapambetura. Ky rregjistrim në SIFQ vetëm me kontroll në planin e buxhetit, sjell tejkalimin e afatit të likujdimit 30 ditor nga data e rregjistrimit të pagesave.* -*Në zbatim të udhëzimit Nr 2 datë 06.02.2012 'Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit' pika 128, është përgjegjës njesia shpenzuese për planifikimin e planit të arkes në nivel mujor .* -*Gjithashtu ju sqaroj se të gjitha urdhër-shpenzimet e paraqitura nga njësite shpenzuese në Degën e Thesarit Tirane, rregjistrohen në SIFQ dhe miratohen brënda ditës të depozituara.*

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Observacioni nuk pranohet, sepse përgjigja juaj nuk është e argumentuar me fakte, dokumenta justifikues dhe bazë ligjore për të replikuar konstatimin e grupit të auditimit, që është "***Mos zbatimin e afateve të likujdimit të faturave nga Degët e Thesarit brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të urdhër-blerjes nga njësia ekonomike",*** por thjesht është bërë një përshkrimi i shkaqeve që kanë sjellë pasojave që janë konstatuar nga grupi i auditimit, që janë vonesa mbi 30 ditë të faturave nga ana e degëve të thesarit.

Tek citimi i **pikës 128** "Për efekt të ndjekjes së buxhetit vjetor në funksion të menaxhimit të likuiditeteve të qeverisë, nëpunësi zbatues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme ***harton*** *planin e arkës në nivel mujor për njësinë e qeverisjes së përgjithshme dhe të detajuar në nivel njësie shpenzuese",* fillimisht ai vetëm e harton planin e arkës, i cili kalon proçedurat sipas ***Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 "Për Proçedurat Standarde Të Zbatimit Të Buxhetit" i ndryshuar***, ***Pika 131.*** Projekti i parë i planit të arkës depozitohet nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes qëndrore tek nëpunësi i parë autorizues, së bashku me projektbuxhetin vjetor, dhe ***diskutohet paraprakisht me strukturën qëndrore përgjegjëse për thesarin.***

Pika 135. Struktura përgjegjëse për thesarin kontrollon: a. përputhshmërinë e totalit të planit të arkës me buxhetin vjetor ë njësisë publike respektive; b. ***kryen krahasime me parashikimet e vetë sistemit të thesarit për pagesat dhe arkëtimet e qeverisjes së përgjithshme dhe kryen miratimin paraprak;***

c. pas miratimit përfundimtar nga nëpunësi i parë autorizues, i rregjistron dhe i bën të vlefshme për zbatim në sistemin informatik financiar të qeverisë; d. njofton nëpunësin autorizues të njësisë respektive për miratimin e planit të arkës. ***Pika 136. Plani i arkës i propozuar nga thesari*** dhe miratuar nga

nëpunësi i parë autorizues, përbën kufirin maksimal mujor për shpenzim për çdo njësi shpenzuese të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, me marrjen e njoftimit nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, organizon proçesin e brendshëm në njësi për regjistrimin e planit të arkës në kontabilitetin e çdo njësie shpenzuese në përbërje të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. *Nuk është vetëm përgjegjësia e njësisë shpenzuese për planifikimin e planit të arkes në nivel mujor të pamjaftueshëm për të përballuar shpenzimet faktike por edhe e juaj sipas përcaktimeve të ligjit të sipër përmendur.*

Për sa më sipër mban përgjegjësi, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me drejtor z.L S, Drejtoria e Operacioneve me drejtor znj.M P dhe Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P, për mosmarrje të masave administrative të parashikuara në ligj për përmirësimin e situatës.

Lidhur me masat administrative në zbatim të Nenit 71 të Ligjit nr.9936 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në Udhëzimin Plotësues nr. 3, datë 17.01.2014, pika 32 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014" si më poshtë cituar:*"Kontratat e lidhura nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të paraqiten dhe të proçedohen në degët e thesarit të rrethit sipas kërkesave të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Në rast vonese, dega e thesarit proçedon me regjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë Nëpunësin e Parë Autorizues, i cili ndërmerr masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për paraqitjen me vonesë në degën e Thesarit të dokumenteve që vërtetojnë shpenzimet e kryera",* për rastet e institucioneve të cilat konstatohen në shkelje të: afatit 5 ditor të rregjistrimit të kontratës nga data e shpalljes së fituesit si dhe të afateve të dorëzimit të faturave brenda afatit 30 ditor, Degët e Thesarit njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme e cila më pas përpilon një shkresë drejtuar institucionit përgjegjës për tërheqje vëmëndje të parregullsisë dhe shkeljes së konstatuar duke cituar dhe bazën ligjore të saj, shkresë kjo e firmosur nga Nëpunësi i Parë Autorizues. DPTH vuri në dispozicion një evidencë të rasteve të njoftuara nga Degët e Thesarit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit e cila përmban emrin e institucionit dhe numrin e rasteve, por jo vlera të kontratave apo dhe ndonjë analizë të rasteve dhe institucioneve tipike në shkelje kuadrit ligjor. Gjithashtu u kërkuan dhe u vunë në dispozicion kopje të shkresave të dërguara ku rezulton se ato janë tepër formale pa cituar numrin e kontratës, datën apo vlerën e saj, por vetëm një përshkrim tepër të shkurtër të projektit për të cilin është lidhur kontrata. Gjithashtu, në asnjë rast nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë për institucionet me raste përsëritje apo me kontrata me vlera të mëdha dhe impakt të konsiderueshëm në raportimin e buxhetit faktit dhe menaxhimit të likuiditetit. Shtuar kjo dhe në listën e mungesave të kontrolleve në SIFQ dhe gjurmë auditimi të cituara sa më lartë, i bën këto shkresa formale dhe inefiçente si proçes për sektorin që i përpilon duke neglizhuar faktin se mosrespektimi i afateve ndikon në sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për kryerjen e pagesave përkatëse, krijon detyrime për të cilat do të paguhen kamatëvonesa në zbatim të ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare".Në vijim është një përmbledhje e numrit të rasteve të shkeljeve për të cilat institucioneve përgjegjëse iu është tërhequr vëmëndja për parregullsinë e konstatuara:

Institucioni	***Fatura mbi 30 ditë***		***Kontrata mbi 3 ditë***	
	V.2017	***V.2018***	***V.2017***	***V.2018***
Ministritë e linjës	31	99	22	39
Njësitë e vetëqeverisjes Vendore	132	177	55	52
ARRSH	1	2	1	0

DP Dogana	0	5	0	2
DP Tatimeve	1	2	0	0
DP Burgjeve	0	1	0	0
INSTAT	1	0	0	0
Dr. Punësimit dhe Aftësimit Profesional	0	9	0	5
Prokuroria e Përgjithsme	4	3	0	0
SHISH	1	0	0	0
Zyra.Adm Shërbimit Gjyqësor	2	6	4	3
Institucione të tjera	0	16	0	10
Totali	173	320	82	111

Institucioni	***Fatura mbi 30 ditë***	***Kontrata mbi 3 ditë***
	V.2019 (J-SH)	***V.2019 (J-SH)***
Ministritë e linjës	23	4
Njësitë e vetëqeverisjes Vendore	18	9
ARRSH	0	0
DP Dogana	0	0
DP Tatimeve	0	0
DP Burgjeve	2	0
INSTAT	0	0
Dr. Punësimit dhe Aftësimit Profesional	1	0
Prokuroria e Përgjithsme	0	0
SHISH	0	0
Zyra.Adm Shërbimit Gjyqësor	0	0
Institucione të tjera	2	0
Totali	46	13

Numri i rasteve të raportuara nga DPTH për evidentimin e problemit me qëllim marrjen e masave disiplinore dhe administrative nga NPA, është **tepër minimal** nëse i referohemi impaktit që kanë ***33,031*** raste të vonesave të faturave dhe ***20,264*** raste të kontratave të regjistruara me vonesë. Si dy tregues të matjes së performancës së njësive publike dhe përgjegjësive që rrjedhin për Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për monitorimin e indikatorëve të performancës, të miratuara me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.89 dt. 28.12.2015, KLSH konstaton se nuk raportohen informacione mbi asnjë masë të marrë kundrejt NA-ve të institucioneve që pengojnë dërgimin e faturave në thesar dhe nuk zbatojnë afatet e regjistrimit të kontratave të angazhimeve brenda afatit ligjor. Shkresat pasi dërgohen nuk monitorohen dhe për më tepër kjo detyrë konsiderohet si kompetencë dhe përgjegjësi e Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik14. Neni 71, gërma (f dhe gj) e Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, parashikon **gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 1 deri në 3 paga mujore (për regjistrimin me vonesë të kontratave) dhe 3 deri 7 paga për moszbatim të afateve të dorëzimit të urdhër-shpenzimit. Kështu, gjoba të përllogaritura për çdo vonesë në dorëzim të faturës në Thesar vlerësohet të ishin minimalisht rreth 9.9 miliardë lekë (*33,031 *100,000 leke*3 paga*) (9,909,300,000 lek).**

Për veprimet dhe mosveprimet për sa konstatuar më sipër në zbatim të Ligjit nr.9936 dt.26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"neni 71 i tij. mban përgjegjësi Nëpunësi i Parë Autorizues znj. G P .

Gjetje:	**Mosmarrja e masave administrative, të vlerësuara nga KLSH në të paktën 9.9 miliardë lekë, nga NPA për shklejet e ligjit në menaxhimin e sistemit buxhetor dhe akteve ligjore për parandalimin e detyrimeve të prapambetura, kur jemi në situatën ku konstatohen vetëm 320 shkresa "tërheqje vëmendje" të dërguara nga NPA kundrejt 33,031 raste të faturave të dorëzuara me vonesë.**
Situata:	Për rastet e institucioneve të cilat konstatohen në shkelje të: afatit 5 ditor të rregjistrimit të kontratës nga data e shpalljes së fituesit si dhe të afateve të dorëzimit të faturave brenda afatit 30 ditor, Degët e Thesarit njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme e cila më pas përpilon një shkresë drejtuar institucionit përgjegjës për tërheqje vëmëndje të parregullsisë dhe shkeljes së konstatuar duke cituar dhe bazën ligjore të saj, shkresë kjo e firmosur nga Nëpunësi i Parë Autorizues. DPTH vuri në dispozicion një evidencë të rasteve të njoftuara nga Degët e Thesarit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit e cila përmban emrin e institucionit dhe numrin e rasteve, por jo vlera të kontratave apo dhe ndonjë analizë të rasteve dhe institucioneve tipike në shkelje kuadrit ligjor. Gjithashtu u kërkuan dhe u vunë në dispozicion kopje të shkresave të dërguara ku rezulton se ato janë tepër formale pa cituar numrin e kontratës, datën apo vlerën e saj, por vetëm një përshkrim tepër të shkurtër të projektit për të cilin është lidhur kontrata. Gjithashtu, në asnjë rast nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë për institucionet me raste përsëritje apo me kontrata me vlera të mëdha dhe impakt të konsiderueshëm në raportimin e buxhetit faktit dhe menaxhimit të likuiditetit. Shtuar kjo dhe në listën e mungesave të kontrolleve në SIFQ dhe gjurmë auditimi të cituara sa më lartë, i bën këto shkresa formale dhe inefiçente si proçes për sektorin që i përpilon duke neglizhuar faktin se mosrespektimi i afateve ndikon në sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për kryerjen e pagesave përkatëse, krijon detyrime për të cilat do të paguhen kamatëvonesa në zbatim të ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare". Numri i rasteve të raportuara nga DPTH për evidentimin e problemit me qëllim marrjen e masave disiplinore dhe administrative nga NPA, është **tepër minimal** nëse i referohemi impaktit që kanë ***33,031*** raste të vonesave të faturave dhe ***20,264*** raste të kontratave të regjistruara me vonesë. Si dy tregues të matjes së performancës së njësive publike dhe përgjegjësive që rrjedhin për Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për monitorimin e indikatorëve të performancës, të miratuara me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.89 dt. 28.12.2015, KLSH konstaton se nuk raportohen informacione mbi asnjë masë të marrë kundrejt NA-ve të institucioneve që pengojnë dërgimin e faturave në thesar dhe nuk zbatojnë afatet e regjistrimit të kontratave të angazhimeve brenda afatit ligjor. Shkresat pasi dërgohen nuk monitorohen dhe për më tepër kjo detyrë konsiderohet si kompetencë dhe përgjegjësi e Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik14. Neni 71, gërma (f dhe gj) e Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, parashikon gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 1 deri në 3 paga mujore (për regjistrimin me vonesë të

	kontratave) dhe 3 deri 7 paga për moszbatim të afateve të dorëzimit të urdhër-shpenzimit. Kështu, gjoba të përllogaritura për çdo vonesë në dorëzim të faturës në Thesar vlerësohet të ishin minimalisht rreth **9.9 miliardë lekë** (***33,031 *100,000 leke*3 paga***) (9,909,300,000 lek). Situata nuk është përmirësuar edhe mbas rekomandimeve të vjetshme të lëna nga KLSH, ndërkohë që fenomeni vazhdon të përsëritet edhe në vitin 2018 si edhe gjatë vitit vijues 2019, ku nga shkresat "tërheqje vëmëndje" për muajtë Janar-Shkurt të 2019, evidentohen se vijojnë të jenë formale, jo efektive dhe pa ndërmarrë masat që parashikohen nga ligji, duke mos pasur impaktin e duhur në rregullimin e situatës dhe frenimin e fenomenit.
Kriteri:	*Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Udhëzimi i përhershëm Nr.2 Datë 06. 02. 2012"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit".* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166, 167*
Impakti:	Moszbatim i nenit 71 të Ligjit të Buxhetit nga NPA në funksion të eleminimit të problematikave të konstatuara në mënyrë sistematike.
Rëndësia:	**E lartë.**

Pagesa të faturave në grup, në një urdhër-shpenzim dhe pagesa pjesore e faturave.

Nga analiza e faturave të ekzekutuara gjatë vitit 2018, konstatohet se janë likuiduar me një urdhër shpenzim disa fatura njëkohësisht, kur duhet që çdo faturë të regjistrohet në sistem në periudhën përkatëse, në mënyrë që shpenzimi të njihet në periudhën në të cilën ai është kryer dhe lind detyrimi. Kështu nga shqyrtimi i informacionit të rregjistruar në SIFQ në fushën "Përshkrimi", janë konstatuar 209 raste të likuidimit të disa faturave njëkohësisht në një urdhër shpenzim në vlerën 2,013 miliardë lekë**.** Në tabelën e mëposhtme evidentohen institucionet me numrin e rasteve të likuidimeve të disa faturave njëkohësisht dhe vlera e faturave të likuiduara.

Nuk ka informacion për raste në të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka identifikuar dhe tërhequr vëmëndjen për këtë parregullsi. Kjo praktikë krijon mundësinë e mosidentifikimit të qartë dhe unik të një fature/detyrimi, kohën kur ka ndodhur shpenzimi dhe nuk lejon monitorim të progresit të realizimit kontratave në mënyrë korrente. Gjithashtu kjo mund të shkaktojë keqklasifikime të llojit të shpenzimit të kryer duke prekur llogari ekonomike të gabuara.

Më poshtë paraqitet në tabelë, në mënyrë të përmbledhur situata për institucionet përkatëse:

Rastet e Pagesave të faturave në grup, në një urdhër-shpenzim		
Institucione	Vlera në lek	Numri i rasteve
Bashkia Tirana	559,944,341	30
Bashkia Maliq	67,753,523	27
Aparati Ministrise se Financave dhe Ekonomise	201,723,095	16
Aparati i Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise	46,935,827	8
Aparati Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	12,796,892	7
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise	53,184,143	6
Bashkia Erseke	3,174,720	6
Bashkia Vlore	80,782,462	6
Bashkia Kamez	50,260,220	5
Bashkia Koplik	678,072	5
Spitali Korce	53,915,472	5
Autoriteti Rrugor Shqiptar	19,208,093	4
Bashkia Librazhd	193,163,302	4
Aparati i Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit	40,957,952	3
Bashkia Kukes	95,865,615	3
Institucione të tjera	533,472,225	74
Total	**2,013,815,954**	**209**

Gjetje:	**Likuidime të faturave në grup të përfshira në një urdhër-shpenzim.**
Situata:	**Nga analiza e faturave të ekzekutuara gjatë vitit 2018, konstatohet se janë likuiduar me një urdhër shpenzim disa fatura njëkohësisht**, kur duhet që çdo faturë të regjistrohet në sistem në periudhën përkatëse, në mënyrë që shpenzimi të njihet në periudhën në të cilën ai është kryer dhe lind detyrimi. Kështu nga shqyrtimi i informacionit të rregjistruar në SIFQ në fushën "Përshkrimi", janë konstatuar 209 raste të likuidimit të disa faturave njëkohësisht në një urdhër shpenzim në vlerën 2,013 miliardë lekë**.** Nuk ka informacion për raste në të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka identifikuar dhe tërhequr vëmëndjen për këtë parregullsi. Kjo praktikë krijon mundësinë e mosidentifikimit të qartë dhe unik të një fature/detyrimi, kohën kur ka ndodhur shpenzimi dhe nuk lejon monitorim të progresit të realizimit kontratave në mënyrë korrente. Gjithashtu kjo mund të shkaktojë keqklasifikime të llojit të shpenzimit të kryer duke prekur llogari ekonomike të gabuara.
Kriteri:	*Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Udhëzimi i përhershëm Nr.2 Datë 06. 02. 2012"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit".* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të*

	pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166, 167*
Impakti:	Mos pasqyrimi detajuar i pagesave dhe periudhave që ato mbulojnë duke përfshirë fatura të datave të ndryshme.
Rëndësia:	E mesme.
Sipas Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit Tiranë me Nr 5237/1 Prot., datë 26/08/2019, ku pretendohen se: Pagesa e faturave në grupe mund të jenë kryer për shpenzime standarte (ujë, drita, telefon etj) për faturat tatimore të cilat janë me data brënda të njëjtit muaj, objekti i shpenzimeve është i njëjtë. Sistemi i rregjistrimit, është bërë me faturën me datë më të hershme. (për të pasqyruar më drejtë kohën e kalimit të pagesës).	

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: *Nga shqyrtimi i observacionit, fakteve, argumentave dhe dokumentacionit justifikues të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Duke realizuar pagesat në grup mund të shkaktohen problemet e mëposhtme: a) Mos identifikim i qartë dhe unik të faturave/detyrimit, b) Kohën kur ka ndodhur shpenzimi dhe nuk lejon monitorimin e progresit të kontratave në mënyrë korrekte dhe c) Gjithashtu kjo mund të shkaktojë keq klasifikime të llojit të shpenzimit të kryer duke prekur llogari ekonomike të gabuara. Ne observacionin tuaj na janë paraqitur në shumicën e rasteve urdhër-shpenzime të llogarisë* ***"602"*** *ndërkohë që në konstatimet tona janë paraqitur vetëm raste të llogarisë* ***"230"*** *dhe* ***"231"****, pra nuk janë sjellë fakte dhe dokumenta justifikues për të kundërshtuar konstatimet tona.*
-Do të hiqen nga konstatimi pjesa e konstatimeve tona të cilat rezultojnë e njëjta faturë.
- Do të merren parasysh pjesa e faturave të së njëtës datë por që kanë shumë artikujë për ZA rretheve, të llogarise 230 dhe 231 për të cilat keni paraqitur dokumenta justifikuese. (Ministria e Arsimit).
- Pagesat e TVSH për projektin "SARED", për të cilin ka një Urdhër Ministri, Nr.343, datë 20.08.2018 nuk do të merret parasysh sepse ka mundësi për deformim, mosregjistrimi dhe identifikimi të qartë të periudhës sëcilës i përketë secila faturë TVSH-je. Si dhe kemi faktin që këto pagesa TVSH-je prekin 2 vite buxhetore, sepse janë fatura për peiudhën nëntor 2017 deri në korrik 2018, duke e komplikuar akoma më shumë pjesën e identifikimit të periudhave përkatëse, duke i kaluar në një urdhër-shpenzim si përmbledhëse faturash.

Një tjetër fenomen i konstatuar **është rasti i pagesave pjesore** me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël dhe mbartjen e detyrimit të mbetur në vitin pasardhës. Kështu në të dhënat e pagesave nga SIFQ, është evidentuar fenomeni për institucione si: Aparati Ministrise se Financave dhe Ekonomise, Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit dhe Bashkia Tiranë, të cilat kanë akses në

SIFQ (BI Online), veprimet janë kryer ku me paraqitjen e faturës, rregjistrimi është bërë pjesorë dhe rrjedhimisht dhe pagesa me vlerë të barabartë me fondin disponibël.

Gjetje:	**Likuidime pjesore të faturave me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël dhe mbartjen e detyrimit të mbetur në vitin pasardhës.**
Situata:	**Një tjetër fenomen i konstatuar është rasti i pagesave pjesore me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël dhe mbartjen e detyrimit të mbetur në vitin pasardhës.** Kështu në të dhënat e pagesave nga SIFQ, është evidentuar fenomeni për institucione si: Aparati Ministrise se Financave dhe Ekonomise, Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit dhe Bashkia Tiranë, të cilat kanë akses në SIFQ (BI Online), veprimet janë kryer ku me paraqitjen e faturës, rregjistrimi është bërë pjesorë dhe rrjedhimisht dhe pagesa me vlerë të barabartë me fondin disponibël.
Kriteri:	*Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar* *Udhëzimi i përhershëm Nr.2 Datë 06. 02. 2012"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit".* *Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare.* *Ligji nr 109/2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018".* *Udhëzimi nr. 8 dt 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* *Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.* *Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.* *Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* *Udhëzimi nr.17 datë 23.10.2017 "Për procesin e ekzekutimit të pagesave në sistemin informatik financiar të qeverisë".* *VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar.* *Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166, 167*
Impakti:	Mosregjistrim i plotë I detyrimit të lindur dhe faturuar.
Rëndësia:	E lartë.

Sipas Obsevacionit të dërguar nga Dega e Thesarit Tiranë me Nr 5237/1 Prot., datë 26/08/2019, ku pretendohen se: Për likujdimin pjesor të faturës tatimore, ju sqaroj se nuk është në kopetence të Degës së Thesarit Tirane për të refuzuar Urdhër-shpenzimin kur institucioni bën likujdim pjesor të faturës tatimore. Dega e Thesarit Tiranë, bën kalimin e shpenzimeve, kundrejt planit që ka në dispozicion njësia shpenzuese, duke mos lejuar tejkalimin e tij.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH: *Nga shqyrtimi i observacionit tuaj si dhe fakteve të paraqitura, grupi i audituesve të KLSH konkludojë që: Edhe pse qëndron pjesa që nuk është kompetence*

e degës së thesarit për të kundërshtuar urdhër-shpenzimin kur institucioni bën likuidimin pjesorë, ky fakt ju heq nga përgjegjësia por në të njëjtën kohë nuk e rrëzon fenomenin dhe konstatimin e ngritur nga grupi i audituesve të KLSH në lidhje me pikën e pagesave pjesore. Si dhe për rastet kur kemi pagesat pjesore në tejkalim të afatit 30 ditë, duhet të ishin marr masa nga thesari bazuar në Udhëzimin Plotësues nr. 3, datë 17.01.2014, pika 32 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014" si më poshtë cituar"Kontratat e lidhura nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të paraqiten dhe të proçedohen në degët e thesarit të rrethit sipas kërkesave të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Në rast vonese, dega e thesarit proçedon me regjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë Nëpunësin e Parë Autorizues, i cili ndërmerr masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për paraqitjen me vonesë në degën e Thesarit të dokumenteve që vërtetojnë shpenzimet e kryera".

Lidhur me respektimin e procedurave të radhës së prioriteteve të pagesës (FIFO)

Sipas Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166 *"Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve të llogarisë së unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë dhe pika 167: "Me pas, struktura përgjegjëse për thesarin vijon me procedurën e grupimit të kërkesave për pagesë sipas rregullit të rregjistrimit kronologjik të urdhër-shpenzimeve në sistemin informatik financiar (hyrje e parë - dalje e parë)".* Referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u morën me testimin e gjithë popullatës së pagesave (Janar 2018 – Janar 2019), me një total prej 194,462 transaksione, vetëm duke marrë parasysh llogarinë 231, 602 dhe 466 në shumën 112,212,140 mijë lekë, ku u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të rregjistruara në data të mëvonshme. Me qëllim testimin e fenomenit në popullatën e zgjedhur u eleminuan faturat e energjisë, ndihma ekonomike dhe pagat të cilat konsiderohen si pagesa me prioritet. Llogaritë e zgjedhura janë shpenzime për mallra dhe shërbime. Nga popullata u identifikuan Drejtoria Aluizni Lezhë si njësia me numrin më të lartë të rasteve për periudhën Janar - Dhjetor 2018..
Situata për të gjithë institucione e paraqitur në tabelë:

Institucione Total — ***Në mijë lekë***

Viti 2018	Data e Pagesës													
Data e Krijimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar 2019	Total
Janar	1.569.175	458.760	752	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2.028.686
Shkurt	-	6.579.953	527.848	2.488	-	-	-	-	-	-	-	-	-	7.110.289
Mars	-	-	7.535.834	418.726	6.096	-	4	29	-	-	-	480	-	7.961.169
Prill	-	-	-	11.591.734	596.117	514	-	-	400	-	-	-	-	12.188.764
Maj	-	-	-	-	9.188.443	573.811	4.100	741	32.619	-	680	-	-	9.800.393
Qershor	-	-	-	-	-	6.868.611	350.317	6.299	153	-	-	-	-	7.225.380
Korrik	-	-	-	-	-	-	8.692.156	355.813	488	768	-	-	-	9.049.225
Gusht	-	-	-	-	-	-	-	6.359.262	263.783	2.792	78	-	-	6.625.915
Shtator	-	-	-	-	-	-	-	-	7.266.999	473.749	3.753	-	-	7.744.501
Tetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	9.189.972	650.737	992	-	9.841.701
Nentor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	7.669.897	616.066	-	8.285.963
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	16.403.825	5.812.625	22.216.450
Janar 2019	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2.133.703	2.133.703
Total	1.569.175	7.038.713	8.064.433	12.012.948	9.790.656	7.442.935	9.046.577	6.722.144	7.564.441	9.667.282	8.325.145	17.021.364	7.946.327	112.212.140

Paraqitja e situatës për Drejtorinë e Aluiznit Lezhë:

DREJTORIA ALUIZNI LEZHE

Në mijë lekë

	Data e Pagesës												
Data e Krijimit	Janar 2018	Shkurt 2018	Mars 2018	Prill 2018	Maj 2018	Qershor 2018	Korrik 2018	Gusht 2018	Shtator 2018	Tetor 2018	Nentor 2018	Dhjetor 2018	Total
Janar 18	112.585												112.585
Shkurt 18		190.607											190.607
Mars 18			362.976	489.032								479.870	1.331.878
Prill 18				38.194	202.274								240.468
Maj 18					44.478	550.792							595.270
Qershor 18						67.998	197.520		83.300				348.818
Korrik 18							89.996	184.275					274.271
Gusht 18								253.215	87.793	267.120			608.128
Shtator 18									258.056				258.056
Tetor 18										378.972			378.972
Nentor 18											405.662		405.662
Dhjetor 18												744.872	744.872
Total	112.585	190.607	362.976	527.226	246.752	618.790	287.516	437.490	429.149	646.092	405.662	1.224.742	**5.489.587**

Prandaj grupi i auditimit analizoi të dhënat dhe realizojë teste për këtë institucion, për gjithë vitin 2018 me shtrirje për të gjithë vitin Janar-Dhjetor, për të pasur një pamje më të qartë të situatës, ku ky fenomen del qartazi edhe nga paraqitja në tabelën e mësipërme, ku rregullisht në shumicën e muajve të vitit ka shtyrje në kohë të pagesave 30-90 ditë, paraqiten dhe vlerat përkatëse të faturave të shtyra dhe atyre të paguara ku duket qarte se vlera e fatures së shtyrë në kohë është e vogël dhe nuk ka të bëjë me kushtëzimin e limit ditor.

Komentet nga subjekti i audituar*:* Në kundërshtimet me nr.prot 5927/8, datë 26.08.2019 për akt konstatimin nr.2 datë 20.08.2019, ku citohet se.
sqarojmë se në zbatim të ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare" trajtohen vetëm vonesat e pagesave të pasqyruara në tabelën e mësipërme për muajin mars 2018 në vleren prej 479,870 mijë lekë, paguar në muajin dhjetor 2018; për muajin qershor 2018 në vlerën prej 83,300 mijë lekë, paguar në muajin shtator 2018; për muajin gusht 2018 në vlerën prej 479,870 mijë lekë, paguar në muajin tetor 2018; të cilat përbëjnë shtyrje në kohë të pagesave mbi 60 ditë [duhet korrigjuar në akt konstatim "30-90 ditë" në "**60-90 ditë**", duke konsideruar që nga totali i vonesave mbi 60 ditë (të dhënat në tabelën e mëposhtme) të përjashtohen njësitë e sistemit të shëndetësisë për të cilat ligji përcakton si detyrim të prapambetur vetëm vonesat mbi një vit/365 ditë].
Gjithashtu, shpjegojmë se përpara se të procesohet pagesa elektronike nëpërmjet SIFQ, procesi i kontrollit automatik të faturave kryhet kundrejt planit të thesarit (limitit) **mujor** të detajuar **sipas burimit të financimit** (kapitull 1-"Çelje nga buxheti", kapitull 2-Financim i huaj me sistem të plotë thesari, kapitull 3-Kosto lokale e projekteve me bashkëfinancim nga buxheti, kapitull 4-Pagesë TVSH-je për projektet e financimit të huaj të përjashtuar me marrëveshje dypalëshe, kapitull 5-fonde nga të ardhurat e veta, kapitull 6-fonde jashtë limitit nga legjislcioni specifik) në të cilin është regjistruar fatura në SIFQ. Për kapitullin 6 kryhet rritje e autorizuar e fondeve për shpenzim nga të ardhurat e realizuara të periudhës, kurse për kapitullin 1 çelja e planit në SIFQ është detajuar për çdo muaj në fillim të vitit (zakonisht aplikohet pjestimi i planit total me 12 muaj, duke anashkaluar ndikimet sezonale nga hartuesit/miratuesit e planit të thesarit (limitit) mujor, NA dhe NZ e njësisë shpenzuese). Për arsye të kësaj veçorie midis dy kapitujve, faturat e kapitullit 6 paguhen menjëherë me çeljen e totalit të limitit **ditor,** sepse kanë gjithmon plan në momentin e pagesës, kurse faturat e kapitullit 1 për muajin përkatës të vitit mund të mos kenë plan të detajuar në fillim vitit nga pjesa 1/12, duke u paguar kështu (megjithëse në vlera të vogla) pas faturave të kapitullit 6 (që mund të jenë sipas rastit në vlera relativisht të mëdha). Theksojmë se procesi i renditjes për pagese të faturave është automatik dhe nuk mund të

ndërhyhet manualisht nga struktura operacionale e Thesarit në degë dhe në drejtori, vetëm nga administratori i SIFQ.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Duke analizuar argumentimin e DPTH, shihet se nuk është dhënë asnjë shpjegim real mbi arsyet se pse nuk është aplikuar prioriteti i radhës së pagesave sipas *Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, aq më tepër që ky fenomen nuk është hera e parë që është konstatuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit . Në nivel makro referuar tabelës "Institucione Total" shohim se kemi fatura me datë emetimi muajin maj 2018 dhe pagesa e tyre shkon deri në vonesa si shtator 2018, ndërkohë që nga ana tjetër kemi fatura me datë emetimi qershor 2018 të cilat paguhen, edhe pse me vonesë, në korrik gusht dhe shtator 2018. Ky kundërshembull i cituar është vetëm për muajin maj dhe qershor, por shoqërohet dhe me muajt e tjerë te vitit 2018. Thënë kjo, dalim në konkluzionin që faturat me datë emetimi qershor 2018 paguhen më përpara se faturat me datë emetimi maj 2018. Kjo përbën një shkelje të hapur të pikës 167 të të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, dhe argumentimi i DPTH se është vecoria e kapitujve që ndikon në prioritetin e pagesës së faturave nuk justifikon faktin e pagesës së faturave më datë emetimi më të vonshme dhe paguhen me herët sesa faturat me datë emetimi më të hershme dhe që paguhen më vonë. Për këtë arsye argumentimi juaj nuk merret në konsideratë nga ana e grupit të auditimit.*

Gjetje:	***Lidhur me respektimin e procedurave të radhës së prioriteteve të pagesës (FIFO)***
Situata	Sipas Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166 *"Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve të llogarisë së unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë dhe pika 167: "Me pas, struktura përgjegjëse për thesarin vijon me procedurën e grupimit të kërkesave për pagesë sipas rregullit të rregjistrimit kronologjik të urdhër-shpenzimeve në sistemin informatik financiar (hyrje e parë - dalje e parë)".* Referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u morën me testimin e gjithë popullatës së pagesave (Janar 2018 – Janar 2019), me një total prej 194,462 transaksione, vetëm duke marrë parasysh llogarinë 231, 602 dhe 466 në shumën 112,212,140 mijë lekë, ku u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të rregjistruara në data të mëvonshme. Me qëllim testimin e fenomenit në popullatën e zgjedhur u eleminuan faturat e energjisë, ndihma ekonomike dhe pagat të cilat konsiderohen si pagesa me prioritet. Llogaritë e zgjedhura janë shpenzime për mallra dhe shërbime. Nga popullata u identifikuan Drejtoria Aluizni Lezhë si njësia me numrin më të lartë të rasteve për periudhën Janar - Dhjetor 2018.. Prandaj grupi i auditimit analizoi të dhënat dhe realizojë teste për këtë institucion, për gjithë vitin 2018 me shtrirje për të gjithë vitin Janar-Dhjetor, për të pasur një pamje më të qartë të situatës, ku ky fenomen del qartazi edhe nga paraqitja në tabelën e mësipërme, ku rregullisht në shumicën e muajve të vitit ka shtyrje në kohë të pagesave 30-90 ditë, paraqiten dhe vlerat përkatëse të faturave të shtyra dhe atyre të paguara ku duket qarte se vlera e fatures së shtyrë në kohë është e vogël dhe nuk ka të bëjë me kushtëzimin e limit ditor
Kriteri	Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166: Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve
Shkaku	Mos respektimi i kërkesave ligjore në trajtimin e prioriteteve dhe radhës së pagesës së faturave.

Rëndësia	E mesme

Mbi çlirimin e garancise se punimeve 5% para afatit ligjor ne total 4 raste me vlerë 8 milion lekë

Me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së transaksioneve për clirimin e garancisë për punime për investime, u morën në shqyrtim dhe, jane analizuar të dhënat e llogarisë 466 "Garanci të punimeve" nga databaza e pagesave të kryera gjatë vitit 2018, me burim sistemin SIFQ. Nga fusha "Përshkrimi" e këtyre pagesave konstatohen 29 raste me vlerë 22,947 mijë lekë të çlirimit të garancisë së punimeve (5%) nga llogaria 466 "Garanci të punimeve" në një afat të shkurtër kohor, menjehere ose në një periudhë kohore në me pak se 1 vit pasi është kryer marrja në dorëzim e punimeve, në kundërshtim me legjislacionin për punimet e ndërtimit. Referuar udhëzimit nr.3 datë 15.01.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar në seksionin "II. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit" në pikën 6 dhe 8 citohet;
" *6.Zhbllokimi i garancisë së kontratës bëhet pasi të jetë përfunduar plotësisht kolaudimi i punimeve,* ***ndërsa zhbllokimi i garancisë së punimeve bëhet pas kolaudimit dhe pas afatit të përfundimit të garancisë****. 8. Periudha e garancisë për punimet e ndërtim-montimit në objektet, publike dhe jopublike, të përfunduara,* ***fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve dhe zgjat nga një deri në dy vjet, gjë që përcaktohet në kontratë****, për veprën në tërësi a për pjesë apo procese të veçanta, në varësi të llojit të objektit, kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së punimeve të kryera".*
Pra garancia e punimeve çlirohet mbas një viti apo dy viteve në varësi të kontratës, nga momenti i akt-kolaudimit apo marrjes së certifikatës së defekteve gjatë periudhës së garancisë lëshuar nga institucioni përkatës. Nga analizimi i të dhënave numrin më të madh të rasteve të çlirimit të garancisë së punimeve (5%) nga llogaria 466 "Garanci të punimeve" në një afat të shkurtër kohor pas marrjes në dorëzim të punimeve e zë PIU Burimet ujore dhe të ujitjes me 5,797 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar 29 ***raste me vlerë 22,948 mijë lekë*** clirim garancie përpara afatit të përcaktuar paraqitet më poshtë:

Institucioni	**Furnitori**	**Numri i pagesave**	**Vlera në mijë lekë**
PIU Burimet ujore dhe te ujitjes	AK	1	5.797
Bashkia Vau Dejes	A L B G	2	4.773
Qarku Tirane	F	1	2.579
Instituti i Sigurimeve Shoqerore	I +	1	2.465
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	H	1	623
	K	1	1.225
Bordi i Kullimit Lezhe	A L B G	1	1.226
Bashkia Ballsh	E 007	2	887
ALUIZNI - Drejtoria e Pergjithshme	BNT E	1	48
	PC S	1	41
	S CO	1	491
	T 3A	1	139
Bashkia Himare	A	1	540
	E	1	172
Bashkia Permet	A L B G	1	492
Bashkia Elbasan	B SH.P.K	1	467
Tirana Parking	K I	2	219

Bashkia Kamez	S 2F	1	153
Universiteti i Tiranes	F	2	147
Bashkia Peshkopi	E	1	128
Universiteti "I.Qemali", Vlore	J Z	1	108
Universitet "E. Çabej", Gjirokaster	T-D	1	94
Bashkia Roskovec	A.K.M	1	72
Bashkia Dropull	S	1	44
INUK	I S	1	17
Totali		***29***	***22.948***

Komentet nga subjekti i auditurar: *Në kundërshtimet me nr.prot 5927/8, datë 26.08.2019 për akt konstatimin nr.2 datë 20.08.2019, ku citohet se.*

*1.PIU Burimet ujore dhe të ujitjes: pagesa është 5% i parë i 10% të **TVSH**-së të mbajtur për periudhën e garancisë së punimeve.*

2.Bashkia Vau i Dejes: 5% garanci punimesh për objektin "Gjelbërim i mjediseve publike të Bashkisë Vau Dejës" nga subjekti ALBG është paguar më datë 16.07.2018, sepse në pikën 27.1 të nenit 27 të kontratës nr. 70, datë 08.08.2017, sqarohet se garancia do ti jepet përfituesit 6 muaj pas akt kolaudimit, i cili mban datën 20.11.2017 (bashkëlidhur).

3.Këshilli i Qarkut Tiranë: pagesa për garanci punimesh është likujduar sipas kohës së përcaktuar në kontratë (bashkëlidhur urdhër shpenzimi datë 30.07.2018 që përmban të dhëna të detajuara për disa objekte për të cilat bëhet kthimi i garancisë me proces verbal kolaudimi përkatësisht datë 10.12.2014 dhe 07.07.2015).

4.Instituti i Sigurimeve Shoqerore: është pagesë garanci për paisje dhe zgjerim shërbimi sistemi "softëare". Gabimisht në rregjistrim te fusha "Përshkrimi" janë shënuar garanci punimesh.

5.Fondi i Zhvillimit Shqiptar: për objektin "Garanci për rehabilitimin e gjelbërimit anësor të rrugës" nuk është paguar kthimi i garancise 5% jashtë afateve pasi çertifikata e përfundimit të punimeve është në datë 28.12.2016, kurse urdhër shpenzimi mban datën 15.03.2018.

6.Bordi i Kullimit Lezhë: garancia 5% e punimeve për Albgarden në vlerën 1,226 mijë lekë është paguar më 19.03.2018, një vit pas akt kolaudimit të punimeve datë 27.02.2017 Në kontratën nr. 32, datë 13.02.2017 të Bordit të Kullimit Lezhë neni 9, shprehet se garancia e difekteve të punimeve çlirohet 12 muaj pas akt kolaudimit të punimeve (bashkëlidhur).

*7.Bashkia Ballsh: janë dy pagesa me datë kolaudimi **26.05.2016,** me datë likuidimi në urdhër shpenzim **08.10.2018**. Periudha e çlirimit të garancisë nuk është para një viti, para afatit, por është brenda afateve të kontrates, pasi është çliruar në periudhën 2 vjet e 5 muaj. Theksojmë se përshkrimi në SIFQ është lapsus pasi është regjistruar data 26.5.2018 në vend të datës **26.05.2016** (bashkëlidhur urdhër shpenzimi dhe akti i kolaudimit).*

8.ALUIZNI Drejtoria e Përgjithshme: është pagesë garanci për paisje dhe zgjerim shërbimi sistemi "softëare". Gabimisht në rregjistrim te fusha "Përshkrimi" janë shënuar garanci punimesh.

9.Bashkia Himare: numri dhe data e kontratave janë regjistruar gabimisht tek të dy çlirimet e 5% të garancive. Duhet:

1. *ALUERA i përket kontratës nr. 97, datë 09.11.2016*
2. *EREDA i përket kontratës nr. 112, datë 19.12.2016*

Si rrjedhoje, çlirimet e garacive janë bërë brenda afateve të përcaktuara në legjislacion.

10.Bashkia Përmet: nuk ka çlirim garancie para afatit për Investitorin Albgarden, sepse Akti i kolaudimit të punimeve (bashkëlidhur) është i datës 17.09.2016, por nga Bashkia Përmet gabimisht në urdhër shpenzimi ishte shënuar data 17.09.2017.
11.Bashkia Elbasan: çlirimi i garancisë për subjektin Blerimi sh.p.k. është bërë konform ligjislacionit pasi procesverbali i kolaudimit (bashkëlidhur) mban datën 14.10.2016, por nuk është vendosur në përshkrimin e faturës në sistem.
12.Tirana Parking: për këtë pagesë me urdhër shpenzim datë 18.06.2019 gjeni bashkëlidhur aktin e kolaudimit datë 05.06.2017, i cili nuk është shënuar në përshkrimin e pagesës në SIFQ.
13.Bashkia Kamëz: pagesë garancie me urdher shpenzimi date 14.11.2018 (bashkëlidhur) për objektin "Vijëzim rrugësh Kamëz 2015" që është shërbim me afat më pak se një vit.
14.Universiteti i Tiranës: Rektorati ka paguar 5% garanci punimesh me urdhër shpenzimin datë 02.07.2018 (bashkëlidhur) që përmban akt kolaudimin datë 09.05.2017, periudha mbi një vit në përputhje me legjislacionin.
15.Bashkia Peshkopi: pagesa për objektin "Sistemim asfaltim i rrugëve ku ka përfunduar ujësjellësi" nga furnitori E nuk është likuidim garancie. Në përshkrimin: "2106001 Bashkia sist asf rruge Gj.Doci,V Dibra pas përf ujësjellësit. Kontr 77/15 dt 22.11.2016,
Preventiv, Sit përfundimtar, Kontr shtesë 77/18 dt 16.03.2017, Sit përf, Fat 4 dt 22.01.2018, PV kolaudim dt 12.04.2018" ka vetëm një lapsus, PV kolaudimit ka datën 12.04.2017 (bashkëlidhur).
Likuidimi i garancisë për këtë investim është bërë konform rregullave më datë 11.06.2019, urdhër për shlyerje garancie datë 22.05.2018, PV marrje dorezim datë 22.05.2018, PV kolaudimi datë 12.04.2017.
16.Universiteti "I.Qemali", Vlorë: Numri dhe data e kontratës me Jonian Zaimi janë lënë pa regjistruar tek përshkrimi. Duhet: kontrata nr. 921/8, datë 03.12.2017. Si rrjedhojë, çlirimet e garacive janë bërë brenda afateve siç parashikohet në legjislacion.
17.Universiteti "E. Çabej", Gjirokastër: nuk është çlirim garancie, por mbajtje e garancisë së punimeve (4662104) për furnitor T-D në vlerën prej 94 mijë lekë.
*18.Bashkia Roskovec: 5% i garancisë së punimeve për objektin "Shpim pusi uji në fshatin Luar nga subjekti A.K.U. i paguar me urdhër shpenzimin datë 14.05.2018 (bashkëlidhur) përmban aktin e koladimit datë **03.04.2016**, regjistruar në sistem lapsus 03.04.2018, për rrjedhojë afati i çlirimit është mbi një vit.*
19.Bashkia Dropull: Për furnitorin S shuma 43,513 lekë nuk është çlirim garancie, por mbajtje e garancisë së punimeve (4662104).
20.INUK: është pagesë garanci për paisje dhe zgjerim shërbimi sistemi "softëare". Gabimisht eshte perzgjedhur nga KLSH-ja, sepse edhe në rregjistrimin në SIFQ te fusha "Përshkrimi" nuk është shënuar garanci punimesh.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, duke u bazuar vetëm ne dokumentacionin justifikues bashkëlidhur dhe dërguar me shkresën përcjellëse 5927/8 datë 26.08.2019, grupi auditimit merr në shqyrtim si më poshtë;
Rastet 2-4, 6-11, 14-20 pasi është verifikuar argumentimi i DPTH me dokumentat justifikues, argument ii DPTH qëndron**.**
Për rastin e parë **(PIU** Burimet ujore dhe të ujitjes) nuk na është paraqitur dokumentacion justifikues.
Në rastin e pestë referuar udhëzimit nr.3 datë 15.01.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar në seksionin "II. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 8, njeh si datë fillestare per fillimin e periudhës së garancisë datën e akt- kolaudimit dhe jo certifikaten provizore të përfundimit të punimeve. Për këtë arsye argumentimi i DPTH nuk merret parasysh.

Për rastin dymbëdhjetë, dokumentacioni justifikues i përket një tjetër kontrate (nr.1231 date 29.09.2016) dhe normalisht ka një tjetër proces verbal kolaudimi (nr.prot 780 datë 05.06.2017) dhe vlerë urdhër-shpenzimi 2,527,984 lekë kurse shpeznimi për të cilin është konstatuar nga ana jonë shkelja e afatit të shlyerjes së garancisë, nga fusha përshkrimi, ka numër kontrate në vazhdim 1230 datë 29.09.2016 dhe proces verbal kolaudimi me nr.prot. 780/1 dt 05.06.2017. Deri në paraqitjen e dokumentacionit përkatës të duhur, kjo kundërshti nuk merret parasysh.
Për rastin trembëdhjetë, nga ana e bashkisë nuk është paraqitur dokumentacion justifikues (kontrata e shërbimit) ku të cilësohet se garancia e këtij shërbimi do të clirohet në një periudh më pak se 1 vit nga data e akt-kolaudimit. Për këtë arsye kundërshtimi nuk merret parasysh

Gjetje:	**Mbi çlirimin e garancisë se punimeve 5% para afatit ligjor ne total 4 raste me vlerë 8 milion lekë në kundërshtim me kërkesat ligjore.**
Situata	Jane analizuar të dhënat e llogarisë 466 "Garanci të punimeve" nga databaza e pagesave të kryera gjatë vitit 2018, me burim sistemin SIFQ. Nga fusha "Përshkrimi" e këtyre pagesave konstatohen 8 raste me vlerë 8,016 mijë lekë të çlirimit të garancisë së punimeve (5%) nga llogaria 466 "Garanci të punimeve" në një afat të shkurtër kohor, menjehere ose në një periudhë kohore në me pak se 1 vit pasi është kryer marrja në dorëzim e punimeve, në kundërshtim me legjislacionin për punimet e ndërtimit. Nga analizimi i të dhënave numrin më të madh të rasteve të çlirimit të garancisë së punimeve (5%) nga llogaria 466 "Garanci të punimeve" në një afat të shkurtër kohor pas marrjes në dorëzim të punimeve e zë PIU Burimet ujore dhe të ujitjes me 5,797 mijë lekë.
Kriteri	Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", indryshuar Udhëzimi nr.1 datë 22.02.2005 Për disa shtesa në udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", të ndryshuar.
Impakti	Likujdim i parakohshëm i garancive të punimeve
Shkaku	Mos respektimi i kërkesave ligjore në trajtimin e garancive të punimeve.
Rëndësia	E Lartë

IV.4 MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Në zbatim të programit të auditimit pika 4 e tij, u kërkua informacion mbi statusin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në raportin përfundimtar për "Auditim përputhshmërie i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për vitin 2017" miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë Shtetit, përcjellë me shkresën nr. 706/8 dt. 3.10.2018 (prot i MFE nr.11445/9). Sipas këtij vendimi u lanë gjithsej 10 rekomandime nga të cilat sipas llojit: **1** masë për përmirësim legjislacioni**, 3** masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzime të realizuara në kushte të paligjshmërisë proceduriale **4** masa organizative, 1 masë administrative dhe **1** masë disiplinore. Në përgjigjen e mbërritur nga subjekti me shkrese nr. Prot.11445/9 subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka pranuar vetëm 6 rekomandime nga të cilat 3 rekomandime për masa për eleminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe 3 masa organizative. Nuk janë pranuar 1 masë për përmirësim legjislacioni, 1 masë administrative, 1 masë disiplinore dhe 1 masë organizative. Më hollësisht statusi i rekomandimeve paraqitet si vijon:

Në lidhje me propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi: Rekomandimi:1 *Me qëllim që e gjithë veprimtaria e Sistemit të Thesarit, të ketë një kornizë ligjore, bazuar në rregulla të qarta dhe pa interpretime, për shkak të natyrës specifike të tij dhe një procesi kompleks të financave të shtetit, qe mbart në vetvete të punohet për një kuadër të plotë rregullativ në përputhje dhe me kërkesat e rregulloret e Bashkimit Evropian, kjo edhe për të garantuar qëndrueshmërinë e këtij kuadri për një kohë të gjatë dhe të mos ndikohet nga situatat me të cilat ndeshet kjo drejtori në aktivitetin e përditshëm dhe problematik të realitetit shqiptar.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim në përgjegjësinë e subjektit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të dytin vit rradhazi nuk pranohet duke e konsideruar i panevojshëm marrja e një hapi të tillë për përmirësimin ligjor dhe rregullator të veprimtarisë së Thesarit citojmë "*Parimet e funksionimit të Thesarit rregullohen me Ligjin Organik të Buxhetit të shtetit nr. 9936, datë 26.06.2008, të ndryshuar me ligjin nr.57, datë 02.06.2016, akteve nënligjore të tij, si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet respektive"*, duke e lënë në po të njëjtën situatë veprimtarinë ligjore dhe rregullatore të Sistemit të Thesarit duke e lënë veprimtarinë e tij të bazohet ende në VKM nr.183, datë 16.04.1993 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të thesarit", *pavarësisht se kjo VKM e ka humbur koherencën rregullatore të saj, referuar ndryshimeve që ka pësuar ndër vite Sistemi i Thesari, automatizimit të proceseve në nivel njësie ekonomike dhe integrimi me sistemet e tjera të administrimit publik kërkon forcimin e rolit të kësaj Drejtorie, rritjen e mbikëqyrjes së veprimeve që kalojnë përmes Sistemit të Thesarit, dhe funksionimin e një filtri në ekzekutimin e pagesave dhe transaksioneve që kryen nëpërmjet sistemit të tij, duke parandaluar dhe mos lejuar pagesa të cilat nuk janë të rregullta nga ana financiare apo në kundërshtim me kuadrin ligjor.*

Në lidhje me masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzime të realizuara në kushte të paligjshmërisë proceduriale nga 3 rekomandime të lëna janë pranuar 3 të cilat rezultojnë të pazbatuara, argumentuar më hollësisht në vijim:

Rekomandim 1.1: Të merren masa për eliminimin e problematikave të konstatuara më sipër përmes vënies në funksionalitet të plotë të sistemeve të kontrollit të brendshëm jo vetëm si kontrolle detektuese por kryesisht si parandalues të situatave që krijojnë paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike. *Afati: menjëherë.*
Sipas DPTH integrimi midis SIFQ dhe sistemit të APP do të automatizojë procesin manual të konfirmimit nga degët e Thesarit (DTH) për në APP të ekzistencës së fondeve buxhetore (autorizimi i urdhrave të prokurimit-UP) dhe do të parandalojë prokurimin e kontratave pa fonde buxhetore disponibël ose pa fonde të mjaftueshme për shmangien e detyrimeve të prapambetura ("arrears"). Kur njësia shpenzuese (BI) të aplikojë në APP, atëhere sistemi i APP do të "pyesë" automatikisht SIFQ për vlefshmërinë e fondeve (ekzistencën e një transaksioni UP).
Qëndrimi i grupit të auditimit: Pavarësisht se DPTH shprehet se ka përfunduar dizenjimi i procesit të automatizimit, kjo procedure deri në përfundim të këtij auditimi nuk është ende funksionale dhe sipas DPTH parashikohet të jetë live në varësi të përfundimit të projektit AFMIS dhe plotësimit të kapaciteteve. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në process zbatimi.

Rekomandim 2.1: Të merren në analizë dhe të vendosen në kontroll të plotë të gjitha operacionet të cilat kryhen nga BI-online dhe që kanë shkaktuar pjesën më të madhe të problematikave të konstatuara, analizë që në gjykimin tonë duhet të konkludojë me një qasje më afër realitet shqiptar lidhur me këtë hapje të sistemit të thesarit. *Afati: menjëherë.*
***Sipas DPTH** parashikohet forcimi i kontrollit paraprak të UP me parashikimet e regjistrit të prokurimeve nga DTH (aktualisht kryhet manualisht) në zbatim të komponentit të AFMIS për*

regjistrimin e kodit të Output-it/Projektit edhe për shpenzimet operative duke mundësuar kontrollin me planit buxhtor të regjistruar në SIFQ. Monitorimi periodik (jo vetëm vjetor) i treguesve të performancës së BI për parashikimet e likuiditetit dhe dokumentacionin e parregullt të shpenzimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi në mënyrë që të sigurohet informacion i saktë për përgatitjen e rishikimeve të buxhetit gjatë vitit. Shkeljet e konstatuara i janë njoftuar dhe do t'i njoftohen menjëherë sekretarit të përgjithshëm për marrje masë disiplinore. Forcimi i kontrollit nga DTH në momentin e paraqitjes së dokumentacionit të angazhimeve dhe detyrimeve financiare për miratim në SIFQ në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për Buxhetin në drejtimet e mëposhtme:

- BI "online" me SIFQ të regjistrojnë detajimin e PBA në tre vitet e ardhshme për të mundësuar regjistrimin e vlerës së plotë të kontratës kundrejt fondeve disponibël në SIFQ.

- Monitorimi në kohë nga DTH për mbartjen nga BI e të gjitha projekteve të angazhimeve nga viti i mëparshëm për të bllokuar fondet buxhetore të çelura, duke respektuar ndjekjen e prioritetit të procesimit sipas rendit kronologjik dhe më pas regjistrimin e angazhimeve të reja. Kjo kërkon bashkëpunim me Buxhetin për regjistrimin në kohë të planit fillestar të miratuar në SIFQ.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Citimi i kontrolleve që faktikisht duhet të kryej DPTH dhe/ ose në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit janë të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi si në kushtet kur kontrollet janë të parashikuara të kryhen manualisht apo në mënyrë të automatizuar. Nga auditimi i aktivitetit të vitit 2018 thyerjet e sistemit dhe procedurave ligjore të miratimit dhe ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore janë të pranishme dhe të përhapura sic edhe janë përshkruar në këtë raport auditimi. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se edhe këtë vit DPTH dhe NPA është mjaftuar me disa njoftime për "tërheqje vëmëndje" të NA-ve të njësive ekonomike për dërgimin e faturave dhe kontratave me vonesë por në asnjë rast nuk është marrë nga NPA asnjë masë e vetme në zbatim të neneve 71 dhe 72 të Ligjit për menaxhimin e buxhetit. Ndërkohë nuk konstatohen hapa apo veprime konkrete të ndërrmara për të realizuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në lidhje me rregjistrimet në kohë të planit fillestar të miratuar në SIFQ. <u>Në këto kushte rekomandimi konsiderohet i pranuar por i pazbatuar.</u>

Rekomandim 3.1: SIFQ duhet të shërbejë si një sistemi themelor bazë për një programim sa më real dhe kredibël të buxhetit të shtetit si dhe si i vetmi sistem që raporton treguesit fiskal në vend, dhe për të arritur në këtë pikë strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për hartimin e buxhetit duhet të orientohen nga analiza e të dhënave që prodhon ky sistem dhe jo të dhënat e mbajtura jashtë këtij sistemi që nuk ofrojnë siguri dhe transparencë të kërkuar në menaxhimin e financave publike. Përgjegjëse: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për të dhënat e planit buxhetor; *Afati: menjëherë.*

Sipas DPTH Në zbatim të këtij rekomandimi për të gjeneruar të dhënat e programimit buxhetor nga SIFQ (aktualisht raportohen me excel) me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (DPB), Drejtoria e Procesimit të Biznesit ofroi mbështetjen funksionale me qëllim rakordimin e të dhënave të Buxhetit Operativ dhe Buxhetit Fillestar në raportin e tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar prodhuar nga SIFQ me të dhënat në tabelat e excel-it të disponuara nga DPB.Treguesit fiskal të prodhuar nga SIFQ, referuar realizimit faktik të zërave të buxhetit të konsoliduar gjatë vitit korent, kanë qenë dhe janë referenca e vetme mbi të cilën bazohen zyrtarisht analizat, vlerësimet dhe raportimet e njësive përgjegjëse në MFE, finalizuar më tej me proçesin e planifikimit buxhetor për vitin pasardhës. Në këtë këndvështrim, rekomandimi është i pabazuar. Ndërkohë, përsa i përket treguesve fiskal të prodhuar nga SIFQ referuar planit me ndryshime të zërave gjatë vitit korent, theksojmë se edhe në këtë rast analizat, vlerësimet, rakordimet dhe raportimet e njësive përgjegjëse në MFE bazohen në listën e raporteve të tjera, të gjeneruara po nga SIFQ për këtë qëllim. Rekomandimi mund të vlejë vetëm për një raport integral, atë të tabelës fiskale, i cili për efekt të bashkërendimit mes ngarkimeve tabelare të të

dhënave në SIFQ, pati nevojë për një rifreskim të formulave të përdorura për gjenerimin e konsoliduar. Kjo u realizua në vitin 2018 dhe reflektohet edhe në procesimin e vitit 2019 në SIFQ. Megjithatë, ritheksojmë këtu se, në asnjë rast, njësitë përgjegjëse në MFE nuk kanë përdorur rekorde apo database të mbajtura jashtë SIFQ, sic citohet në rekomandim, por i janë referuar gjithnjë serisë së raporteve të konfiguruara dhe të gjeneruara nga SIFQ.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nisur nga mangësitë e konstatuar në këtë auditim për aktivitetin e vitit 2018, ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar. Problematika të cituara në gjetjet e këtij raporti si lista e investimeve me reflektime jo të sakta të celjeve fillestare për disa projekte, rregjistrime të rishikimeve buxhetore dhe korrigjimeve me data retrospektive tregon që në SIFQ veprimet nuk hidhen gjithmonë në momentin e miratimit. Ecuria e investimeve si i vetmi raport që vërtetë gjenerohet nga SIFQ por nuk bëhet asnje verifikim, rakordim a përpunim i informacionit që ky raport paraqet me qëllim identifikimin e projekteve të përfunduara, të pezulluara për shkak të mungesës së fondeve etj.

Mbi Masat Organizative

Rekomandim 1.1: Kërkohet plotësimi i bazës rregullative për një qeverisje të kujdesshme të sistemeve të TI e cila në gjykimin tonë është një prioritet i lartë për sa kohë flitet për sisteme që kanë një rëndësi jetike për qeverisjen e vendit dhe shtetin në përgjithësi. Afati: *Brenda datës 01.07.2019*

Sipas AKSHI-t citojmë:"Plotësimi i bazës rregullative për një administrim të kujdeshëm të sistemeve të IT"

Rekomandim 1.2: Miratimi i Manuali i Teknologjisë së Informacionit.Afati: *Menjëherë*

Sipas AKSHI-t: Kryerja e ndryshimeve të nevojshme në emërtesa dhe miratimi i Manualit nga Titullari i institucionit. Si pasojë e ndryshimit të VKM Nr.673 dt 22.11.2018, për kalimin e të gjitha njësive TIK në administrimin e AKSHI-T, nevojitet kryerja e disa ndryshimeve në emërtesat e Manualit

Rekomandim 1.3: Plotësimi i vendeve vakant, si dhe krijimi i strukturave me një përbërje të përshtatshme referuar raportit drejtor/përgjegjës sektori/specialistë në përputhje me kriteret e Këshillit të Ministrave.

Sipas AKSHI-t: Është emergjent për vazhdimin normal të punës

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga përgjigjet e subjektit rezulton se asnjë nga 3 rekomandimet e pranuara nga AKSHI nuk është zbatuar.

Rekomandim 2.1: Të merret në analizë dhe të nxirren konkluzionet dhe arsyet e gabimeve sistematike në regjistrimin e shpenzimeve për çdo degë thesari dhe në veçanti për degët e thesarit me më shumë problematika. Të sistemohen të gjitha gabimet e konstatuara brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Afati: brenda datës 1.7.2019

Sipas DPTH: Sqarojmë se SIFQ nuk të lejon modifikimin e fushës "Përshkrimi" pas miratimit të faturës dhe specialisti i DTH nuk mund të ndërhyjë që të vendosi datën e saktë të faturës në fushën "përshkrimi" kur e ka konstatuar se është regjistruar gabim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi nuk është pranuar. Pavarësisht pamundësisë së korrigjimit pas faktit të gabimeve, numri i lartë i sistemimeve kërkon vëmëndjen e strukturave të DPTH në lidhje me njohjen e plotë të procedurave, funksioneve të sistemit dhe dokumentacionit për të gjetur shkaqet pertej gabimeve njerëzore.

Masa Administrative: KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 "*Menaxhimi i Angazhimeve*" dhe nenit 71 *"Kundravajtjet administrative"* të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, ndaj Nënpunësve Autorizues dhe Zbatues

në entet publike, duke analizuar rast pas rasti gjetjet e mësipërme, të reflektuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Sipas DPTH: Në lidhje me masat e ndërmarra sqarojmë se në zbatim të udhëzimit të kontabilizimit të detyrimeve të prapambetura sipas zërave analitikë (nr. 8, datë 09.08.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme") struktura përgjegjëse e Thesarit në degë rakordon çdo muaj me njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore, duke siguruar gjurmë elektronike për marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 "Menaxhimi i angazhimeve" dhe nenit 71 "Kundravajtje administrative" të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. DTH ka kryer kontrollin e dokumentacionit justifikues. Specialisti i DTH ka vendosur datën gabim në fushën e përshkrimit të faturës në të cilën nuk mund të ndërhyhet për ta korrigjuar. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka kërkuar nga përgjegjësit e DTH që të propozojnë masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi mbi specialistët përgjegjës për gabimet. Për vitin 2017 nuk ka patur propozime të tilla pasi nuk kanë qenë gabime të përsëritura.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi nuk është pranuar, megjithatë nisur edhe nga shkeljet, parregullsitë e konstatuara si dhe përhapja e tyre edhe gjatë vitit 2018, KLSH rikërkon zbatimin e këtij rekomandimi i cili nuk konsiston në marrjen e masave ndaj specialisteve të Degëve të Thesarit për gabimet në rregjistrim por për NA e institucioneve për autorizim të transaksioneve në thyerje të afateve ligjore.

Gjetje:	**Nga verifikimi i dokumentacionit dhe përgjigjeve të menaxhimit të DPTH dhe AKSHI rezulton se nga 10 rekomandime të lëna në auditimin e vitit 2017 janë pranuar vetëm 6 rekomandime nga të cilat vetëm 1 rekomandim është në process zbatimit dhe 5 rekomandime janë ende të pazbatuara**
Situata:	Në zbatim të programit të auditimit pika 4 e tij, u kërkua informacion mbi statusin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në raportin përfundimtar për "Auditim përputhshmërie i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për vitin 2017" miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë Shtetit, përcjellë me shkresën nr. 706/8 dt. 3.10.2018 (prot i MFE nr.11445/9). Sipas këtij vendimi u lanë gjithsej 1 masë për përmirësim legjislacioni, 8 masa organizative dhe 1 masë disiplinore
Kriteri:	*Ligji nr. 154/2014 dt.19.2.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" Neni 15 gërma j; Neni 16, pika 1; Neni 25 pika ç; Neni 30 pika 1 dhe 2*
Impakti:	Problematikat e konstatuara në DPTH vijojnë të ekzistojnë duke mos u marrë masat e duhura për përmirësimin e situatës, duke sjellë një impakt në disiplinën buxhetore.
Shkaku:	DPTH në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe NPA nuk ka marrë masat e duhura dhe mbetet në mosveprim.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nisur nga niveli i zbatimit të rekomandimeve si dhe ekzistenca e fenomeneve në thyerje të sistemeve të kontrollit të disiplinës buxhetore dhe fiskale, rikërkojmë pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pa pranuara si dhe të atyre të pranuara por të pazbatuara.

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të sistemit të thesarit për vitin 2017, bazuar në Sistemin informatik financiar të Qeverisë (SIFQ), nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit.

Opinioni i Auditimit mbi Përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se sistemi i thesarit, përgjatë të gjitha proceseve të ekzekutimit dhe raportimit financiar, për shkak të rëndësisë të anomalive të trajtuara në këtë raport, ka devijime materiale dhe të përhapura jo në përputhje me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr. 50 datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **opinionit të kundërt mbi përputhshmërinë.**

Baza për Opinionin

Procesi i ekzekutimit të buxhetit të shtetit nëpërmjet sistemit të thesarit nga të gjitha hallkat, rezulton me thyerje të përhapura të zbatimit të kontrolleve dhe masave parandaluese, detektuese, dhe korrigjuese që do të garantonin disiplinimin fiskal të sektorit publik. KLSH ka konstatuar që shumë nga masat dhe përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, eliminimin e mundësive për mos raportimin në kohë të shpenzimeve, dhe marrjen e angazhimeve financiare pa fonde buxhetore, në bashkëpunim dhe me FMN, kanë rezultuar joefikase dhe të pazbatuara. Entet publike vijojnë të mos marrin miratimin e Thesarit përpara fillimit të procedurave të prokurimit, dhe mos raportimin e saktë dhe në kohë të angazhimeve dhe shpenzimeve buxhetore. Gjithashtu u konstatua, që strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, megjithëse në dijeni të shkeljeve nga entet publike, si në rastet e shkeljeve të afateve të regjistrimit të angazhimeve dhe shpenzimeve, nuk kanë marrë asnjë masë administrative konkrete për të disiplinuar procesin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ndërkohë këto struktura kanë kontribuar në krijimin e mundësive për kapërcimin e kontrolleve si në rastin e mos regjistrimit të planit të buxhetor sipas PBA-së, lejimit të regjistrimeve të fragmentarizuar të urdhër- prokurimeve, kontratave, dhe faturave në SIFQ për shkak të mungesës së fondeve buxhetore disponibël.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin "Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë" të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për administrimin e sistemit të thesarit, në përputhje me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr. 50 datë 05.02.2017 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera

nënligjore në zbatim të tyre. Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit të enteve publike në sistemin e thesarit me kriteret e vlerësimit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse funksionimi i sistemit të thesarit nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të sistemit të thesarit për vitin 2017, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me sistemin e thesarit.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të regjistrimit, ekzekutimit dhe raportimit në sistemin e thesarit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT